

# BIBLIOTHECAE 3

Organ i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë



BIBLIOTEKONOMI

PROJEKTE TË REJA

DOKUMENTE

LEXIME TË REKOMANDUARA

HISTORI E LIBRIT DHE E SHTYPIT

2002

*Organ i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë*

**Nr. 3 Viti 2002**

*Botues:*

**PROF. AS. DR. AUREL PLASARI**

*Kryeredaktore:*

**ETLEVA DOMI**

*Redaksia:*

**Ramazan Vozga (sekretar)**

**Farfuri Xhaja**

**Maksim Gjinaj**

**Tefta Buzo**

*Këshilli botues:*

**Dr. Moikom Zeqo**

**Prof. As. Dr. Kaliopi Naska**

**Prof. Nasho Jorgaqi**

**Prof. Koli Xoxe**

**Dr. Kujtim Bevapi**

**Sherif Delvina**

**Aida Veliaj**

**Kujtim Dashi**

*Design & Layout:*

**Elzana Agolli**

© Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

*Adresa:*

**Biblioteka Kombëtare  
Sheshi "Skënderbeu" / Tiranë**

**Tel./ Fax. +355 257670**

**e-mail: biblioteka@abissnet.com.al**

**2002**

Shtypur në shtypshkronjën "Mësonjëtorja"

PI

122

**1922-2002**

**80 VJET**

**BIBLIOTEKË  
KOMBËTARE**



**80- VJETORI I BIBLIOTEKËS KOMBËTARE**

- Biblioteka Kombëtare në 80-vjetor 8
  
  - Themelimi i Bibliotekës Kombëtare 17
- 

**FIGURA TË ALBANOLOGJISË**

- Zef Valentini, brenda dhe jashtë tij 27  
**Dr. Moikom Zeqo**  
*Muzeu Historik Kombëtar*
  
  - Pal Petta: figura e një shkencëtari autoritar ndër albanologët e shek.XX 35  
**Prof. As. Dr. Aurel Plasari**  
*Biblioteka Kombëtare*
- 

**BOTIME**

- Leksikoni i shkrimtarëve shqiptarë 1501-2001 41  
**Kujtim Dashi**  
*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve*
  
  - Koleksionet e bibliotekës 46  
**Aida Veliaj**  
*Biblioteka Kombëtare*
- 

**BIBLIOTEKONOMI**

- Hyrje në formatin UNIMARC 49  
**Behije Luga**  
*Biblioteka Kombëtare*

- Nxitje zhvillimit të kulturës së komunitetit 75  
**Rob Davies**  
*MDR Partners, Londër (Angli)*
  
- Shërbimet e reja bibliotekare: akses i komunitetit në Internet 83  
**Ioannis Trohououlos**  
*Biblioteka publike qendrore e Verias (Greqi)*
  
- Spastrimi i koleksioneve bibliotekare 91  
**Ramazan Vozga**  
*Biblioteka Kombëtare*
  
- IFLA në 75-vjetor 94  
**Ermerina Kristani**  
*Biblioteka Kombëtare*
  
- LIBER 96  
**Etleva Domi**  
*Biblioteka Kombëtare*
  
- Sistemi i ISBN-së 98  
**Violeta Viso**  
*Biblioteka Kombëtare*
  
- Koleksionet po përjetojnë një shërbim të ri 101  
**Gjergj Shyti**  
*Biblioteka publike (Lezhë)*

**PROJEKTE TË REJA**

■ MEDLIB	105
■ BALKAN BIBLIOGRAPHY	105
■ VOIES ROMAINES EN MÉDITERRANÉE	105

---

**DOKUMENTE**

■ Statuti i Bibliotekës Kombëtare	109
■ Rezolutë e Glasgow-it për bibliotekat, shërbimet informuese dhe lirinë intelektuale	114
■ Deklaratë për bibliotekat dhe zhvillimet mbështetëse	116
■ Parimet e Kopenhagës	118
Rezolutë mbi zhvillimin e shërbimeve të bibliotekave publike shqiptare për komunitetin lokal	121
■ Rezolutë e Takimit të Drejtorëve të Bibliotekave Kombëtare të Vendeve të Europës Juglindore	123

---

**NGJARJE**

■ Në Bibliotekën Kombëtare përurohet salla "Paolo Petta"	125
■ Për herë të parë Dita Botërore e Librit në Shqipëri	128
■ Java e Gjuhës Italiane në Botë	129
■ Kontribut në realizimin e bashkëpunimit ndërinstucional Tiranë-Prishtinë	130

■ Konsultë për rikonstruksionin e « aneksit » të Bibliotekës Kombëtare	131
--	-----

---

### **VEPRIMTARI NDËRKOMBËTARE**

■ Prirjet bashkëkohore në biblioteka	133
■ Nxitja dhe mbështetja e identitetit të komunitetit, zhvillimit ekonomik, arsimimit dhe diversitetit kulturor	134
■ Bibliotekat publike në një Europë të re	135
■ Bibliotekat në shoqërinë e informacionit dhe teknologjive të reja	135
■ Sofie 2002	136
■ Në kërkim të dimensionit të humbur: MESDHEU	137

---

### **LEXIME TË REKOMANDUARA**

■ Recensione	138
■ Hyrje të reja	143
■ Website	154

---

### **TERMINOLOGJI**

■ Fjalor shpjegues nga fusha e bibliotekomisë	159
---	-----

# Biblioteka Kombëtare në 80-vjetor

---

**P**ër historinë gjithë valavitje të kombit shqiptar nuk është për t'u befasuar që shenjat e para të lindjes së kësaj biblioteke të bartin ngjyresë mirëfilli ushtarake.



Ato kanë të bëjnë me 16 prillin e vitit 1917, kur në Shkodër themelohej Biblioteka e Komisionit Letrar, e cila u quajt edhe “Biblioteka e Shqipërisë”. Zotërinjtë ideues të kësaj nisme, Gurakuqi, Mjeda, Peci, Logoreci, Mosi, Naçi etj., kishin në të vërtetë përpara vetes një shkresë të Shtatmadhorisë austro-hungareze, të datës 28.03.1918, që udhëzonte pikërisht organizimin e një biblioteke të tillë. Në gusht të 1919-s nisma shndërrohej në themelimin e “bibliotekës së shtetit” në Shkodër, ndërsa më 1920-n qeveria e sapovendosur në Tiranë themelonte ‘Bibliotekën Kombëtare’, të atashuar pranë Ministrisë së Arsimit, me një akt të nënshkruar nga ministri i asikohshëm. Në 1921 nisin edhe vendimet shtetërore për dërgimin e detyruar të kopjeve të çdo botimi shqip kësaj bibliotekë. Në këtë mënyrë hidheshin gurët e themelit të atij që tanimë do të duhet quajtur i pari institucion qendror kulturor i shtetit shqiptar: Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, e cila përurohej në nëntorin e 1922-it me një fjalë historike të të parit drejtor të saj, z. Karl Gurakuqi.

Tanimë, 80 vjet mbas, institucioni qendror kombëtar bibliotekar i vendit sjell një histori të vetën, e cila pret të hidhet në letër. Sido i rrethuar nga të tjera institucione kulturore gjithashtu qendrore, të themeluara në vitet ’30, ’40, ’50 apo ’60, ai mbetet në qendër të tyre. Jo thjesht për nga fati i vet historik, por si institucion ku janë përqëndruar gati të gjitha problemet e thepisura të shoqërisë bashkëkohore shqiptare: problemet e lirive të shoqërisë dhe atyre të individit, i lirive të informimit

dhe i atyre të shprehjes së mendimit, problemet e barazisë së shanseve dhe atyre të aksesit në shërbimin publik për një shoqëri të hapur, problemet e marrëdhënieve mes pushtetit politik dhe atij kulturor, dhe sa të tjera. Është e kuptueshme, në një pozicion si ky, që si institucion i quajtur “Bibliotekë Kombëtare e Shqipërisë”, ashtu edhe gjithë bibliotekat e tjera të rrjetit kombëtar bibliotekar në Shqipëri, të kenë nevojë, ndoshta më shumë se asnjëherë, për debate dhe rragatje mendimesh për t’i qëndruar si tani dhe 80 vjet trusnisë që vjen prej intolerancës, valës së opotunizmit dhe obskurantizmit, konformizmit, stereotipive banale sa i përket librit dhe rolit të pamë në jetën kulturore të një kombi.

Në momentin kur festojmë këtë përvjetor të 80, libri është së rishti në qendër të debateve në botën kulturore. Epoka e kibernetikës dhe e internetit, konkurrenca e informimit dhe formimit me anë të mjeteve të reja të teknologjisë informatike, deri edhe vetë *bibliotekat virtuale* bëjnë që libri të vijojë të jetë “i diskutuari i madh”. Ndërkohë që ai nuk lëviz nga vendi i tij si guri i themelit i fillimit të çdo kulture, vijon të vihet në dyshim fuqia e tij qëndrësore. Por, në bashkësinë e “punëtorëve të librit”, të gjithë janë të bindur se pa librat, historia do të ishte e heshtur, letërsia do të qe memece, shkenca do të çalonte, vetë mendimi njerëzor do të kishte mbetur në-vend-numëro. Pa librat, krejt zhvillimi i qytetërimit do të kishte qenë i pamundur. Si për njeriun e vjetër, ashtu edhe për njeriun modern librat janë shokë, miq apo, sikurse i quan një kolegia

jonë amerikane, “bankierë të pasurive të mendjes”. Pavarësisht konkurrencës së botës së magjishme të virtualitetit, librat vijojnë të jenë vetë humaniteti “in print” dhe kjo është një arsye e mjaftueshme për të pohuar me bindje rolin e pazëvendësueshëm dhe, njëherësh, të patjetërsueshëm të këtij institucioni qendror kulturor të shtetit shqiptar në 80-vjetorin e tij.

## Historiku

Ndonëse institucionet bibliotekare të shqiptarëve në shtetin e tyre janë relativisht të reja, tradita bibliotekare në Shqipëri është e vjetër. Dëshmi të shumta vërtetojnë se gjatë Mesjetës në oborret e princërve shqiptarë, si dhe të bujarëve, kontëve, arhonëve etj., funksiononin kancelari në të tria gjuhët diturore të kontinentit: latinisht, greqisht, sllavonisht e, pranë tyre, edhe bibliotekat përkatëse. Pozicioni gjeo-historik i shqiptarëve në zonën e kalimit nga Perëndimi në Lindje dhe anasjelltas u mundësonte atyre kontaktet librore si me Kostantinopojën, ashtu dhe me zhvillimet e “përtejdetit”. Cezura osmane që një ndërprerje e dhunshme e këtyre zhvillimeve. Megjithatë, edhe nga gati pesë shekuj sundimi osman, shqiptarët nuk e humbën traditën bibliotekare. Në kushtet e reja, ajo u përcoll kryesisht nëpërmjet bibliotekave të familjeve të mëdha, të pashallarëve e bejlerëve, por edhe atyre të institucioneve fetare: abacive benediktine, kuvendeve françeskane e jezuite, manastireve ortodokse, medreseve, teqeve të bektashinjeve etj.

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë (më tej BKSh), si institucion i parë shtetëror, publik e laik, mban për datë të themelimit të saj 10 Dhjetorin 1920. Si bërthamë e saj shërbeu fondi i bibliotekës së “Komisë Letrare Shqipe”, organizëm i përbashkët shqiptaro-austriak, e krijuar në qytetin e Shkodrës në vitin 1917 në kontingjencat e njohura të Luftës së parë botërore. Më 1920 ky fond u vendos në Ministrinë e Arsimit, Tiranë. Mbas vitit 1920 u bënë përpjekje për pasurimin e këtij fondi, si dhe për riorganizimin e bibliotekës si institucion kombëtar.

Në momentin e përrimitit si BKSh, 1922, ajo kishte rreth 6000 vëllime. Për periudhën e paraluftës, spikat veprimtaria e saj në vitet e Mbretërisë Shqiptare (1928-1937), kur institucioni drejtohej nga atdhetari dhe lëvruesi i gjuhës shqipe Sotir Kolea.

Mbarimi i Luftës II-të Botërore e gjeti BKSh me një koleksion prej 15.000 vëllimesh. Ajo u vendos në një nga ndërtesat më të mira të asaj kohe, e cila shërben edhe sot si “aneks” i saj. Koleksionet me karakter albanologjik u rritën kryesisht si rezultat i konfiskimit të disa librarive dhe bibliotekave private të personaliteteve të kulturës. Në fund të vitit 1947 fondi i saj numëronte rreth 100.000 vëllime. Ngjarje me rëndësi për BKSh, por dhe për kulturën kombëtare, ishte dalja më 31.05.1948 e dekretit «Mbi dërgimin e detyrueshëm të shtypshkrimeve Bibliotekës Kombëtare», sipas të cilit asaj i dërgoheshin falas një numër ekzemplarësh të çdo shtypshkrimi të vendit. Ky dekret i dha mundësi BKSh të kryejë rolin e qendrës arkivore të të gjitha botimeve të vendit dhe

të botojë më pas Bibliografinë Kombëtare të Librit Shqip. Dekreti është ndryshuar e plotësuar disa herë; varianti i fundit është ai i vitit 1992, sipas të cilit botuesit detyrohen t'i dërgojnë BK nga 5 kopje të çdo botimi të tyre. Nga institucion në vartësi të Institutit të Shkencave, në vitin 1959 BKSh kaloi në vartësi të Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës. Në vitin 1966 ajo u zhvendos në një pjesë të ndërtesës së re të Pallatit të Kulturës, ku gjendet dhe sot.

## Funksionet

BKSh është aktualisht insitucioni kryesor bibliotekar i vendit dhe qendër e rëndësishme studimore-kërkimore shkencore.



Ajo ka për detyrë të grumbullojë dhe të ruajë të gjithë trashëgiminë kulturore të shkruar të popullit shqiptar.

Ka karakter shkencor dhe njëkohësisht masiv. Ajo është :

- qendër e depozitimit dhe e ruajtjes së botimeve shqip;
- qendra kryesore bibliografike e vendit;
- qendër e studimeve në fushën e bibliotekonomisë dhe bibliografisë;
- qendër e përgatitjes dhe kualifikimit të vazhdueshëm profesional të personelit bibliotekar-bibliografik të vendit;

- qendër e ruajtjes së botimeve me karakter albaniano-balkanologjik;

- agjenci e ISBN-së për botimet shqip.

## Koleksionet bibliotekare


BKSh numëron në fondet e veta rreth 1 milion vëllime (libra, periodikë, harta, atlase, mikrofilma e materiale të tjera).

Fondi i arkivit të botimeve shqip, i antikuarit, i dorëshkrimeve, hartave, si dhe fondi i albaniano-balkanologjisë përbëjnë pasuri me vlera të mëdha për thesarin e kulturës kombëtare shqiptare e, si të tilla, të kulturës europiane.

**Fondi i Arkivit** përfshin botime me vlera të veçanta për pasurinë e shkruar të shqiptarëve, duke filluar nga botimet e para në gjuhën shqipe (shek.XVI) dhe duke vazhduar deri në ditët tona.

**Fondi i antikuarit** përbën një fond të posaçëm, shumë të rëndësishëm, jo aq nga numri i vëllimeve sa nga përmbajtja e tij. Në këtë fond ruhen botime të shekujve XV-XVIII, si dhe inkunabula.

**Fondi i dorëshkrimeve** përmban dorëshkrime në gjuhët orientale, si dhe një numër të vogël në gjuhët perëndimore dhe në shqip. Këto u përkasin shekujve XV-XX. Kjo pjesë fondi llogaritet me vlerë të jashtëzakonshme për kulturën shqiptare,



Dokumenti origjinal i Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, 28.11.1912



Nga fondi i Bibliotekës Kombëtare

por edhe në kontekst mesdhetar e të evropian. Aktualisht ai përfshin vepra në arabisht, në turqisht, në persisht dhe në dy ose tri gjuhë orientale njëherësh. Dorëshkrimet në gjuhët orientale kanë përmbajtje fetare, historike, gjuhësore, letrare, si dhe shkencore. Vlerësohen posaçërisht dorëshkrimet me tematikë historike, ndër të cilat “munsheatet” apo krestomacitë dokumentare (dokumente zyrtare apo letërkëmbime private), që trajtojnë ngjarje, përkrahajnë vende apo bëjnë fjalë



për persona të historisë së Shqipërisë. Në serinë e veprave letrare zotërojnë “divanet” me poezi erotike, shoqërore e fetare të autorëve të huaj. Vlera të veçanta paraqet ajo pjesë e dorëshkrimeve me miniatura e dekoracione.



*Në fondin e hartave*

të antikuarit ruhen harta me shtyp (riprodhime incizimesh në bakër), botime të vjetra me vlerë të hartografëve të shquar evropianë, nga shekujt XV-XVIII. Është fond burimor për studimet historike, etnografike, gjuhësore, gjeologjike etj. të

Shqipërisë dhe, më gjerë, të Ballkanit.

*Në fondin e albano-balkanologjisë* ruhen të gjitha botimet shqipe, si dhe ato të huaja, që flasin për Shqipërinë, shqiptarët dhe popujt e ndryshëm të Ballkanit, që trajtojnë historinë, gjuhën, folklorin, kulturën e tyre. Sot qendra e studimeve albanologjike është përqendruar në shtetin shqiptar dhe literatura bazë për këto studime ndodhet në këtë bibliotekë.

## Pasurimi dhe zhvillimi i koleksioneve

Koleksionet e bibliotekës pasurohen nëpërmjet *ligjit të ekzemplarit të detyruar, shkëmbimit, dhuratave dhe blerjeve*.

Politika e pasurimit të BKSht është drejtuar kryesisht në sigurimin e plotësisë së arkivit të botimeve shqip.

Drejtimit tjetër i politikës së pasurimit është njohja e botimeve me karakter albanologjik kudo në botë dhe gjetja e rrugëve e mundësive për sigurimin e tyre. Në sajë të marrëdhënieve të shkëmbimit me biblioteka të vendeve të ndryshme, BK është pasuruar me materiale me vlerë për fondin e albanologjisë. Duke pasur parasysh dhe natyrën universale të BKSht, ajo përpiket të sigurojë botime nga të gjitha degët e diturisë të karakterit referativ e informativ dhe që janë me interes për një numër sa më të madh përdoruesish.

Sa i përket raportit midis gjuhëve të literaturës së huaj, deri në vitet '70 zotëronte gjuha ruse, ndërsa më pas shpërndarja ka ardhur duke u përpjesëtuar në

mënyrë më racionale, drejt zotërimit të gjuhëve perëndimore: anglisht, frëngjisht, gjermanisht etj.

## Marrëdhëniet ndërkombëtare

Nëpërmjet *Sektorit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare e Publike* BKSht mban dhe kryen marrëdhënie dy- dhe shumëpalëshe me bibliotekat dhe institucionet e tjera homologe, si dhe punon për anëtarësimet dhe pjesëmarrjet e veta në veprimtaritë e organizatave ndërkombëtare. Pas ndryshimeve demokratike në Shqipëri ('90), BKSht është anëtarësuar në IFLA, CENL, CDNL, SEENL, GABRIEL, ELAG etj. Mbështetur në marrëveshjet dy dhe shumëpalëshe, si dhe në anëtarësimet ndërkombëtare e në lidhjet tradicionale me institucione dhe biblioteka të tjera, BKSht përpiket të ketë më shumë dhe më mirë bashkëpunim e shkëmbim me vende të tjera. Kontaktet e drejtpërdrejta kanë ardhur duke u çmuar gjithnjë më shumë, mbasi ato hapin dhe krijojnë mundësi të reja për të gjitha palët.

## Klasifikimi & katalogimi

Riorganizimi i fondeve në vitet e para pas Luftës II-të Botërore, njohja e rregullave unike të përshkrimit dhe e tabelave të klasifikimit, diktoi ripunimin e të gjithë literaturës dhe krijimin e skedarëve alfabetikë e sistematikë. Klasifikimi dhjetor universal (KDU) u vu në zbatim në vitin 1964 dhe vazhdon të

përdoret duke ndjekur të gjitha plotësimet e ndryshimet që i bëhen sistemit nga Federata Ndërkombëtare e Dokumentacionit (FID). KDU është sistemi që aktualisht përdoret në të gjithë rrjetin e bibliotekave në Shqipëri.

Standardet ndërkombëtare të përshkrimit bibliografik (ISBD) dhe rregullat anglo-amerikane të katalogimit (AACR2), BKSh i vuri në zbatim në vitin 1989. Katalogimi lëndor i literaturës ka filluar në vitin 1995, pas hartimit nga specialistët e BKSh të *Treguesit të Emërtimeve Lëndore* në gjuhën shqipe.

Sot BKSh ka një rrjet të gjerë skedarësh alfabetikë, sistematikë e lëndorë për të gjitha llojet e literaturës, si dhe kronologjik e gjeografik për një pjesë të tyre.

## Automatizimi

Në vitin 1994 në BKSh u instalua programi CDS/ISIS, siguruar falas nga UNESCO dhe filloi katalogimi në një sistem të automatizuar i hyrjeve të reja (libra). Ky vit shënon fillimet e krijimit të skedarit elektronik.

Tanimë është krijuar baza e të dhënave për botimet shqiptare dhe të huaja, e disertacioneve shkencore, si edhe e artikujve të periodikut shqiptar e të huaj. Realizimi i plotë i projektit të automatizimit u mundësua në sajë të mbështetjes financiare të fondacionit SOROS, PNUD-it dhe të qeverisë shqiptare. BKSh ka instaluar një sistem të ri të integruar bibliotekar; ky është sistemi ADLIB.

Instalimi i Internetit, që prej vitit 1998, ka bërë të mundur komunikimin me botën

duke realizuar një informacion të shpejtë, të saktë e të larmishëm. Së afërmi, nëpërmjet Internetit BKSh do të realizojë vënie në shfrytëzim të vlerave të rralla duke e bërë kështu informacionin të aksesueshëm për lexuesin shqiptar e të huaj.

## Botimet

BKSh boton periodikisht, që nga viti 1959, *Bibliografinë Kombëtare të Librit* që botohet në Republikën e Shqipërisë dhe, që nga viti 1961, atë të *Artikujve të Periodikut Shqip*. Fillimi relativisht vonë i veprimtarisë së organizuar bibliografike, ka diktuar nevojën e përgatitjes së bibliografive retrospektive si për librin ashtu dhe për artikujt e periodikut. Një pjesë e këtyre bibliografive janë botuar dhe disa të tjera janë në proces. Punohet për *Bibliografinë Retrospektive të Librit Shqip të viteve (1555–1958)*, që përfshin botimet nga libri i parë në gjuhën shqipe deri në fillimin e botimit të Bibliografisë Kombëtare të Librit Shqip.

Botim i rëndësishëm bibliografik është ai i *Librit Shqip të Botuar Jashtë Shqipërisë*, i cila ka filluar të realizohet nga viti 1981 dhe vijon periodikisht. Prej vitit 1969, BKSh merr pjesë në botimin bibliografik të UNESCO-s *Index Translatio-num*, ku paraqiten dhe përkthimet që botohen në Shqipëri.

Si qendër e ruajtjes dhe e shfrytëzimit të literaturës albanologjike, BKSh nga viti 1971 boton *Hyrjet e reja albanologjike në BKSh*.

Me specifike të veçantë është seria *Albanica* (shqip-anglisht), që njeh

studuesit me fondin albanologjik. Vëllimi i parë i saj përfshin libra të botuar në shekujt XV-XVIII, ndërsa i dyti botime të viteve 1800-1849. Janë në procesin e përgatitjes vëllimet në vazhdim.

Paraqet vlerë edhe seria bibliografike *Autorë të huaj për Shqipërinë dhe shqiptarë I,II*, ku paraqiten veprat e autorëve italianë (I) dhe francezë (II) që trajtojnë problemet e historisë, gjeografisë, etnografisë, kulturës shqiptare që prej shek. XIV e deri në ditët e sotme.

BKSh ka organin e saj profesional **BIBLIOTHECAE**.

Përgatit dhe boton tekste dhe manuale në ndihmë të bibliotekave të vendit.

## Shërbimi për publikun

Numëron çdo vit rreth 7.000 anëtarë dhe 90.000 frekuentues. Qarkullon mbi 100.000 materiale bibliotekare në vit. Është e hapur për lexuesit nga e hëna në të premte prej orës 08<sup>oo</sup> deri 20<sup>oo</sup> dhe të shtunën e të dielën prej orës 08.00 deri në orën 14.00. Lexuesit mund të huazojnë materiale ose t'i shfrytëzojnë ato në sallat e leximit. Ka dy pika të huazimit të literaturës (në ndërtesën kryesore dhe "aneksin" e vjetër) dhe pesë salla leximi. Të gjitha sallat kanë fond ndihmës me fjalorë, enciklopedi e materiale të tjera referative sipas profilit të tyre.

Materialet me vlerë të veçantë (arkiv, antikuar, dorëshkrime etj.) shërbehen në sallën e leximit të posaçme për to.

Dy sallat e leximit të shtypit periodik (korent dhe retrospektiv) janë me fonde të hapura. Lexuesit gjejnë në këto salla edhe informacion në CD-ROM për fusha



të ndryshme të shkencave.

Në ndihmë të lexuesve është zyra e informacionit, punonjësit e së cilës i orientojnë ata në gjithë aparatit informativ (skedarë, botime bibliografike, materiale referuese, INTERNET, katalog elektronik etj.).

Vend të veçantë në veprimtarinë e BKSh, sidomos pas viteve '90, zënë marrëdhëniet me publikun. Ajo organizon kolokuiume shkencore kombëtare e ndër-kombëtare, ekspozita, promovime botimesh me rëndësi kombëtare, konferenca me albano-balkanologë të ftuar nga jashtë etj.

## Mirëmbajtja dhe restaurimi

Gjendjen e materialeve bibliotekare, seleksionimin e atyre të dëmtuara dhe restaurimin e tyre e kryen një sektor i ngarkuar me këtë detyrë. Vjetërsia e materialeve dhe kushtet jo të përshtatshme të mikroklimës në mjediset e fondeve kërkojnë kujdes të vazhdueshëm në trajtimin e këtyre materialeve. Duke qenë qendra e vetme restauruese në vend e materialeve të tilla, BKSh kryen shërbime dhe për materiale me vlerë të veçantë që

gjenden në bibliotekat e tjera të vendit.

## Arsimimi dhe kualifikimi i vazhdueshëm profesional

BKSh është qendra e vetme e përgatitjes profesionale të punonjësve të bibliotekave të vendit dhe e studimeve në fushën e bibliotekonomisë e të informacionit bibliotekar. Nga viti 1969 ajo organizon rregullisht një kurs dyvjeçar për aftësimin profesional, i cili është i vetmi në vend për dhënie e njohurive bibliotekare e të infor-

macionit. Programi i këtij kursi rishikohet herë pas here me qëllim që të përfshihen në të zhvillimet e bibliotekonomisë.

Duke patur parasysh zbatimin e teknologjisë së informacionit në bibliotekat e sotme, si dhe zhvillimet e përgjithshme aktuale të bibliotekonomisë, që prej vitit 1999 BKSh ka ngritur *Qendrën e Trajnimit Bibliotekar*, të mbështetur edhe nga Fondacioni SOROS. Programi i kësaj Qendre përfshin kurse trajnimi për punonjësit e tërë sistemit të bibliotekave të vendit.

### THE NATIONAL LIBRARY OF ALBANIA IN THE 80-ANNIVERSARY

*The National Library of Albania, as the first state institution, public and laic, was founded by the Albanian government's decision in 1920. 1922 is held as its inauguration date.*

*Located in Tirana, it is currently the main library institution of the country and an important study-research scientific center. The NLA has the status of a cultural institution of national importance. It is its duty to collect and safeguard the written cultural heritage of the Albanian people. It has both a scientific and a public character. It is: center of the deposition and safeguarding of the Albanian publications; country's main bibliographic center; the study center in the field of library & information science as well as bibliography; center for librarian's education and continual professional training for all the country; center of preserving and safeguarding all publications of Albanio-Balkanological character; ISBN agency for Albanian publications; center of CIP (cataloguing in publication for books published within Albania).*

*The NLA collections count in its stacks about 1 million items (books, periodicals, maps, atlases, microfilms and other library materials).*

*The archive collections, the antiquary, manuscripts, maps as well as the Albanio-Balkanological collections constitute assets of great value for the treasure of the national culture and as such, of the European one.*





Nji përgjegje revistës "Drita" të Tiranës

## Themelimi i Bibliotekës Kombëtare

---

**K**ushti i parë i njij historije  
kasht vërtetsija, d.m.th. ai  
që merr në dorë të shkruiejë  
nji histori, lipset të ketë para  
sysh të vërtetën, t'i paraqesë  
sendet ashtu sikurse janë, pa  
bishtnime e pa shtrembnime, por  
tue u mbështetë në fakte të  
kontrollueme e të dokumentueme, të nxjerruna nga  
gurrat përkatse, qi, ndër të tjera, mund të jenë  
përmendoret, gojdhana, aktet e arkivavet, por  
edhe dishmitarët të cilvet mund t'u nxihet besë.

Kushti i parë i njëj historije asht vërtetsija, d.m.th. ai që merr në dorë të shkruetj një histori, lipset të ketë para sysh të vërtetën, t'i paraqesë sendet ashtu sikurse janë, pa bishtnime e pa shtrembnime, por tue u mbështetë në fakte të kontrollueme e të dokumentueme, të nxjerruna nga gurrat përkatse, qi, ndër të tjera, mund të jenë përmendoret, gojdhana, aktet e arkivavet, por edhe dishimitarët të cilvet mund t'u nxihet besë.

Kushti i dytë, jo ma pak i randësishëm se i pari, asht pa-ansija, d.m.th. duhet të parashtrohen ngjarjet pa i mbajtë pajë kuj, pa marrë anën e njënit apo të tjetrit; historishkruesi nuk lipset të jetë i shtymë nga mënija, nga urrejtja, nga partia apo nga interesa.

Shtypi i Shqipnis së sotme i përbuzë këto parime, i parashtron ngjarjet ashtu si i a kërkon interesa, tue i bishtnue së vërtetës, tue e shtrembnue, apo dhe tue heshtë ato pika qi nuk i bijnë për shtat. Shkruesit e atjeshëm, të gjith pa përjashtim, në çdo fushë, në daç historike, në daç letrare, janë gjithnji të shtymë nga paramendimet politike, nga mënija qi ushqejnë për njënin a për tjetrin, tue mohue meritime, tue përçmue vlefta, tue sjellë ujin në mulli të vet.

Ndër këto ditë na ra në dorë, mbas njëj vjeti të botimit, numri 8 (113) i së përjavëshmes tiranase "Drita" i ditës 24 shkurt 1963. Në faqen e parë të kësaj reviste shofim lajmin e njëj mbledhjeje kushtue 40 vjetorit (sic) të krijimit të Bibljotekës kombtare. Nxjerrim nga ky artikull se data e themelimit të Bibljotekës në fjalë na paska qënë vjeti 1923 dhe se drejtori i parë i saj na paska qënë Sotir Kolea. Na qi kemi qënë në krye të punvet dhe dishimitarë

të kësaj ngjarjeje së randësishme, i përgënjeshtrojmë me fakte në dorë këto pohime të pathemelta. Për ndriçimin e lexuesvet të "Shejzavet" por edhe për hir të së vërtetës, duem të bajmë në pak fjalë historinë e themelimit të këtij instituti kulturuer të vendit t'onë, tue u a mveshë meritimin atyne qi u përket.

Më 11 mars 1920 ushtria franceze, me në krye gjeneralin Bardi de Fortou, e la Shkodrën, qi e pat mbajtë nën sundim qysh prej vjetit 1918, atëhere kur Austriakët patën qenë tërhjekë nga qyteti. Po atë ditë mbasdreke krejt populli i Shkodrës, me të madh e me të vogël i primë nga Sulço Beg Bushati dhe Shuk Serreqi, i doli para te Ura e Bahçallekut, nën rrënojat e Kishës së Zojës së Këshillit të Mirë Ahmet Zogut, i cili, si ministër i Punvet të Mbrendëshme, n'emnin e Qeveris së Tiranës, mori në dorzim qytetin për t'a bashkue me trupin e At-dheut (1). I nënëshkruemi aso kohe vepronte si mis e sekretar i Komisis Letrare, e cila i kishte pasë vu themelet, nën drejtimin e Luigj Gurakuqit, njëj Bibljotheke albanologjike tue mbledhë veprat ma në shej t'albanologjis. Në njëj pjekje qi pat me Zogun, u poq mendimi për t'a shpërngulë në Tiranë bibljotekën e Komisis. Nuk vonoi shumë dhe ministri i atëherëshëm, Sotir Peci (2), me shkresë zyrtare, përcjellë me dy gisht letër private, i lutej të nënëshkruemit të gjente mënyrën për të sjellë në kryeqytet të gjitha orendit dhe arkivin e ish-drejtoris së përgjithëshme t'arsimit, e cila kishte pas veprue në Shkodër gjatë pushtimit austriak nën kryesinë e Luigj Gurakuqit, ashtu edhe bibljotekën e Komisis Letrare. Aso kohe mjete e transportit ishin të pakta e të pamjaftueshme; udhëtimi i njerzvet për

në Tiranë bahej me karrocë e zgjaste tri ditë të mira. Nuk mbetej rrugë veç ajo e dedit, por edhe kjo me shumë pengime. Zuna me qira një barkë të madhe me vela Ulqinakësh, e, nëpër Bunë e gjatë bregut t'Adriatikut, mbas tri ditësh e mbas tri netësh, mërrijta në Durrës. Prefekti i këtij qyteti, Rexhep Jella, u kujdesue për dërgimin e plaçkavet në Tiranë në ministrin e arsimit, e cila i kishte zyrat e veta në një nga shtëpijat e Selim Stërmasit në Rrugën e Postës. Ishte kjo një shtëpi katër kthinash të vogla sa me t'u marrë fryma, me dritore si biruca qi lëshojshin dritë sa mos me thye qafën, me pak orëndi, edhe këto të vjetrueme; në këto oda punojshin katër – pesë nëpunës: një sekretar, një protokolist, një arkivist, një shërbtuer e një... ministër. Në njënen nga këto oda u vendosën raftat me librat e sjellun nga Shkodra; këta qenë nisërza (fillimi) e asaj qi ma vonë muer emnin “Biblijoteka Kombtare”, qi do t'i hapte dyert në 28 nanduer 1922.

Mbas Sotir Pecit u zgjodh ministër i arsimit Rexhep Mitrovica, njeri i vullndetshëm, përparimdashës, me pamje të largta dhe nisjtuer punësh të dobishme. Në kohën e tij ministria e arsimit u shpërngul nga shtëpia e Selim Stërmasit, e padejë për një ministri, në shtëpinë e Abdi Toptanit, në Rrugën Pjetër Bogdani, e cila më vonë pat qenë ble nga Viansone, që e shëndroi në bujtinë me “Hotel Continental”. Shtëpia ishte e gjanë, me shumë oda, me një kopësht të madh përpara. Në pjesën

përdhese ishte një salon i madh nga ana e rrugës; këtu u vendosën librat e Biblijotekës s'arsimit, e cila kishte ardhë tue u pasunue me botime të ndryshme të bleme apo të dhurume; kujdesin e saj e pat i nënshkruemi, derisa kjo me 28 nanduer 1922 u përruue e mori emrin “Biblijoteka Kombëtare”. Në ket përrurim morrën pjesë të gjitha aktoritetet e vendit, tue fillue te ministrat, prefekti, kryetari i bashkis dhe një shumicë e madhe populli. Fjalimin e rasës e mbajti ministri i arsimit, Rexhep Mitrovica e, fill mbas tij, foli shkruesi i këtyne rradhve tue theksue rëndësin e biblijotekavet për kulturën e popullit. Drejtimi i biblijotekës m'u ngarkue mue përkohësisht derisa u emnue si drejtuer Visko Babatasi.

Prej sa u tha ma sipër, del në shesh se Biblijoteka pat qenë themelue në vjetin 1922 e jo në vjetin 1923, se drejtori i parë definitiv ka qenë Babatasi e jo Sotir Kolea si don me thanë revista “Drita”. Kolea e ka marrë në dorë drejtimin e saj ma vonë kur kjo pat qenë shpërngulë në shtëpinë e Toptanit në Rrugën Pjetër Bogdani, pranë njëj pjese së Shkollës Teknike Amerikane. Me këtë nuk duem me thanë se qeverija e Tiranës ka veprue ligëisht tue e dekorue Kolen me urdhnin e punës së klasës së parë, por jo si drejtuer i parë i Biblijotekës, por si puntuer i zellshëm qi i ka vu themele të shëndoshta këtij instituti kulturuer, i cili sot, sikurse po na tregon revista “Drita” ka 420 000 vëllime (numër i rumbullakët).

### Marrë nga “Shejzat”, Romë, 1964

1. Qeveria e Tiranës u formue me 30. I. 1920 me këta ministra: kryemin: Sulejman Delvina; i drejtësis: Hoxha Kadriu; i jashtëm: Mehmet Konica; i mbrendëshëm: Ahmet Zogu; i financavet: Ndoc Çoba; i arsimit: Sotir Peci; i luftës: Riza Kolonja.

2. Sotir Peci qe dy herë ministër i arsimit: a) prej 30.I. 1920 deri më 14 nanduer t'atij vjeti dhe b) prej 11.VII. 1921 deri me 16.X. t'atij vjeti.

## Bibliotekë Kombëtare.

Me gëzim të patreguar mësuam që Ministria e Arsimit themelojti një Bibliotekë kombëtare, edhe aq më shumë na shtonet gëzimi ynë kur se shohim që Biblioteka është vënë nënë përkujdesje të Z. Profesor M. Logareci, një nga më të mëdhenjtë e të vjetër përpjekjes të gjuhës amtare edhe çestjes kombëtare.

Duhat pra që të vrapojnë për një kohë nënë u pasun gjithë Shqipëria me 6000 vllime. tuar këtë Biblioteka Komtare

Mos të hme libra, ndërsa Mder kto dit erdhen nga Vlona oji Mos të hme libra, ndërsa Mder kto dit erdhen nga Vlona oji Mos të hme libra, ndërsa Mder kto dit erdhen nga Vlona oji

## Falënd

Në rastë të bukur të kremtimit të amurit komtar u bë shugurimi i Bibliotekës komtare, qi gjindet në Ministri t' Arsimit.

Urdhënuen plot zotni e Drejtori i Bibliotekës Z. Prof. Karl Gurakuqi bëjti një biscedë të bukur tue tregue historia e shkuritë të kësaj Bibliotekë, bërmetis të tjerve, dha:

Nat kohë kur popujt e botës ishin të përthym shoq me shoq; kur fatin e tynë dante pushka e gopedra: n' at kohë na, qi njerzimi i mbarë rrinte pezull e pritun mbarimiu e mizorivët të tjetës së përbotshëmë, Drejtorija e Bibliotekës e Arsimit i' asajë kohë; në dashituni të vërtetë, prej Z. Luigji Gurakuqit, e në dëshir të kulturës e t' Arsimit.

Me nderim  
R. MITROVICA  
MINISTRI I ARSIMIT

të ndershmit Deputetë të sotshëm të Shkodrës, tu: pamun nevojën e madhe qi Shqipnja, atdheu i ynë, kishte për një vend kë mendja detrehej e shpirtit t' ushqehet me njofime të duheshme, muer nisimëni e themelimit të kësaj ngrëftin kul.ore; të kësaj Bibliotekë, qi na sot kemi ardhun për t' a shugu ruemun.

Ndodheshim nën pushimit t' ushtrivët Austro Magjare kur në muin 1917, në një mbledhje që ato koha bani komisijsa letrare shqypte në shkodër, u pa me nevojë themelimi i njëj Bibliotekë e me 16 Prill t' atij moti i u shtin themelut e para. Librat e para qi e zuen themelin e hijshuen ket Bibliotekë të ru qenë ata të shtypun deri atdhe: të dy shpeshkrojt të Shkodrës: "Nikaj" e "Zotit t'ap'urpeme


Tue qenë se në një kohë të shkurtë u mltosh një sasi bukur e madhe librash, u pa nevojë qi për të mbajtin rregulltimin e tynë të shenohet një kufidestare për ket u zgjohi Z. Hil Masi qi qindrou për pak kohë, tue i a t'ishue vendin Z. Alois Norsci, i cilli me kujdes të matn e tregulltou me regjistra të duhuen e e pasunou me libra gjithfarësh. N' at kohë kjo Bibliotekë quhej e komisijs letrare.

Kur në vjetën 1918 u zhgaterue monarkija Austro Magjare e sundimin mbt Shkodër e muerën ushtrit Alcaie. Komisijsa letrare vijou në veprimet e veta, por me pjestar të tjerë.

Kur fati i Shqipnis e sull qi edhe Shkodra të bashkohej me qeverin komtare, Ministri i Arsimit i atdherëshëm. Z. S. Peci, sot antar i Këshillit të Naltë, dha urdhën qi Biblioteka të shperngulej në Tiranë e une vetë para ndërrin t' a bijsha ktu në ket qptit; e me 10 Korrik 1920. Biblioteka zfini vend pranë Ministris t' Arsimit, sikurse gjindet edhe sot, tue u shtrun Biblioteka e Shtetit.

Ministri i sotshëm. Z. Rexheb Mitrovica gjith dëshir për parimi t'arsimit, i dha fuqin ma të madhe Bibliotekës e munditini i tij nuk shkou kot, pse sot kemi fatin të shofim nga të gjitha anët tue na ardhun ndihma, kshru tu

# NATIONAL LIBRARY OF ALBANIA



# G U I D E

*On the 80th anniversary occasion, the president of the Republic of Albania  
Mr. Alfred Moisiu accorded to the National Library of Albania the title  
"Honor of the Nation".*



# Bibliotekës Kombëtare për 80-vjetor i jepet titulli “Nderi i Kombit”

**B**iblioteka Kombëtare festoi në dhjetor të vitit 2002 80-vjetorin e përrimit të saj. Në këtë ditë të shënuar për të, ajo afroi në mjediset e saj personalitete të kulturës, artit, shkencës dhe artit, lexues, ish-punonjës të saj, përfaqësues të medias etj.

Veprimtarinë e nderuan: kryetari i Parlamentit Shqiptar z. Servet Pëllumbi, Ministrija e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve znj. Arta Dade, përfaqësues të Presidencës, të trupit diplomatik të akredituar në Shqipëri etj.

Fjalën e hapjes e mbajti drejtori i saj, Dr. Aurel Plasari. Veprimtarinë e përshëndeti znj. Arta Dade.

Presidenti i Republikës z. Alfred Moisiu nderoi Bibliotekën Kombëtare në 80-vjetor me titullin e lartë “Nderi i Kombit”.

Në këtë ceremoni u dhanë çmime edhe për punonjës të BK dhe disa personalitete që kanë kontribuar në ecurinë e këtij institucioni.





## KARL GURAKUQI

(1895 - 1971)

U lind në Shkodër më 24 mars 1895 dhe vdiq në Bressanone (Itali) më 6 dhjetor 1971. Mbasi kreu disa vite shkollimi në Kolegjin Saveriane të qytetit të lindjes, kreu maturën klasike në Salzburg dhe studimet e larta në Universitetin Filozofik të Gracit (Austri). Që prej kthimit në atdhe, më 1917, deri sa u mërgua më 1944, kontribuoi dukshëm në fushën e arsimit, që nga mësimdhënia deri në organet drejtuese, me ndihmesë të veçantë në përgatitjen e teksteve shkollorë.

Sekretar i Komisionit Letrar Shqipe (1917), konkretizoi nismën e mbledhjes dhe ruajtjes së një biblioteke albanologjike e cila, me kujdesin e tij, u bë bërthamë e Bibliotekës Kombëtare. Me sjelljen e këtij fondi në Tiranë, pranë Ministrisë së Arsimit, iu ngarkua detyra e përkohëshme e drejtimit të saj. Me këtë funksion organizoi përrurimin e Bibliotekës

Kombëtare (28 nëntor 1922) dhe drejtimin deri në emërimin definitiv të drejtorit të ri.

Është, gjithashtu, autor i një publicistike të gjerë me tematikë të lakmueshme. Në fushën e përkthimeve, solli kontribute me vlerë në fushën e shqipërimit të literaturës albanologjike. Si leksikograf dhe mbledhës e përpunues i folklorit shqip ka merita të veçanta që prej hartimit të një skedari voluminoz të Fjalorit të Shqipes për Akademinë Austriake të Shkencave dhe deri tek hartimi i disa vëllimeve të korpusit folklorik "Visaret e kombit". Në Itali vijoi punën mësimore e shkencore si pedagog i shqipes pranë Katedrës Albanologjike të Universitetit të Palermos, ku bashkëthemeloi Qendrën e Studimeve Shqiptare. Së bashku me E. Koliqin dhe M. Camajn deri në fund të jetës drejtoi revistën e njohur "Shejzat".

(M. Gjinaj)



## SOTIR KOLEA

(1872 - 1945)

U lind në Berat më 1872. Në qytetin e Manastirit kreu gjimnazin grek. Më pas, në Egjipt gjeti një koloni shqiptare me tradita atdhetare e kulturore, e cila i dha mundësi të aktivizohet në shoqërinë “Vëllazëria”. Nëpërmjet shtypit mbrojti të drejtat kombëtare të shqiptarëve. Veprimtaria publicistike u bë veçanërisht e dendur në vitet e Luftës së Parë Botërore, kur në Gjenevë botoi revistën “L’Albanie”.

Gjurmimi dhe grumbullimi i pasurisë leksikore të popullit u kthye në një ambicie fisnike që e shtyu të punojë gjithë jetën, në Shqipëri dhe diasporë për mbledhjen e fjalëve të rralla dhe proverbave shqipe.

Më 1928, pas ftesës që iu bë për drejtimin e Bibliotekës Kombëtare, u kthye në atdhe. Për dhjetë vjet, në kushtet e

mjaft mungesave e vështirësive, bëri përpjekje për vënien e institucionit mbi baza profesionale. Hodhi hapat e parë të veprimtarisë të mirëfilltë bibliotekonomike në Shqipëri. Me përgjegjësi të veçantë punoi për sistemimin, mirëmbajtjen e shtimin e fondeve të bibliotekës. Në buletinet vjetorë të institucionit realizoi përshkrimin bibliografik të disa veprave tepër të rëndësishme të kulturës dhe shkencës shqiptare, duke filluar nga *Dorëshkrimi i Kostë Beratit*.

Deri në fund të jetës mbledhi burime bibliografike e dokumentare për historinë, etnografinë, folklorin dhe gjuhën e popullit shqiptar. Por la vetëm një vepër të përfunduar “*Një tufë proverbash*” (1944).

(M. Gjinaj)





## Mahir Domi

(1915 - 2000)

Për vite me radhë akademiku Mahir Domi ka dhënë ndihmesën e vet të çmuar edhe në fushën e zhvillimit të rrjetit kombëtar të bibliotekave dhe sidomos të Bibliotekës Kombëtare. Kjo ndihmesë është fare pak e njohur nga opinioni i gjerë, por tepër e njohur dhe e vlerësuar nga menaxherët dhe specialistët e këtyre institucioneve.

Në cilësinë e kryetarit të Këshillit Kombëtar të Bibliotekave-një ndër organizmat e paktë, në mos i vetmi, i ngjashëm me shoqatat apo organizatat e sotme, që shteti monist kishte lejuar të ngrihej - zoti Domi, si intelektual i shquar, diti ta shfrytëzojë atë në të mirë të kulturës shqiptare dhe të librit shqip.

Nëpërmjet atij Këshilli, Shqipëria kishte aderuar në Federatën Botërore të Shoqatave të Bibliotekave (International Federation of Library Associations-IFLA). Materialet e IFLA-s, si një ndër burimet e pakta të lidhjeve profesionale me botën e komunitetit tonë bibliotekar, trajtoheshin me seriozitetin më të lartë nga zoti Domi, i cili

këmbëngulte që ato të shiheshin me kujdes dhe të zbatoheshin në praktikën tonë bibliotekare.

Në porosinë dhe në fjalën e tij të mençur ndihej përherë sintaksa e pastër dhe e saktë shqipe, e harmonizuar me shqetësimin e intelektualit që i dhimbte libri, Biblioteka dhe kultura. Vizionet e tij të qarta, intelektualiteti në trajtimin e problematikave të bibliotekave shqiptare shpesh, sado që nën trystinë e politikës së kohës, ishin një përprjekje për të sjellë me vete konceptime europiane dhe demokratike.

Dekorata e lartë me të cilën u nderua akademiku Mahir Domi është shprehje e konsideratës që shoqëria shqiptare dhe komuniteti i bibliotekarëve ushqejnë për këtë personalitet të shkencës dhe kulturës shqiptare, posaçërisht për ndihmesën në zhvillimin e sistemit kombëtar të bibliotekave, dimension ky që e bën më të plotë portretin e tij si njeri dhe figurë shoqërore.

(R. Vozga)

- 
- Zef Valentini, brenda dhe jashtë tij 27
  - Pal Petta: figura e një shkencëtari autoritar ndër albanologët e shek. XX 35
-



## Zef Valentini, brenda dhe jashtë tij

**Dr. Moikom ZEQO**

Muzeu Historik  
Kombëtar

---

**Z**ef Valentini është jo vetëm një emër emblematic, dijepërhapës dhe kulturëpërcjellës. Ky emër ka koncentruar një materie të dendur shkencore.

Të jesh brenda tij do të thotë të ringjallësh hulumtime të ngjashme, të jesh jashtë tij, do të thotë të tejkalosh arritjet diturake, kulturologjike, gjë, që në thelb, është të rikthehesh prapë tek ai. Kështu emri i Zef Valentinit është një medium ndërmjetës, i pashmangshëm, ai mund të quhet një mentor shpirtëror i raporteve të Shqipërisë me Venedikun në shekuj, ai është gjithashtu një rojtar grifon i një thesari ende të pazbuluar plotësisht. Koncepti i burimologjisë së dokumenteve nuk mund të shkëputet nga akribia ballafaqese, kritikizmi i shumë niveleve. Para se të artikuloj atë që duhet thënë për Valentinin, një dishepull vëllam i tij, i ndjeri miku im Injac Zamputi, e kreu në heshtje, me modesti spartane, një vepër kolosale shqipërimesh të dokumenteve të Venedikut në lidhje me Shqipërinë, pra, bëri In Memoriam për Valentinin gati anonimisht.

Po pse është kaq e rëndësishme të flasim për dokumentacionin e Venedikut me Shqipërinë?

Venediku ka përfaqësuar lidhje tepër të hershme me bregun lindor të Adriatikut.

Studimet për të ashtuquajturën Shqipëri venedikase janë në një fillim. Ky fthillëzim është i domosdoshëm, jo vetëm në rrafshin shkencor historik, por sidomos në rrafshin kulturor. Kornizat konvencionale të formulave për tema studimore janë mjete ndihmëse jo për t'iu larguar thelbit dhe për të mbetur në sipërfaqe. Është shumë e rëndësishme dhe jetike optika konceptuale e problematikës. Ideologjizimet, apo tendencat e purizmit etnik, tashmë, janë të tejkaluara. Në një farë kuptimi, mund të paraqesin një lloj historie ekumenike të

raporteve të Shqipërisë mesdhetare me Venedikun për një periudhë jashtëzakonisht të gjatë, ku edhe limitizimi i pesë shekujve nuk është plotësisht i saktë, sepse, me të drejtë, mendimi hulumtues rikthehet akoma më hershëm në kohë dhe në hapësirë. Ka një prirje të një mesjetarofilie, gjë që padyshim, është një kufizim, gjithashtu konvencional për të parë ndërthurrjet, madje dhe osmozën e lidhjeve të Shqipërisë me Venedikun, kryesisht në epokën mesjetare, madje mesjetare të vonë, deri tek epoka inkandeshente e Rilindjes Italiane. Unë do të guxoja të tërhiqja vemendjen për periudha akoma më të tejlashta.

Të gjithë e dimë shprehjen e famshme të Horodotit ("Historia") (I,196) për pjesën verilindore të Italisë, ku jetonte fisi i quajtur "Enetë Ilirë". Hershëm janë bërë identifikime të enetëve me venetët. Kështu, disa ekspertë të vjetër filologë krijuan një ekuacion jo vetëm historik, por edhe etnik të venetëve me ilirët. Kështu mendonte Karl Pauli. Sipas tij depërtimi i ilirëve në Itali madje edhe në Italinë e Mesme dhe Apuli ka qenë të paktën që në epokën e hekurit. Por këtë mosmarrëveshje të enetjëve të Herodotit me venetët, e shpjegoi për herë të parë Hans Krahe që në vitin 1939. Më vonë hulumtimet arkeologjike, analizat e onomastikës së venetjëve si dhe gjuhës së tyre, treguan se bartësit e kulturës Este, siç e quajnë arkeologët nuk mund të posedonin karakterin ilir. Ky saktësim nuk duhet të na bëjë skeptikë për praninë e ilirëve, sidomos të fiseve japikë e mesapë në Itali. Studimet e mikut tim, arkeologut italian D'Andria e vërtetojnë këtë gjë, për t'i

shpëtuar komplekseve apo miteve tabu akulturologjike.

Si arkeolog mund të them se monumentet mbishkrimorë apo të arkitekturës, apo, dhe të artit të epokës venedikase në Shqipëri, në bregun lindor të Adriatikut ende nuk janë studiuar dhe nuk janë vënë në qarkullimin shkencor. Këto monumente janë absolutisht të rëndësishme. Mund të them se epiqendra e hulumtimeve duhet të jetë qyteti i Durrësit, që ka qenë gjithashtu koncentrimi i formacionit të quajtur Dukati Venedikas. Gjithashtu, guxoj të them se, studimi i arkitekturës së kështjellave të Shqipërisë bregdetare ka vulën e përcaktuar të kulturës venedikase jo vetëm në Durrës, në Lezhë, në Shkodër, në Ulqin, në Budva dhe Kotorr, por edhe në Berat dhe Gjirokastër. Unë vetë kam zbuluar disa emblema në relief të luanit të Shën Markut në të gjitha këto pika. Luani i Shën Markut dokumentohet dhe në afreskat tashmë të zhdukura siç qenë ato në shtëpitë kështjellore të Gjirokastrës, që i dëshmon saktësisht në shek. XVII edhe Elvija Çelebiu.

Ky material i shumtë nuk mund të shkëputet nga një koleksion i pasur i strukturave të skulpturuara të puseve venedikase sidomos në Durrës dhe në Shkodër, padyshim edhe në Lezhë. Ky kapitull nuk duhet mbyllur, por duhet hapur, sepse kemi të bëjmë jo vetëm me kulturën e jetesës, por edhe me motive të artit, madje dhe të heraldikës.

Kapitulli dokumentar shkrimor i lidhjeve të Shqipërisë me Venedikun është një pasuri kolosale. Kjo pasuri nxjerr në dritë disa çudi juridike siç janë Statutet e Shkodrës të botuara nga mikja e mirë dhe

e ditur e Shqipërisë, Prof. Lucia Nadin.

Nga zbulimet arkeologjike në qytetin e Durrësit, do të ndalesha në dy qeramika të gllazuruara me figura femrash, me ngjyra, që duhet ta kenë burimin në Venedik. Këto qeramika i përkasin shek. XIV dhe janë gjetur në kullën D të kështjellës së Durrësit para shumë vitesh. Unë i kam botuar këto qeramika dhe kam shprehur mendimin se arti i portreteve të këtyre dy femrave në shek. XIV është një art i lartë, me ndikime rilindase, shumë më përpara artit të shkëlqyer postbizantin, por gjithashtu, sipas skemave të paluajtshme të gjenit piktorik Onufri në shek. XVI, pra dy shekuj më vonë.

Këto dy qeramika, që tregojnë femra në profil, me frizurën e flokëve si dhe kezat mbi kokë, shprehimisht tregojnë që në Durrës frymëmerrte një art jashtëzakonisht i përparuar, që fthillëzohej nga Venediku dhe që kish gjetur mirëkuptim dhe parapëlqim tek banorët e Durrësit. Ky është një art laik, ndonëse dihet zotërimi tepër i madh i artit kishtar në këtë lak kohor. Arti piktorik i qeramikave është dhe një shprehje e veçantë e një kultivimi fisnik plot nuanca dhe nojma i mënyrës së jetesës në Durrës dhe interlandin përfaq.

Tërheq vëmendjen për dy rrafshë të mëdha studimorë: së pari për gjetjet e veprave të bëra nga qelqi Muranës, që dëshmojnë në bregun shqiptar të Adriatikut, kryesisht në qytetin e Durrësit dhe, së dyti, për ndikimin e shkollës ikonografike, që njihet me emrin shkolla "Kreto-Venedikase". Kjo shkollë ikonografike ka lënë gjurmë tepër të lexueshme në ikonografinë mesjetare shqiptare dhe

përfaqëson një ndërmjetësi të veçantë të kulturës kishtarë të përbashkët midis Shqipërisë dhe Venedikut. Kjo temë është tepër e gjerë dhe hulumtimet për të kanë qenë dobiprurëse, krahasimtare dhe, njëkohësisht, sintetike.

Shekujt XIV, XV dhe XVI janë shekujt e osmozës dhe të interesave të përbashkëta. Një nga kryeveprat e kulturës shkrimore, që lidhet me emrin e kryehumanistit shqiptar, priftit të Shkodrës Marin Barleti, është botuar në Venedik. Botimet e shqiptarëve në Venedik janë të shumta. Venediku është vendi, ku shkëlqeu dhe piktori me origjinë shqiptare Mark Bazaiti, bashkëpunëtori i Alvisa Vivarinin. Venediku është poli italian i Europës për shqiptarët. Ky pol nuk e humbet rëndësinë e vet edhe në shek. XVII kur shqiptarët e Elbasanit botojnë në Venedik akuilthe etj., kushtuar Gjon Vladimirit. Zhbirimet e ardhshme do të na rezervojnë të papritura të mëdha.

Kam lexuar disa shkrime të Giannino Mastrinaridit për studimin e emigrimeve të shqiptarëve në Venedik në vitet 1272, 1388, 1393 etj. Ekzistenca dhe fuqizimi i komunitetit shqiptar në Venedik, sidomos pas rënies së qytetit kështjellor të Shkodrës është një fakt tashmë deri diku i studiuar. Mastrinaridi përmend një poemë venedikase të vitit 1500 të quajtur “Qerthulli i çuditshëm”, shkruar nga Aleksandro Caravio. Në këtë poemë gjendet dëshmia e pranisë shqiptare në Venedik. Në poemë janë edhe këto rreshta : “Ho fatto zuffi e la miecra d’ariento, le gambe sotto me e s’infiga...”, “El va mananando cofa in le onde el schifo, co la so miecra e mustachi de

gato...”, “... co la so miecra e rizi petenao”.

Por më të rëndësishme janë fjalët e veçuara, të futura në dokumentet latine e venedikase, të përfshira në veprën madhore “Acta Albania - Veneta saeculorum XIV et XV”.

Kontaktet e raportet mesjetare, jo vetëm ato tregtare të Venedikut me Shqipërinë, janë të njohura. Republika e Venedikut arriti disa përparësi të paktën nga shekulli XI, kur edhe nisën organizimet bashkiake në Shkodër, Lezhë e krahina të tëra shqiptare. Në disa nga aktet e botuara nga Zef Valentini për të cilin do flas më poshtë, të paktën që më 1301, shumë më herët se sa dëshmitë e ekzistencës së shkrimeve shqipe, gjen fjalë të ndryshme, emra njerëzish dhe vende shqiptare.

A. Guzzeta, ka studiuar shprehjet shqipe në shek. XV në dokumentacionin e epokës. Në listat e tij ai ndalet sidomos te mbiemrat, që pak a shumë në dialekt venedikas e zbulojnë origjinën e tyre shqiptare.

Por kryemjeshtri i botimit të dokumenteve venedikase për Shqipërinë është padyshim i paharruari Zef Valentini. Nga thellësia e zemrës unë mund të shprehem: Nderim Zef Valentini! Do të ishte jo vetëm honorifike, por edhe morale si dhe mirënjohje e madhe, që Shqipëria të kish festuar 100-vjetorin e lindjes së tij para 3 vjetësh. Shkrimet e pafundme e librat e botuar nga Valentini përbëjnë një korpus të pashembullt. Ai është nga albanologët më të mëdhenj të të gjithë kohërave dhe me të drejtë, poeti dhe dietari Martin Camaj e vlerëson Valentinin jo vetëm “Historiani më i madh i kohës, jo vetëm i Shqipërisë,



por një ndër më të mëdhenjtë e Gadishullit Ballkanik”. George Shtadtmyler e vlerëson kryeveprën e Valentinit “Acta Albaniae Veneta” si shprehje të mahnitëshme të këmbënguljes së tij të famshme për erudicion.

Zef Valentini duke mos qenë etnikisht shqiptar iu afrua kulturës dhe gjuhës shqipe më në substancë se sa vetë shqiptarët. Ai përfaqëson tipin e klerikëve humanistë të kulturës baroke, enciklopedike si askush tjetër. Kryesore për njohjen e veprimtarisë së Valentinit është padyshim bibliografia e shkrimeve të tij paraqitur për herë të parë nga dijetari i ndërjerë Vinçens Malaj. Për të ka shkruar edhe Vili Kamsi. Në Arkivin e Shtetit është gjithashtu një dokumentacion i hatashëm prej njëmijë e ca referencash, përpiluar prej Zef Valentinit për Historinë e Shqipërisë. Do ishte kuptimplote një skulpturë e Valentinit në Muzeun Historik Kombëtar. Valentini me botimin e koleksionit të mahnitshëm të dokumenteve është prijëtar dhe pishartregues si dhe udhëhapës, njësoj si Farlati, Shuflai, Jireçeku etj. Të vjen keq që ka kaluar më shumë se gjysëm shekulli dhe s’kemi asnjë botim kushtuar Valentinit në Shqipëri apo

ribotime jetike referenciale të veprave të tij të panumërta. Besoj se puna e tij mund të quhet strukturë treguese dhe shembullore për tërë hulumtuesit e ardhshëm. Interesat e Valentinit janë polivalente dhe të shumëfishta. Ai njeh shkëlqyeshëm fondet burimore, dokumentacionin shkrimor; ai studion kanunet e popullit shqiptar, folklorin, krijimtarinë artistike, pikturën religjioze, muzikën, madje dhe kinematografinë dhe eseistikën letrare moderne. Ai është autori i shumë syzheteve, madje dhe i rikonstrukcioneve arkitektonike të kishave të Shqipërisë, siç është ajo e Shën Stefanit brenda kështjellës së Shkodrës.

Prirja për një klasifikim të krijimtarisë së Zef Valentinit është e natyrshme, e vetkuptueshme. Vepra suma sumarum e Valentinit ka disa horizonte apo rrafshje, që në realitet janë të ndërfutura dhe të ndërlidhura me njëra tjetrën. Çdo klasifikim ka pak simplifikim. Megjithatë unë do të bëja këto veçime:

## Studimet e Valentinit për botën ilire

Në 1939 në revistën “Leka” Valentini boton një studim numizmatik për koleksionin saverian në Shkodër. Ai flet për monedhat e mbretërve ilirë, Balleos, Gentius, për monedhat e Scodras, Apolonisë, Dyrrachiumit, por edhe për monedhat mesjetare të qyteteve arbërore si Scutari, Drivastum, Dulcigno (Ulqini) etj.

Në 1939 në revistën “Numismatica” në Romë Valentini boton një studim tjetër për monedhat ilire. Bashkëpunimin me këtë revistë e vazhdon për disa vjet dhe boton

studime të veçanta për një monedhë të quajtur “follar të Manfredit të Hohenstau-fenit”, si dhe për një monedhë të qytetit ilir Amantia.

Në një vëllim të Universitetit të Palermos më 1956, Valentini boton studime për fiset ilire dhe tributë shqiptare, për qytetet dhe kështjellat e ndërtuara dhe rindërtuara nga Justiniani, kurse në “Dictionaire d’Istoire” Paris, 1959, vëllimi XIV, boton një studim për Drishtin. Në “Enciclopedia Cattolica”, Firence 1948-1953, Valentini shkruan zërat e Shqipërisë, Durrësit dhe Ilirisë.

Rrafshi më i plleshëm për Valentinin janë studimet për krishtërimin. Këto janë të pafund. Shumë hulumtime janë mbi veprën e Farlatit me referenca, saktësime.

Më 1936 tek “Leka” boton studimin “Lindje e Perëndim. Tue gjurmue kuptimin themeluer të mistikës”. Po këtu më 1937 boton : “Të drejtat e metafizikës”. Valentini është i pari që shkruan hagografinë e martirëve të krishtërimit apo shenjtorëve me origjinë ilire dhe shqiptare. Kështu ai flet për shenjtorin françeskan Frano Durrësakun, për Gjergj Albanin, për fra Angeliko Di Bargellini si dhe për Suvanarolën, për apostolin e Geatano Petrotës, për Gjergj Guxetën, Gjergj Fishtë, Xanonin, Ndre Mjedën, Marin Sirdanin dhe, padyshim, edhe për Gjon Buzukun etj. Vëmendjen e Valentinit e tërheqin historitë e patriarkëve dhe organizatorëve ekleziastë në Gadishullin Ballkanik. Ai gjithashtu flet për një lloj internimi në vitin 304 të Gjon Gojëartit në Epir, flet për rrymat heretike të krishtërimit që kanë gëluar në Ballkan dhe brigjet e Shqipërisë etj. Për krishtërimin Valentini

është i interesuar edhe mbi artet, arkitekturën, pikturën, muzikën. Më 1936 boton një studim për rikonstruktimin e kishës së Shën Stefanit në Kalanë e Shkodrës dy herë. Ai ka shkruar për pikturën, poezinë dhe muzikën në artet bizantine më 1958, për universalitetin e pikturës kristiane më 1960, për pikturën kristiane në Hindit më 1961, kurse në revistën “Shejzat” Romë, 1962, precizon leximin e një mbishkrimi në një kishë të Kosturit, ku ka pikturuar Onufri më 1547. Studiuesi grek Orlando e ka lexuar gabim emrin e një qyteti në këtë mbishkrim. Orlando jep si variante emrat Grebenion ose Venetion, kurse Valetini zbuloi se është emri Beration. Kështu u vërtetua se Onufri erdhi për të pikturuar në Kostur “nga qyteti i shumëshkëlqyer Berat”. Po tek “Shejzat” më 1963, Valentini boton një studim për Mark Bazaitin, piktorin shqiptar të Venedikut, në shek. XV. Valentini është i pari që ka hedhur dritë për një familje artistësh shqiptarë, Albanëzët e Viçensës. Ai ka trajtuar temat teologjike të artit pikturik në Athos, si dhe rëndësinë e arteve ekumenike. Një studim tepër interesant i tij botuar më 1970 është “La mystice Iconaria di Trubeckoi”.

Valentini ka qenë i interesuar për humanistët shqiptarë, ka shkruar për Marin Biçikemin (1468-1526) për Gjon Gazullin (ka shqipëruar në fakt studimin e Florio Banfit), ka shkruar për gjeneralin e kavalerisë Gjergjë Bastën e shek. XVII, por në mënyrë të veçantë ka shumë shkrime për Gjergj Kastriot Skënderbeun. Valentini ka patur në optikën e tij shkrimtarët shqiptarë si dhe diturakët Fishta, Koliqi, Ilo Mitkë Qafëzezin,



Zamputin, arbëreshët, De Radën, Zef Skiroin, por ka dhe ndonjë polemikë me Branko Merxhanin. Valentini e ka patur pasion kinematografinë. Ai ka botuar tek "Drini" më 1943 një skenar për film për "Gjon Vladiminin Princi i Krajës". Më 1956 shpalo mendime për filmin "Skënderbeu". Për Valentinin rëndësi të veçantë kishte edhe muzika. Më 1951 ai boton një studim eseistik dhe estetik për Meshën e Requilmit të Verdit.

Por ajo që është gati e pabesueshme lidhet me interesin e Valentinit për letërsinë moderne.

Ai ka dhënë mendime për përkthimin e Tajar Zavalanit të "Sonatës së Krojzerit" të Tolstoit, shkruan për përkthimin e "Faustit" të Gëtes nga Lazër Shantoja, për librin "Në frontin e Perëndimit asgja të re" të Remarkut. Ai shkruan dhe për nobelistin amerikan Folkner, Graham Grinin, Çehovin, Zolanë, Sigrid Undset (Nobel-1938) apo për funeralin e Coletjs, më 1954, ku pasqyron dhe polemikën me këtë rast në "Figaro Litteraire". Valentini ka qenë interesuar për librat e Plutarkut, Vitorio Alfierit, Pjer Korneit, për libra shkencorë të Taljavinit, Baldaçit, Franc Nopçës etj.

Një libër i quajtur "Favole e Legende del Veneto" është botuar në Bologna më 1960 dhe përbëhet nga këngë italiane me motive mitike. Ky libër është bërë nën kujdesin e Valentinit nga sekretari i tij


Gastoni Tedeschi. Do ishte mirë që ky libër të përkthehej në shqip për të bërë të njohur botën fabuleske të Venedikut.

## Zef Valentini, brenda dhe jashtë tij

Zef (Giuseppe) Valentini si një prej njohësve dhe studiuesve më të shquar të Shqipërisë dhe të popullit të saj prezantohet përmes këtij artikulli njohës dhe vlerësues.

Autori, duke vënë në dukje faktin që shkenca shqiptare, për shkaqet e njohura politike, po e trajton me vonesë këtë personalitet madhor të albanologjisë, synon të ridimensionojë atë përmes një shikimi biobibliografik të veprimtarisë së tij shumëplanëshe në disa fusha të rëndësishme si arkeologjia, arkivistika, historia, veçanërisht ajo medievale etj. Nëpërmjet një këndvështrimi specifik, trajtohet ndihmesa e Valentinit në studimin e lidhjeve shqiptaro-venedikase dhe, veçanërisht përmes dokumentacionit shumëvëllimor në «Acta Albania Veneta...», çka ndihmon në ndriçimin historik të asaj që tashmë në historiografi ka hyrë me termin «Shqipëria venedikase».

Vend të posaçëm në shkrim zë kontributi i Zef Valentinit në studimin e konstitucionit shpirtëror të shqiptarëve, veçanërisht përmes së drejtës zakonore.



## ZEF VALENTINI, INSIDE AND OUTSIDE HIMSELF

*Zef (Giuseppe) Valentini, as one of the distinguished connoisseur of Albania and Albanian people as well, is presented in this article as an erudit scholar. The author notes the fact that Albanian science, for well-known political reasons, is dealing with tardiness with this great and famous personality of albanology. He intends to enlighten his figure from a bibliographical point of view of his multilateral activities in some important fields, such as archeology, archives science, history, particularly the medieval one etc. From a specific point of view, the contribution of Valentini was treated concerning the study of alliances Albano-Venetian and especially through the documentation in several volumes in "Acta Albania Veneta ...", which contributes to the historical illumination of "Venetian Albania".*

*In this article, a particular place has been dedicated to the contribution of Zef Valentini concerning the study of the Albanian spiritual constitution, especially through customary law.*

# Pal Petta: figura e një shkencëtari autoritar ndër albanologët e shek. XX<sup>1</sup>

**Dr. Aurel PLASARI**

Biblioteka Kombëtare

---

**M**odeli i studiuesve si Pal Petta (Paolo) nuk është i panjohur në botën e punëve shkencore: një nëpunës i specializuar i administratës së lartë shtetërore, në një nga institucionet e rëndësishme të shtetit, i përpiktë në profesionin e tij me të cilin ngjith pa zhurmë rangjet e shërbimit, shëmbëlltyrë gati e përkryer e nëpunësit "të përhimë"...

Pak vetë e dinë që ky nëpunës, duke gdhirë orët e natës, duke shpërdoruar orët e pushimit ose duke vjedhur weekend-et, punon mbi do tema të tij të dashura që aspak (ose fare pak) lidhje kanë me detyrën zyrtare apo institucionin ku ai shërben. Temat e tij të dashura i zbulojmë tani ne si lexues në dy veprat e tij më të rëndësishme: *Stradiotët: ushtarë shqiptarë në Itali* (1998) dhe *Despotë të Epirit e Princër të Maqedonisë* (1999). Nga shfletimi i parë i tyre të befason bibliografia e gjerë e shtënë në punë, informacioni i hollësishëm deri në kufijtë e shterimit. Mandej, faqe mbas faqeje, të befason aftësia e tij për analiza si dhe për sinteza, e gërshetuar me zotërimin mjeshtëror të kritikës së burimeve. Mbresën e fundit ta lë stili i thjeshtë, që duket se vjen prej zotësisë për t'i thënë qartë ato që mendon. Kështu, prej shëmbëlltysës së nëpunësit "të përhimë" vjen e përvijohet figura e një shkencëtar autoritar, me shokët shumë të rrallë, - ndër albanologët e shek. XX.

*Despotë të Epirit e Princër të Maqedonisë* përfaqëson, deri më tani padyshim, veprën madhore të Petta-s. Kur kam pasur rastin ta përmend këtë vepër, kam pasë shkruar: "*Vini re: një libër për t'u lexuar prej çdo shqiptari që dëshiron të njohë veten*". Mendoj se ajo e meriton këtë vlerësim sikur edhe për specifikën e saj nr. 1: marrjen me atë institucion të rëndësishëm që e quajmë "aristokraci", d.m.th. me rrjetin e madhërishtëm të "familjeve të mëdha". Duke hulumtuar në kthinat pak të njohura të këtij institucioni, Petta na dëfton se si

aristokracia ka funksionuar për shekuj jo vetëm si përfaqësuese e zotërimit të trojeve dhe e administrimit të pasurisë së shoqërive nënshtruar asaj, porse me idealet e veta dhe me pasionet e veta, me doket e veta dhe pompën e vet, me mënyrën e vet të jetuarit (shkurt me ato që studiuesi i aristokracisë angleze L. Stone i ka quajtur "minds & manners") aristokracia ka qenë njëherësh shprehëse e një tradite politike dhe bartëse e kujtesës historike të kombit të vet.

Drama e aristokracisë pasbizantine është, pa fjalë, një ndër subjektet joshëse të historisë së rajonit tonë në kapërcyell të Mesjetës për në Kohën e re; është e kuptueshme që ky subjekt të ketë bërë për vete Petta-n. Pushtimi osman ose, thënë ndryshe, instaurimi i Perandorisë osmane në Europën jug-lindore, u shndërrua në një dramë mësepari për aristokracinë e rajonit. Nga njëra anë, drama ishte ideologjike për një aristokraci të mësuar ta konceptonte politikën brenda skemës së Perandorisë romane të Lindjes; nga ana tjetër, drama ishte ekonomike për një aristokraci pronare trojesh që në rajonet e ish-Perandorisë kishte zotërimet e veta. "Ç" të bëjmë?" Këtë pyetje klasike aristokracia bizantine duhet të ketë filluar t'ia bënte vetes qysh në shekullin XIV. Dy ishin rrugët që mbeteshin para saj. E para: ajo e ikjes, e mërgimit kryesisht përtej Adriatikut dhe Jonit, d.m.th. në Perëndim. E dyta: rruga e bashkëpunimit me pushtuesin si sundues i ri, duke u integruar në të dhe duke e shtyrë këtë integrim deri në apostazi, në mos edhe asimilim.

Ndryshe prej aristokracisë bizantine në përgjithësi, një pjesë e mirë e aristokracisë

shqiptare duket se e ndiente veten në një hipostazë tjetër. Së paku prej rënies së Kostandinopojës në duar të “latinëve” (1204), kjo pjesë kishte filluar ta bënte jetën me Perëndimin. Çfarë do të thoshte që, në ndryshim prej parimit aristokratik bizantin, aristokracia shqiptare kishte filluar të vishej me titujt e sistemit trashëgimor perëndimor: *kalorës, baronë, kontë, markezë, princër* etj., madje ta ndiente veten mirëfilli të tillë. Në i kishte në rregull apo jo “kartat e fisnikërisë”, në qe regjistruar apo jo në *Librat e Artë*, kjo për të nuk ngrinte peshë vendimtare. Ishte një specifikë që e shtynte aristokracinë shqiptare jo thjesht të bëhej në rajon një ndër elementet më refuzuese të sundimit osman, por edhe një ndër aristokracitë që e pati më të vështirë mimetizimin në rendin e ri. Shpjegohet kështu edhe ai realitet i veçantë faktesh që një pjesë e madhe e saj parapëlqeu rrugën tjetër të shpëtimit: mërgimin jo vetëm në viset italice, por pak a shumë në gjithë Europën perëndimore, deri në Flandër dhe në Skoci. Sikurse në librin e Petta-s përshkruhet tani përimtisht, duke filluar me Kastriotë, mandej Arianitë, Topiaj, Dukagjinë, Balshë, Spanë, Skurraj, Matarangë, Muzakë, Buaj, Dushmanë, Zahariaj, Gropaj, Jonimë, Zenebisë etj., nuk gjen thuase një familje të madhe shqiptare pa pinjoj të degëdisur nëpër Perëndim. (Ka të ngjarë që një familje e tillë luftëtarësh patën qenë edhe vetë stërstërgjyshërit e autorit të librit: Petajt.) Ngjan si një *web* i vërtetë i hedhur përtej detrave, në të cilin aristokracia shqiptare nuk u ndodh asnjëherë vetëm, por përzier në një rrjet marramendës lidhjesh: me italianë si Tocco-t, që kishin qenë despotë

dhe zotër të Artës e Qefalonisë; me serbë si Brankoviqët, dikur despotë të Serbisë; me Kosaka, dukë të Shën Sabës dhe zotër të Hercegovinës; me Crnojeviqë të Malit të Zi që qenë sjellë herë si shqiptarë, herë si malazias; deri me Paleologë të shtëpisë perandorake të Kostandinopojës apo aristokraci greke. Me këtë rrugë ikjeje shpresohej të shpëtoheshin të gjitha të quajturat “*minds & manners*”: besimi i krishterë, tradita dhe doket, idealet dhe pasionet, mënyra e të jetuarit, pompa e moçme arbërore, ceremonialet dhe ritet, stemat dhe shqytet, miqësitë e vjetra dhe aleancat, nderi, emri.

Një aventurë të tërë krushqinore në Itali të familjes Kastrioti e kishim lexuar në libërthrin *Mbi Gjergj Kastriotin Skënderbë dhe mbasardhësit e tij* (1879) të C. Padiglione-s, atë të familjes së Muzakajve në *Historinë dhe gjenealo-gjinë e Shtëpisë Muzaka*, hartuar prej Gjon Muzakës në Itali (1570) etj. Në faqet e Petta-s na shpaloset tani në panoramë rropatja e përgjithshme e këtyre familjeve për të ruajtur edhe në Perëndim një çfarëdo shkalle fisnikërie, duke i ridimensionuar lidhjet e veta. Pikësëpari me anë krushqish të reja; tjera herë familjeve të mëdha shqiptare përtej detit u duhet t’ia nisin nga e para përpjekjeve për t’ia “shpikur” vetes një traditë nëpër-mjet titujsh fantomatikë apo rivendikimesh platonike. Ishin përpjekjet e përjetshme të aristokracisë, që dëshmojnë vitalitetin dhe energjinë e saj për t’u rimëkëmbur, në situata krize, dhe për të përtëritur privilegjet duke u kapur me thonj e me dhëmbë mbas sovranësh të rinj. Formula e një përfaqësuesi të tyre (e cituar nga Petta),

e cila ndryn në vete sqimën boshe të këtij grupi, mund të mbahet si devizë historike për gjendje të tilla: “*Edhe në i humbëm unazat, gishtërinjtë i kemi shëndoshë e mirë*”.

Kështu nisën të gjejnë strehë te kujtimet e qëmoçme dhe të shndërrohen, dalngadalë, në një “botë të kapërcyer”. Çdonjëra prej këtyre familjeve pati atje, në viset e huaja, një histori të vetën fatesh njerëzore, dhe pikërisht këtë “histori fatesh njerëzore” ka lakmuar Petta ta pikturojë. Për t’u kujtuar mbetet se, me gjithë të quajturat “*minds & manners*”, ajo çfarë të ikurit e mëdhenj mundën të shpëtonin në Perëndim ishte një copëz Shqipërie virtuale, në kohë e sipër që Shqipëria reale i lihej Orientit.

Për ne - shqiptarët e mbetur në Shqipërinë reale - historia që rindërton Petta ka edhe një përthyerje aktuale. Ajo ndihmon të kuptohet edhe ana e përkundërt e dukurisë: se si ndodhi në Shqipëri shkatërrimi i atij që Šufflay e ka quajtur “*palc shtetëror*”; sepse besoj që Šufflay e pati sintetizuar më qartë këtë dukuri historike: “*Nën Skënderbeun palci shtetëror i këtyre familjeve të mëdha u shkri në një shtet të vërtetë: në shtetin e krishterë më të madh të Ballkanit mbas rënies së Kostandionopojës, të Serbisë dhe të Bosnjës [...] Mbas vdekjes së Skënderbeut osmanët e shkatërruan sistematikisht këtë palc shtetëror*” (f. 196). Besoj na punon kujtesa të përmendim tani se si edhe përpjekjet e shqiptarëve që mbas pesë shkeqjesh jete perandorake osmane të krijonin një “*palc shtetëror*” të ri nëpërmjet përtëritjes së një rrjeti familjesh

të mëdha, u përdhunuan për së dyti. Një nga xhelozitë më të mbrapshta të komunizmit si mendësi dhe si praktikë drejtohej pikërisht kundër këtij web-i familjesh, kundër çdo orvatjeje për rimëkëmbje aristokratike. Kjo xhelozia e meriton të cilësohet “e mbrapshtë”, sepse ndërkohë që përdhunonte traditën e saporingjallur të “familjeve të mëdha”, komunizmi rrekej t’i krijonte vetes një “aristokraci të llojit të ri”: *nomenklaturën*. Goditja e dytë kundër “*palci shtetëror*” shqiptar ishte, me sa është parë, simetrike me atë të pesë shekujve përpara. Si ta kesh kthyer edhe faqen e fundit të librit të Petta-s, nuk mund të mos e ndiesh këtë kundërpunk.

Modeli i studiuesve si Pal Petta (Paolo) nuk është i panjohur në botën e punëve shkencore: një nëpunës i specializuar i administratës së lartë shtetërore, në një nga institucionet e rëndësishme të shtetit, i përpiktë në profesionin e tij me të cilin ngjit pa zhurmë rangjet e shërbimit, shëmbëlltyrë gati e përkryer e nëpunësit “të përhimë”: një ekspert i së drejtës kushtetuese. Pak vetë e dinë që ky nëpunës, duke gdhirë orët e natës, duke shpërdoruar orët e pushimit ose duke vjedhur weekend-et, punon mbi do tema të tij të dashura që aspak (ose fare pak) lidhje kanë me detyrën zyrtare apo institucionin ku ai shërben. Temat e tij të dashura i zbulojmë tani ne si lexues në dy veprat e tij më të rëndësishme: *Stradiotët: ushtarë shqiptarë në Itali* (1998) dhe *Despotët të Epirit e Princërit të Maqedonisë* (1999). Nga shfletimi i parë i tyre të befason bibliografia e gjerë e shtënë në punë, informacioni i hollësishëm deri në

kufijtë e shterimit. Mandej, faqe mbas faqeje, të befason aftësia e tij për analiza si dhe për sinteza, e gërshetuar me zotërimin mjeshtëror të kritikës së burimeve. Mbresën e fundit ta lë stili i thjeshtë, që duket se vjen prej zotësisë për t'i thënë

qartë ato që mendon. Kështu, prej shëmbëlltyrës së nëpunësit "të përhimë" vjen e përvijohet figura e një shkencëtari autoritar, me shokët shumë të rrallë, - d.m.th. vërtet shumë të rrallë, - ndër albanologët e shek. XX.

### PAOLO PETTA – AN AUTHORITARIAN RESEARCHER AMONG THE ALBANOLOGISTS OF XXth CENTURY

*The model of scholars like Paolo Petta, a specialist officer in one of the most important institution of state administration, punctual in his profession, expert of constitutional law, is not unknown to the world of research works.*

*There are a few people who know that this employee, passing the whole night awoken, abusing with his breaks or stealing his own leisure time on weekends, worked on some topics, which have no relation at all with his official work or with the institution where he served. We, the readers, discover his loving themes in his two most important works: "Stradioti: Soldati albanesi in Italia (sec. XV-XIX)" and "Despoti d' Epirio e principi di Macedonia".*

*Turning over the pages of his books, everyone can be surprised by the immense bibliography and detailed information he used, and the ability to clearly express his thoughts.*

*That is why he has been ranked among the best albanologists of the XXth century.*

1. Në Bibliotekën Kombëtare është hapur salla «Paolo Petta» me fonde albano-balkanologjike, dhuratë e Senatit të Republikës Italiane. Shih po në këtë numër kronikën përkatëse në rubrikën «Ngjarje».

---

■ Leksikoni i shkrimtarëve shqiptarë 1501-2001	41
■ Koleksionet e bibliotekës	46

---





# Leksikoni i shkrimtarëve shqiptarë 1501-2001

***Kujtim DASHI***

Ministria e Kulturës,  
Rinisë dhe Sporteve

---

**G**jithnjë e më tepër po rriten kërkesat e lexuesve për informacion të gjithllojshëm që u shërben atyre për të plotësuar nevojat për formim, argëtim etj. Në punën e përditshme të bibliotekave sigurimi i informacionit për lexuesit është një ndër treguesit kryesorë të ecjes së tyre në një hap me zhvillimet bashkëkohore.

Megjithëse sot bibliotekat janë pajisur me teknologji të reja që sigurojnë informacion të bollshëm, prapëseprapë botimet referative si fjalorë, enciklopedi, manualë, direktori etj. vazhdojnë të zenë një vend të rëndësishëm në përpjekjet e tyre për t'i shërbyer sa më mirë lexuesit. Parë me këtë sy *Leksikoni i shkrimtarëve shqiptarë 1501-2001*, hartuar nga shkrimtari dhe studiuesi nga Kosova Hasan Hasani është një mjet themelor referativ që bibliotekat shqiptare u venë në dispozicion lexuesve për të vjelur informacion nga kjo fushë e rëndësishme e kulturës së shkruar kombëtare.

Me botimin e versionit të tretë të plotësuar, të përpunuar dhe të korigjuar të *Leksikonit të shkrimtarëve shqiptarë 1501-2001* (Shtëpia botuese "Faik Konica", Prishtinë, 2003), tashmë mund të themi se shkrimtari Hasan Hasani e ka fituar ekskluzivitetin e hartimit të doracakëve të tillë informativë, biografikë e bibliografikë. Kur më ka rënë në dorë, në 1994-ën varianti i parë i *Leksikonit*, duke e ditur se ç' ndërmarrje e vështirë ishte të siguroje, grumbulloje e sistemoje të dhënat biobibliografike për 1381 autorë, sa ç' përfshinte leksikoni, dhe se çfarë "urie" kishin për të lexuesit, nxënësit, studentët, mësuesit dhe studiuesit, kam thënë me vete "I lumtë punëtorit të palodhur të letrave shqipe Hasan Hasani!".

*Leksikoni*, i cili ka njohur disa botime (1994, 1995 dhe 2003), është një kontribut i rëndësishëm në lëmin e biobibliografive. Në këtë veper informuese historiko-letrare është pasqyruar për herë të parë pasuria krijuese dhe shpirtërore e

shqiptarëve në një hark kohor prej 500 vjetësh. Duke përbajtur shënimet më elementare për një krijues, *Leksikoni* (botimi III-të përfshin 2600 shkrimtarë) është një pasqyrë reale e gjithë krijimtarisë artistike të shkrimtarëve tanë, duke filluar nga "Rrethimi i Shkodrës", shkruar nga humanisti i shquar shkodran Marin Barleti e botuar në Romë më 1501. Kësisoj H. Hasani, duke realizuar një veper, që institute të tëra s' e kanë bërë, ia ka mbërritur qëllimit për t'i përbashkuar në një leksikon të gjithë shkrimtarët shqiptarë, të cilët krijuan përgjatë pesë shekujve, duke patur parasysh kontributin e tyre në planin kulturor, letrar e artistik.

Me një punë sistematike, durim dhe këmbëngulje dhe, mbi të gjitha, me një përkushtim prej dijetari atdhetar, nga botimi i parë tek i treti H. Hasani është përballur e ka kaluar, përgjithësisht me sukses, vështirësi jo të pakta si kriteri rigoroz i përfshirjes së autorëve në leksikon, grumbullimi e sistemimi i të dhënave biobibliografike për autorët shqiptarë që kanë krijuar ndër shekuj, dhe jo vetëm në gjuhën shqipe, brenda dhe jashtë atdheut. Pra, në leksikon janë përfshirë krijuesit që kanë krijuar brenda kufijve shtetërorë të Shqipërisë, ata të trojeve shqiptare në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi si edhe krijues nga diaspora. Edhe pse leksikoni u kushtohet para së gjithash shkrimtarëve dhe veprave letrare të tyre, në të janë përfshirë edhe shkrimtarë më të hershëm se Marin Barleti, si Leonik Tomeu, Marin Biçikemi, Gjon Gazulli etj., të cilët, veç veprave letrare, shkruan edhe vepra në fushën e filozofisë, astronomisë, matematikës, fizikës, etnografisë,

historisë, gjuhësisë, teksteve shkollore etj. I njëjti kriter është ndjekur edhe për veprat religjioze. Literatura e reduktuar e vënë për disa nga autorët më të njohur, sipas mendimit tim, është një informacion i domosdoshëm e vlerë tjetër që i shtohet librit, paçka se si kriter mund të ndiqej edhe për disa autorë të tjerë, vepra e të cilëve është me peshë në kulturën tonë kombëtare dhe ajo është vënë në fokusin e studuesve.

Leksikoni duke qenë informativ dhe jo vlerësues jep të dhëna të përgjithshme e konkrete nga jeta dhe vepra e autorëve: kur dhe ku kanë lindur, shkollat e kryera, ku e çfarë punësh dhe profesionesh kanë patur dhe i kanë ushtruar, si dhe ku jetojnë aktualisht. Në fund u janë vënë veprat e krijuara si dhe botimet, kur janë bërë. Përgjithësisht ky leksikon ka një informacion më të gjerë e më të plotë se fjalorët e tjerë që janë botuar gjer më sot, natyrisht edhe të këtij autori. Hasan Hasani në këtë nismë të vyer për kulturën e letërsinë shqiptare dhe për këtë botim të ri ka meritën e veçantë pasi:

*së pari*, ka përfshirë në veprën e vet gjithë vlerat krijuese të tërë etnisë shqiptare, pra, të mbarë kombit shqiptar;

*së dyti*, leksikonit i “mungon” vlerësimi ideologjik, kësisoj krijuesit nuk etiketohen më as përparimtar, as reaksionar, por si krijues të përkatësisë etnike shqiptare dhe atëherë, kur ndonjë autor, në pamundësi, për shkak të rrethanave të njohura historiko-shoqërore e ka botuar veprën në gjuhë të huaj;

*së treti*, leksikoni zgjon një ndjenjë të fuqishme krenarie tek çdo shqiptar për shkak se, pavarësisht nga rrethanat tepër

të vështira historike të kombit tonë, kultura shqiptare jo vetëm që ka mbijetuar përgjatë pesë shekujve, çka dëshmohet nga autorët dhe veprat e tyre të përfshira në “Leksikonin e shkrimtarëve shqiptarë 1501-2001”, por renditet me dinjitet në mes të simotrave të saj.

Natyrisht midis 2600 autorëve të përfshirë që kanë begatuar e lulëzuar letërsinë e kulturën shqiptare ka shumë të talentuar, mesatarë e, pse të mos e themi edhe të dobët ose të themi ndryshe hobistë. Hasan Hasani, duke mos bërë vlerësime (me ndonjë përjashtim të përligjur plotësisht) ua ka lënë gjykimin dy gjykatësve më të mirë: kohës dhe njerëzve, ndonëse në jo pak raste ai duket se e krijon hap pas hapi panteonin shqiptar.

Nëse nisemi nga maksima e njohur “Më mirë një punë e kryer se sa 100 e në mendje” edhe njëherë do të përshëndetja punën e madhe të shkrimtarit e studiuesit të palodhur Hasan Hasani. Por në të njëjtën kohë, që të jemi të sinqertë, do desha të evidencoj ndonjë mangësi të bartur edhe nga dy versionet e tjera, si dhe në botimin e tretë të leksikonit. Në parathënien e librit autori ripërsërit apelin drejtuar autorëve, të cilët për shkaqe objektive nuk janë përfshirë në të ose vepra e tyre paraqitet e cunguar. Pra, ai sinqerisht shpalos pengun që ka “*për të fituar një pasqyrë reale për të gjithë atë që u krijua në literaturën shqiptare për pesë shekuj*”. Nga botimi i dytë (1995) i leksikonit në të tretin (2001) kanë kaluar gjashtë vjet. Jo pak. Dashamirësisht them se ndërkohë ka qenë e mundshme që shumë e shumë gjëra të ndreqeshin. Mjaft autorë paraqiten me nga një “fëmi” të vetëm, domethënë me nga

një vepër, ndërkohë që kanë më shumë dhe indikacionet për këtë krijimtari nuk mungojnë. Thuajse është kthyer në refren për dhjetra e dhjetra autorë shprehja “Të dhënat biografike mungojnë”. Vetëm në dy shkronjat e para të leksikonit gjënden afro 50 raste, kur autori nuk shënon pothuajse asgjë për shkrimtarët. Dhe nuk janë, bie fjala, autorë të shekullit XVI apo XIX, por janë të dekadave të fundit të shekullit XX, kur burimet informative nuk mungojnë, përkundrazi. Në këso rastesh për X a Y autor nga versioni i parë i leksikonit në të tretin përsëriten thuajse të njëjtat gjëra, të mangëta, të pasakta, të paredaktuara. Të marrim dy autorë: Anton Papekën dhe Sherif Balin. Në faqen 340 për A. Papekën shkruhet: Nuk kemi të dhëna biografike. Ka botuar një roman për të rritur dhe një përmbledhje me tregime për fëmijë. Vepra letrare: “Mynxyra”, 2000, “Legjenda e vezëve të mëllenjës”. Tiranë, 2001. Vetëm një faqe më tej, po për këtë autor, shënimet biobibliografike vijnë më të plota. Kështu edhe me Sherif Balin. Mirëpo me “raste” si “Papeka” dhe “Bali”, për fat të keq, është i mbushur tej e anë leksikoni. Këtu kemi të bëjmë me një ngutje të papërligjur për “të kapur 500-vjetorin e pesë shekujve të letërsisë së shkruar shqiptare”, por edhe me një punë jo të mirë pararedatoriale nga vetë autori, por edhe, për fat të keq, edhe nga redaktori N. Rrahmani (nëse). Teksa shkruaj këto radhë më bie ndërmend një pasazh nga rrëfimi i H.Hasanit në parathënien e versionit të parë, kur thotë se leksionin e shihte “pa pretendime të mëdha shkencore e leksikografike”. Një punë e vyer 30 vjeçare dhe një literaturë mjaft e gjerë e konsultuar s’mund të “humbasin” për ca gjëra që mund të korrigjo-

heshin lehtësisht me një bashkëpunim më të mirë në mes autorëve, studiuesve dhe bibliografëve. Tashmë vendet tona janë të hapura, janë shtuar ndjeshëm shkëmbimet, është e-mail-i, fax-i etj. Mbase unë “flas rehat”, por jam i sigurt që ashtu si dhe Prof. Odhise Grillo, hartues i leksikonit “Shkrimtarët shqiptarë për fëmijë (1872 - 1995)” edhe “Instituti” (po i themi kështu) Hasan Hasani do të jetë ndeshur me moskorrektesën e mjaft autorëve, të cilët nuk i janë përgjegjur “a thua se në leksikon nuk do të flitej për ta, por për njerëz të tjerë”. Duke evidencuar këto dhe të tjera mangësi një shkrimtar, ndër njohësit më të mirë të letërsisë kosovare, më tha “Mua të më kishte shkruar Hasani dhe do t’ia dërgoja të dhënat”. Në po të njëjtën mënyrë m’u shpreh edhe një ndër bibliografët më të njohur të Bibliotekës sonë Kombëtare. Të njëjtën gatishmëri do të shprehja edhe vetë. Padiuria nuk është do argument.

Sidoqoftë kam besim se “njeriu i punës së kryer”, shkrimtari e studiuesi i palodhur e pasionant “Instituti” Hasan Hasani në versionet e tjera do të na japë leksikone të tjera më të plotë, me pretendime më të mëdha shkencore e bibliografike. Tashmë janë të gjitha mundësitë.

## Leksikoni i shkrimtarëve shqiptarë 1501-2001

*Leksikoni*, i cili ka njohur tre botime (1994, 1995 dhe 2003), është një kontribut i rëndësishëm në lëmin e biobibliografive. Në këtë vepër informuese historikoletrare është pasqyruar për herë të parë pasuria krijuese e shpirtërore e shqipta-

rëve në një hark kohor prej 500 vjetësh. Duke përmbajtur shënimet më elementare për një krijues, *Leksikoni* (botimi III-të përfshin 2600 shkrimt “Rrethimi i Shkodrës”, shkruar nga humanisti i shquar shkodran Marin Barleti e botuar në Romë më 1501.


Me një punë sistematike, durim dhe këmbëngulje dhe, mbi të gjitha, me një përkushtim prej dijetari atdhetar, H.Hasani

është përballur e ka kaluar, përgjithësisht me sukses, vështirësi jo të pakta që kanë të bëjnë me kriterin rigoroz të përfshirjes së autorëve në leksikon, grumbullimin dhe sistemimin e të dhënave biobibliografike për autorët shqiptarë që kanë krijuar ndër shekuj, dhe jo vetëm në gjuhën shqipe, brenda dhe jashtë atdheut.

### LEXICON OF ALBANIAN WRITERS 1501-2001

*This Lexicon, edited three times (1994, 1995 dhe 2003), is an important contribution in the field of bibliography, and it has more completed information than all other lexicons published so far. For the first time, in this historical and literary edition, the Albanians' creative and spiritual treasure, covering a period of 500 years, has been represented. Lexicon (III-rd edition), which includes 2600 writers, is a review of the artistic creativity of the Albanian writers, beginning from "Siege of Shkodra", written by the outstanding humanist Marinus Barletius, published in Rome, in 1501.*

*With a systematic work, patience and tenacity, and over all, with devotion of a patriotic savant, the author of this lexicon Hasan Hasani, has come up against difficulties related to the strict criterion of authors' inclusion in Lexicon, collection and arrangement of bibliographical data for Albanian authors who have contributed during centuries, not only in Albanian language, but also in foreign languages, within and without.*



# Koleksionet e bibliotekës

**Aida VELIAJ**

Biblioteka Kombëtare

---

**T**eksti profesional *Koleksionet e Bibliotekës* i autores Farfuri Xhaja, përfshin në tërësinë e tij probleme shumë të rëndësishme të aspektit njohës dhe teorik.

Duke patur parasysh pikërisht aspektin teorik dhe funksionin utilitar në punën e përditshme për punonjësit e bibliotekave, ai merr rëndësinë e një manuali bazë udhëzues për punonjësit e të gjithë bibliotekave të vendit.

Teksti është botim i përmirësuar i botimit “Koleksionet e bibliotekës dhe përshkrimi bibliografik i materialeve” të vitit 1996.

Me një vështrim të thjeshtë të pasqyrës së lëndës, problemet janë po ato, veçse në pjesën më të madhe të kësaj lënde kemi saktësime, riformulime, plotësime deri dhe eëndimentime të koncepteve të reja të fushës së bibliotekomisë. Integrimi dhe azhurnimi me këto të reja, qoftë i studentëve të shkollës së bibliotekomisë, qoftë i punonjësve të niveleve të ndryshme merr një rëndësi të dorës së parë, në përputhje me zhvillimin e bibliotekomisë

si shkencë.

Autorja është ndalur gjërësisht tek rrugët e pasurimit të koleksioneve, mënyrës së vendosjes së materialeve bibliotekare në raftet, kushtet e ruajtjes së tyre etj.

Si një ndër risitë e kohës së automatizimit, autorja shtjellon kompiuterizimin e procesit të pasurimit dhe përdorimin e barkodit duke theksuar përparësitë e automatizimit.

Jo më pak rëndësi autorja i jep edhe procesit të kundërt (atij të spastrimit të koleksioneve), ku i referohet edhe përvojës më të fundit botërore.

Duke mos dashur të bëj një analizë të hollësishme (për t’ia lënë atë vetë bibliotekarëve që do ta kenë në dorë tekstin), mendoj se libri ka vlera profesionale dhe është produkt i një përvoje disavjeçare të znj. Farfuri Xhaja.

## LIBRARY COLLECTIONS

*The professional textbook “Library collection” prepared by F. Xhaja is a basic textbook for all Albanian librarians. A particular attention has been paid to the collection development, arrangement systems, conditions of library materials conservation etc. In this textbook, the author has mentioned the priority of the implementation of new technologies in all library services.*

*In this regard, I would say that this textbook might be considered as a very important guide for libraries.*

---

■ Hyrje në formatin UNIMARC	49
■ Nxitje zhvillimit të kulturës së komunitetit	73
■ Shërbimet e reja bibliotekare: akses i komunitetit në Internet	83
■ Spastrimi i koleksioneve bibliotekare	91
■ IFLA në 75-vjetor	94
■ LIBER	96
■ Sistemi i ISBN-së	98
■ Koleksionet po përjetojnë një shërbim të ri	101

---



# Hyrje në formatin UNIMARC

*Behije LUGA*

Biblioteka Kombëtare

## I. Ç'ËSHTË FORMATI MARC?

MARC është shkurtim i termave Machine Readable Catalogue or Cataloguing (Katalog ose Katalogim i Lexueshëm në Makinë). Ky emërtim duket pak çoroditës, sepse MARC nuk është as katalog, as metodë katalogimi.

MARC në fakt shërben për të vendosur etiketa në çdo element të një regjistrimi bibliografik në një katalog, i cili është i përpunueshëm nga kompiuteri. Formatimi MARC që në fillim u krijua për t'i shërbyer nevojave të bibliotekave si një rrugë e përshtatshme për ruajtjen dhe për shkëmbimin e të dhënave bibliografike.

Formati origjinal MARC u zhvillua nga Biblioteka e Kongresit në vitet 1965-66 i udhëhequr nga projekti pilot i njohur MARC I, i cili shqyrtoi mundësinë e prodhimit të të dhënave të katalogut në formë elektronike. Një punë të tillë të ngjashme po zhvillonte edhe Britania e Madhe, ku Këshilli i Bibliografisë Kombëtare Britanike kishte përgatitur një projekt MARC që do të përdorte të dhënat në formë elektronike për prodhimin e Bibliografisë Kombëtare Britanike (BNB). MARC II ishte një hap tjetër që përcaktonte MARC-un si format komunikimi.

Formati MARC në përgjithësi ka këto veçori:

- *Shërben për të gjitha llojet e materialeve të bibliotekë;*
- *Është elastik në prodhimin e katalogut;*
- *Përdoret në një sërë sistemesh të automatizuar.*

Pavarësisht nga bashkëpunimi midis agjencive kataloguese të vendeve të ndryshme, dolën disa variante të MARC-ut, si për shembull: UKMARC, INTERMARC dhe USMARC, të cilët dallonin për sa i takonte praktikave të ndryshme kataloguese

kombëtare. Që nga viti 1970 u zhvilluan më shumë se 20 variante të ndryshme kombëtare të MARC-ut. Ndryshimet në përbajtjen e të dhënave kërkonin një redaktim para se regjistrimi të ishte i gatshëm për shkëmbim.

Krijimi i një formati ndërkombëtar MARC (UNIMARC) do të zgjidhte problemin e shtimit të formateve të ndryshme kombëtare MARC si dhe papajtueshmërinë e tyre. UNIMARC është një format bartës për qëllime shkëmbimi. Ai nuk kundërshton formën, përbajtjen ose strukturën e regjistrimit të të dhënave brenda sistemeve individuale, përkundrazi pranon regjistrime të krijuara në çdo format kombëtar MARC. Kështu regjistrimet nga një format MARC kombëtar konvertohen në UNIMARC dhe me pas konvertohen nga UNIMARC në një tjetër format MARC. Për këtë arsye, çdo agjencie kombëtare do t'i duhen vetem dy programe - një për të bërë konvertimin në UNIMARC dhe një për të konvertuar nga UNIMARC-u, në vend që të sigurohen programme konvertimi për çdo format kombëtar MARC si: INTERMARC në UKMARC, USMARC në UKMARC etj.

Në vitin 1977 IFLA botoi *UNIMARC: Universal MARC format* (UNIMARC: Formati MARC universal) i cili theksonte: "Qëllimi kryesor i UNIMARC-ut është të lehtësojë shkëmbimin ndërkombëtar të të dhënave në formë të lexueshme nga makina ndërmjet agjencive bibliografike kombëtare". Një botim i dytë më 1980 çoi te manuali i UNIMARC-ut më 1983, që mbulonte katalogimin e monografive dhe të serialeve duke i dhënë një rëndësi të madhe zhvillimit të standardizimit të informacionit bibliografik në përputhje me standardet ndërkombëtare të përshkrimit bibliografik (ISBD). Më vonë, u pa i nevojshëm, zgjerimi i mëtejshëm i UNIMARC-ut për të përfshirë edhe tipet e tjera të dokumenteve dhe më 1994 doli botimi i manualit të UNIMARC-ut, që përfshinte dhe materialet jo libra.

Më 1991 doli formati UNIMARC i termave të unifikuar (*UNIMARC/Authorities*) për të kontrolluar dhe për të lehtësuar hyrjet në formë unike të emrave vetjakë, të emrave të organizmave, të titujve uniformë dhe të emërtimeve lëndore.

## Pse është i nevojshëm formati MARC ?

Katalogët me skeda tradicionale janë ndërtuar në bazë të renditjeve alfabetike, sistematike, kronologjike, topografike etj. Në këta katalogë mund të kërkohet sipas autorit, titullit dhe subjektit. Përdoruesi duhet të dijë korrekt: autorin, titullin dhe termin lëndor. Kërkimi lëndor është më fleksibël se kërkimi me autor apo titull. Por përdoruesi mund të ketë kërkesa, të cilat nuk mund të zgjidhen menjëherë nga skedari me skeda.

Kompiuterizimi e bën mjaft të plotë dhe të shpejtë kërkimin në bazën e të dhënave. Në katalogun e kompiuterizuar mund të kërkohet sipas: autorit, titullit, shtëpisë botuese, vendit, vitit të botimit, një fjale kyçe apo një fraze. Mund t'i kufizojmë kërkimet në prozë apo jo prozë, botime qeveritare të niveleve të ndryshme si botime konferencash, libra referencash të llojeve të ndryshme si fjalore ose manuale. Ne mund të kërkojmë edhe për lloje të veçanta ilustrimesh si harta apo fotografi ose mund të kufizojmë kërkimet tona për materiale jubilarë ose të rinjsh.

Hardware dhe software janë esenciale për realizimin e operacioneve të tilla të sofistikuara, ndërsa zhvillimi i formatit MARC i bëri realitet praktika të tilla të bibliotekave. Baza e të dhënave MARC është faktori më i rëndësishëm në automatizimin e një biblioteke. Në një bibliotekë të automatizuar hardware dhe software kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë në radhë të parë përgjegjësi e organizatave dhe kompanive tregtare fitimprurëse. Bazat e të dhënave të bibliotekave kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë përgjegjësi e bibliotekave. Krijimi i bazës së të dhënave me formatin MARC është investimi më i kushtueshëm në automatizimin e bibliotekës (duke patur parasysh kostot e ndërtimit dhe menaxhimit të bazës së të dhënave me MARC), se hardware ose software. Është shumë më e lehtë të azhurnosh hardware ose software, sesa të azhurnosh cilësinë e një baze të dhënash në MARC. Formatin MARC u krijua për të ndihmuar bibliotekat në zhvillimin, përdorimin dhe menaxhimin e këtyre bazave.

Formati MARC e ka bërë realitet katalogun përbledhës (shared cataloging) si dhe ka bërë të mundshëm automatizimin për shumë biblioteka duke përfitur nga avantazhet e kompjuterave.

Përbledhtasi mund të themi që krijimi dhe përdorimi i formatit MARC ndërkombëtar është i nevojshëm se:

- *Eliminon dublikimin e punës;*
- *Përdor me mirë burimet e përbashkëta bibliografike;*
- *Pasuron të dhënat kataloguese nëpërmjet kopjimit nga burimet e përbashkëta;*
- *Siguron shërbim të shpejtë të informacionit;*
- *Sistemet e integruara bibliotekare punojnë me formatin MARC;*
- *Përfiton nga zhvillimet më të fundit të teknologjisë së informacionit;*
- *Zëvendëson një sistem me një tjetër duke i kaluar të gjitha të dhënat në sistemin e ri pa asnjë humbje.*

## II. FORMATI UNIMARC

Formati UNIMARC si dhe variantet e ndryshme të MARC-ut përbëhen nga tri elemente të regjistrimit bibliografik:

- *Struktura e regjistrimit;*
- *Percaktimi i permbajtjes;*
- *Permbajtja e të dhënave.*

### Struktura e regjistrimit

Struktura e regjistrimit shërben për të kontrolluar paraqitjen e të dhënave, duke i ruajtur ato në formën e stringjeve të karaktereve, të njohura si fusha. Të gjitha të

dhënat në regjistrim duhet të ruhen, duke përdorur një ose më shumë komplete karakteresh. Meqënëse kompiuteri mund të ruajë dhe të përpunojë vetëm numra, atëherë çdo simbol, karakter alfabetik, shënohet me një numër, duke ndjekur rregullat e kompleteve të veçanta të karaktereve. UNIMARC lejon përdorimin e çdo kompleti karakteresh, të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit (ISO).

Struktura e regjistrimit e krijuar nga UNIMARC është një zbatim i standardit ISO 2709-1981: *Formati për shkëmbimin e informacionit bibliografik në shirit magnetik (Format for bibliographic information exchange on magnetic tape)*.

Kjo strukturë shërben për të ndërtuar etiketat e regjistrimit dhe direktoritë. Më poshtë jepet një informacion më i plotë për këto dy elemente mjaft të rëndësishme të regjistrimit, por që kataloguesit janë më pak të interesuar.

### Përcaktimi i përmbajtjes

Përcaktimi i përmbajtjes realizohet nëpërmjet shenjave konvencionale, të cilët shërbejnë për të identifikuar elementet e të dhënave brenda një regjistrimi siç janë: autori, titulli, subjekti etj. Kjo mbështet përpunimin e të dhënave nga kompiuteri për qëllimet e mëposhtme:

- *Siguron pika hyrjeje të shumëfishta për kërkim;*
- *Lejon ndryshimin e tipografisë dhe të rezultatit;*
- *Krijon mundësinë për të evituar elemente të caktuar kur kërkohet.*

Më poshtë, në seksionin 'Paraqitja e përshkrimit bibliografik të regjistrimit' jepet një shembull, i cili e bën më të qartë çfarë thamë më sipër.

Regjistrimet në UNIMARC mund të formatohen për VDU, CD-ROM ose fishe si dhe të printohen.

### Përmbajtja e të dhënave

Të dhënat ose përmbajtja që ruhet në fusha dhe nënfusha brenda një regjistrimi, mund të jenë të dhëna të koduara dhe të dhëna bibliografike.

- *Të dhënat e koduara përdoren për të paraqitur numrat e kontrollit, llojin e botimit, gjuhën kryesore të tekstit etj.*
- *Të dhënat bibliografike përcaktohen sipas standardeve të përshkrimit bibliografik (ISBD) për të gjithë llojet e materialeve. Veç kësaj, çdo regjistrim përmban edhe fushat e klasifikimit dhjetor dhe lëndor.*

Struktura e formatit UNIMARC, duke u bazuar në standardet ndërkombëtare të regjistrimit të informacionit bibliografik (ISBD), lehtëson përshkrimin, gjetjen dhe kontrollin e njësive bibliografike.

### III. ROLI I FORMATIT UNIMARC

Fillimisht, UNIMARC u përdor për shkëmbimin e regjistrimeve në shiritin magnetik, por më pas ai është zhvilluar vazhdimisht për t'u përdorur në një shumëllojshmëri mjediesh shkëmbimi dhe përpunimi. Formatit UNIMARC është i vlefshëm për të gjitha agjencitë që lidhen me shkëmbimin e informacionit bibliografik.

Roli i formatit UNIMARC është të specifikojë përcaktuesit e përmbajtjes (etiketat, treguesit dhe kodet e nënfushave) për t'i vendosur në regjistrimet bibliografike në formë të lexueshme nga makina dhe të përcaktojë formatin logjik dhe fizik të regjistrimeve. Formatit UNIMARC përfshin të gjitha llojet e materialeve si: monografitë, serialet, materialet hartografike si edhe materialet jo libra.

Fushat, të cilat identifikohen nga një etiketë numerike e përbërë prej tre karakteresh, renditen në blloqe funksionale. Të dhënat në këto blloqe organizohen në përputhje me funksionet që ato kanë në një regjistrim katalogu tradicional. Me poshtë, është paraqitur tabela e blloqeve. Blloqet 0xx \_ 1xx përmbajnë të dhëna të koduara, ndërsa blloqet 2xx \_ 8xx përmbajnë të dhëna bibliografike:

Blloku	Shembull
0xx Blloku i identifikimit	010 Numri standard ndërkombëtar (ISBN)
1xx Blloku i informacionit të koduar	101 Gjuha e dokumentit
2xx Blloku i informacionit përshkrues	205 Të dhëna për botimin
3xx Blloku i shënimeve	336 Shënim për një skedar kompiuteri
4xx Blloku i hyrjeve të lidhura	452 Botim në një formë tjetër
5xx Blloku i titujve të lidhur	516 Titulli i shpinës
6xx Blloku i analizës së subjektit	676 Klasifikimi dhjetor i Djuit
7xx Blloku i përgjegjësisë intelektuale	700 Autori-Përgjegjësia intelektuale e parë
8xx Blloku i përdorimit ndërkombëtar	801 Burimi origjinal
9xx Blloku i përdorimit kombëtar	

Blloku 9— rezervohet për përdorim kombëtar nga agjencitë që përdorin formatin UNIMARC. Këto fusha mund të përmbajnë çdo informacion lokal.

Rekomandohet që fushat në bllokun 9— të përjashtohen nga shiritat e shkëmbimit ndërkombëtar. Vështirësitë që mund të dalin zgjidhen me marrëveshje ndërkombëtare.

Agjencitë, që përdorin këtë bllok, mund të bien në marrëveshje për përdorimin e përbashkët të fushave, por kjo është fakultative.

Fushat e percaktuara në formatin UNIMARC sigurojnë lloje dhe nivele të ndryshme informacioni.

## IV. STRUKTURA E REGJISTRIMIT NË FORMATIN UNIMARC

UNIMARC është një zbatim i veçantë i standardit ndërkombëtar ISO 2709, i cili specifikon strukturën e regjistrimeve që përbajnë të dhëna bibliografike. Çdo regjistrim bibliografik i përgatitur për shkëmbim, në përputhje me standardin ISO 2709, duhet të përbëhet nga:

- *Etiketa e regjistrimit më 24 karaktere (0-23);*
- *Direktoria e përbërë nga një etiketë numerike 3-shifrore për çdo fushe të dhënash, nga gjatësia e saj dhe vazhdon me pozicionin e karakterit nisës;*
- *Fushat e të dhënave me gjatësi të ndryshueshme të ndara nga ndarësi i fushës.*

Atë që thamë më sipër mund ta paraqesim si më poshtë:

<b>Etiketa e regjistrimit</b>	<b>Direktoria</b>	<b>Fushat e të dhënave</b>	<b>K/R</b>
-------------------------------	-------------------	----------------------------	------------

*K/R - kufizuesi i regjistrimit*

### Etiketa e regjistrimit

Sipas ISO 2709 çdo regjistrim fillon me Etiketën e regjistrimit të përbërë nga 24 karaktere (0-23). Kjo përmban të dhëna që lidhen me llojin e regjistrimit, nivelin e tij bibliografik, pozicionin në hierarkinë e niveleve, shkallën e kompleksitetit të regjistrimit dhe përdorimin ose jo të standardeve (ISBD) në përgatitjen e regjistrimit.

Elementët e të dhënave të Etiketës së regjistrimit nevojiten kryesisht për përpunimin e tyre nga kompiuteri dhe indirekt përcaktojnë njësinë bibliografike.

Shembull:

00795nas0#22002531##450#

Shembulli tregon etiketën e një regjistrimi të ri (n), është material gjuhësor (a), serial (s), nuk ka lidhje hierarkie (0) dhe është në përputhje me standardet e përshkrimit bibliografik (ISBD). Gjatësia e regjistrimit është 795 karaktere (e llogaritur nga kompiuteri).

### Direktoria

Direktoria vendoset pas Etiketës së regjistrimit. Çdo njësi direktorie përbëhet nga tri pjesë: një etiketë numerike 3-shifrore, një numër 4-shifror i cili tregon gjatësinë e fushës së të dhënave dhe një numër 5-shifror i cili jep pozicionin e karakterit nisës. Në

çdo njësi direktorie nuk lejohet asnjë karakter më tepër. Më poshtëe jepet paraqitja e një direktorie:

Njësia e parë e direktorisë

Njësia e dytë e direktorisë ..... Njësi të tjera

Etiketa	Gjat. e fushës	Pozicioni nisës	.....	.....	K/F
---------	----------------	-----------------	-------	-------	-----

*K/R - kufizuesi i regjistrimit*

Segmenti i dytë i direktorisë (gjatësia e fushës) përmban numrin e karaktereve të fushës. Këtu përfshihen të gjithë karakteret e treguesve, të përcaktuesve të nënfushës, karakteret e të dhënave tekst ose të koduara dhe karakteret e kufizuesit të fushës. Gjatësia e fushës ndiqet nga pozicioni i karakterit nisës të fushës, i cili llogaritet që nga pozicioni i karakterit nisës të fushës së parë.

Direktoria ndërtohet automatikisht nga kompiuteri duke u bazuar në informacionin bibliografik.

Shembull:

001 B8132254@

011 ##\$a0261-6726\$d£0.20 per issue@

020 ##\$aGB\$bB8132254@

001000900000[011003100009[020001700040] .....

Kjo direktori e pjesëshme tregon që:

gjatësia e fushës me etiketë 001 është 9, pozicioni nisës 0 ( fusha e parë)

gjatësia e fushës me etiketë 011 është 31, pozicioni nisës 9 ( 9 + 0 = 9 )

gjatësia e fushës me etiketë 020 është 17, pozicioni nisës 40 ( 31 + 9 = 40 )

Etiketa	Gjatësia e fushës	Pozicioni nisës
001	0009	00000
011	0031	00009
020	0017	00040

### Fushat e të dhënave

Ndryshe nga etiketa e regjistrimit dhe direktoria të cilat përmbajnë të dhëna të nevojshme për t'u përpunuar nga kompiuteri, fushat e të dhënave vendosen pas direktorisë dhe përgjithësisht përmbajnë të dhëna bibliografike.

Fusha e kontrollit të të dhënave ( 00- ) paraqitet:

**Të dhënat**

**K/F**

Fushat e të dhënave ( 01- 999 ) paraqiten:

**Treg. 1**

**Treg.2**

**\$a (etj.)**

**.....**

**Të dhënat**

**Të dhënat**

**.....**

Etiketat nuk mbarten në fushat e të dhënave, ato vendosen vetëm në direktori. Këtu bën përjashtim vetëm blloku 4xx. Fushat me vlerë etiketë 00- (psh. 001) përmbajnë vetëm të dhëna dhe kufizuesin e fushës. Fushat e tjera përbëhen nga dy tregues që ndiqen nga nënfushat. Çdo nënfushë fillon me shenjën (\$) dhe vazhdon me kodin e nënfushës (një karakter alfabetik i vogël ose numerik). Përcaktuesit e nënfushave ndiqen nga të dhëna të koduara ose të dhëna tekst.

Në fund të fushës vendoset kufizuesi i fushës (@) .

Shembull:

|001

|011

|020

B8132254@##\$a0261-6726\$d0.20 per issue@##\$aGB\$bB8132254@ .....

Sa thamë më sipër po e ilustruam me shembullin e mëposhtëm të një regjistrimi bibliografik të një katalogu tradicional:

**Balzak, Honore De**

**Shtëpia misterioze : Novelë / Honore De Balzak ;**

**Përkth. K. Evangjeli. - T. : Apollonia, 1955. -**

**95 f. ; 18 cm.**

**Tit. dhe teksti edhe frengjisht.**

**KDU: 821.133.1 - 32**

**Emërtime lëndore: Tregime franceze**

**S125G12**

### Regjistrimi me “etiketa” tekst

Regjistrimi MARC e ndan informacionin bibliografik të një regjistrimi në mënyrë logjike në fusha, disa prej tyre ndahen në nënfusha. Më poshtë jepet regjistrimi bibliografik i ndarë skematikisht në fusha dhe nënfusha të emëtuara me “etiketa” tekst.



Etiketat (Emrat e fushave)	Të dhënat
Kryetitulli:	Balzak, Honore De
Zona e titullit dhe e personave përgjegjës Titulli i mirëfilltë: Nëntitulli: Autori: Përkthyesi:	Shtëpia misterioze : Novelë / Honore De Balzak ; Përkth. K. Evangjeli
Zona e botimit Botimi:	Ribot.
Zona e të dhënave të botimit Vendi i botimit: Botuesi: Data e botimit:	T. : Apollonia, 1987
Zona e përshkrimit fizik: Faqet: Ilustrime: Dimensionet:	46 f. : me il. ; 26 cm.
Zona e shënimeve:	Tit. dhe teksti edhe frengjisht.
Analiza e subjektit: Emërtimi lëndor: Klasifikimi dhjetor:	Tregime franceze 821.133.1 – 32
Autori kryesor Emri:	Balzak, Honore De
Numri i vendit:	S125/G12

## Regjistrimi sipas etiketave të UNIMARC-ut

Në formatin UNIMARC emrat e fushave zëvendësohen me etiketa tri shifrore, ndërsa emrat e nënfushave identifikohen me kode alfabetike ose numerike. Këto etiketa dhe kode identifikojnë fushën, llojin e të dhënave dhe funksionin e tyre. Duke përdorur etiketat e fushave dhe kodet e nënfushave shembulli i mësipërm do të paraqitej si më poshtë:

Etiketat			Të dhënat
200	1#	\$a	Shtëpia misterioze
		\$e	Novelë
		\$f	Honore De Balzak
		\$g	Përkth. K. Evangjeli
205	##	\$a	Ribot.
210	##	\$a	T.
		\$c	Apollonia
		\$d	1987
215	##	\$a	95 f.
		\$c	me il.
		\$d	26 cm.
300	##	\$a	Tit. dhe teksti edhe frengjisht
606	0#	\$a	Tregime franceze
		\$2	Lc
676	##	\$a	821.133.1 – 32
		\$v	19
700	#1	\$a	Balzak
		\$b	Honore De
990	##	\$a	S125/G12

200 1# \$aShtëpia misterioze\$eNovelë\$fHonore  
De Balzak\$gPërkth. K. Evangjeli

205 ## \$aRibot

210 ## \$aT.\$cApollonia\$d1987

215 ## \$a95 f.\$cme il.\$d26 cm.

300 ## \$aTit. dhe teksti edhe frengjisht

606 0# \$aTregime franceze\$2lc

676 ## \$a821.133.1-32\$v19

700 #1 \$aBalzak\$bHonore De

990 ## \$aS125G12

Sic shihet nga shembujt e mësipërm fushat e formatit UNIMARC i organizojnë të dhënat në përshtatje me rregullat e përshkrimit bibliografik ISBD.

Më poshtë, analizohet një regjistrim tipik në formatin UNIMARC për të kuptuar më mirë çfarë është thënë deri tani.

**Shembull: Romani i Alain-Fournier “Le Grand Meaulnes”, i përkthyer në anglisht “The  
lost domain”.**

Përshkrimi bibliografik i këtij dokumenti është:

Alain Fournier, **1886-1914**

The lost domain / Alain-Fournier; translated from the French by Frank Davison; afterword by John Fowles; illustrated by Ian Beck. - Oxford: Oxford University Press, 1959.

ix, 298 f, 10 fletë faksimile; me il, port. me ngjyra; 23cm

Përkth. nga: Le Grad Meaulnes. Paris: Emile-Paul, 1913

ISBN 0-19-212262-2: £12.95

1.T. 2.The lost domain 3.Davison, Frank 4.Romane franceze

5. 821.133.1-31

S37 / A14

B59-20618

Regjistrimi në formatin UNIMARC:

001 0192122622@

010##\$a0-19-212262-2\$d£12.95@

020##\$aUS\$b59-12784@

020##\$aGB\$b5920618@

100##\$a19590202d1959#####||y0engy0103####ba@

1011#\$aeng\$cfre@

102##\$aGB\$ben@

105##\$aac#####000ay@

2001#\$a{NSB}The {NSE}lost domain\$fAlain-Fournier\$gtranslated from the French by Frank Davison\$gafterword by John Fowles\$gillustrated by Ian Beck@

210##\$aOxford\$cOxford University Press\$d1959@

215##\$aix,298f,10 fletë faksimile\$cm e il, port. me ngjyra\$d23cm@

311##\$aPërkth. nga: Le Grand Meaulnes. Paris : Emile-Paul, 1913@

454#1\$1001db140203\$150010\$a{NSB}Le{NSE}Grand Meaulnes\$1700#0\$aAlain-Fournier\$f1886-1914\$1210##\$aParis\$cEmile-Paul\$d1913@

50010\$a{NSB}Le {NSE}Grand Meaulnes\$mEnglish@

606##\$aRomane franceze\$21c@

675##\$a821.133.1-31@

676##\$a843/.912\$v19@

680##\$aPQ2611085@

700#0\$aAlain-Fournier,\$f1886-1914@

702#1\$aDavison,\$bFrank@

801#0\$aUK\$bWE/N0A\$c19590202\$gAACR2

98700\$aS37/A14@

Përpara se të shohim fushat në detaje, është e rëndësishme të kuptohet sesi realizohet kodimi i përmbajtjes së të dhënave. Kodimi kryhet nëpërmjet numerorëve të fushave, të cilët përbehen nga elementët e mëposhtëm:

- Etiketë ose tagu: një numër tre shifror, i cili përcakton llojin e të dhënës bibliografike. P.sh. 700 përcakton autorin.

- Treguesit: dy numra një shifror të vendosur djathtas etiketës, p.sh. 700#0 që e detajon më tej fushën, ose tregon sesi duhet të trajtohet fusha gjatë prodhimit të një katalogu, p.sh. sinjalizon që shënimi duhet të bëhet. Kur treguesi është i papërcaktuar vendoset shenja # për ta dalluar nga një hapësirë boshe.

- Çdo fushë përmban një ose më shumë nënfusha, p.sh. 700#...\$b...etj në lidhje me llojin ose funksionin e informacionit. Përcaktimi i kodimit të nënfushave ndihmon për një përpunim më të detajuar të të dhënave të një fushe nga kompiuteri. Përcaktuesit e nënfushave përbehen nga një karakter special që mund të jetë karakter alfabetik i vogël, ose numër nga 0-9, dhe paraprihen nga shenja \$.

- Çdo fushë përfundon me shenjën e kufizuesit të fushës, @

Më poshtë jepet në detaje roli i etiketave, treguesve dhe përcaktuesve të nënfushave:

001 0192122622

001 (identifikuesi i regjistrimit) është një numër unik ose një kombinim gërmash dhe numrash që shërben për të identifikuar regjistrimin në një skedar. Kjo është pothuajse e vetmja fushë që nuk ka tregues. P. sh. këtu mund të regjistrohet numri i kontrollit të regjistrimit që përgatit agjencia kataloguese.

010##\$a0-19-212262-2\$d£12.95@

Kjo fushë përmban ISBN-në dhe të dhëna të tjera për të dalluar rastet kur ka më shumë se një ISBN në një regjistrim. Fusha korrespondon me zonën e Numrit Standard dhe të vlefshmërisë sipas standardit ISBD.

Kjo fushë përmban ISBN-në në nënfushën (\$a) dhe çmimin në nënfushën (\$d). Në qoftë se dokumenti ekziston dhe me lidhje tjetër, atëherë fusha 010 përsëritet edhe një herë, duke përfshirë ISBN-në dhe çmimin e dytë të shoqëruar me nënfushën \$bPbk (paperback).

Treguesit në këtë fushë nuk kanë ndonjë funksion të veçantë. Pozicionet e tyre janë plotësuar me shenjën ##.

020##\$aUS\$b59-12784@

020##\$aGB\$b5920618@

Kjo fushë përmban numrin që i vendoset regjistrimit të një dokumenti nga agjencia bibliografike kombëtare dhe kodi i vendit të agjencisë. Numri bibliografik është 59-12784 e vendosur nga Biblioteka e Kongresit dhe kodi i vendit (\$) është US.

1	2	3
012345678901234567890123456789012345		

100## \$a19790202d1959#####||y0engy0103####ba@

Kjo është një fushë me gjatësi të fiksuar ku kuptimi i çdo karakteri varet nga pozicioni i tij. Transkriptimi i mësipërm është paraprirë nga numrat 1-9 për të kuptuar me lehtë pozicionet e karaktereve (pk). Konvencionalisht pozicionet e karaktereve numërohen nga 0 deri në 35.

Pk 0-7 Tregon që regjistrimi origjinal u fut në skedarin e të dhënave të lexueshme nga makina më 2 shkurt 1979.

Pk 8-12 Tregon që është monografi (d) botuar më 1959.

Pk 13-16 Nuk përdoren për monografitë prandaj përmbajnë shenjat ##### (përdoren për serialet).

Pk 17-19 Mund të përfshihen kode që tregojnë përdoruesin, p.sh për fëmijët e moshes 9- 14 shënohet kodi (d).

Në shembullin e mësipërm këto tre pozicione janë plotësuar me karakterin mbushës ( ) që tregon që agjencia nuk ka dhënë informacion për përdoruesin.

Pk 20 Tregon se dokumenti nuk është botim qeveritar (y)

Pk 21 Tregon nese regjistrimi është modifikuar (1) ose jo (0).

Për shkak të kufizimeve të serisë së karaktereve të makinës, transkriptimi mund të zëvendësohet me transliterimin, p.sh., për shkrime të veçanta si gërmat greke ose për formula matematike speciale etj. Në këtë rast kemi të bëjmë me një regjistrim të modifikuar. P.sh., titulli i një dokumenti paraqitet në formën " I Paris ", në regjistrim do të shkruhet: " I [love] Paris ". Në këtë rast regjistrimi konsiderohet i modifikuar dhe përdoret kodi (1).

Pk 22-24 Jepet gjuha e katalogimit; në këtë rast është "eng" (anglisht)

Pk 25 Jepet kodi i transliterimit; "y" do të thotë që nuk është përdorur transliterimi.

Pk 26-33 Jepen kodet e completeve të karaktereve që janë përdorur. 01 është kodi bazë karaktereve latine, ndërsa 03 kodi i kompletit të zgjeruar të karaktereve latine. Vazhdon me katër hapësira boshe ##### që tregon se nuk janë përdorur complete të tjera karakteresh.

Pk 34-35 Jepet kodi i shkrimit të titullit të saktë të dokumentit. Në këtë rast është Latin (ba).

1011# \$aeng\$cfre@

Kjo fushë përmban informacion të koduar që lidhet me gjuhën e dokumentit. Treguesi i parë ka vlerën (1) dhe tregon që dokumenti është përkthim. Dokumenti është përkthyer në anglisht (\$aeng) nga frengjishtja (\$cfre).

102## \$aGB\$ben@

Kjo fushë përmban informacion të koduar që lidhet me vendin e botimit, ose të prodhimit të dokumentit. Në këtë rast vendi i botimit është GB (Great Britain) dhe lokaliteti “en” (England). Kodet e vendeve i përmbahen standardit ISO, ndërsa kodet e lokaliteteve përcaktohen nga agjencitë kombëtare kataloguese.

105## \$aac#####000ay@

Kjo fushë përmban të dhëna të koduara që lidhen me monografitë dhe është aq komplekse sa edhe fusha 100. Për rastin konkret tregon se dokumenti ka ilustrime (a), portret (c), ështëë prozë (a) dhe nuk është vepër biografike (y).

2001# \$a{NSB}The {NSE}lost domain\$fAlain-Fournier\$gtranslated from the French by Frank Davison\$gafterword by John Fowles\$gillustrated by Ian Beck@

Kjo fushë në përgjithësi përmban titullin, titullin paralel, informacion plotësues për titullin dhe personat përgjegjës për botimin. Kjo i korrespondon zonës së titullit dhe të autorit në (ISBD).

Fusha e titullit ka indikatorin “1”, që tregon se titulli “Lost Domain” shërben si pikë hyrëse (mund të kërkohet edhe me titull). Nuk merret parasysh në renditje “The”. Këtë funksion e luajnë karakteret speciale {NSB} dhe {NSE}. Këto karaktere nuk shfaqen as në lista, as në ekranet e kompjuterit të përdoruesit.

Në nënfushën \$f vendoset autori; në nënfushën \$g, e cila është e përsëritshme vendosen përkthyesi, ilustruesi etj.

210##\$aOxford\$cOxford University Press\$d1959@

Kjo fushë përmban informacion për botimin, shpërndarjen dhe prodhimin e dokumentit duke përfshirë datat përkatëse. Kjo fushë korrespondon me zonën e të dhënave të botimit, të shpërndarjes. të ISBD-së etj.

Në këtë rast ka vetëm tri nënfusha: \$a për *vendin* ( Oxford ), \$c për *Shtëpinë botuese* (Oxford University Press) dhe \$d për *vitin e botimit* (1959).

215##\$aix,298f,10 fletë faksimile\$come il, port. me ngjyra\$d23cm@

Kjo fushë përmban informacion për të dhënat e përshkrimit fizik të dokumentit. Kjo fushë korrespondon me zonën e përshkrimit fizik të ISBD-së.

311##\$aPërkth. nga: Le Grand Meaulnes. Paris : Emile-Paul, 1913@

Kjo fushë përmban shënime dhe tregon që dokumenti është përkthim nga origjinali frengjisht. Zakonisht ky shënim bëhet nga kompiuteri jo nga kataloguesi. Për detaje të mëtejshme shih fushën 454 më poshtë.

454#1\$1001db140203\$150010\$a{NSB}Le{NSE}Grand Meaulnes\$1700#0 \$aAlain-Fournier\$f1886-1914\$d1210##\$aParis\$cEmile-Paul\$d1913@

Kjo fushë përdoret për të lidhur dokumentin që katalogohet, i cili është përkthim, me origjinalin e tij.

Çdo nënfushë \$1 përmban: identifikuesin e regjistrimit 001, titullin uniform 500, autorin 700, dhe të dhënat e botimit 210. Në sistemet e sofistikuara nevojitet vetëm 001 dhe përdoruesi vetëm nëpërmjet kësaj fushe mund të kërkojë regjistrimin origjinal të dokumentit në frengjisht. Indikatorin i dytë "1" ( 454#1 ) do të thotë: "Të bëhet shënim". Kompiuteri në një kohë të përshtatshme mund të prodhojë fushën 311, Përkth. Nga: Le Grand Meaulnes. Paris : Emile-Paul, 1913

50010\$a{NSB}Le {NSE}Grand Meaulnes\$mEnglish@

Kjo fushë përmban titullin uniform, që përcaktohet nga agjencia kataloguese për një dokument, në të cilin gjenden disa tituj të ndryshëm.

Indikatorin "1" (50010) ka të njëjtin funksion si edhe në fushën 200, pra ta trajtojë titullin uniform si pikë hyrëse. Nënfusha '\$mEnglish' shërben për të grupuar në skedar të gjitha përkthimet në anglisht të kësaj vepre.

606##\$aRomane franceze\$21c@

Kjo fushë përmban një emër ose frazë të zakonshme që përdoret si emërtim lëndor. Në \$2 vendoset lloji i listës apo treguesit e emërtimeve lëndore që përdoren për klasifikimin lëndor. Në këtë rast është përdorur "Library of Congress Subject Headings". (Emërtimet Lëndore të Bibliotekës së Kongresit).

675##\$a821.133.1-31

Kjo fushë përmban numrat e klasifikimit sipas Klasifikimit Dhjetor Universal (KDU).

676##\$a843/.912\$v19@

Kjo fushë përmban numrat e klasifikimit sipas Klasifikimit Dhjetor të Djuj (DDC), me treguesin e botimit që përdoret. Në këtë rast është botimi i 19-të i DDC.

680##\$aPQ2611085@

Kjo fushë përmban numrat e klasifikimit sipas Bibliotekës së Kongresit.

700#0\$aAlain-Fournier,\$f1886-1914@

Kjo fushë përmban emrat e autorëve (personale ose kolektiv), të cilët kanë përgjegjësinë e parë intelektuale në krijimin e dokumentit që regjistrohet.

Indikatori i dytë është 0, ( 700#0 ) dhe tregon që autori është futur me emër. Në nënfushën \$f vendosen datat e lindjes dhe të vdekjes së autorit.

702#1\$aDavison,\$bFrank@

Kjo fushë përmban emrat e autorëve (personal ose kolektiv), të cilët kanë përgjegjësi dytësore intelektuale në krijimin e dokumentit që regjistrohet.

Në këtë rast Davison, Frank është përkthyesi. Treguesi i dytë është 1, ( 702#1 ) dhe tregon që autori është futur me mbiemër në nënfushën \$a. Emri futet në nënfushën \$b.

801#0\$aUK\$bWE/N0A\$c19590202\$gAACR2

Kjo fushë përmban të dhëna për burimin origjinal të regjistrimit ku përfshihen: agjencia që krijon të dhënat, agjencia që transkripton të dhënat në formë të lexueshme për makinën, çdo agjenci që ka modifikuar regjistrimin, si edhe të dhënat origjinale dhe agjencinë që ka botuar regjistrimin.

Kjo përdoret veçanërisht për katalogët përmbledhës, të cilët përmbajnë regjistrime nga agjenci të ndryshme kataloguese. Në nënfushën \$a futet kodi i vendit (UK) të agjencisë që ka krijuar regjistrimin, në \$b agjencia kataloguese (WE/N0A), në \$c data



e krijimit të regjistrimit (2 shkurt 1979), ndërsa në nënfushën \$g futet kodi i rregullave të katalogimit, që në këtë rast është AACR2, botimi 2-të.

98700\$aS37/A14@

Siç thamë më sipër, blloku 9— rezervohet për përdorim kombëtar nga agjencitë, të cilat përdorin formatin UNIMARC. Këto fusha mund të përmbajnë çdo informacion lokal.

Kjo fushë në këtë rast përmban numrin e vendit të dokumentit.

## V. SI PUNON FORMATI UNIMARC ?

Regjistrimet bibliografike në formatin UNIMARC përdoren nga sistemet e automatizuara bibliotekare. Në varësi nga shumanshmëria e sistemit të zgjedhur, një sërë funksionesh mbështeten nëpërmjet përpunimit të të dhënave. Dy nga këto funksione janë: kërkimi i informacionit dhe paraqitja e përshkrimit bibliografik të regjistrimit.

### Kërkimi i informacionit

Në formatin UNIMARC çdo element i të dhënave identifikohet për qëllime kërkimi. Duke përdorur një program kompiuteri, mundësohet kërkimi në shumicën e fushave dhe të nënfushave të formatit UNIMARC në një regjistrim. Më poshtë jepen disa elemente të përshkrimit bibliografik, që shërbejnë si elementë kërkimi:

- *Fjalët kyçe (fjalë të rëndësishme);*
- *Emërtimet lëndore;*
- *Autori;*
- *Titulli dhe seria;*
- *Numrat standard (ISBN, ISSN) si dhe numra të shënuar nga agjencitë • kataloguese;*
- *Numrat e klasifikimit;*
- *Botuesi;*
- *Data e botimit;*
- *Shkurtime të formuara nga emra dhe fjalë titulli;*
- *Elemente të koduar. (Psh. 'Prozë' mund të na zgjedhë shembullin e mësipërm, sepse në fushën 105 pozicioni i karakterit 11 e përcakton atë si 'Prozë').*

### Paraqitja e përshkrimit bibliografik të regjistrimit

UNIMARC ofron zgjedhje të formateve për paraqitjen e regjistrimit. Lexuesi nuk

do të dëshironte të konsultohet me regjistrimin e plotë të UNIMARC-ut, sepse ky shërben për përpunimin e të dhënave nga kompiuteri dhe nuk është praktik për lexuesin. Në vartësi të sistemit të automatizimit, hedhja e të dhënave në kompiuter mund të jetë e organizuar me shfaqjen në ekran të fushave dhe nënfushave të formatit MARC ose në formë tjetër më të thjeshtë, sipas fushave të emërtuara për autorin, titullin etj. Programi organizon të dhënat sipas formatit MARC dhe shfaqjen e regjistrimeve sipas formateve të dëshiruara nga biblioteka. Lexuesi e ka më të lehtë të përdorë formatin e skedës së katalogut (shih. shembullin e analizuar më sipër sipas formatit të përshkrimit bibliografik, në paragrafin *Regjistrimi sipas etiketave të UNIMARC-ut*).

## VI. ADMINISTRIMI I UNIMARC -ut.

UNIMARC administrohet nga Komiteti i Përhershëm i IFLA-s (*Permanent UNIMARC Committee, PUC*), nën kujdesin e programit UBCIM (Universal Bibliographic Control and International MARC Programme), i cili vëzhgon zhvillimin e formatit dhe siguron që ndryshimet të përfshijnë edhe regjistrimet e bëra më parë.

Propozimet për ndryshime vijnë nga agjencitë, të cilat krijojnë ose përdorin regjistrimet në UNIMARC. UNIMARC-u zhvillohet në përputhje me standardet ndërkombëtare të përshkrimit bibliografik (ISBD).

Projektet për krijimin e katalogëve të specializuar ndërkombëtar janë bërë të mundshëm nga ekzistenca dhe mirëmbajtja e UNIMARC-ut.

## VII. FORMATI UNIMARC I TERMAVE TË UNIFIKUAR (UNIMARC/AUTHORITIES)

### Hyrje

Krijimi i formatit UNIMARC për shkëmbimin e regjistrimeve bibliografike krijoi nevojën e menjëhershme të zhvillimit edhe të një formati tjetër shoqërues për transmetimin e regjistrimeve të *termave të unifikuar* të kryetitujve (Tu). IFLA iu përgjigj kësaj nevojë me zhvillimin e një standardi për përmbajtjen dhe paraqitjen e informacionit të Tu, duke krijuar formatin UNIMARC të Termave të unifikua (UNIMARC/Authorities). UNIMARC i Termave të unifikuar është pjesë e formateve të ndërvarura të UNIMARC-ut që do të thotë që duhet t'i përmbahet disa standardeve. Këto lidhen me tri pjesë bazë të formatit të regjistrimit të lexueshëm nga makina:

1. Struktura e regjistrimit, është paraqitja fizike dhe planimetria e informacionit.
2. Përcaktuesit e përmbajtjes të regjistrimit, të cilët identifikojnë informacionin rreth elementëve.
3. Përmbajtja e të dhënave të regjistrimit, të cilat janë të dhënat që transmetohen.

Nga sa më sipër është e nevojshme:

*Së pari*, formati UNIMARC i Tu të strukturohet në përputhje me formatin UNIMARC, përderisa të dy llojet e regjistrimeve do të përdoren së bashku në sistemet

e automatizuar. Standardi ISO 2709 (për shkëmbimin e informacionit bibliografik) duhet të përdoret duke zgjedhur të njëjtat opsione si në UNIMARC.

*Së dyti*, përcaktimi i përmbajtjes për Tu të jetë i njëjtë si në formatin UNIMARC, ku elementët e të dhënave të njëjta janë prezente në të dy formatet.

Bashkëveprimi i kryetitujve në regjistrimet bibliografike dhe i Tu nuk duhet të ngarkohet me ndryshime në përcaktimin e përmbajtjes, që kompatibiliteti të ketë një efekt direkt në lehësimin e të kuptuarit dhe të përdorimit të formatit.

Formati UNIMARC i Tu specifikon etiketat, treguesit dhe përcaktuesit e fushave dhe të nënfushave për regjistrimet e Tu, për referimet dhe shënimet shpjeguese të përgjithshme në formë të lexueshme nga makina. Këto regjistrime krijohen për të ndihmuar përdorimin e katalogëve të emrave (vetjakë, të familjes, të organizmave, gjeografike), të titujve uniformë dhe të subjekteve. Të gjithë këto emra të përmendur më sipër, tituj dhe subjekte përdoren në regjistrimet bibliografike si elemente hyrës kryesorë, shtesë dhe alternative.

### Qëllimi

Qëllimi kryesor i formatit UNIMARC të Tu është të ndihmojë shkëmbimin ndërkombëtar të të dhënave të Tu në formë të lexueshme nga makina midis agjencive bibliografike kombëtare.

Kjo parashikon që çdo agjenci bibliografike kombëtare është përgjegjëse për konvertimin e regjistrimeve të Tu në formatin UNIMARC të Tu për transmetimin tek agjenci të tjera kombëtare dhe të marrë regjistrime të lexueshme nga makina në formatin UNIMARC të Tu nga agjenci të tjera kombëtare. Formatin UNIMARC i Tu paracakton informacionin që kërkohet për një sërë procesesh bibliografike.

### Kontrolli i Termave të unifikuar

Të kuptosh strukturën dhe funksionimin e formatit UNIMARC të Tu, në rradhë të parë është e nevojshme të kuptohet koncepti "*Kontrolli i Termave të unifikuar*". Ky funksion përfshin aspekte të nevojshme të integritetit të një baze të dhënash; siguron një bazë të dhënash cilësore, ku përdoruesit dhe bibliotekarët të jenë në gjendje të përdorin katalogët dhe koleksionet e bibliotekës me efektivitet.

Kontrolli i Tu është kontrolli që kryhet për përdorimin e formave unike të termave që shërbejnë si pika hyrëse ose elemente kërkimi në një katalog.

Qëllimet kryesore të kontrollit të Tu në një katalog biblioteke janë:

*Së pari*, të sigurojë uniformitetin e termave, dmth të përdoren terma uniforme për emrat, disa lloje titujsh dhe emërtimesh lëndore që përdoren si pika hyrje apo pika kërkimi. Duke përcaktuar një formë standarde të një fjale ose një fraze që përdoret në

një katalog si pikë hyrjeve, biblioteka mund të sigurojë që përdoruesi i katalogut të mund të gjejë edhe format e tjera që lidhen me to. P.sh. Disa autorë i kanë shkruar veprat e tyre duke përdorur forma të ndryshme të emrave të tyre, si “*Rose M. Miller*”, “*Rose Mary Miller*” dhe “*Rose Miller*”. Përdoruesi i katalogut, të cilit i interesojnë veprat e këtij autori, duhet të njohë të gjitha format e mundshme të emrit të këtij autori për t’i gjetur ato në katalog, në mungesë të kontrollit të Tu. Kontrolli i Tu është një kontroll cilësor i katalogëve të bibliotekës që arrihet nëpërmjet përdorimit të formës uniforme standarde për emrat dhe subjektet që janë pika kërkimi. Me ndihmën e kontrollit të Tu përdoruesi mund të gjejë të gjitha veprat e një autori nën të njëjtin kryetitull. Përveç kësaj duke sqaruar lidhjen midis formave të ndryshme që përdoren për të njëjtin autor, kontrolli i Tu dallon ndryshimet midis autorëve që përdorin të njëjtin emër. P.sh. Ka dy autorë të ndryshëm me të njëjtin emër *Marc Brawn* të vendosur në skedarin e Tu të emrave vetjake. Në këtë rast veprat e këtyre dy autorëve të ndryshëm, por me emra të njëjtë do të renditeshin nën të njëjtin emër gjë që do të sjellë konfuzion në përdoruesit e katalogut. Në këtë rast bëhet dallimi i tyre nëpërmjet emrit të tretë. Për njerin nga *Marc Brawn* forma uniforme bëhet *Marc Tolon Brawn*, dhe tjetri bëhet *Marc H. Brawn*. Zakonisht si formë uniforme e një autori merret ajo formë që përdoret më shumë në veprat e tij. Në disa raste kur autorë të ndryshëm përdorin emra të njëjtë në veprat e tyre, vendoset viti i lindjes ose ndonjë veçori tjetër për t’i dalluar nga njëri-tjetri.

Së dyti, të sigurojë referimet për termat që lidhen me formën uniforme të kryetitullit. Nëse, një përdorues katalogu kërkon nën “*Rose M. Miller*”, ndërkohë kur forma uniforme e përdorur nga biblioteka është “*Rose Miller*”, është i domosdoshëm një referim për formën alternative *Rose M. Miller*, për ta drejtuar përdoruesin në formën uniforme “*Rose Miller*”. Sistemi i referimeve në kontrollin e Tu, e drejton përdoruesin nga një formë variante të një emri në formën uniforme të vendosur të tij. Në këtë mënyrë përdoruesi i katalogut të bibliotekës mund të gjejë me lehtësi të gjitha materialet në të njëjtin vend. Përveç kësaj sistemi i referimeve nuk e mundon përdoruesin që të marrë me mend format e ndryshme variante për të njëjtin emër.

Koncepti i kontrollit të TU përdoret në përgjithësi edhe për lloje të tjera pika hyrëse përveç emrit vetjak, si emra organizmash, emra gjeografikë, emra serish, tituj uniformë dhe emërtime lëndore.

Ndodh që e njëjta seri është vendosur në libër në forma të ndryshme. P.sh. “*Contemporary art and culture*” dhe “*Contemporary arts and culture*”. Ndryshimi midis këtyre dy formave është shumësi i fjalës *art*. Pa kontrollin e Tu këto dy forma të ndryshme do të renditen në vende të ndryshme në skedar dhe përdoruesi duhet t’i kërkojë të dy variantet. Duke përdorur kontrollin e Tu përcaktohet një titull uniform për serinë (zakonisht merret titulli që përdoret më shpesh nga botuesi) dhe atëhere botimet e të njëjtës seri (por të shkruar në forma të ndryshme) do të vendosen në të njëjtin vend në skedar duke praktikuar krahas titullit uniform edhe referimet për format alternative.

Kontrolli i Tu për emërtimet lëndore nënkupton që si pikë hyrëse do të përdoret termi lëndor standard, me referime për format variante të emërtimeve lëndore dhe për emërtimet lëndore që lidhen me të. Kontrolli i Tu për emërtimet lëndore gjithashtu diferencon të njëjtën fjalë të përdorur për kuptime të ndryshme. Kataloguesi i zgjedh emërtimet lëndore nga lista të miratuara.

Duke folur në vija të përgjithshme struktura e formatit UNIMARC të Tu bazohet në strukturën dhe përdorimin e regjistrimeve të Tu dhe referimeve që tradicionalisht janë përdorur në skedarët me skeda. Shembujt e mëposhtëm paraqesin skedën tradicionale të katalogimit të Tu, dhe regjistrimin korrespondues në formatin UNIMARC të Tu, si dhe referimet që lidhen me Tu për katalogun me skeda dhe katalogun e kompiuterizuar.

Skeda tradicionale për Tu të emrit të autorit që përdoret nga kataloguesi për skedarin me skeda:

**Simons, Dennis L. (Dennis Lee)**

**PP Simons, Dennie**

Skeda referuese e një regjistrimi të TU të autorit :

**Simons, Dennie**

**Shih**

**Simons, Dennis L. (Dennis Lee)**

Regjistrimi i Tu të autorit në formatin MARC:

200 #1 \$aSimons, \$bDennis L.\$q(Dennis Lee)

400 #1 \$aSimons, \$bDennie.

Shembujt e mësipërm ilustrjnë rastin kur autori përdor emrin e parë dhe të mesit të plotë në shumicën e veprave të tij dhe në disa raste përdor dhe pseudonimin “Dennie”. Forma unike e kryetitullit është “*Simons, Dennis L. (Dennis Lee)*”. Për arsye se disa përdorues mund të jenë familiarizuar me pseudonimin që ai përdor në veprat e tij

përdorimi i referimit për pseudonimin e çon përdoruesin tek forma unike e emrit të tij nën të cilin gjendet të gjitha veprat e tij.

### **Sruktura dhe kodet e formatit UNIMARC të termave të unifikuar (Tu)**

Formati UNIMARC i Tu shërben për të koduar informacionin që gjendet në regjistrimet e Tu. Regjistrimet e Tu mund t'i ndajmë në dy kategori kryesore: në regjistrime të Tu të emrave dhe në regjistrime të Tu të subjekteve. Kryetitujt e emrave përfshijnë : emra vetjakë, emra organizmash, emra gjeografikë, emra familjesh, tituj uniformë; ndërsa kryetitujt e subjekteve përfshijnë subjektet lëndore. Të gjitha këto shërbejnë si pika hyrëse ose elemente kërkimi në një katalog të komputerizuar.

Struktura dhe kodet e formatit UNIMARC të Tu janë në thelb të njëjtë me ato të formatit bibliografik UNIMARC. Kjo nënkupton që i gjithë informacioni që gjendet në një regjistrim MARC të Tu është i ndarë në fusha fikse dhe të ndryshueshme, në fusha të ndryshueshme që ndahen në nënfusha dhe ashtu si fushat dhe nënfushat e formatit bibliografik MARC bazohen në strukturën e regjistrimeve të katalogut të bibliotekës; edhe fushat e formatit MARC të Tu bazohen në fushat që pëdoren në skedaret e Tu manuale. P.sh. Formatit MARC i Tu përfshin fusha të veçanta për kryetitujt dhe tipe të ndryshme referimesh (p.sh “shih” dhe “shih edhe”) si dhe fusha shënimesh. Përveç kësaj në të dy formatet MARC bibliografik dhe MARC i Tu përfshihet edhe informacion shtesë nga ai tradicional, duke i dhënë një avantazh të madh sistemeve të automatizuara.

### **Funksionet e blloqeve**

Regjistrimi i termave të unifikuar përbëhet nga nëntë blloqe. Blloqet janë si më poshtë:

0xx Blloku i identifikimit	5xx Blloku i referimeve “Shih edhe”
1xx Blloku i inform. të koduar	6xx Blloku i numrave të klasifikimit
2xx Blloku i kryetitullit	7xx Blloku i lidhjeve të kryetitullit
3xx Blloku i shënimeve informuese.	8xx Blloku i burimit të informacionit.
4xx Blloku i referimeve “Shih”	

0xx Blloku i identifikimit: përmban numra që identifikojnë regjistrimin ose Tu.

1xx Blloku i informacionit të koduar: përmban elementë të dhënash me gjatësi fikse (shpesh të koduar) që përshkruajnë aspekte të veçanta të regjistrimit apo të të dhënës.

2xx Blloku i kryetitullit: përmban Tu, referimin ose shënimin shpjegues për të cilin

është krijuar regjistrimi.

3xx Blloku i shënimeve informuese: përmban shënime që shpjegojnë në mënyrë të mjaftueshme lidhjen e kryetitullit në fushën 2xx me kryetituj të tjerë.

4xx Blloku i referimit Shih: përmban kryetituj variante për të cilët bëhet referimi për kryetitullin në fushën 2xx të regjistrimit. Ky bllok përmban referimin Shih.

5xx Blloku i referimit Shih edhe: Përmban kryetituj uniformë që lidhen me kryetitullin e regjistrimit në fushën 2xx. Ky bllok përmban referimin Shih edhe.

6xx Blloku i numrave të klasifikimit: përmban numrat e klasifikimeve që lidhen me kryetitullin e regjistrimit.

7xx Blloku i lidhjeve të kryetitullit: Kjo fushë përmban një kryetitull uniform tjetër nga ai i kryetitullit të regjistrimit në fushën 2xx.

8xx Blloku i burimit të informacionit: përmban informacion për origjinën e regjistrimit si dhe për agjencitë përgjegjëse të regjistrimit.

9xx Blloku për përdorim kombëtar: përmban të dhëna lokale. Ky bllok nuk përfshihet në shkëmbimin e të dhënave në formë të lexueshme nga makina midis agjencive bibliografike.

Çdo bllok përmban një numër fushash dhe çdo fushë ka disa nënfusha. Në disa fusha ka tregues, që karakterizojnë përmbajtjen e përgjithshme të fushës sipas vlerave të dhëna, vendosin raportet midis fushave ose përcaktojnë procedurën e përpunimit të të dhënave.

Jane 3 tipe të regjistrimeve të termave të unifikuar:

1- *Regjistrime të termave të unifikuar*; ku elementi i parë është një kryetitull për një emër apo subjekt të përcaktuar nga agjencia bibliografike përgjegjëse. Kodohet me "x"

2- *Regjistrime referuese*, ku elementi i parë është një variant i kryetitullit uniform. Këto regjistrime referojnë për tek regjistrimet e termave të unifikuar (referimi "Shih"). Kodohet me "y".

3- *Regjistrime shpjeguese të përgjithshme*, ku elementi i parë i tyre informon dhe udhëzon përdoruesin. Kodohet me "z".

Formati UNIMARC i Tu siç e thamë edhe më lart, ndihmon që agjencia bibliografike të vendosë në të njëjtin vend në skedar termat e unifikuar të një autori, të një organizmi etj., së bashku me referimet për format e tjera të emrit. Këto të dhëna lidhen me regjistrimin bibliografik nëpërmjet nënfushës \$3 (Numri i regjistrimit të Tu) me fushat e bllokut 7xx të formatit bibliografik.

Më poshtë jepet regjistrimi UNIMARC i Tu për kryetitull emër vetjak. Janë dy shembuj tipikë për dy regjistrime të thjeshta:

Tipi i regjistrimit; "x" (regjistrim i termit të unifikuar)

```
001 A369875@
100## $a19810715aaly0103####ba@
152## $aAACR2@
200#1 $Stewart, $bJ.I.M.@
500#1 $0Per veprat e shkruara me emrin e tij real shih$aInnes, $bMichael
      $3B329638$
801#0 $aUK$bBL$c198110629@
810## $aWho's who@
```

Tipi i regjistrimit; "x" (regjistrim i termit të unifikuar)

```
001 B329638@
100## $a19810716aaly0103####ba@
152## $aAACR2@
200#1 $aInnes, $bMichael@
500#1 $0Për veprat e shkruara me pseudonim e tij shih $aStewart, $bJ.I.M.
      $3A369875@
801#0 $aUK$bBL$c198110629@
810## $aWho's who@
```

Të dy shembujt janë të ngjashëm, po shpjegojmë vetëm të dytin:

```
01 B329638@
```

001 është fusha e identifikuesit të regjistrimit

```
100## $a19810716aengy0103####ba@
```

100 është fusha e të dhënave të përpunimit të përgjithshëm, e ngjashme me fushën 100 të formatit bibliografik. Në të jepet data e regjistrimit (16 korrik 1981), regjistrimi është përfundimtar (jo provizor) "a", gjuha e katalogimit është gjuha shqipe "al", nuk janë përdorur sisteme transliterimi "y", "0103" tregon që janë përdorur komplete të karaktereve latine dhe shkrimi i katalogimit është në alfabetin latin "ba".

```
152## $aAACR2@
```

Fusha 152 është fusha e rregullave të katalogimit. Regjistrimi i përmbahet rregullave të AACR2. Një informacion i njëjtë me këtë gjendet dhe në fushën 801 \$g të formatit bibliografik.



200#1 \$aInnes, \$bMichael@

Fusha 200 është për autorin vetjak, treguesit dhe kodet e nënfushave, ndjekin fushën 700 të formatit bibliografik.

500#1 \$OPër veprat e shkruara me pseudonim e tij shih\$aStewart, \$bJ.I.M.  
\$3A369875@

Në fushën 500 është vendosur referimi “shih edhe “ për autorin vetjak, treguesit dhe kodet e nënfushave ndjekin fushën 700 të formatit bibliografik. Në nënfushën \$3 vendoset numri i regjistrimit për kryetitullin *J.I.M. Stewart* nëpërmjet së cilës bëhet lidhja me fushën 700 të formatit bibliografik.

801#0 \$aUK\$bBL\$c198110629@

Kjo fushë si dhe në formatin bibliografik jep vendin, institucionin dhe datën e fundit të regjistrimit nga agjencia përgjegjëse.

810## \$aWho's who@

Në këtë fushë jepet informacioni për burimin nga është marrë e dhëna; është fjalori biografik “Who's who”.

## BIBLIOGRAFI

*ISBD(G): General International Standard for Bibliographic Description...* - Revised ed. ; prepared by the ISBD Review Committee Working Group set up by IFLA Committee on Cataloguing.- München, London, New York, Paris : K G Saur, 1992.

*ISO 1001-1986. File structure and labelling of magnetic tape for information interchange.*

*ISO 2709-1981. Format for bibliographic information interchange on magnetic tape.*

*UNIBASE: UNIMARC Demonstration Database.*- Frankfurt : IFLA Universal Bibliographic Control and International MARC Programme, 1994.

*UNIMARC in Theory and Practice : Proceedings of Workshop Held in Sydney, Australia.* 1988.-

London : IFLA Universal Bibliographic Control and International MARC Programme, 1989. (Available from K G Saur).

*UNIMARC/Authorities.*- München, London, New York, Paris : K G Saur, 1991.

*UNIMARC and CDS/ISIS: Proceedings of Workshops Held in Budapest, 21-22 June 1993 and Barcelona, 26 August 1993.*- München, London, New Providence, Paris : K G Saur, 1994.

*UNIMARC/CCF : Proceedings of Workshops Held in Florence, 5-7 June 1991.*- München, London, New York, Paris : K G Saur, 1993.

*UNIMARC Manual : Bibliographic Format.*- 2<sup>nd</sup> ed.- München, London, New Providence, Paris : K G Saur, 1994.

## INTRODUCTION IN UNIMARC FORMAT

*The International format MARC (UNIMARC) makes easy international exchange of data in Machine Readable Catalogue between National Bibliographic Agencies.*

*This format had been developed for the first time in the Library of Congress. Later, following the development of information according to international standard of bibliographic description and unification of authority files, it changed.*

*The structure, the contents, the role, the administration of UNIMARC format and its function in the service of information retrieval are largely treated in the article.*


## LIBECON 2000 - FACTSHEET



LIBECON 2000 is an ongoing study of the activity of libraries in 29 countries in Europe. The project will report on the scope and scale of libraries in the economic context of Europe in the year 2000.

For more information, visit the web-site:

[www.libecon2000.org](http://www.libecon2000.org)



# LIBECON 2000

**Nxjitje zhvillimit të  
kulturës së  
komunitetit<sup>1)</sup>**

**Rob DAVIES**

MDR Partners,  
Londrë (Angli)

Bibliotekat publike të Europës gjenden sot në një udhëkryq zhvillimi si pasojë e një vargu faktorësh si:

- nga njëra anë, sfidat shoqërore, të përfaqësuara nga një nivel i lartë i problematikës shoqërore europiane;

- dhe nga ana tjetër potenciali i ofruar nga zhvillimet e Teknologjive të Shoqërisë së Informacionit (TSHI), të cilat kanë sjellë me vete implementimin në rritje të shërbimeve të reja.

Në përgjigje të kësaj situatë, bibliotekat publike po ndryshojnë me shpejtësi, por është e nevojshme që ato të ndryshojnë edhe më shpejt. Kërkesa për disa shërbime të mirënjohura nga ana e bibliotekave publike të tilla si huazimi i literaturës artistike të rriturve është dukshëm në rritje në disa pjesë të Europës.

<http://www.andit-commission.gov.uk/publications/fair libraries.html>

Kjo është përgjigje ndaj një vargu fenomenesh, përfshirë këtu aksesin në informacion përmes Internetit, numrin e madh të formave dhe të përmbajtjes së mediave kulturore (TV digjital, veprimtari me bazë sistemet kompiuterike etj.) dhe rritjen e numrit të njerëzve që preferojnë të blejnë në sasi të konsiderueshme libra për lexim në vend që t' i marrin ato nga biblioteka.

Megjithatë, bibliotekat publike ruajnë rolin e tyre të rëndësishëm për garantimin e një shoqërie informacioni. Mbështetja për leximin dhe vetëdija e formuar mbi vlerën e literaturës së shtypur mbeten qëllim kryesor: forca e teknologjisë së

shoqërisë së informacionit dhe e World Wide Web-it mund të shfrytëzohen për këtë qëllim. Kjo, mbase, është veçanërisht e rëndësishme për fëmijët në një kohë kur kaq shumë stimuj konkurues janë të pranishëm, por kur pasuria dhe llojshmëria e asaj që ekziston në formë të shtypur nuk është ende e disponueshme *online*. Në ato pjesë të Europës që ende janë në tranzicion ekonomik, sigurimi nga ana e bibliotekave publike i një aksesit të përballueshëm për lexim në formën e tij origjinale mbetet jetësor, por ekziston krahas kësaj dukurie nevoja për sigurimin e aksesit në Internet dhe shërbimet online (në rrjet). Bibliotekat publike në këto vende, për pasojë, përballen me të dy problemet njëherazi, pavarësisht se shpesh me mjete financiare të pamjaftueshme.

Duket se shërbimet informuese në rritje të siguruara në largësi dhe përdorimi i Internetit për kërkim informacioni do të çojnë në rritjen e numrit të vizitave fizike në bibliotekat publike. Ende mbetet një nevojë e madhe për shërbime në rrjet të vlefshme, që do të përballonin kërkesat e përdoruesve dhe që do të ishin të shfrytëzueshme prej të gjithëve. Bibliotekat publike janë në një pozicion të përshtatshëm për të luajtur një rol të rëndësishëm për zhvillimin dhe të ardhmen e këtyre shërbimeve.

Mjaft fëmijë europianë po rriten me njohuri të sakta dhe intuitive në përdorimin e Internetit dhe të teknologjive të shoqërisë së informacionit. Por mbeten mjaft të rritur dhe fëmijë të përjashtuar, të cilët nuk kanë as akses as aftësi në përdorimin e këtyre shërbimeve.

Bibliotekat publike duhet të përqendrohen më intensivisht në kërkesat e grupeve të tillë të veçantë.

Përbajtja e partneritetit mes bibliotekave publike dhe institucioneve të tjera lokale kulturore si muzetë dhe arkivat, po qartësohet gradualisht. Ka një nevojë të qartë për evidentimin, njohjen dhe shfrytëzimin e përbajtjes digjitale lokale që aktualisht zotërojnë arkivat dhe muzetë, e cila mund të mbështesë ndjenjën e të genit lokal në një botë që gjithnjë e më tepër po globalizohet.

Ndërveprimi dhe shfrytëzimi tërësor i kësaj përbajtjeje, mbështetur mbi atë që tashmë po bëhet e mundur nga bibliotekat publike si qendra informimi të komunitetit dhe në rolin e tyre si qendra të mësuarit, mund të japë fryte të mëtejshme në të ardhmen. Ndihet nevoja për të siguruar shërbime në rrjet që rritin mundësinë e qytetarëve për të lidhur plotësimin e kërkesave të tyre të tashme me një njohje të rrethanave të tyre historike, si mjedisi i arsimimit, qeverisja elektronike, argëtimi, jeta familjare ose puna. Një zhvillim i tillë duket i rëndësishëm për zhvillimin e një shoqërie të shëndetshme dhe të balancuar në të gjithë Europën.

Në mënyrë të pashmangshme zgjidhja e këtyre çështjeve do të ngrejë në dekadën e ardhshme pyetje - të cilave nuk mund t' u përgjigjemi lehtësisht sot - rreth shtrirjes së rrjetit të bibliotekave publike, natyrës së tij, pranisë në mjedisin virtual si dhe stafit dhe të aftësive që lipsen për përbushjen e këtij roli gjithnjë në zhvillim.

122 milion përdoruesit e regjistruar të bibliotekave publike në 29 vende të Europës (LibEcon) vërtetojnë rëndësinë

dhe ndikimin e fuqishëm të bibliotekave publike në shoqëri. Për të realizuar gjithë potencialin e tyre në epokën digjitale, bibliotekat publike duhet të jenë të përgatitura të ofrojnë shërbime digjitale të reja dhe novatore, të cilat u japin mundësi qytetarëve të arrijnë me sukses synimet e tyre personale në një botë që ndryshon dhe të kontribuojnë për një shoqëri gjithpërfshirëse dhe një ekonomi europiane të bazuar në informacion.

Në Këshillin e Lisbonës më 2000 udhëheqësit e shteteve dhe qeverive të Europës shpallën objektivin e shndërrimit në "ekonominë më konkurruese dhe më dinamike me bazë informacionin në Europë". Kjo u mbështet nga një angazhim financiar në dobi të gjithpërfshirjes sociale për një gjysmë bilion qytetarë të vendeve të Bashkimit Europian dhe të anëtarëve kandidatë si një e drejtë e tyre dhe si një faktor i konkurrencës ekonomike njëherazi.

[http://europa.eu.int/comm/employment\\_social/news/2001/oct/i011395\\_en.html](http://europa.eu.int/comm/employment_social/news/2001/oct/i011395_en.html)

*Plani i veprimit e-Europe, i cili u konceptua si një mjet për arritjen e këtij qëllimi, propozonte një varg masash për arritjen e tre qëllimeve kulmore:*

- një Internet më të lirë, më të shpejtë dhe të sigurtë;
- investim në njerëz dhe aftësim të tyre;
- nxitje të përdorimit të Internetit.

Mes aksioneve madhore të propozuara për mundësimin e të punuarit në

ekonominë e bazuar në informacion - dhe të një lidhjeje të drejtpërdrejtë me bibliotekat publike - ishte edhe krijimi i pikave të aksesit publik në Internet, lehtësisht të përdorshme në hapësira publike dhe ngritja e tele-qendrave multimediale në të gjitha komunitetet, që do të sigurojnë akses për trajnimin dhe punën elektronike. Në këtë plan veprimi bibliotekat publike ishin përcaktuar si format më të përshatshme ekzistuese për këto qendra.

Që nga marsi i vitit 2002 niveli i futjes së Internetit nëpër familje është rritur më tepër se dy herë (38%); çmimi mesatar i thirrjeve telefonike në distancë ka rënë në mënyrë të dukshme dhe rreth 90% e shkollave të të gjithë Bashkimit Europian tani janë në rrjet. Por, megjithatë, mbetet ende shumë për t'u bërë.

Në mbledhjen e Këshillit Europian mbajtur në Barcelonë më 15-16 mars 2002, kryetarët e shteteve dhe të qeverive të 15 shteteve anëtare të BE-së rishikuan programin e Shoqërisë Europiane të Informacionit. Një plan i ri veprimi *e - Europe 2005* u paraqitua në këshillin europian në Sevilie (21-22 qershor 2002). Ai synon arritjen e mundësive të pakufishme dhe të përdorimit të rrjeteve me reze të gjera si dhe të shërbimeve sa më ndërvepruese në të gjithë BE-në. Në të ardhmen vemendja do të përqendrohet në çështje të tilla si siguria e rrjetit dhe e informacionit, e formave elektronike të qeverisjes, të të mësuarit, shëndetit, tregtisë dhe argëtimit. Synimi do të jetë vënia e përdoruesve në qendër të vemendjes.

Ç'rol mund të luajnë bibliotekat publike

në një e-Europe dhe në përballimin e problemeve të mëdha sociale me të cilat ndeshet Europa sot dhe deri më 2010?

Janë 60 milion njerëz në BE sot (18% e popullsisë) që janë të varfër ose të rrezikuar nga skamja. Varfëria relative ndryshon në mënyrë të konsiderueshme në shtetet anëtare nga 8% në Danimarkë deri në 23 % në Portugali. Veçanërisht fëmijët dhe të rinjtë, të moshuarit, familjet e të papunëve dhe të të braktisurve nga prindërit kanë një shkallë të lartë rreziku të varfërisë.

Ndryshime të rëndësishme strukturore po ndodhin në shoqëri, të cilat megjithëse pozitive për shumicën e njerëzve, mund të çojnë në rreziqe të reja varfërie dhe në përjashtim social të grupeve të veçanta të cënueshme, që përfshijnë:

- ndryshimet në tregun e punës për shkak të globalizimit dhe të rritjes tepër të shpejtë të shoqërisë së bazuar në informacion dhe të teknologjive të shoqërisë së informacionit;
- ndryshimet demografike me njerëz që jetojnë më gjatë dhe ulje të numrit të lindjeve;
- një tendencë në rritje drejt diversitetit etnik, kulturor dhe fetar si rezultat i rritjes së lëvizjes dhe të migrimit ndërkombëtar brenda BE-së;
- ndryshimet në strukturat e familjes me uljen e përqindjes së lindjes;
- deinstitutionalizimi i jetës familjare;
- ndryshimi i rolit të burrave dhe të grave.

Një Europë gjithëpërfshirëse duhet të shfrytëzojë burimet e pasura të aftësive

dhe të kapitalit njerëzor që janë momentalisht të pashfrytëzuara si duhet dhe për shkak të të cilave BE-ja vazhdon të shihet ende të jetë e interesuar për interesat e biznesit të madh, më tepër sesa për njerëzit e thjeshtë.

Teknologjitë e informacionit dhe shërbimet në rrjet kanë një forcë të madhe për kapërcimin e pengesave tradicionale që përjashtojnë më të varfërit në shoqëri. Teknologjitë e reja mund të shërbejnë për shpërndarjen e dijes në mënyrë më krijuese dhe më të barabartë. Ato lejojnë akses më të lehtë dhe më të shpejtë në shërbimet publike.

Me rritjen e zhvillimit teknologjik shërbimet në rrjet do të bëhen më pak të varura nga përdorimi i kompiuterit, duke krijuar mundësi për tërheqjen e grupeve të reja përdoruesish. Telefonat e lëvizshëm tashmë po përdoren më gjerësisht se Interneti, megjithëse fitimet nga teknologjia WAP janë ende mjaft të ulëta. Shërbimet në rrjet janë të afta të forcojnë identitetet kulturore dhe integrimin shoqëror. Teknologjitë e shoqërisë së informacionit mund të aktivizojnë potencialin kulturor të njerëzve me aftësi të kufizuara.

Komunikacionet e lëvizshme të përparuara si 3G dhe TV digjital mundet të përcaktojnë gjithnjë e më tepër mundësitë sociale. Është e rëndësishme të parandalohen rreziqet e reja të përjashtimit të të varfërve (p.sh çmimi). Bibliotekat publike, përmes dhënies së aksesit në shërbimet e tyre nëpërmjet kanaleve të reja, mund të ndihmojnë për t' ia arritur kësaj.

Bibliotekat publike i shërbejnë të mirës së përgjithshme. Si pika aksesit ato janë

të hapura për cilindo që ka nevojë për informacion për të përballuar sfidat në jetën e vet. Duke mbrojtur dhe nxitur pjesëmarrjen demokratike bibliotekat publike u drejtohen veçanërisht nevojave të grupeve me kërkesa të veçanta. Duke bashkëpunuar me muzetë dhe arkivat, për shembull duke bërë të disponueshëm trashëgiminë kulturore dhe materiale që kanë të bëjnë me histori familjesh, ato mund të mbështesin gjithëpërfshirjen sociale dhe kulturore.

Bibliotekat publike kanë një kulturë unike: ato janë vende të shfrytëzueshme, qytetare dhe të këndshme. Ato sigurojnë një përzierje unike burimesh dhe shërbimesh dhe tashmë mishërojnë vlera që i kontribuojnë një shoqërie gjithëpërfshirëse duke qenë një vend i sigurtë, jashtë çdo rreziku dhe që mbështet shoqërinë që i mirëpret të gjithë në mënyrë të barabartë si dhe një portë dijes dhe diversiteti, një forcë potente e të mësuarit dhe një katalizator për ndryshime.

Përjashtimi digjital gjithnjë e më tepër është provuar si një pengesë e vërtetë në jetën e njerëzve. Sfidat lidhen jo vetëm me trajnimin në teknologjinë e informacionit, por edhe me njohuritë bazë. Rreziku i përjashtimit digjital është vazhdimisht i kapërcyeshëm edhe në forma të tjera, ndërsa mundësitë digjitale mund të përmirësojnë cilësinë e jetës për grupe tradicionalisht të diskriminuara. Njerëzit e rrezikuar nga përjashtimi social dhe teknologjikisht të mënjanuar duhet të mësojnë si të përdorin Internetin.

Mungesa e aksesit dhe e trajnimit janë pengesat kryesore. Por ka gjithashtu rezistencë ndaj Internetit: rreth çereku i

popullsisë së BE-së duket se nuk është i ndërgjegjshëm për përfitimet e mundshme për jetën e tyre, megjithëse kjo shifër është më e ulët në vendet që u përkasin shoqërive të informacionit të përpuar. Ndarja digjitale nuk do të zhduket vetiu. Një zgjerim i Shoqërisë së Informacionit i diktuar nga tregu i vetëm nuk mjafton për të tërhequr qytetarët.

Për të përfituar nga të mësuarit elektronik dhe mundësitë e reja të punësimit në shoqërinë e informacionit është tepër i rëndësishëm përvetësimi digjital. Përdorimi i Internetit është në rritje në të gjitha kategoritë social-ekonomike, por hendeku në akses mes burrave dhe grave, të punësuarve dhe të papunësuarve, të atyre me të ardhura të larta dhe atyre me të ardhura të ulta, të atyre me arsim të lartë dhe atyre më pak të arsimuar, të vjetërve dhe të rinjve-është në rritje. Ata që nuk kanë akses në Internet janë duke humbur mundësi.

Bibliotekat publike janë vende jashtëzakonisht të përshtatshme për të përballuar sfidat e dallimeve digjitale përmes përmirësimit të shpërndarjes së shërbimeve, trajtimit dhe ndihmës për personat me disavantazhe që kanë të bëjnë me ndryshimet demografike.

Duhet marrë në konsideratë edhe dallimet ende më të mëdha në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore. Përfshirja elektronike është një dimension qenësor i *e - Europe + Action Plan*, inicuar nga vendet kandidatë në qershor 2001.

Të papunët kanë nevojë për informacion rreth mundësive për vende pune të reja; të rinjtë duan vende takimesh nxitës; fëmijët duan programe të pasura të

ndërtuara mbi bazën e aftësive që ata përvetësojnë në shkollë; të moshuarit kanë nevojë për një vend ku të lexojnë gazetën, të cilën nuk janë në gjendje ta blejnë, dhe njerëzit me aftësi të kufizuara kanë nevojë për një institucion që do t'i trajtonte ata me dinjitet dhe do t'u përshtatej paaftësisë së tyre. Bibliotekat publike janë jashtëzakonisht të përshtatshme për të plotësuar këto kërkesa; ato mund dhe duhet të bëhen zemra e komunitetit.

Të mësuarit gjatë gjithë jetës po bëhet parim udhëheqës për sigurimin dhe pjesëmarrjen e të gjithëve në kontekstin e një të mësuarit të vazhdueshëm. Ai përcaktohet si një cikël i tërë i të mësuarit: nga të mësuarit në fëmijëri, arsimimi formal në të gjitha nivelet deri te të mësuarit gjatë gjithë jetës si të rritur, përfshirë të mësuarit në distancë, pavarësisht nga fakti në janë ose jo të shoqëruar me notë, dëshmi apo diplomë.

Pajisja e njerëzve me aftësi është një element kyç në politikat e BE-së që i përgjigjen Shoqërisë së Informacionit në kuadër të Strategjisë Europiane të Punësimit dhe të planit të veprimit të të mësuarit elektronik.

Nga tash deri më 2006 mbi 12 bilion Euro nga Fondi Social janë parashikuar për iniciativat e të mësuarit gjatë gjithë jetës, përfshirë masat për njohjen dhe përshkrimin e teknologjive informatike.

Të mësuarit elektronik mund të ndikojë fuqishëm në gjithëpërfshirjen sociale dhe përbën një pjesë të rëndësishme të krejt konceptit të të mësuarit gjatë gjithë jetës. Ai siguron akses në mundësitë e arsimimit dhe të trajnimit, veçanërisht për ata që



kanë probleme të aksesit për shkaqe sociale, ekonomike, gjeografike etj.

Për të zhvilluar struktura të reja në sistemin e tyre arsimor, vendet e BE-së do të duhet të ripërcaktojnë arsimimin në kontekst kombëtar dhe europian, duke ndryshuar format e organizimit p.sh. nga forma të një orientimi të paracaktuar në ato të një orientimi mbështetur në kërkesa konkrete, nga forma të një orientimi institucional në ato të një orientimi në proces zhvillimi.

Roli i bibliotekave publike në të mësuarit gjatë gjithë jetës është theksuar në komunikatën e Leuven-it që më 1998. Bibliotekat publike janë një qendër kyç për të mësuarin informal dhe një nga institucionet më të frekuentuara për të mësuarin joinstitucional, të cilat ofrojnë programe trajnimi dhe mbështetje për çdo qytetar si pika shpërndarëse të integruara. Bibliotekat publike nxisin zhvillimin formal brenda një konteksti social dhe ndihmojnë në përmirësimin e nivelit të jetesës. Roli i fuqishëm i bibliotekave publike përputhet

plotësisht me mesazhin kryesor të Memorandumit mbi të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Kalimi me sukses në një shoqëri dhe ekonomi të bazuar në informacion duhet të shoqërohet me një lëvizje drejt të mësuarit gjatë gjithë jetës. E nënkuptuar në programin e të mësuarit gjatë gjithë jetës është edhe thyerja e konceptimit të vendit ku mësohet. Bibliotekat, si rrjedhim, kanë një rol kyç për të luajtur në mbështetje të të mësuarit në kuptimin e tij më të gjerë edhe si një veprimtari formale në një institucion, edhe joformale brenda komunitetit. Nocioni i të mësuarit gjatë gjithë jetës nënkupton aftësinë e kërkimit të informacionit dhe të përvetësimit të dijeve në mënyrë aktive dhe të pavarur. Klasat dhe tekstet shkollore duhet, së këtejmi, të plotësohen nga arkivat, bibliotekat dhe muzetë, institucione këto që ofrojnë një llojshmëri të gjerë të mediave të ndryshme dhe një udhëheqje profesionale në teknikat e kërkimit të informacionit.

*Përktheu R.Vozga*

1) Autori i këtij shkrimi është menaxher i projektit PULMAN (Europe's Network of Excellence for Public Libraries, Museums and Archives).

## IMPACT OF THE DEVELOPMENT OF COMMUNITY'S CULTURE

*Europe's public libraries currently stand at a crossroads of opportunity brought about by a confluence of:*

- social challenges, represented on the one hand by a high level European social agenda;*
- and on the other hand the potential offered by developments in Information Society Technologies (IST) which have increasingly becoming available to implement new services.*

*In response, public libraries are changing fast: but they need to change even faster. The demand for some well-established public library services such as lending fiction to adults is evidently in decline in some parts of Europe.*

*It is likely that this is a response to a variety of phenomena including access to information via the Internet, an ever-expanding quantity of cultural media forms and content (digital TV, computer-based activities etc) and an increase in the number of people who buy rather than borrow a high proportion of the books which they read.*

*Public libraries retain an important role in ensuring a literate information society. Support for reading and maintained awareness of the printed literature remains a crucial goal: the power of IST and the World Wide Web can be harnessed to this end.*

*This is perhaps especially important for children when so many competing stimuli are available, but where the richness and scope of what is available in printed form is not yet available online. In those parts of Europe which are still in economic transition, the provision of by public libraries of affordable access to reading in its original form remains vital... but this exists alongside the need to provide access to the Internet and online services.*

*Public libraries in these countries therefore face both problems at once, but often with many fewer resources.*



# Shërbimet e reja bibliotekare: akcesi i komunitetit në Internet

Domosdoshmëria e një strategjie për Teknologjitë e  
Informacionit në bibliotekat publike

**Ioannis TROHOPOULOS**

Biblioteka publike  
qendrore e Verias (Greqi)

Më 1995, revista *Wired* pyeste disa ekspertë për bibliotekat e së ardhmes. Duke diskutuar për aksesin në rrjet të lirë në bibliotekat publike, shumica e ekspertëve parashikuan që brenda 10 vjetësh pothuajse të gjitha bibliotekat

publike do të siguronin akses të lirë në hapësirën e pamatë të informacionit-Internet. Shfletimi i Web-it dhe telneti mund të kënaqin shumicën e kërkesave shkencore pa qenë nevoja që biblioteka t'i japë e-mail çdo lexuesi. Nga ana tjetër,

ekspertë të tjerë e quajtën aksesin e lirë në rrjet në bibliotekat publike një trill. Sipas tyre, shumica e bibliotekave do të ofronin lidhje me rrjetin kundrejt një pagese, ashtu siç paguajmë për telefonin dhe makinat fotokopjuese. Për më tepër, vëzhgimi i Foundationit Benton kishte nxjerrë në pah dilemën e bibliotekave publike, të cilat kishin vlerësim të lartë publik si qendra tradicionale të mbledhjes së materialeve të shtypura dhe të veprimtarive komunitare, një pikëpamje që mund t'i mbante ato prapa përsa i përket zhvillimit të shërbimeve të tyre në të ardhmen digjitale.

Është më se e qartë se ndryshimet në shoqëri sollën fluksin e Teknologjive të Informacionit (TI), e cila u shfaq me rritjen e pandërprerë të ndikimit në të gjitha fushat. Bibliotekat publike nuk mund të injorojnë presionin social mbi to. Ato duhet të përshtaten me ndryshimet rreth tyre në qoftë se duan të ruajnë prestigjin e tyre. Si mjaft organizma të tjerë, bibliotekat publike po bëhen gjithnjë e më të varura prej sistemeve të TI-së për realizimin e shërbimeve të tyre, sigurimin e informacionit, menaxhimin, administrimin dhe komunikimin e përditshëm. Megjithëse mjaft biblioteka ende kanë dhe përdorin sisteme manuale (kështu është në vendin tim dhe besoj se edhe në vendet e tjera), kjo ngjet kryesisht më tepër për arsye të tjera (mungesa e parave etj.) sesa për qëndrime parimore kundër teknologjive të reja.

Sidoqoftë, ka mjaft implikime për bibliotekat publike në këtë tendencë në rritje të varësisë nga TI. Implikime për:

- *Menaxhimin dhe sigurimin e shërbimeve;*

- *Komunikimet e jashtme dhe të brendshme;*

- *Trajnimin e stafit dhe aftësimin e nevojshëm për përdorimin efektiv të TI;*

- *Buxhetet dhe sigurimin e shpenzimeve në rritje për TI;*

- *Investimet kapitale për pajisje të reja dhe zëvendësim të tyre;*

- *Politikat për sigurimin e shërbimeve të reja të TI për përdoruesit;*

- *Realizimi i shërbimeve bibliotekare përmes rrjeteve botërore web.*

Në qoftë se bibliotekat publike po kalojnë një tranzicion të suksesshëm drejt mjedisit global në rrjet, ka një kërkesë të qartë për konsiderimin me kujdes të rolit të tyre në këtë botë që ndryshon dhe për të caktuar një drejtim të qartë. Planifikimi strategjik dhe hartimi i politikave për TI-të po realizohet në disa nivele. Manifesti i UNESCO-s për bibliotekat publike (1994) përcakton mes 12 detyrave më të rëndësishme “*Sigurimin-e aksesit për qytetarët të të gjithë informacionit komunitar; sigurimin e shërbimeve të barabarta për sipërmarrjet lokale, shoqatat dhe grupet e interesuara; lehtësimin e zhvillimit të njohurive në fushën e informacionit dhe përvetësimin të kompiuterit.*” Bashkimi Europian ka njohur rëndësinë e veçantë të revolucionit të TI dhe në programin e kornizës së 4-t telematike ka parashikuar financime të veçanta për projekte të bibliotekave elektronike me synim zhvillimin e shërbimeve bibliotekare në mbarë Europën për të përballuar kërkesat e shoqërisë së informacionit. Gjithashtu është shpallur një program i 5-të kornizë.

*Më poshtë janë disa nga rolet që bibliotekat publike kanë ose do të kenë në të ardhmen e afërt:*

- Qendër e përvetësimit të punës në rrjet
- Qendër e informacionit elektronik global
- Koordinuese e informacionit qeveritar
- Qendër e të mësuarit elektronik gjatë gjithë jetës
- Qendër e aksesit publik
- Organizuese dhe siguroese e informacionit komunitar
- Qendër e zhvillimit ekonomik

Shumica e roleve të përmendura më sipër janë të lidhura me dy aspekte themelore, të cilat duhen marrë në konsideratë kur flasim për akses në shoqërinë e informacionit:

- Akses fizik në teknologjitë e reja;
- Njohuritë për t'i përdorur ato.

Të dy këto aspekte bëhen jashtëzakonisht të rëndësishme në rast se ne kemi parasysh rolet e mundshme të bibliotekave publike në këtë mjedis të punës në rrjet që evoluon vazhdimisht:

- ✓ Njohjen e komunitetit me teknologjitë e reja të informacionit
- ✓ Demonstrimin e zbatimit dhe përdorimeve të punës në rrjet për arsimimin, të mësuarit gjatë gjithë jetës, zhvillimin ekonomik etj.
- ✓ Shndërrimin në një pikë lokale aksesit për një varg burimesh dhe shërbimesh të informacionit qeveritar

✓ Krijimin, mirëmbajtjen dhe organizimin e informacionit elektronik komunitar

✓ Barazi aksesit në mënyrë që të gjithë anëtarët e komunitetit të mund të realizojnë përfitimet nga "të qenit të lidhur" në mjedisin global të rrjetit

✓ Sigurimin e trajnimit të pjesëtarëve të komunitetit për të përdorur Internetin dhe për të ndërvepruar si duhet me një varg shërbimesh të siguruara përmes rrjetit

✓ Zgjerimin e vargut dhe llojeve të burimeve dhe shërbimeve të siguruara përmes website-ve të bibliotekave publike

## Strategjia për informacionin

Përbërësi më i rëndësishëm i teknologjisë së informacionit është informacioni, në krahasim me teknologjinë. Megjithatë informacioni është bërë një tendencë themelore e veprimtarisë njerëzore, është e vërtetë se njerëzit dhe kombet e varfër nuk i përdorin burimet e informacionit, sepse nuk mund t'i sigurojnë ato. Në mjaft raste problem i madh është mungesa e infrastrukturës bazë që do të mbështeste përdorimin e teknologjive të reja. Është e vërtetë se ndërsa Veriu i industrializuar flet për lidhje Interneti në çdo shtëpi, në Afrikën e Jugut vetëm 2% e shtëpive të zezakëve kanë telefon. Statistikat tregojnë se një hendeq i madh informacioni ekziston midis vendeve të industrializuara dhe atyre në zhvillim si dhe ndërmjet vetë vendeve në zhvillim përsa i përket aksesit si në kompiutera, ashtu edhe në infrastrukturën e telekomunikacionit të nevojshme për lidhjen me Internet. Është e vërtetë se mjaft vende kanë nevojë për

më tepër infrastrukturë banimi, ekzistence dhe transporti përpara se ato të mendojnë për një infrastrukturë informacioni. Unë mund ta trajtoj këtë pikë pak më tej duke marrë në konsideratë vlerën e informacionit në një perspektivë më të gjerë njerëzore. Mund të permend këtu Michael Dertouzos, drejtues i *MIT Laboratory for Computer Science*, i cili thotë se *“Informacioni nuk është i domosdoshëm si ushqimi ose si ndonjë nevojë tjetër bazë e jetës. Në një luftë për jetë a vdekje midis sasisë së informacionit dhe kafshatës së gojës, njerëzit gjithnjë do të zgjedhin ushqimin kundrejt të dhënave të informacionit. Madje, edhe në qoftë se informacioni është i dobishëm për të gjetur ushqim, ai kurrë nuk do të ishte i aq i vlefshëm sa vetë ushqimi. Si përfundim, ai gjithmonë do të vlerësohet pas të mirave materiale drejt të cilave ai çon”*.

Sidoqoftë, duhet shënuar se është vështirë të gesh një komb të painerosuar për forcën e mundësive që ofron shoqëria e informacionit. Në SHBA administrata ka njohur rëndësinë e shoqërisë së informacionit në planet e saj të veprimit për infrastrukturën kombëtare, botuar në shtator 1993. Në Europë, Komisioni Europian botoi më 1994 raportin e tij Bangeman, i cili është një plan për shoqërinë globale të informacionit. Të tjerë politikëbërës në forume të ndryshme si G7 dhe Konferencën Ekonomike Azi-Pacifik kanë bërë thirrje, duke mbështetur me projekte pilot dhe strategji, për nxitjen e investimeve në rrjetet e telekomunikacionit. Duket se çdokush deklaron interesimin e tij për t’u bërë lojtar në shoqërinë e informacionit.

Dua të tërheq vëmendjen këtu në dy pika mes problemeve të shumta që lidhen me këto zhvillime.

*Së pari*, të gjitha këto nisma për infrastrukturën globale të informacionit janë shpesh të drejtuara për nga teknologjia. Në një farë mënyre pranohet se teknologjitë e konverguara rezultojnë në shërbime informacioni me përfitim ekonomik dhe social. Dhe kjo dukuri duhet studiuar me kujdes.

*Së dyti*, është e vërtetë se potenciali i teknologjive të reja është ende larg realizimit të tij të plotë. Në mjaft raste ndryshimet institucionale dhe shtysat për rinovime duhet të shfaqen para se këto teknologji të kenë më tepër efekt. Kështu, është mëse e qartë se investimet në teknologji vetëm nuk mund të japin rezultate të mëdha në përfitimet sociale.

## Zhvillimet teknologjike dhe Shoqëria e Informacionit

Me formësimin e Shoqërisë së Informacionit aksesit efektiv dhe frytdhënës në informacionin cilësor po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm për individët në të gjitha fushat e jetës. Bibliotekat publike duhet të ripërcaktojnë rolin e tyre në qoftë se duan të mbijetojnë dhe të luajnë një rol të rëndësishëm në Shoqërinë e Informacionit. Në një farë mënyre, bibliotekat duhet të ribëjnë vetveten dhe shërbimet e tyre si një element kyç të infrastrukturës komunitare në qoftë se duan të vazhdojnë të plotësojnë funksionet e tyre vitale si burime për arsimimin e komunitetit, risitë qytetare dhe sipërmarrjet tregëtare dhe sociale. Bibliotekat publike sot duhet të marrin pjesë

aktive në projektimin dhe krijimin e një "infrastruktura urbane", e cila do të jetë thelbësore nëse qytetet dhe rrethinat, duan të mbeten qendra të civilizimit dhe të sipërmarrjes në Shoqërinë e Informacionit. Për të përbushur këtë rol të rëndësishëm në krijimin e së ardhmes, bibliotekat, sipas David Pearce Snyder (Life-styles editor, The Futurist) duhet:

➤ *Të bëhen qendra mësimore bashkëvepruese për komunitetin duke punuar në lidhje të ngushtë me drejtuesit e biznesit lokal, shkollat, autoritetet etj. për të mbledhur dhe shpërndarë informacionin që nevojitet.*

➤ *Të ngrënë biblioteka si "Citizens R&D Centers", për depozitim të gjithë të dhënave dhe informacionit lidhur me jetën lokale dhe tregëtinë si dhe për të shërbyer si rregullator institucional për dialogun komunitar mbi probleme të qeverisjes, rregullave dhe planifikimit lokal.*

➤ *Të përdorin si duhet aksesin publik në TV për të reklamuar shërbimet bibliotekare dhe përfitimet që ato sjellin.*

Bibliotekat publike duhet të promovojnë një imazh proaktiv të tyre te komuniteti të cilit i shërbejnë, në rast se duan të vazhdojnë të kenë mbështetje publike dhe politike, të cilat janë të domosdoshme që ato të mbijetojnë në botën që me shpejtësi po shndërrohet në një ekonomi informacioni. Është e vërtetë se teknologjia e informacionit do të ndryshojë mënyrën si ne punojmë dhe argëtohem, por, mbi të gjitha, ajo do të ndryshojë rrënjësisht aspekte të jetës sonë si qenie njerëzore: si kujdesemi për shëndetin tonë, si mësojnë

fëmijët tanë, si i ruajnë lidhjet me shoqërinë të moshuarit, si e bëjnë punën e tyre qeveritë. Në këtë pikë do të doja të përmendja disa prirej të epokës së re që Ian Morrison, president i Institutit për të Ardhmen, përshkruan dhe që duhen marrë në konsideratë, sepse jam i bindur që ato janë tepër të rëndësishme për punën tonë:

■ Zhvendosja nga të mirat materiale në shërbimet për dije: Revolucioni që sjell informacioni po na çon drejt një shoqërie të bazuar në teknologjinë e kompiuterave, në të cilën shërbimet gjithnjë e më tepër po bëhen të rëndësishme si të mirat materiale.

■ Tregje të fragmentarizuar dhe të konsoliduar: Gjithnjë e më tepër ne po shohim tregje që synojnë grupe më të veçanta konsumatorësh. Disa i kanë quajtur këto tregje individualë, në të cilët pluralizmi dhe teknologjia takohen kokë më kokë për të krijuar një transaksion unik midis blerësit dhe shitësit.

■ Zhvendosja nga Teknologjia e Madhe te Teknologjia e Lartë: Kurrë teknologjitë nuk mund të prodhojnë produkte për segmente të veçanta tregu që t'u përshtaten më mirë kërkesave të tyre dhe që mund të shpërndahen më shpejt dhe me kosto më të ulët.

■ Fundi i ekonomive të shkallëzuara: Konsumatori ka më tepër kontroll mbi tregun.

■ Fundi i kërkesë-ofertës: Ne po shkojmë drejt një situatë në të cilën konsumatori dhe prodhuesi përpiqen së bashku për të realizuar një prodhim dhe shërbim që të harmonizojnë atë që konsumatorët dëshirojnë me atë që shitësit mund të sigurojnë.

Nëse bibliotekat publike, ashtu si edhe organizatat e tjera të suksesshme, mund të bëjnë diçka për të administruar ndryshimet që po ndodhin, është e rëndësishme të thuhet se sfida kryesore është njohja e komponentëve të ndryshimit.

*Tri janë forcat kryesore që po e udhëheqin ndryshimin:*

➤ *Teknologjitë e reja janë më të shpejta, më të mira dhe më të lira*

➤ *Konsumatorët e rinj duan çdo gjë, në çdo kohë dhe në çdo vend*

➤ *Kufiri i tregut të ri vjen nga rritja e tregjeve që po lindin*

Megjithëse, natyrisht, është e vështirë të parashikosh ndryshimet teknologjike, disa prijnë pritjet që të vazhdojnë:

- Veglat do të bëhen gjithnjë e më të vogla dhe më të fuqishme
- Kostoja e përpunimit do të ulet
- Njerëzit joprofesionistë do të ndërveprojnë me kompiuterat më lehtësisht
- Teknologjia e informacionit do të invadojë shtëpitë
- Aftësia për t'u lidhur do të përcaktojë forcën e teknologjisë

Jam i sigurt që secili mund të kuptojë lehtësisht domethënien dhe nxitjen që këto prijnë mund të kenë mbi bibliotekat publike.

## **Përdorimi i TI-së në dy biblioteka: e shkuara dhe e ardhmja**

Potenciali i jashtëzakonshëm që teknologjitë e reja sigurojnë për zhvillimet

mund të duket në mënyrat sesi po i përdorin ato dy biblioteka që vijnë nga dy mjedise tërësisht të ndryshme. Silkeborg në Danimarkë ka një popullsi prej 50.000 banorësh. Biblioteka është mjaft popullore dhe ka patur më tepër se 500.000 vizitorë më 1996. Ajo ka një fond prej më se 300.000 librash dhe materialesh të tjera. Më 1997 huazimi vjetor ishte 1.1 milion për banor dhe e kalonte mesataren kombëtare me mëse 30%. Biblioteka ka 64 punonjës me kohë të plotë, prej të cilëve 27 janë të kualifikuar profesionalisht. Nga ana tjetër, Veria ka pak a shumë të njëjtën popullsi. Biblioteka është relativisht mjaft popullore dhe ka më tepër se 15.000 anëtarë të regjistruar. Ajo ka një fond prej 80.000 materialesh, kryesisht libra. Më 1997 huazimi vjetor ishte 110.000, më e madhe se mesatarja e mësipërme. Biblioteka kishte 10 punonjës me kohë të plotë, 4 prej të cilëve bibliotekarë të kualifikuar. Duke parë rrugët e përdorura për zbatimin e teknologjisë së informacionit në këto dy biblioteka mund të bëhen disa komente të dobishme. Në vështrim të parë, mjaft shërbime janë të njëjtë në të dy bibliotekat, natyrisht me një ndryshim në kohën e nisjes së këtyre zhvillimeve.

## **Projekte të zhvillimit të TI: e shkuara dhe e sotmja**

Silkeborg, Danimarkë, Veria, Greqi

1990: Automatizimi i proceseve bibliotekare

1991/-: CDs/ISIS për krijimin e skedarit, automatizimin e zyrave



1991: Shërbimim CD-ROM për publikun, transmetimi i të dhënave mes b-kës qendrore dhe b-kës së lëvizshme

1994: Mobile elektronike

1997: Krijimi i Intranetit lokal për lidhje dhe informacion të brendshëm 1997: Web server, trajnim për përdorimin e Internetit

1998: Netnavigator, krijimi i një shërbimi në rrjet për shërbimin referativ 1998: Automatizimi i të gjitha proceseve, Multimedia, Internet për publikun

1995/-: Projekti i Internetit: biblioteka virtuale 1996/-: Pjesëmarrje në projekte europiane me theks teknologjinë (PLDP, ISTAR)

Interesant është se në të gjitha rastet teknologjia ofron mundësi të mëdha zhvillimi, pa patur si kusht paraprak ekzistencën e një infrastrukture të përshtatshme.

## Konkluzione

Nuk jam i sigurtë, vërtetë, në ç'masë arrita t'i trajtoj qartë disa aspekte të çështjes që unë kisha parashikuar në këtë artikull: si bibliotekat publike mund të përshtasin, zbatojnë dhe shfrytëzojnë teknologjitë e reja. Ajo që do të doja të theksoja në fund janë disa ide që dalin nga mësimet që ne kemi marrë pas kaq vite përpjekjesh për përfshirjen e teknologjive të reja në punët tona.

### ❖ *Të lidhurit*

Në përgatitjen e strategjisë së TI-ve çdo bibliotekë që shërben informacion duhet të

jetë e ndërgjegjshme për nevojën e lidhjes me shërbimet e tjera. Në qoftë se ka ndonjë paralajmërim të përgjithshëm për të gjitha strategjitë e TI-ve ai është kërkesa për krijimin e rrjetit të bibliotekave. Cilatdo qofshin ndryshimet lokale, çdo sistem e instaluar duhet të jetë fleksibël, i hapur dhe në gjendje për t'u lidhur me rrjete të tjerë. Për më tepër, ne duhet të shkojmë nga lidhja në sigurimin e shërbimeve në rrjet. Ndoshta, qëllimi më i mirë i një politike kombëtare p.sh. mund të ishte që 100% e bibliotekave publike të jenë në gjendje të sigurojnë një varg shërbimesh cilësore me bazë Internetin kualitativ që plotëson më mirë se çdo gjë tjetër nevojat e komuniteteve të tyre dhe lidh më mirë se kushdo këto komunitete me infrastrukturën globale të informacionit.

### ❖ *Të menduarit lokal në mjedisin e rrjetit global*

Ne duhet të rishikojmë kush ose çfarë është komuniteti ynë, ç'shërbime në rrjet i sigurojmë këtij komuniteti dhe se si përdoruesit mund të paguajnë për shfrytëzimin nga ana e tyre të shërbimeve në rrjet të bibliotekave publike.

### ❖ *Përmirësim i vazhdueshëm*

Bibliotekat publike duhet të krijojnë strategji racionale dhe buxhet për blerjen, instalimin, mirëmbajtjen dhe zëvendësimin e teknologjisë së re.

### ❖ *Shërbimet e bazuara në rrjet*

Duhet parë me kujdes ç'loj shërbimesh duhen siguruar përmes Internetit.

### ❖ *Përshkrimi dhe caktimi i kostos që lidhet me Internetin.*

Bibliotekat publike duhet të jenë në

gjendje të përcaktojnë dhe përshkruajnë ato kosto që ato duan për t'i menaxhuar me efektivitet këto shpenzime.

❖ *Riorganizimi i burimeve bibliotekare*

Për shkak të kufizimeve në buxhet, bibliotekat publike do të duhet të rishikojnë dhe të rirreshtojnë programet dhe shërbimet e tyre në dritën e këtij mjedisi të punës në rrjet në të cilin po hyjnë.

❖ *Modele të reja për mësimin dhe zbatimin e njohurive në Internet*

Në bibliotekarët duhet thjeshtë të investojmë në burimet njerëzore të bibliotekës dhe të mbështetesim jo vetëm kualifikimin tonë, por edhe shprehitë e të menduarit kritik. Shprehitë e të menduarit kritik përfshijnë mundësinë për të siguruar informacion dhe për ta aplikuar atë në

mënyra të reja për të zgjidhur probleme, veçanërisht në mjedise të tilla të reja si Interneti.

Pasi kam përmendur të gjitha këto çështje që kërkojnë vëmendje në qoftë se bibliotekat publike duan të përdorin me sukses teknologjitë e reja, unë do të doja të të përfundoja këtu duke theksuar sa e rëndësishme është për një strategji të suksesshme në qoftë se qeverisja qendrore, ajo rajonale etj. zenë një pozicion më aktiv në mbështetjen dhe bashkërendimin e politikave dhe programeve për zgjerimin e detyrave të bibliotekave publike për sigurimin e aksesit publik në Internet. Përvoja jonë ka provuar si një domosdoshmëri krijimin e një partneriteti mes komunitetit të bibliotekarëve, siguresve të informacionit, autoriteteve të shtetit dhe atyre lokale dhe institucioneve/organizatave të tjera për rritjen e aksesit në Internet.

*Përktheu R. Vozga*

## NEW PUBLIC LIBRARY SERVICES: ACCESS OF COMMUNITY TO THE INTERNET

*Public libraries as many other organizations are becoming dependent upon IT systems for service delivery, the provision of information, day to day management, administration and communication. Though many libraries still use and have manual systems (this is the case in my country and I can imagine in many other countries) this is mainly for other reasons (lack of money etc) than taking a principled stand against new technology. In any case, there are many implications for Public libraries in this growing trend towards IT dependence. Implications for:*

- *managing and providing services;*
- *internal and external communications;*
- *staff training and the skills needed for the effective use of IT;*
- *budgets and the provision of increasing revenue costs for IT;*
- *capital expenditure for new and replacement equipment;*
- *policies for the provision of new IT services to users;*
- *making library services accessible on world-wide networks.*

# Spastrimi i koleksioneve bibliotekare

**Ramazan VOZGA**

Biblioteka Kombëtare

Nga ligji "Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë", nr. 8576, datë 03.02.2000  
Bazuar në udhëzimet e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve si dhe të dikastereve të tjera nga të cilat ato varen, bibliotekat:

- bëjnë spastrimin e materialeve të vjetëruara e që nuk qarkullojnë, nëpërmjet heqjes nga koleksionet e tyre të këtyre materialeve, në përputhje me rregullat financiare" (kreu IV "Detyrat e bibliotekave", neni 18).

Nga Udhëzim nr. 1, datë 22.09.1992 "Për seleksionimin e fondit të librave në biblioteka"

Me qëllim që bibliotekat e të gjitha niveleve të sistemit të kulturës të rritin efektivitetin e punës së tyre dhe të disiplinojnë administrimin e literaturës që nuk qarkullon udhëzoj:

1. Diktuar nga mbingarkesa e fondeve dhe ngushtica e mjediseve që pengojnë shërbimin normal ndaj lexuesve, herë pas here bibliotekat të bëjnë seleksionimin e literaturës që disponojnë.

2. Gjatë seleksionimit të hiqet nga fondet literatura që me kalimin e viteve është vjetëruar dhe nuk kërkohet për shfrytëzim nga lexuesi, literatura fizikisht e dëmtuar nga përdorimi si dhe kopjet e tepërta të literaturës që ka qarkullim të ngadalshëm.

Nga teksti "Koleksionet e bibliotekës ", T. 2002 (Farfuri Xhaja)

Materialet bibliotekare mund të hiqen nga biblioteka kur janë të dëmtuar fizikisht dhe kur përmbajnë informacion të vjetëruar. Heqja e materialeve, apo harrja ose spastrimi i koleksioneve, është po aq i rëndësishëm sa edhe pasurimi i bibliotekës dhe bën pjesë në procesin e zhvillimit të koleksioneve.

Nga "Weeding of the Library Collections", Stanley J. Slote, Libraries unlimited, Inc. Englewood, Colorado 1997

*E ç' duhen gjithë ata libra të panumërt dhe biblioteka, kur i zoti i tyre gjatë gjithë jetës së vet mezi arrin t'u lexojë vetëm titujt?*

*Seneka (4 p.kr. - 65 pas kr.)*

*Në qoftë se doni t'u bëni vend në bibliotekë librave të rinj, fare lehtë ju mund të hiqni prej andej librat më pak të dobishëm e t'i çoni ata diku tjetër.*

*Thomas Hollis (1725)*

*Një koleksion i vogël librash të zgjedhur me kujdes mjaftojnë për të na kënaqur dhe mësuar dhe gjithë të tjerat nuk janë gjë tjetër veçse ca rrangulla të padobishme.*

*Rev. Reginald Heber (1787)*

Në biseda me drejtues dhe specialistë të bibliotekave shpesh përsëritet si një refren i lodhshëm dhe bezdisës problemi i ngushticës së hapësirave për vendosjen e materialeve bibliotekare dhe pranohet se ky problem mund të zbutet disi përmes procesit të spastrimit të koleksioneve. Por, megjithëse për spastrimin e koleksioneve bibliotekare është organizuar një seminar i posaçëm nga Biblioteka Kombëtare, madje është përgatitur edhe një dokumentar metodik sensibilizues, vihet re se fare pak, për të mos thënë aspak, po punohet në këtë drejtim. Kjo vjen edhe nga mungesa e përgjegjësisë menaxhuese në të gjitha nivelet, por edhe nga paqartësi, ngurrime apo keqinformime në lidhje me këtë proces, i cili paraqitet kompleks me anë e veta teorike, juridike dhe praktike.

Sidomos në bibliotekat e mëdha gjen rrjeshta të gjatë e të pafund raftesh të mbingarkuar me libra. Rëndon mbi to pesha e dijes, informacionit dhe kulturës. Bibliotekarët kujdesen për këto koleksione me përkushtim duke i mbrojtur nga dëmtimet, lagështira dhe brejtësit. Por ata e dinë mjaft mirë se mes asaj pasurie të trashëgimisë së shkruar kombëtare dhe botërore nuk është vështirë të gjejsh edhe libra, shpesh në disa kopje, që nuk janë kërkuar kurrë nga lexuesi ose të atillë që janë kërkuar dikur, ndërsa tani ndihen të braktisur e të panevojshëm.

Këtu nuk është fjala se bëhemi xhelozë për

këta libra të vjetëruar e të papërdorshëm që kalojnë pleqërinë e tyre në komoditetin më të madh, nën kujdesin e brezave të tërë bibliotekarësh që ndërrojnë njëri-tjetrin. Po ashtu as nuk do të donim thjeshtë të thonim se një pjesë e këtyre librave dhe materialeve të tjera bibliotekare tashmë "kanë ndërruar jetë" dhe duhen çuar në varrezë, pra në fabrikat e letrës për karton që kështu së paku të bëhen të dobishëm për diçka. Jo, fjala është se në një kohë kur raftet i kemi plot me materiale të tilla, pothuaj në të gjitha bibliotekat librat e rinj dhe të kërkuar nga lexuesi janë sistemuar, kundër çdo rregulli bibliotekar, në dyshemetë e ftohta prej çimentoje të rrezikuar nga "reumatizma" shkatërruese që ua stimulon mjedisit krijësisht i papërshtatshëm. Ndërkohë ata të privilegjuar rinin atje sipër në raft, paçka se askush nuk kujtohet më për ta. Dhe në bibliotekarët, për hir të ca praktikave të vjetëruara që fetishizojnë çdo gjë që ne kemi në fondet tona, më fort preokupohemi për fatin e vjetërsirave, sesa për hyrjet e reja që na ngatërrohen nëpër këmbë të vendosura vend e pa vend dhe qoshe më qoshe. Ndërkohë ne përsëritim prej vitësh refrenin e njohur e të mërziqshëm të mungesës së mjedisve sikur qeveritë t'i kishin xhepat plot dhe të mos donin t' i jpinin asnjë kacidhe bibliotekave për zgjerime ose ndërtesa të reja. Dhe harrojmë se po të kryejmë sistematikisht

dhe me kujdes sipas metodikave dhe procedurave shkencore procesin e spastrimit të fondeve hapësirat e lira që do të krijoheshin do të reduktonin nevojat për mjedise në biblioteka dhe librat e rinjë të kërkuar nga lexuesi do të sistemoheshin normalisht.

Por ka një kundërshtim herë të heshtur, herë të shprehur hapur nga menaxherët dhe stafi i bibliotekave ndaj këtij procesi të rëndësishëm, madje jetik për mbarëvajtjen e punëve në këto institucione që janë ngritur për t'i shërbyer publikut me mënyrat dhe mjetet e veta. Disa nuk duan t'ia dinë se për procesin e spastrimit kanë mësuar në tekstet mësimore, në saj të të cilave kanë fituar dëshminë e profesionit të nderuar të bibliotekarit, nuk duan t'ia dinë as për literaturën botërore ku trajtohet shkencërisht e metodikisht ky problem. Kur u thua se ka edhe një udhëzim të Ministrisë së Kulturës, bëjnë të paditurin. Atëherë ti je i detyruar t'u tregosh atyre ligjin e bibliotekave. Por ndonjëherë edhe ligjet nuk mund ta mposhtin dot rutinën dhe ndjenjën konservatore.

Kompiuterizimi ose automatizimi i proceseve bibliotekare mund ta reduktojë kërkesën për zgjerim apo ndërtesa të reja bibliotekash. CD-ROM-et, interneti dhe kompiuterat me modeme që i lidhin përdoruesit me botën, tashmë janë

të pranishëm në mjaft biblioteka të huaja. Në vendin tonë ky proces sapo ka nisur. Me siguri që koleksionet e përqendruara dhe të kompiuterizuara me akses për të gjithë do të pakësojnë kërkesat për zmadhime pa fund të ndërtesave të bibliotekave, por gjithsesi spastrimi i fondeve do të vazhdojë të jetë i domosdoshëm.

Ka edhe keqinformim të publikut lidhur me këtë që po trajtojmë. Gazeta "Koha Jonë" para disa kohe "zbulonte" një kundërsens dhe çuditëj me faktin që në ligjin e ri për bibliotekat koleksionet bibliotekare edhe përcaktoheshin si pasuri kombëtare, edhe caktohej detyrë që ato të spastrtoheshin herë pas here. Kur mori vesh se një alarm të tillë të rremë kish dhënë para disa vitesh edhe "Detroit Free Press", dikush tha me qesëndi: "E po të paktën paskan bërë një gabim të nivelit amerikan!"

Së fundi, spastrimi i fondeve bibliotekare është një proces që duhet trajtuar edhe në aspektin ekologjik. Librat e hequr prej rafteve të bibliotekave dërgohen në fabrikat e letrës për t'u ricikluar duke u shpëtuar jetën kështu drurëve që përdoren për të prodhuar letër në rrugë të zakonshme. Sot kudo në botë sasia e letrës së përfutur përmes riciklimit të letrës së përdorur është tregues zhvillimi.


## WEEDING OF LIBRARY COLLECTION

*Frequently, managers and experts of libraries keep repeating the problem of space limitation concerning the arrangement of library materials.*

*This problem can be soften if libraries apply the weeding of library collection policy. In deed, librarians do not pay so much attention to this library process, due to the absence of management-obligation in all levels as well as unclearness, hesitations or misinterpretations regarding this process.*

*Managers and libraries' staff have a silent opposition, sometimes openly, against this very important process, even of vital importance for the good progress of work in these institutions, created to serve the public by various manners and means.*

*Some librarians do not take in consideration that the weeding of library collection was treated in a lot of textbooks as well as in world's professional literature on librarianship; even in some cases they have no idea for the respective guidelines of the Ministry of Culture, Youth and Sport.*



## IFLA në 75-vjetor

**Ermerina KRISTANI**

Biblioteka Kombëtare

IFLA u themelua në Edinburg (UK) në vitin 1927 dhe konferenca e saj e parë si Federatë Ndërkombëtare e Shoqatave të Bibliotekave u mbajt në vitin 1929 në Romë, Firenze dhe Venecia të Italisë.

Shqipëria është përfshirë në të në vitin 1977.

Në vitin 1935 takimi i IFLA-s u mbajt në Madrid dhe Barcelonë. Morën pjesë 65 delegatë nga 26 vende. Kongresi aprovoi rregullat e përgjithshme për huazimin ndërbibliotekar duke i dhënë kështu më shumë frymëmarrje shërbime-ve në nivel ndërkombëtar. Në vitin 1938 në takimin e njëmbëdhjetë (11) mbajtur në Bruksel, Presidenti Godet theksoi me keqardhje shkatërrimin e bibliotekave gjatë Luftës Civile në Spanjë dhe pushtimin Japonez të Mançurisë. Duke shprehur keqardhjen për shkatërrime të tilla, ai bëri thirrje për rindërtimin e tyre.

Takimi i parë pas Luftës II-të Botërore u mbajt në vitin 1947 në Oslo. Presidenti Munthe propozoi një marrëveshje mirëkuptimi ndërmjet IFLA –s dhe UNESCO-s. IFLA dhe UNESCO theksuan domosdoshmërinë e lirisë në shpërndarjen dhe shkëmbimin e lirë përmes kufijve kombëtare të botimeve, materiale të tjera të bibliotekave, informacionit rreth botimeve etj.

Botimi i manifestit të UNESCO-s për Bibliotekat Publike në vitin 1949 i shpalli bibliotekat publike si një instrument për demokraci. Në vitin 1994 u botua versioni i tretë i tij. Shumë ai shpejt u bë i njohur si një

dokument i rëndësishëm e parimeve themelore të shërbimit të bibliotekave publike. Në vitin 2000 u ndoq nga manifesti IFLA/UNESCO për bibliotekat shkollore. Në vitin 1976 në IFLA u përfshinë edhe biblioteka si anëtare insitucionale duke e ndryshuar emrin në: Federata Ndërkombëtare e Shoqatava dhe Institucioneve-IFLA.

Vitet '80 shënuan rritjen numerike të programeve bazë, të cilat më vonë u shndërruan në aktivitete bazë. Këto aktivitete janë në qendër të vëmendjes së IFLA-s e cila vazhdimisht i kushton vëmendje të posaçme proceseve bibliotekonomike në vendet në zhvillim, çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtën e autorit, lirinë e aksesit në informacion, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e materialeve bibliotekare, huazimin ndërbibliotekar, standardizimin e veprimtarive bibliografike etj.

Në vitin 1993 u krijua IFLANET, që u bë mjeti kryesor për funksionimin e Federatës.

Në periudhën 2000-2001 u aprovuan statute dhe rregulla të reja. Këto sollën një IFLA të përtërirë me një strukturë të re (bordi drejtues).

Zgjedhjet e para (të përgjithshme) në historinë e IFLA-s u mbajtën në vitin 2001, ku u zgjodh bordi drejtues, si dhe Presidenti i saj për periudhën 2003-2005.

Kay Raseroka do të ishte presidenti i parë i IFLA-s nga Afrika, si edhe i pari nga një vend jo euro-amerikan.

Sot, në 75-vjetorin e saj IFLA:

- beson se shërbimet bibliotekare ndihmojnë në garantimin e aksesit në informacion dhe dije;

- punon për ngushtimin dhe mbylljen e hendekut midis informacionit të varfër dhe atij të pasur, të saktë e të plotë;

- promovon parimet e lirisë së informacionit;

- justifikon një financim të përshtatshëm për bibliotekat në mbarë botën;

- përfaqëson bibliotekat dhe përdoruesit e tyre në gjithë rruzullin tokësor;

- përmirëson cilësinë e shërbimeve bibliotekare duke promovuar standarde të praktikës bashkëkohore;

- ofron grante duke i dhënë mundësi profesionistëve nga vendet në zhvillim që të zgjerojnë eksperiencën e tyre;

- organizon më të rëndësishmen konferencë vjetore për bibliotekat.

IFLA është organizmi kryesor ndërkombëtar që përfaqëson interesat e bibliotekës, shërbimeve të informimit, si edhe të përdoruesve të tyre.

Rrjeti i ngritur gjatë periudhës 75- vjeçare punon falë angazhimit të shumë specialistëve.

## 75 YEARS OF IFLA

*IFLA was founded in Edinburgh, UK in 1927 and held its first conference as International Federation of Library Associations in Italy. In 1976 IFLA changed its name to include libraries as institutional members in: the International Federation of Library Associations and Institutions. Albania become member in IFLA 1977. Today IFLA:*

*▪ Promotes the principles of freedom of information, ▪ Represents libraries and their users worldwide, ▪ Improves the quality of library services by promoting standards of good practise, ▪ Etc.*



# LIBER

(Ligue des Bibliothèques  
Européennes de Recherche)

## *Etleva DOMI*

Biblioteka Kombëtare

LIBER përfaqëson dhe bën të njohura interesat e bibliotekave kërkimore në Europë. Qëllimi kryesor është të bëjë të njohura që bibliotekat kërkimore në Europë të bëhen një rrjet funksional përtej kufijve kombëtarë me qëllim që të sigurojë ruajtjen e trashëgimisë kulturore europiane, të mundësojë aksesin në koleksionet europiane dhe të ofrojë shërbime informuese në Europë.

## **Statuti i LIBER-it, 1994**

Lidhja e Bibliotekave Kërkimore Europiane (LIBER) është shoqata kryesore e bibliotekave kërkimore të rëndësishme në Europë. Është themeluar në vitin 1971 nën kujdesin e Këshillit të Europës. Në të janë

antarësuar 40 biblioteka kërkimore. Shqipëria ka aderuar në LIBER në vitin 1998. Mund të aderojnë edhe vënde që nuk janë anëtare të BE.

Bashkëpunon me të gjitha organizatat që janë të lidhura me bibliotekat. Mban lidhje me Këshillin e Europës, Komisionin



e Komunitetit Europjan, Federatën Ndërkombëtare të Shoqatave të Bibliotekave dhe Institucioneve (IFLA), si edhe me shoqatat kombëtare të bibliotekave.

## Qëllimi dhe misioni

Përfaqëson dhe inkurajon interesat e bibliotekave kërkimore në Europë. Qëllimi kryesor i LIBER-it është të ndihmojë bibliotekat kërkimore në Europë në organizimin e një rrjeti funksional përtej kufijve kombëtarë, i cili të garantojë ruajtjen e trashëgimisë kulturore europiane, zhvillimin e aksesit në koleksionet e bibliotekave kërkimore europiane dhe shërbime sa më efikase të informacionit shkencor në Europë.

Për të përmbushur këtë objektiv, LIBER përfaqëson interesat e bibliotekave kërkimore europiane (bibliotekat kombëtare dhe universitare) dhe, nëse ka nevojë, kërkon edhe për të identifikuar dhe për të përcaktuar nevojat e domosdoshme për bashkëpunim, inkurajon iniciativat në

këto fusha, vetëm apo në bashkëpunim me organizata të tjera;

Favorizon zhvillimin e aftësive profesionale me mbledhje, seminare, komisione pune dhe botime. Mbështet projekte shkencore specifike dhe programe të zhvillimit;

Inkurajon normalizimin në sektorët kryesorë të bashkëpunimit ndërmjet bibliotekave, si automatizimi;

Luan një rol aktiv në parashikimin afatgjatë të një politike të zhvillimit të rrjetit europian të bibliotekave kërkimore duke realizuar ekspertizën kolektive të bibliotekave anëtare.

Për të përmbushur këtë rol, LIBER inkurajon vendet anëtare që të mbështesin punën duke popullarizuar eksperiencën e secilës prej bibliotekave anëtare.

Boton revistën *LIBER Quarterly* (*The Journal of European Research Libraries*), ku botohen kryesisht artikuj rreth tematikave të ruajtjes dhe mirëmbajtjes së koleksioneve bibliotekare, kontrollit bibliografik, menaxhimit të bibliotekave, digjitalizimit etj. Adresa e saj në Internet është :

<http://liber.library.uu.nl/>

## LIBER

*LIBER is the principal association of the research libraries in Europe. It is found in 1971 under the auspices of the Council of Europe. Its current membership includes research libraries of 40 countries. The National Library of Albania becomes member in 1998.*

*LIBER represents and promotes the interests of research libraries in Europe and support the a functional network across national boundaries in order to ensure the preservation of the European cultural heritage, to improve access to libraries collections and to provide more efficient information services in Europe.*

# Sistemi i ISBN-së

**Violeta VISO**

Biblioteka Kombëtare

**P**roblemi i nevojës së një numërimi ndërkombëtar të librit u diskutua për herë të parë në Konferencën e Tretë Ndërkombëtare mbi kërkimet dhe tregtimin e librit në nëntor 1966 në Berlin.

Në këtë kohë një numërim për botuesit dhe shpërndarësit e librave në Europë ishte llogaritur në bazë të një inventari, prandaj ishte e nevojshme një sistem unik për të bërë një identifikim të thjeshtë të numrit të botuesve.

Sistemi që i përmbushte këto nevoja dhe që filloi të njej si Sistemi i Numërimit Ndërkombëtar Standard i Librit (ISBN), u zbatua fillimisht në Britani në vitin 1967, pastaj në SHBA në vitin 1968 dhe më pas në vende të ndryshme të botës. Sot 165 vende janë anëtarë të Agjencisë Ndërkombëtare të ISBN-së.

## Avantazhet e ISBN

- Është një identifikues unik ndërkombëtar për botimet monografike;
- Është një numur i vendosur në libër që i përgjigjet një sistemi kontrolli ndërkombëtar nga Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së në Berlin;
- Lejon përpilimin dhe plotësimin e katalogëve të tregimit të librave si "*Books in Print*";
- Ndhmon në porositjen dhe shpërndarjen e librave. Kjo është një metodë mjaft e thjeshtë dhe efikase;

- Ndihej në huazimin ndërkombëtar;
- Ndihej në kërkimet bibliografike.

## Struktura e ISBN-së

Çdo ISBN-ë përbëhet prej 10 shifrash që paraprihen me gërmat ISBN, të detyrueshme edhe për vendet që përdorin alfabetin sllav.

Numri 10 shifror është i ndarë në 4 pjesë me gjatësi të ndryshme që ndahen midis tyre me vizë apo hapësirë. Më e preferueshja është viza ndarëse.

## Katër pjesët përbërëse të një ISBN-je janë:

- *Identifikuesi i grupit*—identifikon kombin ose zonën me ngjashmëri gjuhe, gjeografike etj. Ky identifikues akordohet nga Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së;
- *Identifikuesi i botuesit*—identifikon botues të veçantë brënda një grupi. Gjatësia e këtij grupi varet nga numri i botimeve të botuesit. Ky numër akordohet nga Agjencia Kombëtare e ISBN-së;
- *Identifikuesi i titullit*—identifikon një titull të veçantë të botuar nga një botues i veçantë;
- *Shifra e kontrollit*—kjo është një shifër e vetme në fund të ISBN-së, e cila siguron një kontroll automatik në saktësinë e vendosjes së ISBN-së.

## Kryesisht ISBN-ë marrin këto botime:

- Librat e shtypur dhe pamfletat;

- Botimet e përziera të medias;
- Filmata, vidiot, librat në kasetat;
- Botimet elektronike;
- Botimet braille (për të verbërit);
- Mikrofilmat;
- Hartat.

Nuk marrin ISBN botimet në seri, regjistrimet zanore dhe muzika e shkruar.

## Vendosja e ISBN-së

ISBN-ja shtypet në pjesën e pasme të fletës së titullit. Ajo vendoset gjithashtu në fund të pjesës së pasme të kopertinës dhe në fund të pjesës së pasme të mbështjellësës së librit nëqoftëse ka. Për CD-të, kasetat etj. ISBN-ja vendoset në etiketën e tyre. Kur kjo është e pamundur, ISBN-ja shtypet në pjesën e pasme të mbajtësës. ISBN-ja duhet të shtypet me gërma të mëdha dhe të lexueshme lehtësisht.

## Kur jepet ISBN-ja

- Çdo titulli të botuar për herë të parë.
  - Çdo botimi të ri të një titulli kur ka ndryshime në tekst, format, lidhje etj., por jo rishtypjes pa ndryshim në tekstin origjinal.
  - Çdo botimi me shumë volume, i cili merr një ISBN-ë për tërë rrjetin e volumeve dhe një ISBN-ë për çdo volum (të dy ISBN-të shtypen në libër).
  - Çdo ribotimi të librit.
- Duke parë përparësitë e mëdha që kishte ky numërim, në vitin 1997, u krijua edhe në Shqipëri Agjencia Kombëtare e ISBN-së. Kjo agjenci funksionon pranë Bibliotekës

Kombëtare. Nga Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së në Berlin vendit tonë i është akorduar një identifikues grupi me pesë shifra që është 99927. Ky identifikues grupi i jep mundësi Agjencisë Kombëtare të ISBN-së të ketë në dispozicion 10.000 ISBN për vendin tonë.

Çdo botues në fillim të punës së tij për marrjen e ISBN-së bën regjistrimin pranë Agjencisë Kombëtare të ISBN-së, ku jep adresën dhe të dhënat e tij. Pranë Agjencisë ai merr identifikuesin e tij. Për çdo botim botuesi i drejtohet Agjencisë për të marrë identifikuesin e titullit së bashku me shifrën e kontrollit. Botuesi duhet të paraqesë të plotë materialin e pabotuar; krahas ISBN-së ai merr edhe CIP-in (Katalogimin në botim). Shërbim është falas.

Botuesi duhet të shtypë ISBN-në në vendet e duhura sipas rregullave. Nga ana tjetër ai duhet të dërgojë pranë Agjencisë Kombëtare të ISBN-së çdo ndryshim të adresës së tij, numrit të telefonit, faksit si

dhe çdo ndryshim të personit përgjegjës të shtëpisë botuese. Duhet të dërgojë pranë Agjencisë Kombëtare të ISBN-së gjithashtu edhe një parashikim vjetor të numrit të titujve që do të botojë dhe të mbajë një regjistër për çdo ISBN të marrë për botimet e tij. Botuesi duhet të njoftojë agjencinë për çdo ISBN të shtypur gabim.

Rëndësia e aplikimit të ISBN-së po kuptohet gjithnjë e më shumë nga botuesit dhe individët të veçantë. Kjo duket në rritjen e vazhdueshme të numrit të botuesve që regjistrohen pranë kësaj agjencie. Një fakt i rëndësishëm është se aplikimi i ISBN-së po merr një shtrirje të gjërë jo vetëm në Tiranë, por edhe në rrethe të ndryshme të vendit.

Gjatë këtyre viteve pranë kësaj agjencie janë regjistruar 178 botues, nga të cilët 151 botues nga Tirana dhe 27 botues nga rrethe të ndryshme si: Shkodra, Durrësi, Lezha, Vlora etj. si dhe janë marrë rreth 9.000 ISBN.

Adresa në Internet: [www.isbn.org](http://www.isbn.org)

## ISBN SYSTEM

*The ISBN (International Standard Book Number) is a unique machine-readable identification number. Firstly, it was developed in U. K. and then in U.S. Currently, 165 countries and territories are officially ISBN numbers. Taking into consideration the development of ISBN in the entire world, the ISBN Agency in Albania was created in 1997, which functions within the structure of the National Library of Albania (NLA). The NLA is also center of CIP (cataloguing in publication).*

*During these years 178 publishers, registered in the Albanian ISBN Agency, have taken about 9.000 ISBN.*

# Koleksionet po përjetojnë një shërbim të ri

**Gjergj SHYTI**  
Biblioteka Publike  
(Lezhë)

**B**iblioteka Publike e qytetit të Lezhës mbaroi së ndërtuari në vitin 2001. Është një ndërtesë trikatëshe, me një arkitekturë interesante në pamje dhe me ambiente mjaft funksionale.

Në përbërjen e saj ka pesë salla leximi, holle të bollshme e ambiente të tjera të domosdoshme, me mundësi të mëdha për një mjedis tërheqës dhe bashkëkohor.

Kjo bibliotekë është e vetmja e këtij lloji në këtë njësi administrative për më se 60.000 banorë. I shërben qytetit të Lezhës e të Shëngjinit, si edhe zonave përreth tyre. Në një mënyrë a në një tjetër, kryen shërbime për të gjithë zonat e tjera të rrethinave të Lezhës. Me fluksin e madh e

shtrirjen që po pëson qyteti e zonat pranë tij, në një të ardhme, biblioteka do ta ketë të vështirë të përballojë kërkesat në rritje të banorëve veçanërisht të zonave periferike.

Si bibliotekë publike, jemi përpjekur të ofrojmë shërbime bazuar në kërkesat e komunitetit. Gjatë planifikimit të shërbimeve, kemi përcaktuar më parë prioritetet. Hartimi i një strategji afatgjatë do të siguronte shërbime për një kohë sa më të



gjatë, duke i parë ato edhe sipas grupeve të përcaktuara që ka në përbërjen e vet komuniteti ynë. E rëndësishme është të theksojmë se shërbimet tek ne nuk kanë ardhur si rezultat i trysnive ideologjike, politike, fetare. Shërbimet tona, sidomos kohët e fundit, po synojnë për një reflektim e pasqyrim sa më të mirë e më realist të ndryshimeve të ndodhura në shoqërinë shqiptare e sidomos në atë lezhiane, si psh: ndryshimet sociale të ndodhura si rezultat i ardhjeve nga zonat e tjera si: Mirdita, Puka, Malësia e Mbishkodrës; ndryshimet e ndodhura në strukturën familjare; problemet e punësimit; ndryshimet demografike; diversitetet kulturore e mënyrat e komunikimit. Por, mbi të gjitha, jemi përpjekur ta ndërtojmë punën jo vetëm duke patur parasysh psikologjinë e trashëguar dhe kulturën tradicionale, por edhe implementimin e teknologjive të reja. Jemi ende të detyruar që të ruajmë si prioritare e të mbështetemi në metodat gojore të komunikimit për të kaluar dalëngadalë në përdorimin e teknikave të teknologjive të reja të komunikimit e informacionit.

Riorganizimi i gjithë fondit për rreth 100.000 ekzemplarësh dhe kalimi nga një bibliotekë me sistem fiks (sipas formatit të materialeve bibliotekare) në salla me fonde



të hapura, ku koleksionet janë renditur sipas fushave të dijeve, është një hap përpara. Lexuesi tani paraqitet vetë pranë rubrikës, fushës apo autorit që paraqet interes për të. Nëpërmjet orientuesve ai komunikon drejtpërdrejt me librin a dokumentin e preferuar. Kjo ka lehtësuar mjaft shërbimin. Një praktikë e tillë ka rritur ndjeshëm shkallën e informimit e të njohjes së koleksioneve që disponon biblioteka, çka është pasqyruar dukshëm në rritjen e numrit

të frekuentuesve. Për vitin 2002 në këtë bibliotekë u kryen rreth 2.500 shërbime bibliotekare.

Do të dëshiroja të përmendja kontributin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, ndihmesën e fondacionit Partner Fyr me qendër në Zyrih, fondacionit Soros dhe angazhimin e Bashkisë së Lezhë në rihabilitimin e bibliotekës. Një meritë po kaq të veçantë ka edhe Biblioteka Kombëtare (Departamenti i Studimeve & Kualifikimit dhe Qendra e Trajnimit Bibliotekar), si përpunën në drejtim të kualifikimit të vazhdueshëm profesional të bibliotekarëve tanë, ashtu edhe për ndihmesën e veçantë në riorganizimin e shërbimit të bibliotekës.

Në një të ardhme jo të largët përdoruesve do t'ju ofrohet edhe shërbimi i Internet-it.

Aktualisht, kemi krijuar një mjedis të

këndshëm e funksional për fëmijët, të cilët përbëjnë një numër të madh të përdoruesve. Kohët e fundit, koleksionet e bibliotekës po pasurohen jo vetëm me libra, por edhe me materiale jo libra si: CD, video etj., që bëjnë të mundur organizimin e veprimtarive argëtuese për fëmijët. Ato në bibliotekë provojnë jo vetëm kënaqësinë e të lexuarit, por edhe ndjesinë emocionale të fitimit të dijeve dhe të zhvillimit të imagjinatës. Si fëmijët, ashtu edhe prindërit e tyre, po aftësohen për ta përdorur bibliotekën gjithnjë e mirë. Janë organizuar edhe veprimtari të ndryshme si: diskutime librash, tregime përrallash, konkurse poezie e vizatimi etj.

Qëllimi është që fëmijët të mësohen ta përdorin bibliotekën që në moshë të vogël dhe të mbeten përdorues të saj edhe në vitet e ardhshme.

## THE LIBRARY PROVIDES NEW SERVICES FOR THE USERS

*The public library of Lezha is located in the new building. It has comfortable reading-rooms (furniture and equipments) and the staff of the library expects to reorganize the users' services in a near future with its open-stack collections.*

*It is the only library within the administrative (within the administrative territory of Lezha with 60.000 inhabitants). The library provides services for children too.*

*Now and then it organizes cultural activities with children and their parents as well, intending to be a reading and community's debate promotion center for young people.*

- 
- MEDLIB 105
  - BALKAN BIBLIOGRAPHY 105
  - VOIES ROMAINES EN MÉDITERRANÉE 105
-



## MEDLIB

Nën kujdesin e UNESCO-s, në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë Biblioteka Kombëtare është përfshirë në projektin MEDLIB (Bibliothèque Virtuelle Méditerranéenne), që synon realizimin e një Biblioteke Virtuale (libra, dorëshkrime, dokumenta, harta etj. - një pjesë edhe e digjitalizuar) me botimet më përfaqësuese të trashëgimisë kulturore shqiptare.

Projekti parashikon digjitalizimit e 50 dokumentave (libra & dorëshkrime) përfaqësuese të kulturës shqiptare dhe botimin e një bibliografie selective për Shqipërinë me 100 tituj. Bibliografia do të jetë e konsultueshme edhe në Internet.

Në projekt janë të përfshirë edhe vende të tjera.

## BALKAN BIBLIOGRAPHY

Me përfshirjen e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë në Konferencën e Qendrueshme të Drejtorëve të Bibliotekave Kombëtare të Vendeve të Europës Juglindore (SEENL), tashmë miratuar edhe nga CENL-ja (Council of European National Libraries), si hap i parë i bashkëpunimit është projekt-ideja e «Hartimit të bibliografisë së vendeve të Ballkanit për periudhën 1985-2002 ». Në fazën e dytë do të mendohet për mundësinë e krijimit dhe mirëmbajtjes së website-it të bibliotekave anëtare në SEENL.

Bibliografia do të jetë e konsultueshme edhe në Internet.

## VOIES ROMAINES EN MÉDITERRANÉE

Në kuadër të projektit INTERREG III, Biblioteka Kombëtare është përfshirë në projektin « Voies romaines en Méditerranée ».

Projekti synon krijimin e një perceptimi on-line të trashëgimisë kulturore mesdhetare në përgjithësi dhe asaj shqiptare në veçanti.

## MEDLIB

*The National Library in collaboration with the General Directorate of Albanian Archives has been included in the project MEDLIB (Bibliothèque Virtuelle Méditerranéenne). MEDLIB is a UNESCO initiative which aims to create a virtual site (virtual library) for the Mediterranean region.*

*The project envisages the digitalization of the most significant publications of Albanian cultural heritage and the publication of a selective bibliography concerning Albania.*

## BALKAN BIBLIOGRAPHY

*The compilation of « Balkan Bibliography » (1985-2002) is the first step of collaboration among the Council of South East European National Libraries (SEENL).*

*Balkan Bibliography is going to be published in paper format and will be accessible on Internet as well.*

## VOIES ROMAINES EN MÉDITERRANÉE

*In the framework of the project INTERREG III, The National Library of Albania has been included in the new project « Voies romaines en Méditerranée ».*

*The project intends to provide information about Mediterranean cultural heritage.*

The Site is financed by the Communication Strategy for



*WELCOME TO THE PORTAL OF THE NATIONAL  
LIBRARIES OF SOUTHEASTERN EUROPEAN  
COUNTRIES*



Search:



Standing Conference of  
the Directors of the  
NLSEC



Gallery



Links



Discussion



News



Contact

Preservation of cultural  
heritage

Joint projects

Researches of the  
collections

Exchange of librarians and  
information specialists

Exchange of documents  
and interlibrary loan

Conferences and  
exhibitions

Copyright laws

ALBANIA

TURKEY

BOSNIA &  
HERZEGOVINA

SERBIA


BULGARIA

ROMANIA

GREECE

MONTENEGRO

MACEDONIA



---

■ Statuti i Bibliotekës Kombëtare	109
■ Rezolutë e Glasgow-it për bibliotekat, shërbimet informuese dhe lirinë intelektuale	114
■ Deklaratë për bibliotekat dhe zhvillimet mbështetëse	116
■ Parimet e Kopenhagës	118
■ Rezolutë mbi zhvillimin e shërbimeve të bibliotekave publike shqiptare për komunitetin lokal	121
■ Rezolutë e Takimit të Drejtorëve të Bibliotekave Kombëtare të Vendeve të Europës Juglindore	123

---

# Statuti i Bibliotekës Kombëtare<sup>1</sup>

## KREU I

### EMËRTIMI, VENDNDODHJADHE VARËSIA

#### NENI 1

Biblioteka Kombëtare është biblioteka kryesore e shtetit, qendër studimore e shkencore. Veprimtaria e saj zhvillohet në përputhje me: Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr. 8576, dt. 3.2.2000 "Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr. 7603, dt. 9.10.1992 "Për dërgimin pa shpërbim të kopjeve të detyruara të shtypshkrimeve bibliotekave", Ligjin nr. 7867, dt. 12.10.1994 "Për mbrojtjen e pasurisë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme" si dhe ligje e vendime që kanë lidhje me veprimtarinë e saj.

#### NENI 2

Biblioteka Kombëtare ka selinë në Tiranë.

#### NENI 3

Biblioteka Kombëtare funksionon nën autoritetin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Titullari i kësaj ministrie miraton Statutin e Bibliotekës Kombëtare.

#### NENI 4

Biblioteka Kombëtare ka vulën e saj simbas lidhjes I të bashkëlidhur.

## KREU II

### FUNKSIONETE BIBLIOTEKËS KOMBËTARE

#### NENI 5

Biblioteka Kombëtare kryen veprimtari bibliotekare, realizon shërbimin ndaj përdoruesve, kryen shërbime bibliografike e informuese, drejton dhe kryen kërkime në fushën e

bibliotekonomisë e të standardizimit bibliotekar, realizon veprimtari shkencore dhe botuese të profilit të saj.

#### **NENI 6**

Biblioteka Kombëtare krijon, plotëson dhe ruan arkivin e kulturës së shkruar kombëtare. Depoziton për ruajtje të përhershme në fondin e arkivit çdo botim të kryer në vend, bazuar në ligjin e kopjes së detyruar. Në fondin e arkivit depozitohen edhe botime në gjuhën shqipe të realizuara jashtë vendit, që sigurohen nëpërmjet rrugëve të pasurimit bibliotekar.

#### **NENI 7**

Biblioteka Kombëtare depoziton, ruan, përpunon dhe vë në shërbim të përdoruesve koleksionet bibliotekare që bartin regjistrime të mendimit njerëzor në mjedise fizike të ndryshme dhe mënyra regjistrimi të ndryshme: në formë grafike (tekste të shtypura, dorëshkrime, materiale hartografike, grafike e muzikore), regjistrime zanore, dëgjimore-pamore, elektronike etj. që përfshijnë:

- a. Çdo botim që realizohet në Republikën e Shqipërisë.
- b. Dorëshkrime që përbëjnë vlera të kulturës kombëtare.
- c. Materiale në gjuhën shqipe të botuara jashtë vendit.
- d. Përkthime në gjuhë të huaja të autorëve shqiptarë të botuara jashtë vendit.
- ç. Literaturë me karakter albano - balkanologjik.
- e. Literaturë të huaj të karakterit të përgjithshëm.

Kryen në bazë të kriterëve të caktuara bibliotekonomike pastrimin e vazhdueshëm të fondeve të saj.

#### **NENI 8**

Biblioteka Kombëtare është agjenci kombëtare bibliografike. Përgatit dhe boton bibliografitë kombëtare korrente dhe retrospektive të librit dhe të artikujve të periodikut shqiptar. Harton dhe boton bibliografi me tematikë albano-balkanologjike. Përgatit dhe jep të dhëna statistikore për botimet brenda vendit.

#### **NENI 9**

Biblioteka Kombëtare përpunon koleksionet bibliotekare dhe pasuron bazën e të dhënave. Përgatit dhe jep informacion nëpërmjet skedarëve tradicionalë, katalogut elektronik në linjë/ rrjet dhe referimeve shkencore në përputhje me specifikën e saj.

## NENI 10

Përdoruesve (individë ose institucione) u shërbehen koleksionet e bibliotekës dhe informacioni i nevojshëm mbi bazën e rregullores së brendshme.

## NENI 11

Biblioteka Kombëtare kryen veprimtari metodike, ndjek ecurinë e standardizimit dhe njësimin në fushën e bibliotekonomisë dhe bibliografisë, të informacionit, të shërbimeve bibliotekare, leximit, si dhe të ruajtjes së materialeve bibliotekare. Ndër detyrat e saj përfshihen:

- a. Mirëmbajtja e katalogut përmbledhës të bibliotekave të vendit.
- b. Standardizimi dhe njësimi në fushën e bibliotekonomisë dhe bibliografisë.
- c. Botimi i materialeve me karakter metodik e profesional.
- ç. Përgatitja profesionale dhe kualifikimi i vazhdueshëm i punonjësve të bibliotekave të vendit.
- d. Pjesëmarrje në veprimtari studimore dhe projekte të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar me interes për të.

## NENI 12

Biblioteka Kombëtare ndihmon në përmirësimin e veprimtarisë së bibliotekave të vendit, veçanërisht në këto drejtime:

- a. Kryen përpunimin e përqendruar (katalogimin) të librit të botuar në vend.
- b. Jep ndihmë profesionale për të gjithë sistemin e bibliotekave të vendit.
- c. Nxit përdorimin e teknologjisë së informacionit në biblioteka.

## NENI 13

Biblioteka Kombëtare bashkëpunon me biblioteka, institucione dhe shoqata profesionale brenda dhe jashtë vendit nëpërmjet:

- a. Sigurimit të aksesit në koleksionet e saj;
- b. Huazimit dhe shkëmbimit ndërbibliotekar të koleksioneve;
- c. Shkëmbimit të informacionit;
- ç. Shkëmbimit të përvojës;
- d. Pjesëmarrjes në programe bibliotekare kombëtare dhe ndërkombëtare

## NENI 14

Në shkëmbimin e materialeve dhe informacionit Biblioteka Kombëtare u jep përparësi atyre dokumenteve që përbëjnë vlera kulturore kombëtare.

**NENI 15**

Cakton Numrin Standard Ndërkombëtar të Librit që botohet në Shqipëri.

**NENI 16**

Punëson bibliotekarë, studiues, punonjës teknikë dhe administrativë e të tjerë me nivel të përshtatshëm arsimor e profesional, me kohë të plotë ose të pjesshme pune, në përputhje me funksionet e saj bibliotekare e shkencore, në bazë të legjislacionit përkatës.

**KREU III**  
**DREJTIMI BIBLIOTEKËS KOMBËTARE****NENI 17**

Biblioteka Kombëtare drejtohet nga Drejtori, i cili administron, përfaqëson dhe përgjigjet për Bibliotekën Kombëtare. Ai cakton nëndrejtorin dhe ndihmohet prej tij në drejtimin e institucionit.

**NENI 18**

Për realizimin e veprimtarisë së Bibliotekës Kombëtare Drejtori kryen organizimin sipas departamenteve. Përgjegjësit e departamente-ve emërohen dhe lirohen nga detyra nga titullari i saj.

**NENI 19**

Drejtori, nëndrejtori dhe përgjegjësat e departamenteve përbëjnë Mbledhjen e Drejtorisë, e cila thirret nga Drejtori. Mbledhja e Drejtorisë është organ këshillimor i Drejtorit.

**NENI 20**

Në veprimtarinë e saj Biblioteka Kombëtare ndihmohet nga Këshilli Shkencor, përbërë prej 5 deri 7 anëtarësh, personalitete shkencore brenda dhe jashtë bibliotekës. 2/3 e numrit të anëtarëve janë punonjës të bibliotekës, specialistë të bibliotekonomisë dhe të shkencave të afërta. Përbërja e Këshillit Shkencor miratohet nga drejtori i Bibliotekës Kombëtare.

Mbledhja e këshillit drejtohet nga titullari i saj.

Këshilli shkencor shqyrton dhe jep mendime për:

- a. Politikat e zhvillimit të Bibliotekës Kombëtare, programet dhe planet e veprimtarisë studimore dhe vlerësimin e rezultateve të tyre.
- b. Veprimtaritë kryesore të Bibliotekës Kombëtare.



c. Çështje të tjera me porosi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.  
Këshilli mbledhet jo më pak se dy herë në vit. Vepron sipas rregullores së miratuar nga drejtori.

## KREU IV ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I BIBLIOTEKËS KOMBËTARE

### NENI 21

Organizimi i punës dhe funksionimi i Bibliotekës Kombëtare në çdo departament dhe në tërësi, realizohet në përputhje me rregulloren e brendshme, që miratohet nga titullari i bibliotekës.

## KREU V ORGANIZIMI FINANCIAR

### NENI 22

Biblioteka Kombëtare është institucion buxhetor nën varësinë financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

a. Buxheti i Bibliotekës Kombëtare përcaktohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Të ardhurat dytësore biblioteka i krijon nga veprimtari ekonomike të saj.

b. Investimet e Bibliotekës Kombëtare përfshihen në planin e investimeve shtetërore si pjesë përbërëse e planit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve që është investitor qëndror.

c. Dhuratat nga palë të treta përdoren në: procesin e pasurimit të koleksioneve, procese të shërbimit ndaj përdoruesve e ato bibliotekonomike, pajisjeve teknologjike e atyre të mjediseve.

### NENI 23

Përfaqësimi i të drejtave financiare të Bibliotekës Kombëtare dhe detyrimeve që rrjedhin, realizohet nga drejtorja dhe persona të tjerë të autorizuar prej saj. Dokumentet për qarkullimin e vlerave financiare siglohen nga drejtorja dhe përgjegjësi i Zyrës së Financës në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi.

### NENI 24

Biblioteka Kombëtare mund të kryejë shërbime kundrejt pagesës sipas kritereve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të saj.

Çdo shtesë apo ndryshim në këtë statut kryhet nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

1. Miratuar nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me Urdhër Nr. 569, më dt. 26.11.2002



## REZOLUTË E GLASGOW-it PËR BIBLIOTEKAT, SHËRBIMET INFORMUESE DHE LIRINË INTELKTUALE —(*Glasgow 2002*)

**M**bledhja e Glasgow-it, me rastin e 75-vjetorit të krijimit të Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave dhe Institucioneve Bibliotekare (IFLA) deklaronte se:

*IFLA* mbështet të drejtën themelore të njeriut për akses në informacion dhe të lirisë së shprehjes pa kufizime.

*IFLA* dhe anëtarët e saj në të gjithë botën mbështesin, mbrojnë dhe nxisin lirinë intelektuale, siç shprehet në Deklaratën Universale të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Kjo liri intelektuale përfshin pasurinë e dijes njerëzore, mendimin krijues dhe veprimtarinë intelektuale.

*IFLA* pohon se angazhimi në lirinë intelektuale është përgjegjësi me rëndësi për bibliotekat dhe punonjësit e informacionit kudo në botë, e shprehur nëpërmjet kodeve të etikës dhe e demonstruar në praktikë.

*IFLA* afirmon se:

- Bibliotekat dhe shërbimet informuese sigurojnë akses në informacion dhe në ide pavarësisht nga mjedisi dhe pa njohur kufi. Ato shërbejnë si porta drejt dijes, mendimit dhe kulturës, duke ofruar mbështetje për vendimmarrje të pavarur, zhvillim kulturor, studim dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës për individë dhe grupe.

- Bibliotekat dhe shërbimet informuese kontribuojnë në zhvillimin dhe zbatimin e lirisë intelektuale dhe ndihmojnë në mbrojtjen e vlerave demokratike dhe të të drejtave

civile universale. Për pasojë ato angazhohen t'u ofrojnë klientëve të tyre akses në burimet dhe shërbimet përkatëse pa kufizime dhe duke kundërshtuar çdo formë të censurës.

- Bibliotekat dhe shërbimet informuese marrin, ruajnë dhe vënë në përdorin lloje të ndryshme materialesh, që reflektojnë diversitetin e shoqërisë. Zgjedhja dhe vënia në përdorim e materialeve dhe shërbimeve bibliotekare duhet të drejtohet nga konsiderata profesionale dhe jo nga pikëpamje politike, morale e fetare.

- Bibliotekat dhe shërbimet informuese i bëjnë materialet, mjetet dhe shërbimet të përdorshme në mënyrë të barabartë për të gjithë përdoruesit. Nuk duhet të ketë diskriminim për asnjë arsye, përfshirë racën, origjinën kombëtare ose etnike, gjininë, moshën, paaftësinë, besimin fetar apo bindjet politike.

- Bibliotekat dhe shërbimet informuese mbrojnë çdo të drejtë private të përdoruesit dhe fshehtësinë në lidhje me informacionin e kërkuar dhe burimet e konsultuara, të huazuara ose të transmetuara.

*IFLA* u bën thirrje bibliotekave dhe shërbimeve informuese si dhe personelit të tyre të zhvillojnë më tej parimet e lirisë intelektuale dhe të sigurojnë akses pa kufi në informacion.

Kjo deklaratë është përgatitur nga IFLA/FAIFE (Programi i IFLA-s për Aksesin e Lirë në Informacion dhe Lirinë e Shprehjes) dhe është miratuar nga bordi drejtues i IFLA-s.

*Marrë nga IFLA Journal, V. 28, Nr, 5/6, 2002, f.335*

*Përktheu F. XHAJA*



## DEKLARATË PËR BIBLIOTEKAT DHE ZHVILLIMET MBËSHTETËSE — (*Glasgow 2002*)

Mbledhja e Glasgow-it, me rastin e 75-vjetorit të krijimit të Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave dhe Institucioneve Bibliotekare (IFLA) deklaroi se:

- Njerëzit kanë të drejtë themelore të kenë mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tyre ;
- Njeh rëndësinë e angazhimit në zhvillimet mbështetëse për të plotësuar nevojat e sotme, pa rrezikuar të ardhmen;
- Siguron se shërbimet bibliotekare dhe informuese nxisin zhvillimin nëpërmjet mbështetjes së lirisë së aksesit në informacion.

*IFLA* afirmon gjithashtu se:

- Komuniteti ndërkombëtar bibliotekar dhe i informacionit formon një rrjet, i cili lidh vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, mbështet zhvillimin e shërbimeve bibliotekare dhe informuese në botë dhe ndikon nëpërmjet shërbimeve në cilësinë e jetës dhe të mjedisit natyror.
- Profesionistët e bibliotekave dhe të informacionit vlerësojnë rëndësinë e edukimit nëpërmjet formave të ndryshme për të gjithë. Shërbimet bibliotekare dhe informuese veprojnë si porta të hyrjes në dije dhe kulturë. Ato sigurojnë akses në informacion dhe ide në formate të ndryshme, duke mbështetur zhvillimin personal të të gjitha grupmoshave dhe pjesëmarrjen aktive në shoqëri dhe në proceset vendimmarrëse.

- Shërbimet bibliotekare dhe informuese sigurojnë mbështetje bazë për të mësuarit gjatë gjithë jetës, vendimmarrjen e pavarur dhe zhvillimin kulturor për të gjithë. Nëpërmjet koleksioneve të shumta dhe medias së larmishme ato ofrojnë këshillim dhe mundësi për të mësuar. Shërbimet bibliotekare dhe informuese ndihmojnë njerëzit të përmirësojnë aftësitë edukative dhe sociale, shumë të rëndësishme këto në shoqërinë e informacionit dhe për pjesëmarrje në zhvillimet demokratike. Bibliotekat nxisin shprehinë e leximit, edukimin, vetëdijen dhe trajnimin.

- Shërbimet bibliotekare dhe informuese kontribuojnë në zhvillimin e lirisë intelektuale dhe ndihmojnë në ruajtjen e vlerave bazë demokratike dhe të të drejtave civile universale. Ato respektojnë identitetin, zgjedhjen e pavarur, vendimmarrjen dhe fshehtësinë e përdoruesve të tyre pa asnjë diskriminim.

- Shërbimet bibliotekare dhe informuese marrin, ruajnë dhe vënë në shërbim të të gjithë përdoruesve pa dallim, larmi të shumtë materialesh që reflektojnë pluralitetin dhe diversitetin kulturor të shoqërisë dhe pasurinë e mjedisit tonë.

- Shërbimet bibliotekare dhe informuese ndihmojnë në frenimin e pabarazisë në informacion që demonstron në rritjen e hendekut të informimit. Nëpërmjet rrjetit të shërbimeve mundësohet informacioni për studime dhe rinovime, që ndikon në zhvillimin dhe mirëqënien e popullsisë në të gjithë botën.

*IFLA* u bën thirrje bibliotekave dhe shërbimeve informuese, si edhe punonjësve të tyre, të nxisin parimet e mbështetjes së zhvillimit.

Kjo deklaratë është miratura në Bordin drejtues të *IFLA*-s në gusht 2002, në Glasgow.

*Marrë nga IFLA Journal, V. 28, Nr. 5/6, 2002, f.335-336*

*Përktheu F. XHAJA*



## PARIMET E KOPENHAGËS

(LIBER 2002)

### Vështrim i përgjithshëm

Në dekadën e fundit vërehet një zhvillim i shpejtë i një numri faktorësh që ndikojnë në sigurimin e koleksioneve të bibliotekave.

- Vlera në treg e një pjese të madhe të koleksioneve të bibliotekave është e barabartë me çmimet më të shtrenjta të antikave dhe të veprave të artit;
- Interesi i tregtimit të lirë të njësive që gjenden në biblioteka është vazhdimisht në rritje;
- Materialet me vlerë të koleksioneve bibliotekare janë bërë subjekt i vjedhjeve të karakterit ndërshtetëror në vendet e Europës.

Nisur nga kjo situatë, ne kemi vendosur të ndërtojmë një bashkëpunim të ngushtë midis bibliotekave me synim shmangien e këtyre incidenteve.

Është e qartë se biblioteka të veçanta janë ndeshur me këto probleme në mënyrë të izoluar në të shkuarën dhe bashkëpunimi midis bibliotekave ka qenë i rastësishëm. Nga ana tjetër, të gjitha bibliotekat priren të angazhojnë autoritetet policore në raste të vjedhjeve. Organizma të tilla si Interpol-i dhe Europol-i kanë kryer ekspertiza ndaj vjedhjeve të vlerave kulturore. Por në Europë ka larmi të madhe sistemesh ligjore dhe kjo e bën hetimin e vjedhjeve të ndërlikuar dhe të ngadaltë.

Krimi ndërkombëtar nuk varet nga kufizimet ligjore dhe administrative, por shfrytëzon hapjen e madhe të komunikimit modern dhe të shoqërisë së informacionit. Kjo krijon kushte për “krim nëpërmjet Internetit”.

Nga ana tjetër, Interpol-i dhe autoritetet policore kombëtare dhe ndërkombëtare bazohen tërësisht në evidentimet e kryera nga viktimat e vjedhjeve. Puna e pamjaftueshme në këto raste evidenton dobësi si të policisë ashtu dhe të ligjit.

Bibliotekat që kanë në ngarkim koleksione me vlera të veçanta kulturore duhet t'u japin përparësi politikave dhe sistemeve të sigurimit. Ato ndiejnë nevojën të zhvillojnë komunikim dhe bashkëpunim më të mirë me organizma të tillë si Interpol-i dhe Europol-i dhe me sistemet ligjore kombëtare për çështje të sigurimit.

Në botën e biznesit nëse një kompani humbet vlera për shkak të vjedhjeve, ajo ka marrë masa paraprake për kompensim si nëpërmjet sigurimeve ashtu dhe zëvendësimeve. Për institucionet kulturore është krejt ndryshe. Bibliotekat nuk mund të sigurojnë koleksionet e tyre, pasi ajo që ato mund të humbasin është pothuaj e pamundur të zëvendësohet. Nuk ka sigurim në rrugën tradicionale të këtyre materialeve.

Bibliotekat duhet të jenë të hapura për publikun dhe t'i venë koleksionet e tyre në shërbim të përdoruesve. Bibliotekat në përgjithësi janë të hapura dhe krijojnë marrëdhënie bashkëpunimi me përdoruesit - si me nxënësit e studentët, ashtu edhe me publikun e gjerë. Kjo hapje e madhe dhe ky bashkëpunim mund të shfrytëzohet nga kriminelët.

Ky është një realitet me të cilin përballen bibliotekat. Ato nuk janë vende të sigurta. Njëkohësisht bibliotekat, për më mirë apo për më keq, janë pjesë aktive e shoqërisë, me gjithë pasurinë që trashëgojnë.

Ata që janë ngarkuar me ruajtjen e pasurisë kulturore, duhet ta kuptojnë këtë fakt dhe të përballen me të, për të parandaluar aktet e kriminalitetit ndaj koleksioneve tona. Ne duhet të përpiqemi të kapërcejmë naivitetin që na shoqëron herë pas here dhe të veprojmë në mënyrë sa më profesionale.

Të dhënat tregojnë se ka një sërë dobësish në mënyrën se si ne përballojmë sulmet kriminale kundër koleksioneve tona dhe në organizimin e sistemeve të sigurimit. Këto duhen parë me kujdes dhe duhen shmangur nëse duam t'i vemë bibliotekat tona në pozita më të forta kundrejt kriminalitetit ndërkombëtar. Hapja nga ana e bibliotekave është faktor me rëndësi në këtë zhvillim. Heshtja institucionale është vetëm në favor të vjedhësit.

Parime të organizimit të rrjetit të bashkëpunimit ndërkombëtar për probleme të sigurimit të bibliotekave kombëtare dhe shkencore

## Parimi 1

Përfaqësuesit e bibliotekave kombëtare dhe shkencore bien dakort të krijojnë një rrjet siguri për bashkëpunim ndërkombëtar ndërmjet bibliotekave për të shmangur dhe luftuar sulmet kriminale ndaj koleksioneve me vlerë të bibliotekave.

### **Parimi 2**

Përfaqësuesit pranojnë se çdo bibliotekë kombëtare dhe shkencore është përgjegjëse për hartimin e politikës së sigurimit dhe krijimin sistemit të saj të sigurimit dhe njëkohësisht miratojnë angazhimin e tyre për bashkëpunim si pjesë përbërëse e rrjetit të gjerë të sigurimit.

### **Parimi 3**

Përfaqësuesit merren vesh të informojnë dhe të ndihmojnë njëri - tjetrin kur një bibliotekë është subjekt i një sulmi kriminal kundër koleksioneve të saj.

### **Parimi 4**

Përfaqësuesit shprehin vullnetin të hartojnë dhe zhvillojnë një kod etik për ruajtjen e informacionit për sigurimin dhe shkëmbimin e tij midis bibliotekave.

### **Parimi 5**

Rrjeti do të bashkëpunojë me policinë në nivel ndërkombëtar.

### **Parimi 6**

Përfaqësuesit merren vesh të emërojnë një anëtar të personelit si person kontakti për rrjetin.

### **Parimi 7**

Personat e caktur (menaxherë të sigurimit) do të shkëmbejnë mes tyre përvojë dhe praktikat më të mira për çështje të sigurimit të materialeve.

### **Parimi 8**

Informacioni për çështje të sigurimit është konfidencial për rrjetin e sigurimit.

### **Parimi 9**

Përfaqësuesit inkurajojnë LIBER-in të vendosë marrëdhënie bashkëpunimi për çështje të sigurimit me tregtimin e librit dhe me institucione të tjera të kujtesës.

Miraturar unanimisht nga delegatët e Konferencës së LIBER-it për Menaxhimin e Sigurimit të Bibliotekave, Kopenhagen, 12-14 maj, 2002.

*Marrë nga LIBER quarterly, V. 12, Nr. 4, 2002, f. 329-332*

*Përktheu F. Xhaja*



## REZOLUTË MBI ZHVILLIMIN E SHËRBIMEVE TË BIBLIOTEKAVE PUBLIKE SHQIPTARE PËR KOMUNITETIN LOKAL

**P**jesëmarrësit e seminarit rajonal me temë “Nxitja dhe mbështetja e identitetit të komunitetit, zhvillimit ekonomik, arsimit dhe diversitetit kulturor”, organizuar në Tiranë më tetor 2002, ranë dakort për rezolutën e mëposhtme:

Bibliotekat publike bëjnë pjesë në institucionet publike që janë në kontakt të ngushtë me kërkesat sociale lokale. Është kjo arsyeja që seminari u fokusua në përmirësimin e ndihmesës së tyre për jetën sociale të komunitetit. Roli i bibliotekave publike në shoqërinë e informacionit, që vjen e bëhet çdo ditë e më i rëndësishëm, është mjaft me peshë përsa i përket zhvillimit social dhe ekonomik. Ato ofrojnë mundësi të mëdha strategjike për përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe të mundësive demokratike duke siguruar akses të lirë dhe të barabartë në informacion.

Si qendra komunitare, bibliotekat publike janë të stimuluar të ndërgjegjësohen për rolin social të rëndësishëm që ato duhet të luajnë në shoqëritë në tranzicion. Ato kanë një rol vital në konfrontimin e ndryshimeve sociale të shoqërisë globale me rritjen e shpejtë të dijeve dhe të teknologjive të informacionit dhe të komunikimit.

Ne duhet të mbështesim transformimin aktiv të bibliotekave publike si institucione kyç. Ato janë:

- a) partnere aktive në ruajtjen e demokracisë dhe të stabilitetit, duke siguruar akses në të gjitha materialet e publikuara;
- b) mbështetëse të edukimit dhe të të mësuarit, duke shërbyer materialet bazë të dijeve;
- c) qendra lokale të teknologjive informatike, duke siguruar akses në hardware, software dhe network-e, që u japin qytetarëve një mundësi për t'u lidhur me teknologjinë e re të informacionit.

Në rajonin tonë, ashtu si në gjithë Europën, ka patur një rritje të dukshme të kërkesave për njohjen me zhvillimet e fundit në menaxhimin e bibliotekave, gjë që i atribuohet pranimit

të faktit që stabiliteti dhe demokracia nuk mund të funksionojnë pa një qytetari të mirëinformuar dhe institucione që e mbështesin këtë.

Ka një kërkesë të dukshme për bibliotekat publike shqiptare për të ripërcaktuar detyrat e tyre në qoftë se ato duan të mbijetojnë dhe të luajnë një rol të rëndësishëm në kushtet e reja të shoqërisë së informacionit. Ato janë mjaft të interesuara që të bashkëpunojnë me bibliotekat publike të Verias dhe të Lubjanës për të vendosur një mekanizëm përmes të cilit mund të realizohet ky bashkëpunim.

Në Shqipëri puna e bibliotekave publike duhet të fokusohet në një shtrirje më të madhe në mbështetje të jetës sociale. Komunitetet e qyteteve në të cilët këto biblioteka operojnë kanë një numër të madh problemesh të rëndësishme sociale dhe ekonomike që kanë të bëjnë me papunësinë, standardet e arsimit dhe fluksin e madh të popullsisë nga zonat rurale me pasoja për jetën e të gjithë komunitetit.

Bibliotekat publike shqiptare duhet të jenë të përgatitura të rivlerësojnë rolin dhe burimet e tyre si dhe të rikonceptojnë shërbimet për t'iu përgjigjur kërkesave të shndërrimeve sociale. Këtu përfshihet edhe krijimi shërbimeve të veçanta të informacionit për të mbështetur dhe përmirësuar veprimtaritë e biznesit lokal. Ashtu si në Greqi dhe Slloveni, bibliotekat publike shqiptare duhet të shikojnë jo vetëm mundësinë e ngritjes së shërbimeve informuese për biznesin, por edhe të krijojnë marrëdhënie me komunitetin e biznesit. Kjo kërkon një strategji të qartë për zhvillimin e shërbimeve në mbështetje të ekonomisë lokale, veçanërisht të SME-ve.

Më konkretisht seminari konkludoi si më poshtë:

1. Punonjësit e bibliotekave publike dhe stafi drejtues duhet të shumëfishojnë përpjekjet e tyre për një zhvillim modern të shërbimeve dhe të informacionit për komunitetet lokale.

2. Autoritetet lokale dhe qendrore duhet t'i japin përparësi trajtimit të problemit të zhvillimit të bibliotekave si dhe punës për një mbështetje financiare më të mirë për to.

3. T'i bëjë thirrje komunitetit bibliotekar europian për asistencë teknike për bibliotekat publike shqiptare me synim integrimin e tyre në zhvillimet europiane.

4. T'u bëjë thirrje Komisionit Europian, IFLA-s, UNESCO-s dhe fondacioneve të ndryshme të mbështesin financiarisht rrjetin e bibliotekave publike shqiptare.

Pjesëmarrësit lëshuan thirrje për:

1. Hartimin e një strategjie të qartë për zhvillimin e bibliotekave publike në Shqipëri.

2. Marrjen e masave të nevojshme për formimin dhe trajnimin e bibliotekarëve publikë.

3. Përmirësimin e drejtimit të bibliotekave publike.

4. Nxitjen e bibliotekave publike shqiptare për të bashkëpunuar, përmes projekteve të ndryshme, me biblioteka të huaja, nishta europiane dhe fondacione të ndryshme.

5. Inkurajimin e punës për përfitimin nga përvoja e përparuar në fushën e bibliotekave publike dhe përshtatjen me zhvillimet bashkëkohore.

Seminari falenderoi organizatorët dhe miqtë e huaj si dhe shprehu besimin se ata do të mbështesin edhe në të ardhmen zhvillimin e bibliotekave publike shqiptare. Këtyre miqve të bibliotekave shqiptare iu lëshua një thirrje për t'u angazhuar për përgatitjen e projekteve të përbashkëta me kolegët shqiptarë me qëllim nxitjen e mëtejshme të zhvillimit të shërbimeve të bibliotekave publike për komunitetet lokale.

## Rezolutë e Takimit të Drejtorëve të Bibliotekave Kombëtare të Vendeve të Europës Juglindore (Sofie 2002)

Gjatë Konferencës Ndërkombëtare, mbajtur në Sofie, Bullgari, nga 14-16 nëntor 2002, u zhvillua takimi i Drejtorëve të Bibliotekave Kombëtare të Vendeve Europës Juglindore, ku cilin morën pjesë: Bullgaria, Shqipëria, Turqia, Rumania, Greqia, Maqedonia, Serbia.

Drejtorët e institucioneve shprehën dëshirën e tyre për të nxitur bashkëpunimin kulturor rajonal në vendet e tyre nëpërmjet Bibliotekave Kombëtare.

Mendimi i tyre ishte që Bibliotekat Kombëtare janë institucione të rëndësishme kulturore brenda vendeve të tyre dhe premtojnë të mbështesin zhvillimin dhe bashkëpunimin e tyre nëpërmjet qeverive dhe organizatave ndërkombëtare.

Drejtorët vendosën të ndërmarrin çdo veprim për bashkëpunim të institucioneve të tyre, si edhe aktivitete kulturore të tilla si:

- Zhvillimi i politikave të huazimit ndërbibliotekar;
- Zhvillimi i praktikave në njohjen e të drejtave mbi krijimtarinë intelektuale të autorëve, botuesve etj.;
- Shkëmbim eksperience profesionale ndërmjet punonjësve të bibliotekave;
- Ndërmarrje të veprimeve të përbashkëta për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të rajonit dhe veçanërisht të dorëshkrimeve, inkunabulave, librave etj.;
- Hartimi i projekteve kërkimore të përbashkëta;
- Organizimi i veprimtarive kulturore si: konferenca, ekspozita, takime etj.;
- Ndihmë studiuësve të huaj për kërkime në koleksionet e tyre.

Drejtorët vendosën formimin e një Komiteti të Përherëshëm të Drejtorëve të Bibliotekave Kombëtare të Vendeve të Europës Juglindore.

Drejtorët i bënë thirrje të gjitha organizatave dhe institucioneve të tjera që kanë të bëjnë me bibliotekat ose punën informuese si Shoqatat e Bibliotekave, Bashkimet e Bibliotekarëve dhe Specialistëve të Informacionit, të ndërmarrin çdo lloj veprimi për bashkëpunim.

Drejtorët e Bibliotekave Kombëtare do të marrin masa që të ndihmojnë në këtë drejtim.

Drejtorët vendosën t'u bëjnë të ditur qeverive të tyre dhe organizatave ndërkombëtare dëshirën e tyre për bashkëpunim dhe marrëdhënie të fqinjësisë së mirë dhe të shtrojnë çështjen e gjetjes së programeve të veçanta për bibliotekat kombëtare të vendeve të Europës Juglindore nga qeveritë e tyre, Bashkimi Europian dhe organizatat ndërkombëtare.

Takimi tjetër u vendos që të zhvillohej në Ankara, Turqi në vitin 2003.

*Përktheu E. Kristani*

- 
- Në Bibliotekën Kombëtare përurohet salla  
“Paolo Petta” 125
  - Për herë të parë Dita Botërore e Librit  
në Shqipëri 128
    - Java e Gjuhës Italiane në Botë 129
    - Kontribut në realizimin e  
bashkëpunimit ndërinstytucional  
Tiranë-Prishtinë 130
    - Konsultë për rikonstruksionin e  
“aneksit” të Bibliotekës Kombëtare 131
-

PRILL 2002

# Në Bibliotekën Kombëtare përurohet salla “Paolo Petta”<sup>1</sup>

PRILL 2002

**B**iblioteka Kombëtare në bashkëpunim me Institutin Italian të Kulturës në Tiranë, si dhe me mbështetjen e Senatit të Republikës Italiane, z. Marcelo Pera dhe familjes Petta, mundësoi më 5 prill të vitit 2002 hapjen e sallës me fonde të hapura Albano-Balkanologji “Paolo Petta”.

Udhëhoqur nga: Presidenti i Shqipërisë z. Rexhep Meidani, Presidenti i Senatit Italian z. Marcelo Pera, Kryetari i Parlamentit Shqiptar z. Namik Dokle, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve z. Agron Tato. Në këtë ceremoni mori pjesë edhe Ambasadori i Ambasadës Italiane në Shqipëri Z. Mario Bova, drejtori i Institutit Italian të Kulturës Z. Attilio De Gasperis, bashkëshortja e P. Petta-s Znj. Giovanna Petta, kolegë të tij, si dhe shumë personalitete të kulturës, artit, shkencës etj.



Fjalën e hapjes e mbajti drejtori i Bibliotekës Kombëtare Dr. Aurel Plasari, i cili falenderoi palën italiane që mundësoi këtë veprimtari. Më pas ai shpalosi, përmes një analize të thellë shkencore, mesazhin e Paolo Petta-s në faqet e librit “Despotë të Epirit e princër të Maqedonisë.”

Kryesensori italian Prof. M. Pera, pasi bëri një portret të kolegut dhe mikut të tij, ndër të tjera tha: *“Paolo Petta, përmes librit të tij shkruan me dashuri për familjet e mëdha shqiptare, dashuri që kishte mbetur e njëanshme aq sa e njohur në Itali, fare pak ose aspak e njohur në Shqipëri. Por tashmë shqiptarët do ta kenë atë përditë në tempullin e tyre të dijes, siç është institucioni i Bibliotekës Kombëtare”.*

Z. Meidani, në fjalën e tij vuri theksin mbi origjinën shqiptare të autorit të librit. Pasi vlerësoi bashkëpunimin kulturor midis dy popujve i përcolli një falenderim të veçantë kryesensorit Pera, familjes Petta dhe Institutit Italian të Kulturës, që mundësuan ngritjen e sallës “Paolo Petta”.

Tepër e emocionuar, në përshëndetjen e saj, zonja Petta shprehu falenderim dhe mirënjohje për këtë veprimtari.

Veprimtaria u pasua me përrurimin e sallës Paolo Petta, me një fond të pasur me libra libra të karakterit albano-balkanologjik, si dhe mjaft fjalorë, enciklopedi, anuarë etj., dhuruar nga Senati Italian dhe familja Petta.

Të shoqëruar nga Dr. Plasari, Presidenti Meidani dhe kryesensori Pera prenë shiritin e përrurimit të sallës “Paolo Petta”.

Në të njëjtën ditë u promovua edhe botimi shqip i librit të Paolo Petta-s “Despotë të Epirit e Princër të Maqedonisë”.

(Sh. Hudhri)

### **NGA FJALA E PRESIDENTIT TË SENATIT ITALIAN MARCELO PERA**

*P. Petta ishte shumë i njohur në Itali për dashurinë dhe pasionin për Shqipërinë, por fare pak ose aspak i njohur në Shqipëri. Ai nuk mundi ta realizojë ëndrrën e tij për të vizituar Shqipërinë pasi vdekja e parakohshme e ndau nga ne. Por njeriu jeton jo vetëm fizikisht, por edhe si formë e përjetësisë ose si arketip i kujtesës. Edhe P. Petta vjen sot këtu në formën e përjetësisë duke sjellë me vete pjesën më të shtrenjtë të jetës së tij, fondin e pasur të librave të albanologjisë. Kështu fakti që kjo sallë mori emrin Paolo Petta e tregon më së miri këtë, dhe kështu amaneti i tij u krye.*

### **MBRESA NGA ZNJ. GIOVANNA PETTA, BASHKËSHORTE E PAOLO PETTA-S**

*Kam jetuar me aventurat e Petta-s. Historia e këtij libri është e hershme. Ndërsa ardhja në shqip është një tjetër ngjarje. Në të vërtetë ishte një ide e miqve të Petta-s dhe e familjes për të nderuar kujtimin e tij pas vdekjes së papritur. Vdiq duke lënë librin “Despotë të Epirit e princër të Maqedonisë”. Ishte një vëllim i kompletuar dhe i pabotuar, që përfaqëson impenjimin e tij gjatë viteve të fundit. Ndoshta Petta ishte në kërkim të rrënjëve të tij, të paraardhësve të tij shqiptarë këtu e 500 vjet më parë. Mund të them se ky botim ka zgjatur shumë, disa vite studimesh. Ai iu dedikua kësaj pune duke ndjekur gjurmët e çdo personazhi. Me këtë ritëm, gjurmë pas gjurme, zbulim pas zbulimi, ai kalonte shumë aventura. Të gjitha m'i tregonte duke i përjetuar për së dyti historitë e familjeve të mëdha shqiptare.*

*Dhe sot me ndihmën e miqve jemi këtu në Shqipëri.*

## MBRESA TË PROF. KOLI XOXIT, ANËTAR I KËSHILLIT SHKENCOR TË BIBLIOTEKËS KOMBËTARE

*Mund të themi pa ndroje se Biblioteka Kombëtare e çdo kombi është tempulli më fisnik i diturisë. Sidomos për ne shqiptarët ajo është më se e tillë. Në Bibliotekën tonë Kombëtare gjejmë që nga veprat e autorëve të mëdhenj grekë dhe latinë deri tek ato të autorëve bashkëkohorë. Drejtor i vërtetë i kësaj biblioteke ka qenë ai apo ajo që pandërprerë e ka pasuarur atë, e ka mbrojtur librin nga çdo armik i tij. Në Bibliotekën Kombëtare punojnë edhe të huaj, sepse diçka nuk e kanë gjetur në bibliotekat e tyre.*

*Por dita e sotme ka qenë e veçantë sepse ajo u pasurua edhe më shumë, madje edhe në mënyrë cilësore. Enciklopedi të reja, si ajo Treccani, libra të shumtë me karakter historik ballkanik dhe albanologjik tanimë zbukurojnë raftet e saj. Ishte Paolo Petta i nderuar që kishte lënë porosinë që një sërë librash edhe enciklopedish të bëheshin pronë e Bibliotekës Kombëtare, së bashku me librin e tij "Despotë të Epirit e princër të Maqedonisë". vepër me karakter thellësisht shkencor. U mahnita nga pasuria historike e këtyre veprave shkencore me përmbajtje sa të vjetër aq edhe të re.*

---

1. Studiuesi në këtë sallë gjen praktikën e sotme bashkëkohore, organizimin e shërbimit me fonde të hapura. Në një mjedis mjaft komod janë vendosur sipas degëve të shkencës mbi 800 botime, ku dallohen botimet enciklopedike, bibliografitë e ndryshme, fjalorët shumëgjuhësh etj. Vlera të veçanta paraqesin botimet me karakter albano-balkanologjik.

# Për herë të parë Dita Botërore e Librit në Shqipëri

DITA BOTËRORE E LIBRIT NË SHQIPËRI

**D**ita Botërore e Librit, gjatë të cilës organizohen veprimtari mbarëbotërore për librin dhe leximin, shënohet çdo vit më 23 prill, ditëlindjen e Uilliam Shekspirit. Kjo ditë, e konceptuar nga UNESCO-ja si një manifestim botëror, deri në vitin 2001 ka qenë shënuar me veprimtari të ndryshme në rreth 30 vende të botës. Në vitin 2002 këtyre vendeve iu shtua edhe Shqipëria.



Libri është një mjet universal akses i dijet e vlerave, mençurisë, ndjenjës estetike dhe përfytyrimit njerëzor. Si bartës i krijimit, informacionit dhe edukimit, ai i mundëson çdo kulture të shfaqë tiparet e saj thelbësore dhe të njihet me identitetin e kulturave të tjera. Si një dritare për diversitetin e kulturave dhe si një urë midis qytetërimeve përtej kohës dhe hapësirës, libri është një burim dialogu, një mjet shkëmbimi dhe zhvillimi. Për të gjitha këto arsye, UNESCO-ja ka shënuar Ditën Botërore

të Librit dhe të Copyright-it që nga viti 1966 me pjesëmarrjen e milionave njerëzve.

Ishte Biblioteka Kombëtare ajo që organizoi për herë të parë në vendin tonë manifestime në kuadër të kësaj dite. Më 23 prill 2002 në Qendrën e Trajnimit të kësaj biblioteke u prezantua manifesti i UNESCO-s dhe IFLA-s për bibliotekat shkollore. Në këtë mjedis, në bashkëpunim me Shoqatën e Bibliotekave, u zhvillua edhe një seminar për problemet e nxitjes së leximit, si një ndër detyrat themelore të bibliotekave. Po në këtë ditë në sallën shkencore nr.1 të kësaj biblioteke u realizua promovimi i librit “Nikolla Iorga, dijetari pa njollë e pa frikë” të Prof. Koli Xoxit, kushtuar figurës së këtij albanologu të shquar dhe miku të Shqipërisë. Në këtë kuadër, ky institucion organizoi dy ditë më vonë edhe promovimin e manualeve profesionale të botuara me mbështetjen financiare të projektit ALBANET. Ky projekt i Bashkimit Europian, koordinator i të cilit për Shqipërinë ishte Biblioteka Kombëtare, kishte për objekt reformimin dhe strukturimin administrativ dhe teknologjik të bibliotekave universitare të vendit tonë. Botimet që u promovuan ishin: “Udhëzues administrimi për bibliotekat universitare”, “Përshkrimi bibliografik i materialeve bibliotekare”, “Menaxhimi i ndryshimeve në shërbimet bibliotekare dhe informuese”, “Treguesi i emërtimeve lëndore” dhe “Tezauri”. Me këtë veprimtari Biblioteka Kombëtare nisi një traditë të re, e cila duhet të përqafohet edhe nga organizma të tjera që merren me drejtimin dhe administrimin e librit në Shqipëri.

(R. Vozga)





MINISTERO DEGLI AFFARI ESTERI - ACCADEMIA DELLA CRUSCA  
MINISTERO PER GLI ITALIANI NEL MONDO

ALTO PATRIMONIO DEL PRESIDENTE DELLA REPUBBLICA ITALIANA

ISTITUTO ITALIANO DI CULTURA DI TIRANA



IN COLLABORAZIONE CON IL

DEPARTAMENTO DI ITALIANISTICA DELL'UNIVERSITÀ DI TIRANA  
CENTRO DI STUDI

## Java e Gjuhës Italiane në Botë

**N**ë kuadër të Javës së Gjuhës Italiane në botë, Biblioteka Kombëtare në bashkëpunim me Institutin e Kulturës Italiane organizuan në Tiranë, më 15 tetor 2002. konferencën-debat “Problemet e përkthimit letrar nga italishtja në shqip”.

Në këtë veprimtari morën pjesë : shkrimtarë, përkthyes, botues, pedagogë, studentë, përfaqësues të medias së shkruar dhe elektronike.

Veprimtarinë e hapi drejtori i Bibliotekës Kombëtare Dr. Aurel Plasari, i cili foli edhe për veprimtarinë letrare të autores italiane Dacia Maraini. Po atë ditë u hap ekspozita “Autorët italianë në fondet e Bibliotekës Kombëtare-përkthime” dhe u promovuan edhe dy romanet e përkthyer në shqip kohët e fundit të shkrimtares së mirënjohur italiane Daçia Maraini. Paraqitjen e përkthimeve u bë nga përkthyesja Znj. Klodeta Dibra dhe botuesja Donika Omari.

Veprimtaria u ndoq me interes nga të pranishmit.

(E. Domi)

## Kontribut në realizimin e bashkëpunimit ndërinstitucional Tiranë-Prishtinë

**M** bështetur në marrëveshjen e datës 16.02.2000 për bashkëpunimin midis Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës si edhe në kuadër të marrëveshjes kulturore nënshkruar midis dy dikastereve respektive të kulturës, Biblioteka jonë Kombëtare organizoi në Prishtinë gjatë muajit tetor 2002 një kurs intensiv teorik dhe praktik në fushën e bibliotekonomisë, i cili synoi të japë ndihmesën tonë të parë për zhvillimin profesional të bibliotekarëve të Kosovës. Problematika e trajnimit ishte njohja me teorinë dhe konceptimet e reja lidhur me rolin e bibliotekave në shoqërinë e informacionit, freskimi i njohurive që kanë të bëjnë me teknikat, proceset dhe shërbimet bibliotekare. U trajtuan temat që kishin të bënin me probleme të tilla si:

- Vendi i bibliotekave në Shoqërinë e Informacionit;
- Zhvillimi i koleksioneve bibliotekare;
- Përshkrimi bibliografik;
- Klasifikimi i materialeve bibliotekare;
- Metodika e klasifikimit të degëve të veçanta;
- Klasifikimi lëndor;
- Katalogët dhe bibliografitë;
- Bibliografia;
- Shërbimi ndaj lexuesve dhe informacioni;
- Zbatimi i teknologjive informatike në biblioteka;
- etj.

Lektorët që u aktivizuan për realizimin e këtyre problematikave ishin punonjës të kualifikuar të Bibliotekës Kombëtare, të cilët faktikisht janë ndër më të shquarit në veprimtaritë formuese dhe trainuese që zhvillon Biblioteka jonë Kombëtare.

Pjesëmarrësit në këtë veprimtari kualifikuese, gjithsejt afër 60 vetë, ishin punonjës të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Prishtinës dhe të bibliotekave rajonale të Kosovës 18 vetë.

Veprimtaria synoi arritjen e objektivave të mëposhtëm:

- ✓ Aftësimi profesional i stafit të bibliotekave të Kosovës për përballimin e situatës emergjente atje;
- ✓ Rritja e aftësisë të tyre menaxhuese në shërbimet dhe proceset bibliotekare;
- ✓ Formimi profesional i punonjësve të rinj të bibliotekave të Kosovës;
- ✓ Freskimi i njohurive dhe azhurnimi me të rejat e teorisë dhe praktikës bibliotekare i punonjësve me stazh të këtyre bibliotekave.

(R. Vozga)

## Konsultë për rikonstruksionin e “aneksit” të Bibliotekës Kombëtare

**D**rejtoria e Bibliotekës Kombëtare, nën kujdesin e znj. Arta Dade, ministre e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, organizoi më 9 tetor 2002 një konsultë sensibilizuese për gjendjen e rënduar të shërbimit bibliotekar në mjediset e “aneksit” të BK që gjendet në ndërtesën e vjetër të saj. Në këtë konsultë, që u mbajt pikërisht në ato mjedise, morën pjesë. z. Edi Rama, kryetar i Bashkisë së Tiranës, përfaqësues të disa ambasadave të akredituara në Tiranë, të organizmave dhe fondacioneve të ndryshme donatore etj.

Pas një vizite të shkurtër, gjatë së cilës të ftuarit panë nga afër gjendjen e mjerueshme të këtij “aneksi” të institucionit, Dr. Aurel Plasari, drejtor i Bibliotekës Kombëtare, paraqiti vizionin e tij për restaurimin e ndërtesës dhe rinovimin e shërbimeve bibliotekare që realizohen në të për të bërë të mundur vënien në shërbim të lexuesve të Tiranës dhe të krejt vendit të vlerave të çmuara që ruhen aktualisht aty.

Mjaft nga të ftuarit, pas vizitës dhe fjalës sensibilizuese të z. Plasari, premtuan të kontribuojnë financiarisht për daljen nga kjo gjendje dhe reformimin e shërbimeve bibliotekare për publikun e gjerë.

Në këtë mjedis të rrënuar nga koha dhe mungesa e investimeve ruhen, e theksojmë ruhen dhe gati nuk shfrytëzohen fare, me mijëra vepra nga fondi i artë i literaturës filozofike, artistike dhe shkencore, produkt i të gjitha kohërave dhe i të gjithë popujve. Rikonstruksioni i kësaj ndërtese kërkohet jo për motive nostalgjie, por për t’u dhënë mundësi brezave të rinj të lexuesve të kontaktojnë dhe të njihen me këtë thesar të trashëgimisë së shkruar botërore. Jo vetëm nxënësit dhe studentët që studiojnë gjuhë të huaja në shkolla, por e gjithë ajo masë e madhe lexuesish kryeqytetas do të gjenin në koleksionin e kësaj sale në original kryeveprat e Homerit dhe Virgjilit, Dantes dhe Petrarckës, Shekspirit dhe Dikensit, Balzakut dhe Hygoit, Gëtes dhe Shilerit, Tolstoit dhe Çehovit, Drajzerit dhe Hemingueit, Andersenit etj. Askush nuk ka të drejtë t’i privojë qytetarët e Tiranës nga kjo pàsuri e madhe e kulturës botërore, e cila, jo për fajin e Bibliotekës Kombëtare, qëndron e “kyçur” prej vitesh në errësirë këtu në qendër të Tiranës. Në kushtet aktuale, nuk mund të bëhet asgjë për t’ia servirur lexuesit këtë thesar. Investimet e duhura do ta shndërronin këtë sallë të errët në një nga mjediset më komode dhe më të kulturuar të kryeqytetit, ashtu siç i ka hije librit dhe Bibliotekës sonë Kombëtare. Vizioni i drejtuesve të Bibliotekës Kombëtare është që ta organizojmë koleksionin e kësaj sale sipas parimit bashkëkohor të fondeve të hapura, për t’i krijuar kështu mundësi lexuesit të jetë në kontakt të drejtpërdrejtë me vlerat që fshihen këtu.

(R. Vozga)

---

■ Prirjet bashkëkohore në biblioteka	133
■ Nxitja dhe mbështetja e identitetit të komunitetit, zhvillimit ekonomik, arsimimit dhe diversitetit kulturor	134
■ Bibliotekat publike në një Europë të re	135
■ Bibliotekat në shoqërinë e informacionit dhe teknologjive të reja	135
■ Bibliotekat, shoqëria civile dhe zhvillimi social	136
■ Në kërkim të dimensionit të humbur: MESDHEU	137

---

# Prirjet bashkëkohore në biblioteka

## SEMINAR NDËRKOMBËTAR

**N**ë kuadër të veprimtarive trainuese për kualifikimin e vazhdueshëm të punonjësve të bibliotekave tona, Qendra e Trajnimit Bibliotekar pranë Bibliotekës Kombëtare organizoi në mjedisin e saj nga 7-9 mars të vitit 2002 seminarin ndërkombëtar "Tendencat bashkëkohore në biblioteka". Në të morën pjesë punonjës nga Biblioteka Kombëtare, nga bibliotekat shkencore të Tiranës dhe nga bibliotekat publike të vendit.

Prej disa vitesh po bëhen përpjekje për krijimin e lidhjeve të ngushta me bibliotekarët slovenë. Shembulli dhe përvoja slovene në fushën e bibliotekave janë të njohura dhe të vlerësuara edhe përtej rajonit tonë, aq sa mund të thuhet se ato u përkasin modeleve perëndimore të zhvillimit bibliotekar. Ndaj edhe është synuar tërheqja e specialistëve nga ky vend në veprimtaritë tona trajnuese. Konkretisht ishte e treta herë që bibliotekarë slovenë gjendeshin këtu për të dhënë përvojën e tyre.

Siç shihet edhe nga tema, seminari kishte për qëllim njohjen e bibliotekarëve tanë me zhvillimet e sotme në plan teorik dhe praktik. Ai synonte dhënien e një informacioni bazë për sistemin bibliotekar sloven dhe automatizimin e tij, për

legjislacionin bibliotekar, funksionet e tipeve të ndryshme të bibliotekave, formimin dhe trajnimin e bibliotekarëve në Slloveni. U paraqitën gjithashtu burimet elektronike të informacionit dhe përdorimi i tyre në biblioteka si edhe rrugët e kontrollit bibliografik dhe përgatitja e bibliografive kombëtare.

Objektivat e seminarit ishin:

- Njohja me organizimin dhe funksionimin e sistemit bibliotekar sloven dhe rolin e bibliotekarit në të;
- Informimi mbi modelin sloven të formimit dhe trajnimit të bibliotekarëve;
- Marrja e informacion mbi rrugët e mundshme të automatizimit bibliotekar;
- Aftësimi për identifikimin e burimeve elektronike për bibliotekat dhe njohja me rrugët e përdorimit të tyre;
- Njohja me tendencat moderne në përpilimin dhe paraqitjen e bibliografive kombëtare;
- Aftësimi për përgatitjen e projekteve për konvertimin retrospektiv;
- Gjetja e metodave dhe teknikave të përshtatshme për vlerësimin e veprimtarisë bibliotekare.

Format e përdorura në seminar ishin leksioni, demonstrimi dhe diskutimi.

(R. Vozga)

# Nxitja dhe mbështetja e identitetit të komunitetit, zhvillimit ekonomik, arsimimit dhe diversitetit kulturor

SEMINAR NDËRKOMBËTAR

Qendra e Trajnimit Bibliotekar e Bibliotekës Kombëtare organizoi më 21-23 tetor 2002 seminarin me temë “Nxitja dhe mbështetja e identitetit të komunitetit, zhvillimit ekonomik, arsimimit dhe diversitetit kulturor” (zhvillimi i shërbimeve të bibliotekave publike për komunitetet lokale). Seminari u realizua sipas parashikimit të projektit përkatës të miratuar nga programi Lindje - Lindje i Institutit të Shoqërisë së Hapur-Budapest me referatet dhe panelet e planifikuara. Në kuadër të këtij seminari u promovua edhe filmi dokumentar me karakter metodik-profesional i titulluar “Bibliotekat publike shqiptare në rrjedhat e shoqërisë së informacionit”. Në referatet e mbajtura nga bashkëorganizatorët e seminarit Breda Karun (Slloveni), Ioannis Trohopoulos (Greqi) si dhe eksperti Rob Davies (Angli) u trajtuan probleme të zhvillimeve aktuale të bibliotekave publike në Europë. Si njohës të mirë edhe të gjendjes së këtyre institucioneve në Shqipëri, ata dhanë mendime dhe sugjerime me vlerë për kapërcimin e problemeve dhe sfidave që hasin bibliotekat tona publike. Përmirësimi i shërbimeve ndaj komunitetit lokal u trajtua edhe nga specialistët vendas.

Përfaqësuesit e dikastereve të kulturës dhe të pushtetit lokal si dhe ata të njësive vendore mirëkuptuan problemet që u ngritën dhe premtuan vëmendje më të madhe për këto institucione të rëndësishme që ndikojnë drejtpërsëdrejti në zgjidhjen dhe plotësimin e kërkesave të fushave të ndryshme që ka

komuniteti.

Sidomos gjatë diskutimit në panele, pjesëmarrësit dhe bibliotekarët e ardhur nga Greqia dhe Sllovenia, u ndalën në përvojat pozitive dhe të metat që vihen re në punën e bibliotekave publike për të realizuar detyrat e tyre ndaj komuniteteve lokale të njësive vendore në territorin e të cilave ato ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Me rëndësi në këtë seminar ishte sidomos paraqitja para auditorit e nismës së madhe europiane të emërtuar PULMAN, në të cilën përfshihet edhe Shqipëria. Në këtë nisëm të mbështetur financiarisht nga Komisioni Europian janë angazhuar institucione në shërbim të drejtpërdrejtë të komuniteti lokal si bibliotekat publike, muzetë dhe arkivat. Si rezultat konkret i seminarit duhet konsideruar ngritja e një grupi mbështetës të bibliotekave publike shqiptare dhe udhëzimi i tij nga eksperti anglez për t'u angazhuar me projekte konkrete në veprimtarinë e Programit të Teknologjive të Shoqërisë së Informacionit të Komisionit Europian.

Me rëndësi ishte edhe rezoluta që u miratua në fund të seminarit, e cila e vuri theksin në përmirësimin e shërbimeve të bibliotekave publike për komunitetin, ndërgjegjësimin e vendimmarrësve për vlerën e këtyre shërbimeve si dhe në popullarizimin e arritjeve të bibliotekave publike model të Fierit, Vlorës etj. Mbi të gjitha, rezoluta theksoi nevojën e lidhjeve më të ngushta të këtyre institucioneve me homologet e tyre në rajon dhe më gjerë.

(R. Vozga)

## Bibliotekat publike në një Europë të re

KONFERENCË NDËRKOMBËTARE

**M**ë 17-18 tetor 2002 nën kujdesin e Ministrisë Kroate të Kulturës u mbajt në Zagreb të Kroacisë Konferenca e 5-të Ndërkombëtare "Bibliotekat publike në një Europë të re". Merrnin pjesë përfaqësues nga biblioteka të shumë vendeve të Europës Qendrore dhe Juglindore, përfshirë edhe Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë.

Konferenca u organizua nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kroacisë, Shoqata e Bibliotekarëve Kroatë, Instituti Francez i Kulturës & Instituti Gëte me seli në Zagreb. Konferencën e nderuan me praninë e tyre edhe përfaqësues të lartë të Ministrisë së Kulturës Kroate.

Eksptertë dhe bibliotekarë nga Kroacia, Franca, Gjermania kumtuan rreth globalizimit dhe domosdoshmërisë së automatizimit të bibliotekave në epokën e informacionit dhe teknologjive të reja, kryesisht në vendet që janë në tranzicion, duke sjellë edhe përvojën e tyre të përparuar në këtë drejtim.

Pjesëmarrësit ndoqën me interes kumtuesit dhe në diskutimet e tyre theksuan domosdoshmërinë e bashkëpunimit, të dialogut ndërmjet kulturave shkëmbimit të dijeve e informacionit.

## Bibliotekat në shoqërinë e informacionit dhe teknologjive të reja

SEMINAR NDËRKOMBËTAR

**S**eminari ndërkombëtar "Bibliotekat në shoqërinë e informacionit dhe teknologjive të reja" u zhvillua në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë 2002. U ndoq nga bibliotekarë frankofonë të Bibliotekës Kombëtare, bibliotekave publike dhe universitare të Shqipërisë, Kosovës, Moldavisë, Rumanisë dhe Malit të Zi.

Ishin ftuar si lektorë personalitetet e bibliotekonomisë nga Anglia Lyn Robinson, David Bawden, si edhe specialistë shqiptarë. Në temat e tyre ata theksuan rolin e bibliotekave në shoqërinë e informacionit si një faktor i rëndësishëm në zhvillimin kulturor të çdo vendi. Tematikat e referimeve ishin : bibliotekat dhe interneti, epoka e informacionit, digjitalizimi i materialeve bibliotekare, domosdoshmëria e një strategjie të re për bibliotekat në epokën e kibernetikës etj.

Seminari ngjalli interes për pjesëmarrësit, çka u pasyrua dhe në diskutimet e tyre.

Ai synoi ndërgjegjësimin e bibliotekarëve për përkrahjen dhe aplikimin e teknologjive të reja në bibliotekat e tyre, duke i shndërruar ato në qendra informuese për përdoruesin.

(E.Domi)

# Sofie 2002

## Bibliotekat, shoqëria civile dhe zhvillimi social Konferencë ndërkombëtare

**K**onferenca ndërkombëtare «Bibliotekat, shoqëria civile dhe zhvillimi social», organizuar nga Biblioteka Kombëtare e Bullgarisë në bashkëpunim me Universitetin e Sofies dhe Universitetin e Emporias (SHBA), zhvilloi punimet në Sofie nga data 15 deri më 17 nëntor 2002.

Konferenca u ndoq nga bibliotekarë, ekspertë, specialistë të 23 vendeve, përfshirë edhe Shqipërinë. U diskutua rreth rolit të bibliotekave në epokën e informacionit dhe teknologjive të reja, rëndësisë së tyre në demokratizimin e shoqërisë. Të gjithë pjesëmarrësit nga Europa Qendrore dhe Lindore kërkuan që bibliotekarët të bashkëpunojnë më shumë në të ardhmen në fushën e kërkimeve shkencore, shkëmbimit të eksperiencës, krijimit të bazës së të dhënave, lehtësimit të aksesit në burimet të informacionit etj. Konferenca u organizua në disa seksione. Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë u paraqit me kumtesën « Sistemi bibliotekar në Shqipëri », ndërsa Shoqata e Bibliotekarëve të Shqipërisë paraqiti veprimtarinë 10-vjeçare të saj.

Në mbyllje të takimit pjesëmarrësit miratuan rezolutën e konferencës.

Gjatë qëndrimit në Sofie, pjesëmarrësit e konferencës vizituan « Centre for Advanced Study », në të cilën drejtori akademik i saj hodhi idenë e bashkëpunimit ndërmjet bibliotekave kombëtare të vendeve të Europës Juglindore për projektin « Hartimi i Bibliografisë së vendeve të Ballkanit për periudhën 1985-2002 ».

### Takim ballkanik

Gjatë punimeve të konferencës u organizua një takim i veçantë me drejtues të bibliotekave kombëtare dhe kryetarë të shoqatave të bibliotekarëve nga Shqipëria, Greqia, Maqedonia, Serbia, Turqia, Rumania, Bullgaria.

Pjesëmarrësit në takim nëvizuan domosdoshmërinë e ngritjes së një strukture dhe website-i të përbashkët të bibliotekave kombëtare të vendeve të Europës Juglindore dhe një bashkëpunimi më të ngushtë ndërmjet bibliotekave të rajonit. U theksua domosdoshmëria e përkrahjes dhe mbështetjes së veprimtarisë së bibliotekave edhe nga organizatat ndërkombëtare.

Gjatë Takimit ballkanik 2002 (Sofie), duke synuar përfshirjen e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë në strukturat europiane, u mundësua anëtarësimi i saj në Konferencën e Drejtorëve të Bibliotekave Kombëtare të Vendeve të Europës Juglindore.

U shkëmbyen mendime për zhvillimin e politikave të huazimit ndërbibliotekar, shkëmbimit e vizitave mes bibliotekarëve, hartimin e projekteve të përbashkëta kërkimore për ruajtjen dhe evidentimin e trashëgimisë kulturore të rajonit etj.

Drejtorët e bibliotekave kombëtare nënshkruan rezolutën e takimit<sup>1</sup>. (E.Domi)

1. Rezoluta është botuar e plotë në rubrikën "Dokumente"



## Në kërkim të dimensionit të humbur: MESDHEU

**B**iblioteka Kombëtare dhe Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, në bashkëpunim me Qendrën e Kulturës Bashkëkohore të Barcelonës (Spanjë), organizuan më 21 shtator 2002 konferencën ndërkombëtare me temë “Në kërkim të dimensionit të humbur: MESDHEU”. A ekziston një identitet mesdhetar? Mesdheu si gjeopolitikë. Hapësira mesdhetare në epokën e komunikimit modern. Unitet apo diversitet? Mesdheu i vështruar nga Europa juglindore. “Det i hapur” apo “det i mbyllur”?-këto ishin disa nga çështjet intriguese të problematikës që trajtoi konferenca.


Veç të ftuarve dhe kumtuesve shqiptarë morën pjesë edhe figura të njohura të politologjisë, historiografisë, kulturës dhe letërsisë mesdhetare nga Spanja, Italia, Greqia etj. Referatet e mbajtura ishin: *Mesdheu-overdozë identitetesh* (J.

Ramoneda-drejtor, QKB Barcelonë), *Mesdheu si realitet dhe imagjinatë* (B. Shehu-shkrimtar Shqipëri), *Mesdheu si kontrapunkt* (S. Pesmazoglou-Universiteti Panton i Athinës), *Nga utopia ballkanike në utopinë mesdhetare: vënia e një kufiri* (M. Pandolfi-Universiteti i Montrealit), *Nga miti i Mesdheut në një ndër-gjegje euromesdhetare* (P. Misha-Shtëpia e Librit & e Komunikimit), *Identi-tet apo thjeshtë afëri* (A. Chrysostomi-dës-shtëpia botuese Kastaniotis), *Mesdheu midis së shkuarës dhe të ardhmes* (P. Matjevic-Universiteti la Sapienza i Romës), *Shqiptarët në Mesdheun e mesjetës së vonë* (A. Bitri-Universiteti i Tiranës), *Shqipëria politike si lojë e luajtur në det* (A. Plasari-Biblioteka Kombëtare) dhe *Mesdheu: një det që bashkon/një det që ndan* (P. Vilanova-Universiteti i Barcelonës).

(R. Vozga)



## Lexime të rekomanduara



*Ferro, Frank*

*How to use the library : a reference and assignment guide for students [Si të përdorësh bibliotekën : udhëzues për nxënësit] / Frank Ferro, Nolan Lushington. – Westport, Conn. : Greenwood Press, 1998.*

*X, 324 f. : 24 cm.*

*Bibliogr. f. 301. – Indeks.*

*ISBN 0-313-30107-7*

*P520 / 25 C*

Për botimin e këtij libri autorët u nxitën nga disa faktorë si:

Shumë nxënës dhe studentë duan të mësojnë se si të gjejnë një libër në bibliotekë

dhe si të bëjnë kërkime në kompiuter. Ata kanë nevojë të dinë si janë organizuar bibliotekat dhe si të përdorin katalogët me skeda dhe ata të kompiuterizuar. Nxënësit

duan të dinë gjithashtu dallimin midis një atlas, një almanaku dhe një enciklopedie si dhe funksionet e ndryshme që kryejnë këto burime informacioni.

- Një numër botimesh referuese bazë janë të njëjta pothuajse në të gjitha bibliotekat publike dhe në shumë biblioteka të shkollave.
- Shumë detyra shtëpice dhe detyra kursi janë të ngjashme dhe përbajnë të njëjtat njohuri bazë.
- Ndihet mungesa e një botimi që t'u shpjegojë nxënësve si është organizuar biblioteka, si gjenden burimet e informacionit në bibliotekë ose si përdoren mjetet e kompiuterizuara të saj. Nuk ka ndonjë botim që të bëjë lidhjen e temës së detyrës së nxënësit me burimet më të përshatshme të informacionit dhe të ndihmojë në kryerjen me sukses të saj.

Nisur nga këta faktorë ky libër është shkruar për t'u ardhur në ndihmë nxënësve, prindërve dhe bibliotekarëve. Ai është i lehtë në përdorim dhe u mëson nxënësve rëndësinë e bibliotekës gjatë jetës shkollore, si përdoren mjetet e saj për plotësimin e kërkesave të tyre, paraqet një përmbledhje të burimeve kryesore më të përdorshme për kryerjen e detyrave dhe lidh nxënësit me këto burime nëpërmjet një indeksi të fjalëve kyç ku ata drejtohen për subjektet e interesuar.

### Libri është organizuar në tri pjesë:

*Pjesa e parë* shpjegon rëndësinë e kërkimit në bibliotekë dhe mëson si përdoret biblioteka. Jepet informacion për strukturën e saj, sektorët dhe rregullat e shërbimit të materialeve. Janë disa njohuri për katalogët e bibliotekës dhe koleksionet, për sistemet e vendosjes së librave në raftet, për skemën e Dju-it dhe atë të Bibliotekës së Kongresit, numrin e vendit të çdo njësie dhe rëndësinë e tij. Shpjegohen botimet kryesore referuese duke filluar me enciklopeditë. Jepen veçori të disa botimeve kryesore enciklopedike, në letër dhe në CD-ROM, të almanakëve, atlaseve, botimeve statistikore, indekseve dhe burimeve të tjera referuese dhe përse shërbejnë ato. Vend të rëndësishëm në burimet e informacionit zë Interneti. Shpjegohen teknikat e kërkimit në Internet. Një kapitull i veçantë i pjesës së parë të librit jep shembuj të kërkimit në bibliotekë të materialeve për subjekte të caktuara, duke përdorur të gjitha burimet e mundshme tradicionale dhe elektronike.


*Pjesa e dytë* rendit alfabetikisht sipas subjektit një listë burimesh referuese që gjenden në biblioteka. Çdo rubrikë ka përbri dhe numrin e klasifikimit sipas Dju-it me qëllim që përdoruesi të drejtohet, për më shumë informacion për subjektet e interesuar, në rubrikat përkatëse të fondeve të bibliotekës. P.sh. tek rubrika ARTET në kllapa janë vendosur numrat 700-793 që sipas skemës së Dju-it klasifikohen të gjitha degët e artit. Në këtë rubrikë janë renditur botimet kryesore referuese për artet, që mund të gjenden në biblioteka (enciklopedi, botime historike etj.) dhe veç këtyre lexuesi do të dijë të drejtohet në raftet e bibliotekës në rubrikat 700 deri në 793 ku do të gjejë dhe botime të tjera për artet.

*Pjesa e tretë* është një indeks alfabetik fjalësh kyç që lidh temat më të zakonshme të detyrave të nxënësve me burimet kryesore të informacionit, të renditura në pjesën e dytë të librit, për të ndihmuar në zgjidhjen e tyre. P.sh. termi *Zogjtë* është i shoqëruar me numrin e klasifikimit (598) dhe në vazhdim referohen faqet 161-162 të këtij libri ku janë renditur titujt e disa botimeve bazë për këtë subjekt. Rekomandohen gjithashtu po aty dy botime kryesore me informacion për temën: *The Encyclopedia of Birds* dhe *The illustrated Encyclopedia of birds*.

Bibliotekarët që punojnë me lexuesit dhe ndeshen me kërkesat e tyre ndjejnë nevojën e botimeve referuese të kësaj natyre. Ata edhe vetë hartojnë lista të burimeve kryesore për tema të caktuara, pasi gjatë viteve ndeshen me të njëjtat kërkesa nga ana e nxënësve. Nga viti në vit temat e detyrave përsëriten, sepse mësuesit japin të njëjtat tema me ndonjë ndryshim të vogël.

Ky libër u shërben punonjësve të bibliotekave publike dhe atyre të shkollave si mjet për të trajnuar lexuesit e tyre se si të përdorin bibliotekën. Ai është dhe një model sesi mund të përgatiten nga ana e punonjësve të bibliotekave lista ndihmëse për tema të caktuara, ku renditen materiale referuese, që mund të gjenden nga përdoruesit në bibliotekën e tyre, në bibliotekat e tjera ose nëpërmjet burimeve elektronike.

Libri është njëkohësisht udhëzues i përdorimit të bibliotekës dhe botim referues për nxënësit.



*Poulter, Alan*

*The Library and information professional's guide to the World Wide Web [Udhëzues i profesionistëve të bibliotekonomisë dhe të informacionit për World Wide Web-in] / Alan Poulter, Gwyneth Tseng, Goff Sargent. – London : Libray association Publishing, 1999.*

*X, 133 f. : 23 cm.*

*Indeks*

*ISBN 1-85604-227-8*

*P 522 / 22C*

Udhëzuesi ka synim të njohë bibliotekarët, punonjësit e informacionit, personelin mësimdhënës, studentët dhe lexues të tjerë të interesuar, me World Wide Web-in. Ai u shërben atyre që duan të mësojnë si ta përdorin World Wide Web-in për të strukturuar dhe për të botuar informacion dhe jo për të shfletuar Web-in apo për të kërkuar në Web.

### Botimi ndahet në katër pjesë:

*Pjesa e parë "Bazat e World Wide Web-it"* është një hyrje në konceptet, teknologjinë dhe zbatimet në këtë fushë. Kjo pjesë përbën dhe qëllimin kryesor të botimit. Në të përfshihen:

- mjetet dhe teknikat për përgatitjen e faqes në Web, sigurimi i cilësisë së përmbajtjes dhe skicimit të paraqitjes së faqeve;
- forma e faqes, përdorimi i imazheve të hartave, i modeleve, i tabelave etj.;
- zgjedhja midis modeleve të botimit;
- krijimi dhe funksionimi i një serveri World Wide Web;
- publikimi i një burimi informacioni në World Wide Web;
- bashkëveprimi i World Wide Web-it me sistemin e automatizimit të bibliotekës.

Në këtë pjesë shpjegohen termat teknike të përdorur, teknologjia bazë dhe hapat që duhet të

merren për krijimin e faqeve në Web dhe krijimin dhe botimin e Web site-ve.

*Pjesa e dytë "Zbatime të World Wide Web-it në bibliotekat dhe qendrat e informacionit në Britaninë e Mdhë"*, shqyrton zbatime të World Wide Web-it në biblioteka publike, akademike dhe speciale si dhe në njësi të shërbimit të informacionit në institucione të ngarkuara me shërbimin informues ndaj publikut. Vihen në dukje përparësitë dhe të metat e zbatimit të teknologjisë së Web-it dhe si ndikon ajo në punën e bibliotekarit dhe të punonjësit të informacionit.

*Pjesa e tretë, "Zhvillime të teknologjisë së World Wide Web-it"*, është një analizë më e detajuar për zhvillimet e teknologjisë bazë të Web-it. Ndonëse janë probleme shumë teknike, ato janë trajtuar në aspektin shpjegues, me qëllim që të jepet informacion i mjaftueshëm për të nxitur përdorues të rinj të teknologjisë së Web-it, si dhe të shërbejnë si udhëzime edhe për ata që tashmë kanë filluar të botojnë faqe në World Wide Web.

*Pjesa e katërte* librit është një udhërnëfyes burimesh në Web që mund të përdoren për informacion më të detajuar. Ajo fillon me burimet e vetë World Wide Web-it, me tregues për software-t, manuale dhe materiale referuese. Guida është e ndarë në po ato seksione që është dhe teksti kryesor. Rendi i c

burimeve është sipas citimit të tyre në tekst, duke shuar dhe burime të tjera të pa cituara. Çdo burim është përshkruar sipas një forme standarde:

*Emri*: emri i plotë i burimit të informacionit, zakonisht titulli i faqes hyrëse të Web-it.

*Furnizuesi*: emri i organizatës ose emri vetjak i furnizuesit.

*Përshkrimi*: përshkrim i shkurtër i burimit.

*URL*: një ose më shumë URL (Uniform Resource Locator – adresë unike që identifikon një burim në Internet).

Botimi u vjen në ndihmë punonjësve të bibliotekave, të cilët dëshirojnë të hapin faqet e tyre në World Wide Web.



*Ferguson, Bobby*

*Cataloging nonprint materials : Blitz Cataloging workbook [Katalogimi i materialeve jo libra : manual për katalogim të shpejtë] / Bobby Ferguson. – Englewood, Colorado : Libraries Unlimited, 1999.*

*XII, 169 f. : 28 cm.*

*ISBN 1-56308-642-5*

*P 515 / I2A*

Katalogimi dhe klasifikimi përbëjnë pjesë të rëndësishme të bibliotekonomisë. Në mungesë të katalogut, qoftë ai tradicional apo elektronik, biblioteka nuk është veçse një dhomë e mbushur me libra që nuk mund t'u shërbejë klientëve të saj me seriozitet dhe në kohë. Vepritaritë e tjera të bibliotekës si pasurimi me materiale të reja, huazimi ndërbibliotekar dhe shërbimi referues nuk mund të kryhen nëse përdoruesit dhe punonjësit nuk dinë se ç' materiale gjenden në bibliotekë. Njohuritë për katalogimin janë të nevojshme për çdo punonjës të bibliotekës dhe jo vetëm për kataloguesit. Sa më shumë të automatizohen bibliotekat, njohuritë për fushat e formatit MARC dhe formatet elektronike, për klasifikimet dhe emërtimet lëndore, mbeten po aq të rëndësishme dhe i bëjnë punonjësit e bibliotekës më të aftë. Seria e manualeve të katalogimit përmban informacion të pasur dhe të dobishëm për bibliotekarët në çdo situatë. Ato ndihmojnë për të kuptuar formatin MARC dhe funksionet e fushave dhe nënfushave të tij, për të

vlerësuar kopjimin e katalogimeve dhe klasifikimet e materialeve në formate të ndryshme, për të konstatuar gabimet dhe parregullsitë, për të mësuar pikat hyrëse dhe cilat prej tyre janë më të rëndësishme, për të përcaktuar emërtimet lëndore duke përdorur listat përkatëse, për përcaktimin e numrit të vendit bazuar në skemat e klasifikimit dhe për të vlerësuar referimet dhe kryetitujt e njësuar.

Një ndër botimet e serisë së katalogimit është ai për katalogimin e materialeve jolibra. Katalogimi i materialeve jolibra i "frikëson" jo vetëm kataloguesit e rinj, por edhe ata me përvojë. Në të vërtetë nuk ka ndryshim nga katalogimi i librave. Vetëm një numër i vogël fushash të formatit MARC ndryshojnë, siç është p.sh. shkalla për hartat apo specifikimet teknike për skedarët e kompiuterit. Pjesa tjetër e regjistrimit bibliografik në themel është e njëjtë si edhe për librat. Kështu për shembull fusha e përshkrimit fizik ka përsëri katër nënfusha: madhësia e njësisë, detaje të tjera fizike,

dimensionet dhe materialet shoqërues. Fusha e të dhënave të botimit ka tri nënfusha: vendi i botimit, botuesi dhe data e botimit. Emërtimet lëndore janë kryesisht të njëjta, dhe fusha të tjera (e serisë, e elementëve hyrës shtesë etj.) janë po ato si në katalogimin e MJL ashtu dhe të monografive. Megjithatë krahas ngjashmërisë ka edhe ndryshime. Fushat e shënimeve mund të përmbajnë informacion të llojeve të ndryshme, në vartësi të tipit të materialit. Edhe pse fushat e shënimeve ekzistojnë për të dhënë informacion plotësues rreth njësisë që katalogohet, përmbajtja e shënimeve mund të jetë krejt e ndryshme.

Një element dallues për materialet jo libra është se që në fillim të përshkrimit jepen veçori të përgjithshme për tipin e materialit që katalogohet. Ky element analizohet në zonën e parë të rregullave të katalogimit sipas AACR2, pas titullit kryesor, ndërsa veçori specifike të tipit të materialit vendosen në fushën e përshkrimit fizik. P.sh. për materialet dëgjimore veçori të përgjithshme të tipit të materialit përcaktohen me fjalët "Regjistrim zanor", kurse në fushën e përshkrimit fizik këto materiale specifikohen sipas llojit: disk zanor, kasetë zanore, shirit zanor, bobinë zanore, shirit filmi me zë etj.

Manuali trajton në kapituj të veçantë katalogimin e regjistrimeve pamore, të regjistrimeve dëgjimore, të skedarëve të kompiuterit, të hartave dhe të materialeve të përziera. Veç këtyre është dhe një kapitull me ushtrime për tipe të tjera materiale si vepra arti të shtypura, mikroforma dhe materiale realë. Përdoruesi gjen shembuj të regjistrimeve, ushtrime për etiketat e fushave, për indikatorët dhe simbolët e nënfushave në formatin MARC, si dhe ushtrime për identifikimin e gabimeve. Për çdo tip material jepen paraprakisht rregullat specifike të tij sipas Rregullave Anglo-Amerikane të Katalogimit. Kështu p.sh. për regjistrimet pamore theksohet se zakonisht titulli është elementi kryesor hyrës (kryetitull), pasi përgjegjësia për përmbajtjen intelektuale në këto materiale nuk mund të jetë atribut i një personi të vetëm. Përgjegjës për përgatitjen e një regjistrimi

pamor janë drejtori, prodhuesi, kompozitori, aktorët, operatori, regjisor, skenaristi etj.. në dallim nga libri ku roli i autorit për përgjegjësinë intelektuale është i përcaktuar qartë. Rekomandohet që në regjistrimin bibliografik të videoregjistrimeve të vendoset edhe një përmbledhje e shkurtër, pasi ato nuk mund të shiftohen si librat.

Regjistrimet zanore janë në formate të ndryshme: disqe, kasete, bobina me shirit. Zona e përshkrimit fizik në këtë rast ka rëndësi për të përcaktuar formatin që katalogohet. Manuali i tërheq vemendjen kataloguesit se këto materiale, në dallim nga regjistrimet pamore, jo gjithmonë përshkruhen me titull. Autor i tyre mund të jetë kompozitori ose këngëtar.

Skedarët e kompiuterit (që mund të jenë të dhëna ose programe), mund të jenë në disketa, në CD-ROM dhe në format elektronik në adresa të ndryshme të Internet-it. Për këto të fundit vihet në dukje se nuk plotësohet fusha e përshkrimit fizik, pasi kataloguesi nuk ka objekt fizik për të përshkruar, por materiali është në formë elektronike në Internet ose në ndonjë shërbim tjetër në rrjet.

Hartat janë materiale që kanë ekzistuar mijëra vjet më parë dhe vazhdojnë të jenë materiale të pranishme në çdo bibliotekë. Në këtë kapitull, element që duhet të zgjidhet nga kataloguesi.

Sipas autorit katalogimi i materialeve të përziera kryhet me kënaqësi nga bibliotekari. E rëndësishme është të dallohen qartë materialet që bëjnë pjesë në këtë grup. Fusha e shënimeve dhe ajo e përshkrimit fizik pasqyrojnë veçoritë e çdo pjese përbërëse të një materiali të përzier.

Ky libër me ushtrime për katalogimin e materialeve jolibra u shërben kataloguesve të zgjerojnë aftësitë e tyre të katalogimit. Për zgjidhjen e ushtrimeve kataloguesi duhet të përdorë manualin e formatit bibliografik MARC, rregullat e katalogimit AACR2 dhe listën e emërtimeve lëndore.

Zgjidhjet e ushtrimeve janë dhënë në faqet e fundit të librit.

(F. Xhaja)

## Hyrje të reja

### Libra

*Bryson, Jo*

**Effective library and information centre management** [Menaxhimi efektiv i bibliotekës dhe i qendrës së informacionit] / Jo Bryson. – 2<sup>nd</sup> ed. - Burlington : Ashgate, 1999.

XIX, 428 f. ; 24 cm.

Bibliogr. – Indeks

ISBN 0-566-07691-8

Ky ribotim i librit pasqyron drejtimet moderne të menaxhimit, duke na sjellë së bashku disiplinat e bibliotekonomisë, të arkivave dhe të menaxhimit të regjistrimeve, sistemet e informacionit, kompiuterizimin dhe telekomunikimin në këndvështrimin e arritjes së një sistemi të integruar. Tradicionalisht këto disiplina janë trajtuar të veçuara, bazuar në formën e informacionit. Sot rëndësia e menaxhimit të përmbajtjes (burimit të informacionit) ka fituar përparësi ndaj formës dhe për pasojë synohet në menaxhimin e këtyre njësisve si një shërbim i integruar informacioni. Roli i bibliotekarit përgjegjës përkufizohet si menaxher i shërbimeve të informacionit. Ky rol zgjerohet në drejtim të menaxhimit të regjistrimeve, të sistemeve të informacionit, të kompiuterizimit dhe të telekomunikimit.

Drejtimet e menaxhimit janë trajtuar në një mjedis dinamik në ndryshim, për të plotësuar nevojat për informacion të këtij mjedisi. Që shërbimet informuese të jenë në nivel drejtues dhe konkurues, menaxherët e shërbimeve të informacionit duhet:

- Të kuptojnë rolin e tyre si menaxherë;
- Të njohin mjedisin e jashtëm dhe të brendshëm në të cilin veprojnë;
- Të menaxhojnë mjedisin nëpërmjet planifimit efektiv të burimeve njerëzore të informacionit, burimeve teknologjike dhe financiare;
- Të krijojnë një mjedis të përbashkët që nxit krijimtarinë;
- Të kujdesen dhe të menaxhojnë veten dhe të tjerët si individë;
- Të vlerësojnë rreziqet dhe t'i menaxhojnë ato;
- Të kryejnë shërbime për të plotësuar kërkesat e klientëve.

Këto kërkesa janë përdorur si tema për nëntë pjesët e librit, në kapitujt e të cilit vërehet një përzjerje e problemeve tradicionale, që formojnë bazën e teorisë së menaxhimit, me problemet e reja që pasqyrojnë mjedisin e sotëm.

Libri është një manual i menaxhimit për punonjësit e shërbimeve të informacionit dhe njëkohësisht shërben si tekst për për studentët e bibliotekonomisë.

*Chapman, Liz*

**How to catalogue: a practical handbook using AACR2 and Library of Congress** [Si të katalogosh: udhëzues praktik duke përdorur rregullat e AACR2 dhe të Bibliotekës së Kongresit] / Liz Chapman. 2<sup>nd</sup> ed. – London : Clive Bingley, 1991.

X, 86 f. ; 21 cm.

Bibliogr. – Indeks.

ISBN 0-85157-427-0

Vitet e fundit ka ndryshuar mënyra e organizimit të punës për katalogimin. Shumë biblioteka janë automatizuar dhe shumë të tjera përdorin katalogimin e kryer nga biblioteka të mëdha siç është Biblioteka e Kongresit. Ky manual pasqyron ndryshimet e bëra në AACR2 si dhe në praktikën e Bibliotekës së Kongresit, veçanërisht në fushën e emërtimeve lëndore. Manuali bazohet në praktikën e marrjes së regjistrimeve të katalogimit nga një burim i centralizuar dhe vazhdimin e procedurave standarde të redaktimit. Për deri sa ka shumë biblioteka që ende nuk janë automatizuar, botimi nuk përqëndrohet vetëm në proceset e automatizuara dhe nuk përmban ndërlikimet e formatit MARC. Megjithatë ai synon të ndihmojë në krijimin e regjistrimeve kataloguese të rregullta në çdo format, duke u bazuar në procedurat standarde të katalogimit. Botimi shërben për punonjës të bibliotekave të vogla që e kanë të kufizuar kohën për katalogim.

**Children and young people: Library Association guidelines for public library services** [Fëmijët dhe të rinjtë: udhëzime të Shoqatës së Bibliotekarëve për bibliotekat publike]. – 2<sup>nd</sup> ed. – London : Library Association publishing, 1997. 61 f. ; 30 cm. ISBN 1-85604-209-X

Ndryshimet politike, ekonomike, sociale dhe teknologjike kanë ndikuar në bibliotekat publike dhe në aftësitë e tyre për t'iu përgjigjur nevojave në rritje për informacion të fëmijëve dhe të rinjve. Ky botim është përgjigje e ndryshimeve. Udhëzimet nuk kanë qëllim të përshkruajnë, por të theksojnë çështjet kryesore që përbëjnë bazën për një politikë të qartë dhe objektive në shërbimet bibliotekare, pavarësisht nga madhësia, struktura, kompleksitetet apo lloji i komunitetit të cilit i shërben biblioteka. Këtu përfshihen:

- Fëmijët dhe biblioteka;

- Llojet e shërbimeve;
- Standardet dhe objektivat;
- Marrëdhëniet midis atyre që ofrojnë shërbimet:
  - Projekti i bibliotekës dhe pajisjet;
  - Punonjësit dhe trajnimi;
  - Politika e zhvillimit të koleksioneve;
  - Nxitja e shërbimeve bibliotekare.

Menaxhimi efektiv i ndryshimeve është i nevojshëm për të pasur një vizion të qartë për të ardhmen. Udhëzimet e këtij botimi i shërbejnë këtij qëllimi. Ato janë burim me vlerë për menaxherët e bibliotekave publike dhe specialistët e bibliotekave të fëmijëve.

**Continuing professional education for the information society** [Arsimi i vazhdueshëm profesional në shoqërinë e informacionit] : *The Fifth World Conference on Continuing Professional Education for the Library and Information Science Professions* / ed by Patricia Layzell Ward. – München : Saur, 2002.

263 f. ; 22 cm. – (IFLA publications ; 100). ISBN 3-598-21830-3

Me rritjen e rolit të menaxhimit të informacionit dhe të dijeve në shoqërinë e sotme dhe ndikimin e teknologjisë së informacionit për të lehtësuar këtë proces, rritet nevoja e punonjësve të bibliotekave dhe e punonjësve të informacionit për zgjerimin e njohurive të tyre dhe aftësimin profesional në këto fusha. Përgatitja profesionale fillestare mund të konsiderohet si një licencë për fillimin e punës, pasi nëpërmjet saj merren njohuri bazë. Për të mbajtur këtë vend pune bibliotekari duhet të angazhohet në zhvillimin e vazhdueshëm profesional. Kurset në kualifikimin e vazhdueshëm profesional përfshijnë një mori subjektesh dhe specialitetesh të fushës së bibliotekonomisë. Ky botim i IFLA-s përmbledh materialet e paraqitura në Konferencën e Pestë Ndërkombëtare të CPERT (Continuing Professional Development Round Table–Tavolina e



Rumbullakët për Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional). Prezantohet përvoja e specialistëve të zhvillimit profesional të shumë vendeve të botës, puna e shkollave të bibliotekonomisë dhe të shkencës së informacionit, përvoja e punës së vetë bibliotekave për kualifikimin si dhe bashkëpunimi midis bibliotekave në fushën e kualifikimit të vazhdueshëm.

### Corrall, Sheila

**The New professional's handbook: your guide to information services management** [Manual i profesionistit të ri: guidë për menaxhimin e shërbimeve informuese.] / Sheila Corrall, Antony Brewerton. – London : Library Association publishing, 1999. XIV, 322 f. : 23 cm. Bibliogr. – Indeks ISBN 1-85604-311-8

Punonjësit e bibliotekave dhe të informacionit po përballen me një mjedis ku zhvillimet teknologjike dhe konkurimi global po ndryshojnë formën dhe llojshmërinë e shërbimeve informuese. Në këto kushte paraqitet e ngutshme nevoja e tyre për mbështetje në zhvillimin profesional. Ky manual synon pikërisht këtë mbështetje në nivel operacional dhe strategjik. Ai ka qëllim të ndihmojë profesionistët e rinj të kuptojnë botën e sotme të informacionit dhe përdorimin e mënyrave efektive për zhvillimin e aftësive të tyre profesionale dhe të shërbimeve ndaj përdoruesve. Jepen rrugë të menaxhimit të elementeve të shërbimit, të personelit, të projekteve në një botë në ndryshim. Tërhiqet vemendja sesi duhet të përdorim me zgjuarsi burimet e kufizuara financiare, si të planifikojmë me efektivitet, si të mbikqyrim dhe të vlerësojmë.

**Botimi është i ndërtuar në katër pjesë:**

*Pjesa e parë* trajton mjedisin e shërbimeve dhe strategjinë e planifikimit.

*Në pjesën e dytë* "Nevojat për informacion" përfshihen burimet e informacionit, shërbimet informuese, sistemet e informacionit.

*Pjesa e tretë* "Menaxhimi i organizimit" trajton menaxhimin e personelit dhe të fondeve buxhetore, menaxhimin e hapësirave dhe marketingun.

*Pjesa e katërt* i kushtohet profesionistit të informacionit dhe zhvillimit të tij.

Manuali u shërben profesionistëve të rinj. Me ndërthurjen e teorisë me zbatimet praktike, ai është i vlefshëm edhe për studentët e bibliotekonomisë dhe të shkencës së informacionit, si dhe për freskimin e njohurive të punonjësve me përvojë.

**Education and research for marketing and quality management in libraries = La formation et la recherche sur le marketing et la gestion de la qualité en bibliothèque** [Edukimi dhe studime për marketingun dhe cilësinë e menaxhimit në biblioteka]: satellite meeting, Quebec, August 14-16 août 2001 / International Federation of Library Associations and Institutions. – München : Saur, 2002. X, 326 f. ; 22 cm. – (IFLA publications ; 99) ISBN 3-598-21829-X

Marketingu dhe cilësia e menaxhimit janë dy çështje të lidhura ngushtë mes tyre dhe konsiderohen vendimtare për zhvillimin e bibliotekave dhe të shërbimeve të tjera informuese. Megjithatë është vënë re se bibliotekarët nuk kanë trajnimin e duhur në marketing dhe se vetëm një numër i paktë shkollash të bibliotekonomisë dhe të shkencës së informacionit ofrojnë kurse në marketing dhe në cilësinë e menaxhimit.

Ky botim është përmbledhje e materialeve të një kolokiumi të organizuar në gusht 2001 nga seksioni i "Menaxhimit dhe marketingut" dhe ai i "Arsimit dhe trajnimit" të IFLA-s. Në

këtë veprimtari morën pjesë specialistë nga 25 vende të ndryshme të botës, të cilët shkëmbyen ide dhe përvojë lidhur me marketingun dhe menaxhimin në biblioteka. Botimi i kumtesave të mbajtura në këtë veprimtari ka synim të nxisë edukimin dhe studimet në fushën e marketingut dhe të cilësisë së menaxhimit brenda bibliotekave.

**The Ethics of librarianship: an international survey** [Etika e bibliotekonomisë: vështrim ndërkombëtar] / ed by Robert W. Vaagan with the introduction by Alex Byrne, chairman of IFLA/FAIFE. – München : Saur, 2002. 344 f. ; 21 cm. – (IFLA publications ; 101) ISBN 3-598-21831-1

Çështjet etike kanë përbërë prej kohësh një problem për bibliotekarët dhe shoqatat bibliotekare. Me daljen e revistës *The Journal of Information Ethics* në vitin 1992, studimet në fushën e bibliotekonomisë dhe të shkencës së informacionit i kanë kushtuar më tepër vemendje etikës. Sot me vërshimin gjigand të informacionit ka një rritje të nevojës për këtë aspekt moral. Ndonëse në Website-in e FAIFE (<http://www.faiife.dk/>) gjenden kode etike të shoqatave bibliotekare kombëtare, ndihet nevoja e komentit dhe e analizës së tyre. Pikërisht këtë qëllim ka dhe ky botim i IFLA-s. i cili përmban kode të 12 vendeve si dhe zgjidhje të pjesëshme të disa vendeve të tjera. Të gjithë artikujt bëjnë një përshkrim të zhvillimit historik të bibliotekave dhe të etikës bibliotekare.

Përveç Shoqatës së Bibliotekarëve Amerikanë, e cila ka botuar kodin e parë të etikës së bibliotekarëve në vitin 1938, kodet e tjera që analizohen në këtë botim janë hartuar kryesisht në fund të shekullit XX. Në disa prej artikujve vihet në dukje roli i shoqatave bibliotekare në hartimin e kodeve si dhe hapat e marrë për zhvillimin e tyre. Veç ndikimit që mund të kenë pasur këto kode në veprimtarinë bibliotekare, secili artikull përcjell një përvojë

unike dhe konfirmon raportin gjithnjë në rritje të etikës me bibliotekonominë.

**Guidelines for reference and information services in public libraries** [Udhëzime për shërbimet referuese dhe informuese në bibliotekat publike] / Library Association Information Services Group. – London : Library Association publishing, 1999.

60 f. ; 30 cm.  
Bibliogr. f. 58-59.  
ISBN 1-85604-350-9

Që nga koha e botimit të udhëzimeve të mëparshme në vitin 1980, kanë ndodhur shumë ndryshime në mënyrën e paketimit të informacionit, të botimit dhe të mënyrës së përdorimit të tij si dhe të nevojave të përdoruesve. Zhvillimet e teknologjisë kanë ndryshuar shumë formatet e informacionit tradicional dhe kanë mundësuar daljen e prodhimeve dhe të shërbimeve të reja. Udhëzimet e këtij botimi janë strukturuar si një mjet për meaxherët e ngarkuar me shërbimet referuese dhe informuese në bibliotekat publike. Paketa është e ndërtuar në nëntë seksione, të cilët mund të përdoren të ndarë, për qëllime të veçanta ose dhe së bashku si një strukturë e vetme:

- Përdoruesit;
- Shërbimet informuese;
- Burimet e informacionit;
- Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit;
- Mjetet e nevojshme;
- Menaxhimi;
- Cilësia e shërbimit dhe treguesit e rezultateve;
- Publikimi dhe reklama;
- Marrëdhëniet.

Paketa si një e tërë ndihmon menaxherët në planifikimin e të gjitha aspekteve të shërbimeve të tyre.

Katz, William A.

**Introduction to reference work** [Hyrje në punën referuese] / William A. Katz. – 7<sup>th</sup> ed. – New York : McGraw-Hill, 1997.

1 v. ; 23 cm.

V. 1 : Basic information sources. – 444 f.

Bibliogr. – Indeks

ISBN 0-07-034277-6

**Vëllimi i parë i këtij libri është i ndërtuar në tri pjesë:**

*Në pjesën e parë* vihen në dukje dy fusha të shërbimit referues: komuniteti të cilit i shërbehet dhe teknologjitë e përdorura në këtë proces. Shpjegohet gjithashtu ç'është biblioteka elektronike.

*Pjesa e dytë "Informacioni, kontrolli dhe aksesit"* analizon llojet e bibliografive, katalogët, indekset dhe abstraktet. Të gjitha këto mjete informacioni ofrojnë citime bibliografike dhe bazuar në to përdoruesi kalon në një fazë të dytë për gjetjen e burimit të plotë të informacionit (libër, artikull etj.).

Ndërsa "*Burimet e informacionit*" të trajtuara në pjesën e tretë sigurojnë informacion të mjaftueshëm për t'iu përgjigjur pyetjes së përdoruesit. Të tilla janë enciklopeditë e përgjithshme dhe tematike, vjetarët, direktoritë, burimet biografike dhe dokumentet qeveritare. Në trajtimin e këtyre materialeve vend të parë kanë zënë burimet e informacionit në CD-ROM dhe on-line dhe më pas ato në formë të shtypur. Kjo për faktin se automatizimi i bibliotekave po çon gjithnjë e më shumë në shtimin e burimeve elektronike.

**Libraries in the age of the Internet** [Bibliotekat në epokën e Internet-it]: papers from the International Conference held in Sofia, Bulgaria, 8-10 November 2000. / ed. by Herbert K. Achleitner, Alexander Dimchev. – Sofia, 2001.

369 f.

ISBN 0-934068-135

Janë materialet e konferencës të organizuar në Sofie nga Departamenti i Bibliotekonomisë dhe i Informacionit të Universitetit Shtetëror të Emporias (SHBA) dhe Departamenti i Bibliotekonomisë dhe i Shkencës së Informacionit të Sofies. Krahas përfaqësuesve të dy vendeve organizuese dhe të 11 vendeve të Europës, konferencën e ndoqën dhe përfaqësues të IFLA-s dhe të Bashkimit Europian. Në qendër të punimeve të kësaj konference ishte e ardhmja e bibliotekave dhe e bibliotekarëve profesionistë në shoqërinë e informacionit. Disa nga çështjet e trajtuara janë: teknologjia e informacionit në biblioteka, infrastruktura e rrjetit bibliotekar, roli i bibliotekave në përdorimin e informacionit elektronik, menaxhimi i informacionit, shërbimet referuese, Interneti dhe biblioteka si dhe trajnimi i punonjësve të bibliotekave në kushtet e reja.

**Libraries in the information society** [Bibliotekat në shoqërinë e informacionit] / ed. by Tatiana V. Ershova and Yuri E. Hohlov. – München : Saur, 2002.  
172 f. ; 22 cm. – (IFLA publications ; 102)  
ISBN 3-598-21832-X

Botimi është një përpjekje për të mbledhur së bashku punimet që kanë të bëjnë me rolin e bibliotekave si institucione sociale në shoqërinë e sotme të informacionit, të përgatitur gjatë viteve 1998-2000. Atrikujt e përmbledhur në këtë botim janë shkruar nga bibliotekarë dhe specialistë të informacionit nga Europa, Azia, Amerika, Afrika dhe Australia. Në këtë libër bibliotekat janë parë në këndvështrime të ndryshme:

- Institucione që sigurojnë informacion dhe dije në shërbim të zhvillimit social dhe ekonomik;
- Porta që i ofrojnë publikut, përfshirë dhe të paaftët fizikisht, përparësitë e elektronikës;

- Pjesë të rrjeteve të informacionit dhe të partneriteteve të reja për realizimin e shërbimeve më të mira në përgjigje të kërkesave moderne të përdoruesve;
- Porta të informacionit, mjete për të lidhur informacionin digjital brenda vendit dhe midis vendeve;
- Institucione të cilat përballojnë me sukses diversitetet kulturore, gjuhësore dhe që zhvillojnë diversitete në burimet e informacionit.

Këto janë disa nga rolet e bibliotekave në shoqërinë e sotme. Për të arritur këto bibliotekat nga institucione të ruajtjes dhe të sigurimit të aksesit në trashëgiminë e kulturës së shkruar, duhet të drejtohen më shumë nga shërbimet.

### *Locke, Joanne*

**International resource book for libraries serving disadvantaged persons** [*Libër i burimeve ndërkombëtare për bibliotekat që u shërbejnë personave të disfavorizuar*] / Joanne Locke, Nancy M. Panella; with the assistance of Margaret Girolami. – München : Saur, 2001.

XII, 249 f. ; 22 cm. – (IFLA publications ; 96)  
ISBN 3-598-21826-5

Botimi është një nismë e Seksionit të IFLA-s të Bibliotekave që u Shërbejnë Personave të Disfavorizuar (LSDP - Libraries Serving Disadvantaged Persons). Qëllimi i botimit është të bëjë të njohur zhvillimin e këtij seksioni dhe veprimtarinë e tij në komunitetin bibliotekar ndërkombëtar si dhe të prezantojë një koleksion citimesh të literaturës me këtë temë në formë bibliografike që përfshin periudhën 1970 – 2000.

**Botimi është i organizuar në disa seksione:**

*Seksioni i parë* është një vështrim historik i periudhës shtatëdhjetë vjeçare të Seksionit të LSDP të IFLA-s (1931-2001), duke theksuar

ngjarjet më të rëndësishme në renditje kronologjike.

*Seksioni i dytë* paraqet kumtesat e mbajtura në konferencat vjetore të IFLA-s në vitet 1965-2000. Pas tyre renditen raportet profesionale të Seksionit të LSDP. Këto materiale pasohen nga pesë punime bibliografike ndërkombëtare me subjekt: shurdhët, të moshuarit, të sëmurët në spitale, të burgosurit, personat me kufizime të të parit. Renditja e materialit në secilën bibliografi është alfabetike dhe përfshihen monografi, artikuj revistash, disertacione, teza, kumtesa shkencore. Këto bibliografi mund të shërbejnë si pikënisje për grumbullimin e literaturës në këto fusha të specializuara.

Botimi është i pajisur me tregues alfabetik të autorëve dhe tregues lëndor.

**Managing the preservation of periodicals and newspapers** [*Menaxhimi i ruajtjes së periodikëve dhe gazetave*] : Proceedings of the IFLA Symposium = *Gérer la conservation des périodiques et de la presse : Actes du Symposium IFLA, Bibliothèque nationale de France Paris, 21-24 Août 2000* / ed. by Jennifer Budd. – München : Saur, 2002.

175 f. ; 22 cm. – (IFLA publications ; 103)  
ISBN 3-598-21833-8

Simpoziumi IFLA-s është bashkëpunim i Programit të IFLA-s për Ruajtjen dhe Konservimin (IFLA/ PAC) me seksionin e IFLA-s për botimet në seri dhe me tavolinën e rumbullakët të IFLA-s për gazetat. Qëllimi i kësaj veprimtarie ishte nxitja e ruajtjes së botimeve në seri, përfshirë dhe ato në formë elektronike. Një nga përparësitë e IFLA-s në këtë fushë është të mundësojë koordinim në nivel ndërkombëtar nëpërmjet programeve të saj si përkrahja, trajnimi, zhvillimi dhe shpërndarja e standardeve dhe e përvojave më të mira. Materialet e simpoziumit të përmbledhura në këtë botim analizojnë arritjet dhe dobësitë në një periudhë 11 vjeçare, që nga simpoziumi i mëparshëm për këtë qëllim,

dhe analizojnë mjedisin krejt të ndryshëm në të cilin jemi sot. Sot bibliotekat janë përpara një teknologjie të re, e cila ofron mundësi emocionuese për të siguruar akses universal në pasurinë e tyre. Lektorët vënë në dukje në punimet e tyre sfidat, treziqet, mundësitë dhe kostot për ruajtjen dhe shfytëzimin e materialeve periodike.

#### *Pantry, Sheila*

**Your successful LIS career: planing your career, CVs, interviews and self-promotion** [Kariera juaj e suksesshme në bibliotekonomi dhe në shkencën e informacionit: planifikimi i karrierës tuaj] / Sheila Pantry, Peter Griffiths. – London: Library Association publishing, 1999. XII, 115 f. : 23 cm. – (The Successful LIS professional / ed. Sheila Pantry).  
Bibliogr. – Indeks.  
ISBN 1-85604-329-0

Botimi udhëzon për menaxhimin e çdo shkalle të karrierës, si në rastin kur jeni punonjës i ri në profesion dhe dëshironi të dini si të ngjiteni, ashtu dhe kur jeni profesionist i informacionit në një nivel mesatar dhe dëshironi të ecni përpara. Duke përdorur studimet, leximet dhe website-t që rekomandohen si dhe burime të tjera që japin ndihmë praktike, ky udhëzues ndihmon në:

- planifikimin e karrierës dhe teknikat e zhvillimit personal;
- aftësimin sipas kërkesave të tregut;
- njoftimet për punë, aplikimet dhe teknikat e intervistimit;
- zgjerimin e mundësive nëpërmjet aftësimit në bibliotekonomi dhe në shkencën e informacionit.

#### *Totterdell, Anne*

**The Library and information work primer** [Ndihmës për punën në bibliotekë dhe informimin] / Anne Totterdell, Colin T. Harrison. – London: Library Association publishing, 1998.  
IX, 227 f. : 23 cm.  
Bibliogr. – Indeks.  
ISBN 1-85604-254-5

Udhëzuesi azhuron lexuesin me zhvillimet më të fundit në fushën e bibliotekomisë dhe të informacionit. Ai prezanton funksionet dhe strukturën e tipeve kryesore të bibliotekave dhe shërbimeve informuese dhe përqëndrohet në çështjet kyç që lidhen me këto drejtime: menaxhimi dhe trajnimi, administrimi financiar dhe planifikimi, bashkëpunimi bibliotekar, fondet e bibliotekave, shërbimet ndaj përdoruesve, marketingu dhe marrëdhëniet me publikun, teknologjia e informacionit dhe e komunikimit, vlerësimi i shërbimeve.

Botimi shërben si tekst për studentët e kurseve të bibliotekomisë dhe të informacionit. Ai është gjithashtu një manual për punonjësit e rinj të bibliotekave.

## Artikuj

#### *Beaudiquez, Marcelle*

**What will be the usefulness of national bibliographies in the future** [Cila do të jetë dobia e bibliografive kombëtare në të ardhmen] / Marcelle Beaudiquez.  
Në: *IFLA Journal*. – Vol. 28, Nr. 1, 2002, f. 28-30.

Pasi përshkruhet zhvillimi i bibliografive kombëtare në 30 vjetët e fundit në kontekstin e kontrollit universal bibliografik, autori ndalet në disa nga komponentët që ndikojnë në këto bibliografi si materialet, vetë biblioteka, mjedisi i automatizuar etj. Këto kanë sjellë një

evolucion të natyrshëm drejt një bibliografie korente on-line për materialet tradicionale. Ndërsa koncepti i bibliografisë kombëtare për materialet on-line kërkon një riformulim krejtësisht të ri.

*Byford, John*

**Publishers and legal deposit libraries cooperation in the United Kingdom since 1610: effectiv or not? [Bashkëpunimi i botuesve me bibliotekat depozituese të kopjes së detyruar: efektiv apo jo?]** / John Byford.

Në: *IFLA Journal*. – Vol. 28, Nr. 5/6, 2002.

Përshkruhet historiku i kopjes së detyruar në Britaninë e Madhe që nga viti 1610. Analizohet zgjerimi i madh në shekujt 18 dhe 19 dhe arrijtet e aktit të vitit 1911 për kopjen e detyruar. Shtimi i materialeve elektronike dy dekadat e fundit dhe roli i bibliotekave depozituese të kopjes së detyruar në grumbullimin e materialeve të trashëgimisë kombëtare, ka çuar në një debat të gjerë lidhur me nevojën e rishikimit të legjislacionit. Bashkëpunimi midis botuesve dhe bibliotekave depozituese shihet si një element kyç në arrijten e ndryshimeve të suksesshme.

*Chan, Lois Mai*

**Ensuring interoperability among subject vocabularies and knowledge organization schemes: a methodological analysis [Sigurimi i ndërveprimit midis fjalorëve të subjekteve dhe skemave të organizimit të dijeve : analizë metodologjike]** / Lois Mai Chan, Marcia Lei Zeng.

Në: *IFLA Journal*. – Vol. 28, Nr. 5/6, f. 323-327.

Mjedisi heterogjen i kërkimit të informacionit në World Wide Web ka çuar në nevojën e bashkëveprimit midis sistemeve të ndryshme. Në kërkimin sipas subjektit, përdoruesit ndeshen jo vetëm me fjalorë dhe skema të ndryshme, por dhe me gjuhë të

ndryshme. Për pasojë ka pasur disa projekte kohët e fundit për të arritur një përmirësim të bashkëveprimit midis fjalorëve të termave lëndore dhe të skemave të organizimit të dijeve (skemat e klasifikimit). Shkrimi analizon mënyrat e përdorura në këto projekte. Autorja është specialiste e njohur në fushën e katalogimit, klasifikimit, indeksimit lëndor dhe të kërkimit on-line. Ajo është autore e shumë botimeve në këto fusha, që shërbejnë si manuale bazë në përpunimin e informacionit bibliotekar.

*Ciccarello, Domenico*

**Politiche statali per il servizio bibliotecario pubblico in Inghilterra : 1997-2001 [Politika shtetërore për shërbimin bibliotekar në Angli: 1997-2001]** / Domenico Ciccarello. Në: *Bullettino AIB: rivista italiana di biblioteconomia e scienze dell'informazione*. – No 4, 2001. f. 455-476.

Është një përmbledhje e strategjisë së qeverisë angleze për përmirësimin e shërbimit të bibliotekave publike. Nuk analizohet roli i bibliotekave publike në shoqërinë e informacionit dhe as nisimat e kohëve të fundit për funksionet e tyre. Në kushtet e reduktimit të buxhetit dhe të mbylljes së degëve lokale të bibliotekave publike, Departamenti i Kulturës, Medias dhe Sportit u përqëndrua në rishikimin e menaxhimit të këtij sektori dhe konkretisht në tre elementë kyç: kriteret e procesit të planifikimit, modernizimin e qeverisjes lokale, propozime për nivelin e shërbimeve në shkallë vendi. Në orientimet për hartimin e planit vjetor iu kërkua bibliotekave të përfshihet në të informacion për kushtet e zonës ku biblioteka zhvillon veprimtarinë, të përcaktohet misioni i shërbimit të bibliotekës, të dhëna për aksesin në bibliotekë, orët e shërbimit, godinat, shërbimi për të rritur, për fëmijët, për grupet speciale (minoritete, të paafët), shpenzimet, menaxhimi i personelit, trajnimi. Botohet gjithashtu standardi për bibliotekat publike i miratuar në vitin 2001.

Krahas treguesve të mësipërm, politika qeveritare përfshin dhe aspektin social të shërbimit të bibliotekave publike. Ato shihen si institucione të sigurta, të respektuara dhe vende që mirëpresin këdo që hyn, pavarësisht nga mosha, gjinia, niveli shoqëror dhe u ofrojnë atyre informacion, dije dhe shërbim.

#### Gannon-Leary, Pat

**The Round Table on Women's Issues snapshot project: status of the women in libraries, internationally** [Tavolinë e rumbullakët për çështje të grave: statusi i grave në biblioteka në shkallë ndërkombëtare] / Pat Gannon-Leary, Sandra Parker.

Në: *IFLA Journal*. – Vol. 28, Nr. 1, 2002, f. 17-23.

Është botuar raporti i rezultateve të tavolinës së rumbullakët për statusin e grave në bibliotekat e botës. Studimi është bazuar në një pyetësor të shpërndarë nga IFLA në mbledhjen e Bostonit, 2001. Në të pasqyrohen të dhëna lidhur me kontributin e grave në shoqëri në epokën e informacionit si dhe respekti ndaj tyre dhe ndaj profesionit në përgjithësi. Vërehet në këtë studim gjithashtu se burrat arrijnë pozicione më të larta pune në një kohë më të shkurtër. Analizohen dhe çështje të kualifikimit e të trajnimit.

#### Kessler, Jack

**Les Bibliothèques françaises en ligne: une vue de l'extérieur** [ Bibliotekat në rrjet në Francë: vështrim nga jashtë] / Jack Kessler

Në: *BBF*, No 5, 2002, 10-32.

Franca është bërë një shembull për të gjithë botën lidhur me përdorimin e Internet-it, të informacionit digjital dhe të transferimit të informacionit në mënyra gjithnjë e më të reja e efikase dhe në gjuhë të ndryshme. Ashtu si dhe në vende të tjera, bibliotekat kanë qenë ndër institucionet pararojë në këtë proces. Përkrahjen arrijtjet e dhjetë viteve të fundit

dhe drejtimet kryesore për të ardhmen.

**Liber quarterly: The journal of European research libraries.** – Vol. 1 (1991)–. – Munich: Sauer, 1991-

ISSN 1435-5205

Vol. 12 (2002), No 4.

Konferenca vjetore e LIBER-it (Bashkimi i Bibliotekave Shkencore Europiane) e zhvilluar në Kopenhagen në maj 2002, pati si tematikë menaxhimin e sigurimit të bibliotekave. Drejtues të 20 bibliotekave shkencore europiane dhe nga SHBA diskutuan rreth incidenteve të ndodhura lidhur me vjedhjen e materialeve në biblioteka si në ndërtesa të vjetra ashtu dhe në ndërtesa të kohëve të fundit. Në këtë numër të revistës janë botuar disa nga kumtesat e konferencës në formë të përmbledhur, duke hequr atë informacion që mund të kompromentojë sistemet e sigurimit. Në këto materiale tregohet se si incidentet e së shkuarës kanë bërë të ndryshojnë politikat dhe strategjitë e bibliotekave si dhe mendimet e punonjësve për sigurimin e materialeve nga vjedhja. Është përvoja e vendeve pjesëmarrëse lidhur me sistemet dhe strategjitë e përdorura për sigurimin e materialeve. Në përfundim të konferencës u hartua një paketë rekomandimesh të quajtura “Parimet e Kopenhagenit për një rrjet të ri sigurimi”, të cilat janë botuar gjithashtu në këtë numër të revistës në rubrikën “Dokumente”.

#### Öhrström, Bo

**Denmark's electronic research library: a single virtual research library for Denmark** [Biblioteka kërkimore elektronike e Danimarkës: një bibliotekë e vetme virtuale për Danimarkën] / Bo Öhrström

Në: *LIBER Quarterly* – Vol. 12, Nr. 2/3, 2002, f. 156-174.

Biblioteka kërkimore elektronike e Danimarkës është realizim i vizionit të një

biblioteke të vetme virtuale, për të plotësuar kërkesat për akses në informacion të studiuesve dhe të nxënësve e studentëve. Projekti pesëvjeçar i ministrive në Danimarkë (Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Shkencës dhe Ministrisë së Arsimit) synon kalimin nga biblioteka të veçanta të automatizuara me bashkëpunim individual, në një strukturë të një biblioteke të madhe elektronike që realizon shërbime të integruara elektronike. Drejtimet e projektit ishin: infrastruktura kombëtare, infrastruktura bibliotekare, burimet digjitale dhe mjetet për përdoruesit. Artikulli vë në dukje domsdoshmërinë e bashkëpunimit në ecurinë e projektit. Shërbimet e dy kategorive të përdoruesve: bibliotekat dhe lexuesit, na njeh me arkitekturën e sistemit dhe rezultatet e deritanishme të projektit.

**Polish libraries today: the National Library tradition and contemporaneity** [*Bibliotekat polake sot: tradita dhe e sotmja e Bibliotekës Kombëtare*]. – Vol. 5 —. – Warszawa: Biblioteka Narodowa, 2001. ISSN 0867-6976

Revista është një botim i Bibliotekës Kombëtare Polake që nuk ka periodicitet të caktuar. Ky numër i kushtohet historikut të kësaj biblioteke dhe gjendjes së saj në fillim të shekullit të ri.

*Theksohen tri detyrat bazë të bibliotekës:*

- 1) funksionet e saj si bibliotekë kombëtare;
- 2) roli i bibliotekës kombëtare si biblioteka më e madhe publike;
- 3) biblioteka kombëtare si qendër kulturore (që organizon takime, ekspozita, konferenca për probleme të librit) dhe ent botues.

Në artikuj të veçantë pasqyrohen veprimtaritë e bibliotekës, koleksionet e saj,

bibliografia, studimet dhe shërbimet ndaj lexuesve në sektorë të veçantë. Jepet gjithashtu një përmbledhje e ndryshimeve të fundit në ligjin polak për bibliotekat dhe ndikimet e këtyre ndryshimeve në shërbimet e bibliotekës. Botimi mbyllet me recensione të një sërë botimesh të bibliotekës të dala vitet e fundit.

*Roncaglia, Gino*

**Libri elektronik: problemi e perspektive** [*Libri elektronik: probleme dhe pespektiva*] / Gino Rocaglia.

Në: *Bullettino AIB : rivista italiana di biblioteconomia e scienze dell'informazione*. – No 4, 2001, f. 409-442.

Jepen mendime për konceptin e librit elektronik dhe përkufizimet e ndryshme lidhur me të. Ai konsiderohet si objekt digjital me ndërfaqen e leximit dhe pajisjet për lexim. Libri elektronik mund të përcaktohet si tekst elektronik i gjatë, i plotë që përbën një njësi, i koduar dhe përdoret me një pajisje hardware dhe software që mundëson leximin me lehtësi.

Konsideratat e përgjithshme për konceptin e librit elektronik pasohen nga një vështrim mbi situatën aktuale të tij, pajisjet e leximit dhe veçanërisht formatet kryesore. Pjesa e fundit e shkrimit i kushtohet raportit të bibliotekës me librin elektronik që nga lindja dhe përhapja e tij sot. Një ndër problemet që shtrohet është ruajtja e librit elektronik, duke pasur parasysh jo vetëm tekstin, por dhe pajisjet e dekodimit dhe të leximit. Jepen mendime për kriteret e katalogimit, mundësinë e përdorimit të tekstit dhe hardet e softet e nevojshëm që duhet të ketë biblioteka për konsultimin e tij.

**Safeguarding the World digital heritage** [*Ruajtja e trashëgimisë digjitale botërore*]. Në: *IFLA Journal*. – Vol. 28, Nr. 1, 2002, f. 48-49.

Konferenca e përgjithëshme e 31-të e UNESCO-s hartoi një rezolutë për ruajtjen dhe



aksesimin e vazhdueshëm të trashëgimisë digjitale në të gjithë botën, e cila botohet në këtë numër të revistës. Gjithashtu programi i UNESCO-s për periudhën 2002-2003 pasqyron angazhimin e saj në identifikimin, mbrojtjen, ruajtjen dhe transmetimin në gjeneratat e ardhshme të trashëgimisë digjitale, veçanërisht nëpërmjet hartimit të një karte për ruajtjen e këtyre materialeve. Kjo veprimtari e UNESCO-s është e lidhur ngushtë me programin e saj *Kujtesa e Botës*, i cili ka synim ruajtjen e trashëgimisë dokumentare botërore.

*Schleihagen, Barbara*

**Intellectual freedom and libraries: German perspectives** [*Liria intelektuale dhe bibliotekat: perspektiva gjermane / Barbara Schleihagen*].

Në: *IFLA Journal*. – Vol.28, Nr. 4, 2002, f. 185-189.

Shkrimi paraqet disa nga rezultatet e takimit të organizuar në Gjermani nga IFLA (FAIFE) për lirinë intelektuale dhe bibliotekat. Ndër të tjera u bë një prezantim historik i censurës në Gjermani dhe i kuadrit ligjor, nismave dhe veprimtarive të IFLA/FAIFE dhe projektit të FAIFE për aksesimin e informacionit nëpërmjet INTERNET-it. U diskutua gjithashtu për aspektet politike, fetare, etike dhe morale, si edhe qëndrimet ndaj lirisë intelektuale dhe censurës në biblioteka.

*Seidelin, Susanne*

**Intellectual freedom and libraries: international perspective** [*Liria intelektuale dhe bibliotekat: perspektiva ndërkombëtare /*

*Susanne Seidelin*].

Në: *IFLA Journal*. – Vol.28, Nr. 4, 2002, f. 181-184.

Në takimin e organizuar në Berlin me temë *Liria intelektuale dhe bibliotekat: perspektiva ndërkombëtare*, u prezantua puna e programit të IFLAs Liria e Aksesit në Informacion dhe Liria e Shprehjes (FAIFE) dhe prioritetet në vitet e ardhshme. Një nga detyrat e FAIFE është mbledhja e informacionit për gjendjen e lirisë së aksesit në informacion në shtirje globale. Paraqitet gjithashtu bashkëpunimi i ngushtë me IFLA-n për politikat e zhvillimit të programit, për Manifestin e INTERNET-it dhe nisma të tjera.

*Wilhite, Jeffrey M.*

**DANIDA and the World Stage** [*DANIDA dhe platforma botërore / Jeffrey M. Wilhite*].

Në: *IFLA Journal*. – Vol. 28, Nr. 1, 2002, f. 24-27.

Angazhimi i posaçëm i IFLA-s me bibliotekat e vendeve në zhvillim ka filluar vite më parë. Janë ndërmarrë disa nisma për të ndihmuar bibliotekat dhe bibliotekarët e këtyre vendeve. Një nga format e ndihmës janë dhe grantet e ofruara nga Agjencia Ndërkombëtare Daneze e Zhvillimit (DANIDA) e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Danimarkës. Kjo agjenci ofron shpenzime udhëtimi për dyqind bibliotekarë të vendeve në zhvillim për të marrë pjesë në konferencat vjetore të IFLA-s. DANIDA ka deklaruar se do të vazhdojë të japë mbështetje deri në vitin 2004 për të ndjekur këtë veprimtari të rëndësishme të IFLA-s.

(F.Xhaja)

# Website

Shërbimet bibliotekare informuese për zhvillimin social dhe ekonomik

Një nga realizimet e projektit PULMAN ka qenë edhe hartimi i disa udhëzuesve digjitalë për zhvillimin e bibliotekave publike evropiane, të cilët nuk janë gjë tjetër veçse 20 paketa profesionale të shkruara nga specialistë prej më të mirëve të teorisë dhe praktikës bibliotekare. Në fund të çdo udhëzuesi hartuesit e kanë parë me vend të rëndisur lidhje (links) me site të projekteve dhe nismave të suksesshme për problematikën e trajtuar në të. Udhëzuesit dhe lidhjet përkatëse gjenden në website-n e PULMAN-it me URL <http://www.pulmanweb.org>

## LIDHJE

### Europë

#### *Trashëgimi e hapur*

Një projekt shkencor financiar nga FFP (janar 2001-dhjetor 2002) me synimin e krijimit të një infrastrukture dhe shërbimi të TI-së për të përmirësuar aksesin në informacionin e koleksioneve të muzeve dhe galerive rajonale. Koleksionet e muzeve më të vegjël do të jenë kështu po aq tërheqës dhe të shfrytëzueshëm sa ato të muzeve më të mëdhenj dhe më të njohur. Kjo ekonomi "e shtyrë nga kultura" mund të japë një kontribut domethënës në zhvillimin ekonomik lokal duke mundësuar pasurimin e kapaciteteve turistike dhe kulturore.

<http://www.openheritage.com/>

#### REGNET

I lidhur me *Trashëgiminë e hapur*, ky synon të krijojë një rrjet funksional të qendrave kulturore në krejt Europën, i cili do të sigurojë shërbime të TI-së për organizatat kulturore dhe ato të trashëgimisë. Është i rëndësishëm në forcimin e kooperimit rajonal.

<http://www.regnet.org/>

#### TRIS Projekti i testimit të trashëgimisë kulturore

Këto projekte nxitin implementimin e produkteve dhe shërbimeve novatore në sektorin e trashëgimisë kulturore.

<http://www.trisweb.org/tris/trisportalpro/home/default.asp>

### Republika Çeke

*Biblioteka Shtetërore Teknike*

siguron akses në informacioni e biznesit dhe atë teknik si edhe shërbime digjitale.

### Danimarkë

#### *Bibliotekat e bashkisë Aarhus*

kanë ngritur një shërbim që përfshin shërbimin "Pyet një bibliotekar" dhe mjaft lidhje informacioni.

Një shërbim tjetër me përgjigje administruar nga këto biblioteka është i lidhur me ePort për bizneset e vogla dhe të mesme në atë rajon. Këto biznese mund të paraqesin përmes formularëve pyetje që kanë të bëjnë me biznesin.

<http://www.eport.dk/eport/ekspert/index.htm>

#### *Rrjeti i autorëve*

Një shërbim në Aarhus që paraqet për publikun autorë bashkëkohorë të letërsisë daneze. Bashkëpunojnë 47 biblioteka. Mëse 400 autorë janë paraqitur me CV, bibliografi, adresa e-mail, fragmente nga një vepër, ndonjëherë me lexim në skedar me zë. Ky shërbim tani po shndërrohet në portalin e parë të letërsisë daneze duke bashkuar nisma të ndryshme nga institucione letrare dhe biblioteka (gjithashtu Bookweb) nën kujdesin e bibliotekave publike në Aarhus.

<http://www.forfatternet.dk/>

#### *Biblioteksvagten*

"Pyet një bibliotekar" është një shërbim referativ tradicional, në të cilin ju mund të bëni një pyetje dhe të merrni një përgjigje si një e-mail së paku brenda 24 orësh. Ka gjithashtu një pajisje për chat

ku ju mund të diskutoni problemin tuaj me një bibliotekar. Shërbimi bazohet në bashkëveprim në rrjet midis 18 bibliotekave publike daneze më të mëdha. Shërbimi është pa pagesë.  
<http://www.biblioteksvagten.dk/>

#### *BizGate*

Një hyrje në internet që përmban lidhje cilësore mbi tematikën të tilla si ekonomia e biznesit, strategjia dhe menaxhimi, organizatat dhe HRM, statistikën, gjuhën e biznesit, ligjin e biznesit, kompanitë dhe financat, një projekt të përbashkët të 4

bibliotekave shkencore daneze: Shkolla e Biznesit - Kopenhagë, Shkolla e Biznesit Aarhus, Statistikat Daneze dhe Biblioteka Universitare e Danimarkës Jugore.

#### **Estoni**

Mjaft biblioteka ofrojnë tani koleksionet dhe shërbimet e tyre përmes Internetit.

<http://www.nlib.ee/inglise/lib/lib.html>

#### **Finlandë**

*Pyet një bibliotekar*

Mundësi kërkese e përbashkët në rrjet.

<http://www.libraries.fi/fi/asklibrarian/default.asp>

#### *Informacion në pikat e karburantit*

Kabina lëvizëse si qendra informacioni që shkojnë atje ku ka njerëz: në vende publike, p.sh. stacione treni ose qendra tregëtare, panaire ose blloqe shërbimi. Klientëve të web-it u jipet shërbim informacioni përmes e-mail-it ose mesazheve tekst. Në të ardhmen gjithashtu me teknikën e chat-it. Informacioni gjendet përmes web-it <http://igs.kirjasto.fi/>

#### **Francë**

*Biblioteka publike Montpelje*

Siguron vizita virtuale në bibliotekë.

<http://www.ville-montpellier.fr/vmtm/modele/index.php?idrub=331&>

#### **Germany**

*Biblioteka publike e Këlnit*

Një shembull i shkëlqyer për sigurimin e informacionit të biznesit nga ana e bibliotekave

publike është biblioteka publike e Këlnit, e cila për rreth 10 vjet ka siguruar një shërbim të plotë informacioni për SME-të dhe persona privatë. Mund të ketë pagesë për disa shërbime.

#### *Biblioteka publike Shuttgart*

ka një site interesant informacioni "Beruf – Karriere – Wirtschaft"

<http://www.s.shuttle.de/buecher/ci/>

#### **Greqi**

*Biblioteka publike qendrore Veria*

Biblioteka e parë publike në Greqi me një web server dhe web site (1996), përbën një shembull sesi burime të kufizuara mund të përdoren për të ofruar shërbime elektronike për publikun e përgjithshëm dhe grupe të veçanta. Biblioteka ka marrë pjesë në projekte të ndryshme europiane dhe ka ngritur shërbime speciale. Rëndësi e veçantë i është kushtuar faqeve web për organizatat vullnetare dhe biznesin e vogël, p.sh. punishteve të verës. Për publikun e gjerë janë organizuar kurse trajnimi për njohjen me TI-në.

<http://www.libver.gr/>

#### **Irlandë**

**SWAP (Projekti i veprimit në juglindje)**

bibliotekat në Bantry dhe Clonakilty kanë një shërbim informacioni biznesi të quajtur SWAP që u shërben zonave rurale dhe ofron një varg informacionesh për ato që janë të interesuar për biznes.

<http://www.corkcoco.com/ccmms/services/library/>

#### **Maqedoni**

*Qendra e kompjuterave, shkencës, kërkimit dhe informacionit*

Në bibliotekën publike dhe universitare "St. Kliment Ohridski" në Bitolja, sponsorizuar nga USAID, është një qendër rajonale për të gjithë përdoruesit e Maqedonisë juglindore ku ata mund të kenë akses në rrjet në bazat e të dhënave bibliografike të mjaft bibliotekave të botës.

<http://www.mubbt.edu.mk>

#### **AGRO**

Projekt rajonal me programin e vet për ndërtimin e bazës së të dhënave të literaturës bujqësore.

<http://www.culture.in.mk/>  
<http://www.nubsk.edu.mk/>  
<http://www.realitymacedonia.org.mk/>

### Moldavi

*Qendra e informacionit ekonomik në bibliotekën bashkiake "B.P.Hasdeu"*

ofron informacion dhe dokumentacion në fushën e biznesit. Është e hapur për gjithë personat e interesuar: studentë të ekonomisë, sipërmarrës të rinj, kompani të vogla etj.

<http://www.hasdeu.md/>

*Biblioteka publike e ligjeve*, degë e bibliotekës bashkiake "B.P. Hasdeu". por financuar nga Moldova-Soros Foundation dhe COLPI, e përqendron veprimtarinë e saj në zhvillimet e informacionit ligjor.

### SIBIMOL

Një projekt i nisur nga Biblioteka Kombëtare dhe i mbështetur nga qeveria për krijimin e një skedari të përbashkët kombëtar dhe ngritjen e një baze të dhënash për të gjitha bibliotekat e Moldavisë. Synimi kryesor i programit është të krijojë një rrjet të vetëm informacioni të bibliotekave dhe t'i integrojë ato në sistemin kombëtar dhe global të informacionit përmes sistemeve të informacionit të hapura.

### Hollandë

**ADIC (Current Information and Documentation Centre)**

Një shërbim informacioni për biznesin (dhe qeverinë) i institucionalizuar si një nismë e bibliotekës publike në Apeldoorn, pjesë e së cilës është ende.

*bibliotheek.nl*  
biblioteka virtuale e Hollandës.  
<http://www.bibliotheek.nl>

### Zelandë e Re

*Bibliotekat e qytetit Auckland*  
ofron burime të gjera interneti: <http://www.akcity.govt.nz/library/bussites.html>

*Bibliotekat e qytetit Wellington*  
*Kutia e Mjeteve të Biznesit*

Projekuar për t'u siguruar njerëzve të biznesit në Wellington akses të lehtë në një numër website-sh të vlefshëm që nga informacioni i qytetit deri në bursat ndërkombëtare, përfshirë informacionin për tregëtinë elektronike, ligjet dhe kompanitë.

<http://www.wcl.govt.nz/popular/businessstoolbox.html>

### Poloni

*Baza e të dhënave e informacionit lokal (LID = BIL – Baza Informacjii Lokalnej)*

*Një shërbim interneti. Siguron akses të lehtë në informacionin mbi provincën.*

<http://www.bil-wm.pl/index.html>

**Rrjeti i qendrave të informacionit ligjor dhe tregtar në Pomerania.**

Përfshin informacion ligjor. Një staf tepër i kualifikuar (bibliotekarë, ekonomistë dhe juristë) u jep përdoruesve materiale në formë tradicionale dhe elektronike nga fusha të ekonomisë (bankat, biznesi, financat, këmbimi i monedhave, kontratat, paratë. Bashkimi Europian etj.) dhe nga fusha të legjislacionit civil, tregtar dhe penal.

### Spanjë

*Bibliografia salmantina*

Bibliografi mbi subjekte lokale përfshirë në website-in FGSR të bibliotekës bashkiake në Penarada de Bracamonte. Përmbledh të gjitha llojet e informacionit në cilindo format ose bartës: shtypshkrimë, audiovizuale, elektronike dhe digjitale.

<http://www.fundacionsr.org/bsalmanina.htm>

*Diputacion de Barcelona Library Departament*

Ky departament qendror paguan paratë e abonimit në botime elektronike (baza të dhënash për buletine zyrtare qeveritare, lajme, arsim, mjekësi dhe legjislacion) për bibliotekat e rrjetit të tij për të siguruar informacion për biznesin vendas.

<http://www.diba.cs/biblioteques/inici.asp>

*"Finestra ciutadana" (FIC), biblioteka publike në Tarragona*

Sistem informacioni komunitar për çështje lokale në ekonomi, institucione, turizëm, administratë etj.

dhe bazë të dhënash të shtypit lokal. Ka edhe informacion për autorë vendas dhe një galeri figurash lokale me të dhëna bibliografike, tekste dhe biografi.  
<http://www.biblio.fut.es/castella/sil.html>

#### *Shërbimet FAQ*

Një seri pyetjesh dhe përgjigjesh mbi subjekte të interesit të përgjithshëm për përdoruesit.  
<http://www.gipuzkoa.fut.es/castella/sil.html>

#### **Mbretëria e Bashkuar**

##### **A2A Akses në Arkiva**

Si pjesë e rrjetit kombëtar të arkivave, A2A siguron përshkrime skedarësh të një vargu të gjerë arkivash në mbarë Anglinë në bazën e vet të të dhënave në website-in kryesor A2A në duke e bërë këtë trashëgimi dokumentare më lehtësisht të përdorueshme prej kujtdo. Arkivi i mbuluar nga A2A është i një rëndësie kombëtare, rajonale dhe lokale dhe daton që nga vitet 900 deri sot.

<http://www.pro.gov.uk/archives/A2A/abouta2a.htm>

##### **Pyet një bibliotekar**

*Bibliotekë referative elektronike, shërbim i përbashkët kombëtar i shpërndarë në mbi 60 autoritete bibliotekash.*

<http://www.ask-a-librarian.org.uk/>

#### **BEASTS**

*Një projekt që synon të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të industrisë së turizmit përmes sigurimit të faktit që bizneset e vogla dhe të mesme në zonat rurale të shpërdorojnë potencialin e marketingut elektronik të burimeve kulturore kombëtare. Përdoruesit e përfshirë janë fermerë dhe njerëz të tjerë në industrinë bujqësore, që kanë nevojë të zgjerojnë veprimtari të tyre dhe për të cilët rezultatet e këtij projekti mund të jenë një mjet i ri jetese përmes turizmit dhe industrisë së argëtimit.*

<http://inf2.pira.co.uk/factsheets/inform/digicult/beasts.html>

**Shërbime të informacionit të biznesit në bibliotekat publike (UK)**

Bibliotekat publike të Mbretërisë së Bashkuar prej shumë vitesh sigurojnë shërbime të lira informacioni

për komunitetin e biznesit. Shembujt e praktikës pozitive përfshijnë shërbime të tilla si ato të Essex-it, Westminsterit dhe bibliotekën City Business. Shërbimet e biznesit të bibliotekave të Essex-it organizojnë kurse trajnimi për njerëzit e biznesit të fokusuar në burimet e biznesit që gjenden në Internet.

Essex

Westminster

Stoke

[services/i\\_business.htm](http://services/i_business.htm)

City Business Library. Cooperation of London – përfshin një shërbim të shërbimit me pagesë: [Business Information Focus](http://www.cityoflondon.gov.uk/leisure_heritage/libraries_archives_museums_galleries/city_london_libraries/cbl.htm)  
[http://www.cityoflondon.gov.uk/leisure\\_heritage/libraries\\_archives\\_museums\\_galleries/city\\_london\\_libraries/cbl.htm](http://www.cityoflondon.gov.uk/leisure_heritage/libraries_archives_museums_galleries/city_london_libraries/cbl.htm)

*British Library*

Shërbimi i informacionit të biznesit  
Përmban një prej koleksioneve më të plota të informacionit të biznesit në UK

<http://www.bl.uk/services/information/business.html>

Shërbimi i patentave

#### **BROADNET**

Një shërbim interneti për rajonin West Midlands të Mbretërisë së Bashkuar me synim komunitetin e biznesit. Ai siguron një radhë shërbimesh nga Universiteti Worlverhampton përmes materialeve trajnimi në rrjet në informacion të nivelit lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

*Shërbimi i Informacionit të Biznesit*

Përmban një prej koleksioneve më të plota të informacionit të biznesit në Mbretërinë e Bashkuar.

*Hatrics*

Një grup bibliotekash dhe kompanish që sigurojnë informacion biznesi në Anglinë Jugore.

*Shërbimi i Biznesit të Vogël*

Një agjenci brenda Departamentit të Tregtisë dhe Industrisë në mbrojtje të interesave të biznesit të vogël nëpërmjet kryerjes dhe administrimit të shërbimeve që mbështesin biznesin, duke përkrahur sipërmarrjet veçanërisht në grupet e papërfaqësuar si duhet dhe të diskriminuar dhe duke minimizuar barrën e rregullave,

*Businesslink*

Një shërbim këshillimi për biznesin, i administruar nga Shërbimi i Biznesit të Vogël.

*Co East*

Një konsorcium i 10 autoriteteve të bibliotekave publike që operon në rajonin e Anglisë Lindore me synimin që t'ua mundësojë anëtarëve të publikut sigurimin lehtësisht të burimeve nga bibliotekat e rajonit përmes kompjuterit në biblioteka ose përmes Internetit.

<http://www.co-east.net/>

*Chain – rrjeti i aksesit në informacionin e trashëgimisë në Cornwall*

Një website ombrellë për muzetë dhe galeritë në Cornwall, mbështetjen dhe mundësimin e aksesit në rrjet të koleksioneve të muzeve anëtarë.

<http://www.chain.org.uk/>

*Bibliotekat e Essex-it*

Përgjigje direkt-shërbim përmes telefonit ose email-it.

<http://www.essexcc.gov.uk/libraries/askaquestion/answersdirect.htm>

*Essex Online: portal komunitar për Essex-in*

Përfaqëson një partneritet të organizatave lokale, rajonale dhe kombëtare për të siguruar shërbime informacioni për publikun.

<http://www.seamless.org.uk/essexonline/>

*FAMILIA*

Burime të historisë së familjeve në bibliotekat publike në Angli dhe Irlandë.

<http://www.familia.org.uk/main.html>

*Bibliotekat në Gateshead*

Kërkuesi mund të bisedojë me një bibliotekar përmes linjës chat. Gjithashtu të përdorë teknologjinë e bashkëshfletimit për të "shtrirë" faqet web në kompjuterin e kërkuesit.

<http://www.gateshead.gov.uk/libraries/index.htm>

*Hatrics*

Një grup bibliotekash dhe kompanish që sigurojnë informacion biznesi në Anglinë jugore.

<http://www.hatrics.org.uk/>

*UK online për Biznesin*

E krijuar për të siguruar një burim të gjerë për kompanitë e Mbretërisë së

Bashkuar me qëllim që përmes informacionit dhe teknologjive të komunikacionit të përmirësojnë konkurrencën e tyre.

**SHBA***Shoqata e Bibliotekave Speciale, divizioni i biznesit dhe financës*

Një web site i përgjithshëm bibliotekash dhe shërbimesh biznesi në SHBA.

*Biblioteka publike Queensborough, Nju Jork*

Siguron një "Qendër Informacioni për Punë", e cila administron një koleksion

të specializuar me burime me profesionesh dhe arsimimesh, i cili përmban libra, periodikë, gazeta, broshura, formularë dhe katalogë. Qendra nxjerr Seritë e Burimeve të Kërkimit për Punë, që janë udhëzues on-line për të përzgjedhur mes profesioneve më të njohura.

*Biblioteka publike e Nju Jorkut*

Shërbimet e bibliotekës së shkencës, industrisë dhe biznesit përfshijnë kurse të lira trajnimi për publikun.

<http://www.nypl.org/research/silb/>

*Biblioteka e Kongresit*

siguron shërbimin "Pyet një bibliotekar" me akses në një rrjet global.

<http://www.questionpoint.org/>

Fjalor shpjegues nga  
fusha e bibliotekonomisë

(vijon nga numri i kaluar)

## Analizë e subjektit [*Subject analysis*]

Pjesë e procesit të katalogimit ose indeksimit, që ka të bëjë me përcaktimin e përmbajtjes intelektuale të njësisë dhe përshtatjen e saj me një sistem klasifikimi, me një sistem të emërtimeve lëndore ose sistem indeksimi që përdoret nga kataloguesi ose klasifikatori. Për përmbajtjen dhe formën e veprës caktohet një simbol në bazë të sistemit të klasifikimit që përdoret (p.sh. KDU, KDD etj.) dhe emërtimet lëndore sipas një fjalori të kontrolluar të termave (listë e emërtimeve lëndore e miratuar ose thesar).

*Art original*

## Atlas [*Atlas*]

Koleksion me harta të lidhura ose në kuti që zakonisht kanë të bëjnë me një subjekt të caktuar, i pajisur me indeks të emrave të vendeve. Në shumicën e atleve hartat janë shtypur në të njëjtën mënyrë dhe shkallë. Atlasi mund të botohet i pavarur ose si material shoqëruar me ose pa tekst përshkrues.

## Autor vetjak [*Personal author*]

Person që është përgjegjës kryesor për krijimin intelektual ose artistik të një vepre, emri i plotë i të cilit vendoset në përshkrimin bibliografik në të dhënat për përgjegjësinë. Ky mund të jetë autor, artist, hartograf ose interpretues.

## Bashkautor [*Joint author*]

Person që bashkëpunon me një ose më shumë persona të tjerë për prodhimin e një vepre dhe të gjithë kanë kryer funksion të njëjtë. Kontributet e secilit bashkëpunëtor mund të mos jenë treguar si të veçanta. Në katalogim, në kryetitullin e përshkrimit bazë vendoset autori që është renditur i pari në burimin kryesor të informacionit dhe bëhen përshkrime shtesë (ose në sistemet e kompiuterizuar përcaktohen elemente kërkimi shtesë) për autorët e tjerë. Është sinonim me bashkëautor (coauthor).

## Bashkim [*Cooperative*]

Grup bibliotekarësh që kanë krijuar një shërbim të përbashkët, nga i cili përfitojnë të gjithë anëtarët.

## Baud [*Baud*]

Njësi për matjen e shpejtësisë së transmetimit të të dhënave midis dy kompiuterave. Numri i sinjaleve të transmetuar për sekondë.

## Bazë të dhënash relacionale [*Relational database*]

Bazë të dhënash në të cilën regjistrimet janë strukturuar në mënyrë që informacioni nuk ruhet i gjithë në të njëjtin skedar. Krijohen skedarë për lloje të ndryshme informacioni (p.sh. skedar bibliografik, skedar i emrave vetiakë, skedar i emrave të organizimave, skedar i subjekteve, skedar i klasifikimeve etj.). Regjistrimet e skedarit bibliografik kanë referime (tregues) për të regjistrimet e skedarëve të tjerë dhe anasjelltas. Struktura e një baze të dhënash relacionale ruan hapësirë depozitimi, lejon kërkim më të shpejtë dhe modifikim të të dhënave. Referimet vendosin lidhjet midis regjistrimeve.

## Botim përkujtitor [*Festschrift*]

Koleksion prej dy a më shumë esesh, fjalimësh, punimesh biografike, bibliografike etj., botuar për nder të një personi, institucioni, shoqate, zakonisht me rastë përvjetorësh. Subjekti ose tema e punimeve të përmbledhura lidhet me fushën në të cilën është dalluar personi ose organizata. Bashkëpunëtorët shpesh janë miq, kolegë ose ish-studentë të personit që nderohet.

## Burim referimi [*Reference source*]

Çdo botim nga i cili sigurohet informacion i besueshëm, serioz. Të tilla janë veprat referuese, katalogët, indekset dhe abstaraktet si dhe materiale të tjera.

## Burime [*Resources*]

Materiale informuese që gjenden në bibliotekë dhe janë në shërbim të përdoruesve. Këto mund të jenë libra, periodikë, broshura, raporte, dorëshkrime, mikroforma, filma, materiale audio e video, CD-ROM etj. Çdo objekti fizik që bart informacion mund të përfshihet në koleksionet bibliotekare.

## Byte [*Byte*]

Përfaqëson një shkronjë të vetme, numër ose simbol të përpunuar nga kompiuteri. Një byte përbëhet



nga 8 bit-e. P.sh. 01000001 përfaqëson "A". Numri i byte-ve përdoret zakonisht si masë e madhësisë së një skedari ose e kujtesës së kompiuterit (në kilobyte, megabyte ose gigabyte).

#### **Cilësor** [*Qualifier*]

Term (në kllapa) i vendosur pas një emërtimi lëndor për të dalluar ose sqaruar kuptimin e emërtimit që shoqëron. P.sh. Paris (Francë); Të ftohtit (Sëmundje).

#### **Çelës funksion** [*Function key*]

Çelësat "F1 – F 12" nga e majta në të djathtë në rreshtin e parë të tastierës standarde të kompiuterit. të cilët janë programuar për kryerjen e funksioneve të caktuara në një program të kompiuterit.

#### **Disk** [*Disc*]

Mjedis për ruajtjen e të dhënave. Disqet me të dhëna kompiuterike janë të tipeve të ndryshëm: disketa, disqe kompaktë audio dhe video, CD-ROM etj.

#### **Disk optik** [*Optical disc*]

Mjedis për ruajtjen e të dhënave me kapacitet të lartë që konsiston në një disk me veshje speciale, në sipërfaqen e të cilit kodohen të dhënat, të cilat shkruhen dhe lexohen me anë të përdorimit të një burimi rrezesh lazer. Disqe të tilla janë kompakt-disqet, CD-ROM dhe DVD.

#### **Disketë** [*Discette*]

Disk magnetik fleksibël i mbuluar me një xhakët mbrojtëse dhe që përdoret për ruajtjen e të dhënave kompiuterike. Quhet dhe *Floppy disc*.

#### **Ditarë** [*Diaries*]

Shënime ose regjistrime të përvojës personale, vëzhgime, mendime, ndjenja të mbajtura nga një person qdo ditë ose herë pas here, jo me mendimin që do të botohen. Ndonjëherë ditaret janë botuar pas vdekjes dhe disa prej tyre janë bërë vepra historike dhe letrare shumë të njohura si p.sh. Ditari i Ana Frankut.

#### **Dosje, Skedar** [*File*]

Koleksion dokumentesh që zakonisht kanë lidhje mes tyre, të ruajtur së bashku dhe të renditur sipas një radhe sistematike. Në kompiuter është

koleksion me elementë të dhënash të strukturuar si një njësi e vetme ose koleksion regjistrimesh që kanë lidhje mes tyre nga burimi ose qëllimi, të ruajtura në një mjedis magnetik (disketë, hard disk etj. nën një emër që i është dhënë për t'u referuar ose për ta përdorur më pas. Çdo kompiuter që përdorim i ruan të dhënat që ne krijojmë në skedarë.

#### **Emërtim gjeografik** [*Geographic heading*]

Emërtim në formë emri të përveçëm që tregon vend ose njësi të lidhur ngushtë me një vend (p.sh. emër parku, pylli, tuneli etj.). Përdoret nga kataloguesi për të përcaktuar formën unike të emrit gjeografik si element kërkimi.

#### **Emërtim i ndërsjelltë** [*Inverted heading*]

Emërtim lëndor në formë frazë ku fjalët renditen në mënyrë që fjala më domethënëse të jetë në pozicionin fillestar. (P.sh. Bimët, ndikimi i dritës).

#### **Emërtim model** [*Pattern heading*]

Emërtim lëndor nënndarjet e të cilit shërbejnë si model për ndarje të emërtimeve lëndore të të njëjtës kategori. Nënndarjet e renditura nën një emërtim lëndor model në një listë të emërtimeve lëndore mund të përdoren si ndarje dhe të emërtimeve të tjera të të njëjtës kategori. (P.sh. Nënndarjet e emërtimeve lëndor *Gjuha angleze* përdoren si ndarje për të gjitha gjuhët e tjera.)

#### **Emërtim uniform** [*Uniform heading*]

Emërtim i veçantë sipas të cilit pasqyrohet në katalog një subjekt ose person, i cili gjendet me emra të ndryshëm ose në forma të ndryshme të emrit në burimet e informacionit.

#### **Emërtim unik** [*Unique heading*]

Emërtim që përfaqëson vetëm një person, organizëm ose subjekt. Kur subjekte të ndryshëm kanë emër të njëjtë, emërtimi shoqërohet me cilësor për të qënë unik. P.sh. *Unazat (Algjebër)*: *Unazat (Gjinnastikë)*.

#### **Faqe e titullit** [*Title page*]

Faqe në fillim të një dorëshkrimi, libri ose materiali tjetër të shtypur, që përmban titullin e veprës dhe zakonisht emrin e autorit, të redaktorit, të përkthyesit dhe informacion për botuesin, vendin dhe vitin e botimit. Faqja e pasme e fletës së titullit

zakonisht ka të dhëna për të drejtën e autorit, për botimin, shtypin, për katalogimin në botim. ISBN etj.

## Faqe paraprake [*Preliminaries*]

Faqet e shtypura të librit përpara tekstit. Përfshihet faqja ose faqet e titullit të një njësie, së bashku me pjesën e pasme të tyre, faqe që paraprijnë faqen e titullit, kapaku dhe shpina.

## Faqe titulli shtesë [*Added title page*]

Faqe titulli që paraprin ose pason faqen e titullit të zgjedhur nga kataloguesi si burim kryesor informacioni për përshkrimin bibliografik të njësisë. Ajo mund të ketë të dhëna më të përgjithshme (p.sh. faqja e titullit e serisë) ose të barabarta (p.sh. faqe titulli në gjuhë tjetër).

## Film [*Motion picture*]

Shiriti filmi, me ose pa zë të regjistruar në të. që mban imazhe të cilat krijojnë iluzionin e lëvizjes kur projektohen me shpejtësi njëra pas tjetrës.

## Fletë (libri) e ilustruar [*Plate*]

Material ilustrues në një libër ose botim tjetër, zakonisht e shtypur në fletë letre me cilësi tjetër nga ajo e tekstit, me faqen e pasme të bardhë. (P.sh. fletët e ilustruara që janë të panumërtuara.) Fletët e ilustruara mund të jenë vendosur të shpërndara në tekst ose të grupuara së bashku. Nuk janë pjesë përbërëse të numrit të faqeve ose e fletëve në vazhdim të librit. Mund të kenë numërtim të veçantë. Në regjistrimin bibliografik të njësisë këto faqe vendosen pas sasisë së faqeve të librit.

## Format [*Format*]

- 1) E dhënë e përgjithshme e madhësisë së librit, bazuar në numrin e palosjeve për lidhje të fletëve të shtypura (palosje dyshe, katërshë, tetëshë, dymbëdhjetëshë, gjashtëmbëdhjetëshë etj.).
- 2) Parapitja fizike e një njësie bibliografike. Për materialet e shtypura formati përfshin përmasat, cilësinë e letrës, ilustrimet, stilin e lidhjes etj.
- 3) Në përpunimin e të dhënave, mënyra e vendosjes së të dhënave në mjedisin e futjes së tyre, të daljes apo të ruajtjes, përfshirë kodin si edhe instruksionet që përcaktojnë vendosjen. Për përgatitjen e një diskete për regjistrimin e të dhënave ajo formatohet

paraprakisht. Formatim quajmë edhe procesin e rregullimit të një teksti në ekranin e kompiuterit, në formën që duam të shtypet në letër (madhësia e gërmave, stili, largësia e rreshtave etj.).

## Futje [*Input*]

Informacion i hedhur në sistemin kompiuterik për t'u përpunuar. Pajisjet më të zakonshme që përdoren për hedhjen e informacionit në kompiuter janë tastiera dhe skaneri.

## Gigabyte [*Gigabyte*] (GB)

Njësi e ruajtjes në kompiuter, afërsisht e barabartë me një bilion byte. Kapaciteti i hard-diskut matet me gigabyte.

## Glob [*Globe*]

Paraqitje e sipërfaqes së tokës ose e trupave të tjerë qiellorë në një sipërfaqe të një objekti sferik. Globet mund të jenë me letër të fortë, karton, material plastik, metal, xham, të montuar në një aks dhe të vendosur në një mbështetëse që i jep mundësi globit të rrotullohet.

## Gopher [*Gopher*]

Sistem që punon mbi bazën e menuve për kërkim në Internet. Përpara zhvillimit të World Wide Web-it, skedarët dhe burimet e Internetit kërkoheshin me anë të sistemit të menuve hierarkike të instaluara në një server Gopher (emri Gopher është venë nga prodhuesit e këtij programi). Edhe pse tani janë zhvilluar shfletues grafikë të Web-it, serverat Gopher kanë dy përparësi: ato listojnë burimet e Internet-it të të gjithë tipeve (jo vetëm Web site-t) dhe i paraqesin burimet në hierarki logjike të direktorive të krijuara nga njeriu. Adresat në Gopher fillojnë me gopher://.

## Gjuhë natyrore [*Natural language*]

Gjuhë njerëzore në të cilën struktura dhe rregullat janë zhvilluar gjatë përdorimit të një periudhë të gjatë kohe, në kundërshtim me gjuhën artificiale të bazuar në rregulla të përcaktuara paraprakisht për zhvillimin dhe përdorimin e saj, si p.sh. gjuha e kompiuterit. Gjuha e përdorur nga një person kur shpreh një koncept rreth të cilit ai kërkon informacion dhe e bën pyetjen në kompiuter në atë formë që ai e flet ose e shkruan kërkesën.

**Gjuhë ndërmjetëse** [*Switching language*]

Gjuhë që përdoret për ekuiivalentimin e gjuhëve të ndryshme të indeksimit lëndor ose të skemave të klasifikimit. Klasifikimi mund të quhet si gjuhë lidhëse midis shumë gjuhëve. Simbolet e një sistemi klasifikimi (KDD, KDU) nuk i përkasin një gjuhe të veçantë, megjithatë ato mund të kuptohen në çdo gjuhë.

**Ilustrim me ngjyra** [*Coloured illustration*]

Ilustrim me dy c më shumë ngjyra, përveç ngjyrave të bardhë dhe të zezë.

**Import** [*Importing*]

Leximi ose marrja e regjistrimeve nga një sistem tjetër kompiuterik dhe hedhja në katalogun e bibliotekës për ta azhurnuar atë. Në këtë proces mund të kërkohej që të dhënat të konvertohen në një format të përshtatshëm me sistemin.

**Indeksim i parabashkënduar** [*Precoordinate indexing*]

Përcaktimi i subjekteve në regjistrime në atë mënyrë që disa koncepte, nënkoncepte, cmra vendesh, periudha kohore dhe koncepte forme vendosen së bashku në vargun e tjalëve që përcaktojnë subjektin e përbërë, për të lehtësuar kërkimin e informacionit. Ky indeksim realizohet me përdorimin e listave të emërtimeve lëndore që përmbajnë subjekte kryesorë dhe nëndarje të tyre. (P. sh. për subjektin *Bibliotekat dhe të verbërit në Shqipëri*, përdoret emërtimi *Bibliotekat dhe të verbërit – Shqipëri* në vend të *Bibliotekat + Të verbërit + Shqipëri*).

**Indeksim i pasbashkënduar** [*Postcoordinate indexing*]

Mënyrë indeksimi në të cilën emërtimet lëndore ose termat që shprehin subjekte të dokumenteve, tregojnë koncepte të thjeshta dhe për të gjetur informacionin e kërkuar për një subjekt të përbërë, duhet bërë koordinim i termave nëpërmjet teknikave të tilla si ajo Booleane. (P.sh. për të kërkuar informacion për subjektin *Bibliografi e adnotuar* duhet të përdoren termat *Bibliografi + Adnotim*.)

**Informacion i nxjerrë** [*Output*]

1) Rezultati përfundimtar i përpunimit nga kompiuteri. Mund të dërgohet nga kompiuteri në

një pajisje periferike për ruajtje ose shfaqje (p.sh. ekran, printer).

2) Prodhim. Sasia totale e punës së kryer nga një person, grup, organizëm, makinë etj., gjatë një periudhe të caktuar kohe (orë, ditë, javë, muaj etj.), p.sh. njësitë e kataloguara nga sektori i katalogimit në një periudhë të caktuar kohe.

**Informacion plotësues i titullit** [*Other title information*]

Titull i një njësie, përveç titullit kryesor, titullit paralel dhe titullit të seriës, si dhe çdo frazë që ka lidhje me titullin kryesor dhe që tregon karakterin, përmbajtjen etj., të njësisë ose dhe motivet e prodhimit ose të botimit të saj. Termi përfshin nëntitujt, por jo variante të titullit kryesor si titulli i shpinës, titulli i kapakut etj.

**Katalog lëndor** [*Subject catalog*]

Katalog që përbëhet nga përshkrime ku elemente hyrëse janë emërtimi me që shprehin subjekt. Në këtë katalog janë elemente kërkimi vetëm termat që shprehin subjekt.

**Katalog në rrjet** [*Online catalog*]

Katalog bibliotekar që përmban koleksion të regjistrimeve bibliografike në format të lexueshëm nga kompiuteri, që mirëmbahet në një kompiuter të dedikuar, i cili ofron mundësi përdorimi të pandërprerë nëpërmjet terminaleve dhe kompiuterave që janë të lidhur dhe komunikojnë me kompiuterin qendror. Regjistrimet ruhen në kujtesën e kompiuterit ose në CD-ROM dhe janë të përdorshme në mënyrë ndërvepruese.

**Katalog përmbledhës** [*Union catalog*]

Katalog i cili pasqyron materialet e më shumë se një biblioteke ose të më shumë se një koleksioni bibliotekar. Çdo regjistrim përmban dhe emrin e bibliotekës ku gjendet njësia. Renditja e përshkrimeve në katalog është zakonisht alfabetike sipas autorit ose titullit.

**Kërkim në rrjet** [*Online searching*]

Proces i kërkimit në baza të dhënash të kompiuterave në distancë, të lidhur me anë të rrjeteve të telekomunikimit.

## **Kilobyte (Kb) [Kilobyte (Kb)]**

Njësi e matjes së informacionit të ruajtur në kompiuter, e barabartë me 1.024 byte (zakonisht merret 1.000 byte). Skedarët me tekst dhe me imazhe zakonisht maten me kilobyte.

## **Klasifikim Dhjetor Universal (KDU) [Universal Decimal Classification (UDC)]**

Sistem klasifikimi i zhvilluar në vitin 1885 nga belgët Paul Otlet dhe Henri Lafontaine si sistem i organizimit të paketave të informacionit. Bazohet në sistemin dhjetor të Djuitt, por ka zhvilluar më tej klasifikimin sipas veçorive nëpërmjet përdorimit të përcaktuesve. Si simbole përdor numrat arabë dhe shenjat matematike. Sot ky sistem vlerësohet për faktin se i lejon klasifikatorit të shprehë të gjitha aspektet e një subjekti me anë të një simboli klasifikimi.

## **Kod i vijëzuar [Barcode]**

Të dhëna alfanumerike ose numerike të koduara në një seri vijash vertikale, të cilat kanë gjërësi të ndryshme për të shprehur karaktere të ndryshëm. Këta mund të lexohen nga kompiuteri duke përdorur pajisje leximi të barkodeve (pajisje skanimi). Përdoren për identifikimin e librave dhe të materialeve të tjera gjatë procesit të inventarizimit dhe për të lidhur kartelën e huazuesit me materialin e huazuar në sistemet e automatizuar të qarkullimit.

## **Kokë e TEI [TEI Header]**

Grup të dhënash elektronike në fillim të një dokumenti TEI, që përshkruan dokumentin, përmbajtjen dhe origjinën e tij. Motivimi për krijimin e një standardi për kokën e TEI është sigurimi i një burimi informacioni për katalogim.

## **Komandë [Command]**

Instruksion i dhënë me anë të tastierës ose nga programi, që e drejton kompiuterin të kryejë një punë të caktuar.

## **Kontroll i fjalorit [Vocabulary control]**

Procesi i krijimit dhe i kontrollit të fjalorit të termave të njësuar. Përcaktimi dhe zgjedhja e termit të vetëm për të shprehur një koncept ose emër dhe lidhja e sinonimeve me termin e preferuar.

## **Kontrolli Bibliografik Universal dhe MARC Ndërkombëtar (UBCIM) [Universal Biblio-**

## **graphic Control and International MARC (UBCIM)]**

Program i IFLA-s për koordinimin e veprimtarive të zhvillimit të sistemeve dhe standardeve për kontrollin bibliografik në nivel kombëtar dhe shkëmbimin ndërkombëtar të të dhënave bibliografike si dhe nxitjen e zhvillimit të formatit UNIMARC. Programi synon nxitjen e shkëmbimit dhe të përdorimit të regjistrimeve bibliografike midis bibliotekave dhe veçanërisht midis agjencive bibliografike kombëtare, nëpërmjet standardizimit të përshkrimit bibliografik dhe zgjedhjes së formës së njësuar të pikave hyrëse në regjistrimet bibliografike.

## **Konvertim retrospektiv [Retrospective conversion]**

Procesi i kthimit të informacionit nga regjistrime të lexueshme me sy, në formë të lexueshme nga makina (kompiuteri). Procesi lidhet kryesisht me kthimin e katalogëve me skeda (skedarë) në katalogë të kompiuterizuar, por mund të jetë edhe riformatim i të dhënave nga një sistem kompiuterik në një tjetër.

## **Kopje rezervë [Backup]**

Kopjim i skedarëve të kompiuterit nga disku i rëndë ose disketa në një disk tjetër, shirit ose mjedis tjetër, për të siguruar një kopje tjetër në rast se dëmtohet origjinali.

## **Kreu i gazetës [Masthead]**

Të dhëna për titullin, pronësinë, redaktorët etj. të një gazete ose periodiku. Te gazetata zakonisht gjendet në faqen e editorialit ose në krye të faqes së parë, kurse te periodikët gjendet në faqen e përmbajtjes.

## **Kufizues regjistrimi [Record terminator]**

Simbol që përdoret për të treguar mbarimin e një regjistrimi në formatin MARC.

## **Kujtesë [Memory]**

Hapësira e mundshme për mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave në kompiuter. Ka *kujtesë të jashtme (external memory)*, që është hapësira e ruajtjes së qëndrueshme në diskun e rëndë dhe në disketë, dhe *kujtesë kryesore (main memory ose RAM)*, e cila ruan të dhëna vetëm gjatë një seksioni pune, ndaj

skedarët duhet të ruhen përpara përfundimit të një seksioni.

### **Kursor** [*Cursor*]

Shënjesë i lëvizshëm, zakonisht në formën e një vije vertikale, nënvizimi ose simboli tjetër, që merr një pozicion në ekranin e kompjuterit nëpërmjet tastjerës, mausit ose të ndonjë pajisjeje tjetër kontrolli, për të treguar kur duhet të futet, të zhvendoset apo të fshihet një karakter ose cili variant i menisë është zgjedhur. Në Windows dhe në ndërfaqe të tjera me përdorues grafik, kursori ndryshon formën kur lëviz nga një dritare apo kuti dialogimi në një tjetër, duke u kthyer në formën e shkronjës I për redaktim teksti, në shigjetë ose gisht për të zgjedhur një variant të menisë, në formën e orës me rrëzë kur një veprim është në proces ose si laps i vogël në programet grafike.

### **Lëvizje me anë të menuve** [*Menu-driven*]

Mënyrë e dhënies së komandave për një zbatim në kompjuter, me anë të zgjedhjes së tyre nga lista që i paraqitet përdoruesit. Ndërfaqe e kompjuterit që ofron lista hierarkike të zgjedhjeve të mundshme, nga të cilat përdoruesi zgjedh atë që është e përshtatshme për të komanduar kompjuterin të kryejë veprimin e dëshiruar. Zgjedhja e komandave me anë të menuve është më e lehtë për fillestarët, por më e ngadaltë.

### **Lista e Sears-it e Emërtimeve Lëndore** [*Sears List of Subject Headings*]

Listë emërtimelesh lëndore e hartuar nga Minnie Earl Sears për klasifikimin lëndor të materialeve në bibliotekat e vogla publike. Pas botimit të parë në vitin 1923 lista është ribotuar shumë herë me shtesa e ndryshime dhe vazhdon të ribotohet për t'u përdorur në bibliotekat e vogla. Duke vlerësuar nevojën e uniformitetit, sot Lista e Sears-it ndjek strukturën e emërtimeve të listës së Bibliotekës së Kongresit, ndonëse është shumë më e vogël.

### **Listë e emërtimeve lëndore** [*Subject heading list*]

Listë termash dhe frazash të vendosura, të një ljalori të kontrolluar, së bashku me referime, shënime dhe ndënarje që lidhen me çdo term ose frazë. Lista shërben për katalogimin lëndor të paketave të informacionit.

### **Material grafik** [*Graphic*]

Material dydimensional opak (p.sh. vepër arti origjinale ose riprodhim, fotografi, vizatim teknik, pllakat) ose që mund të shihet me anë të një pajisjeje optike (shiriti filmi, transparente etj.).

### **Material muzikor (shtyp me format të madh)** [*Music (large print)*]

Term që përdoret në përshkrimin bibliografik për të treguar veçori të përgjithshme të materialit për materialet muzikore të shtypur, të cilat përdoren për persona me aftësi të kufizuara të të parit.

### **Material shoqërues** [*Accompanying material*]

Material që del së bashku me njësinë që katalogohet dhe përdoret bashkë me të.

### **Materiale jolibra** [*Nonbook materials*]

Emërtim që përdoret për çdo njësi bartëse informacioni që nuk është tekst në formë libri. Përfshihen harta, materiale grafike, fotografi, transparente, shirita filmi, filma, regjistrime zanore dhe të tingullit, materiale të përzier, modele etj.

### **Megabyte (Mb)** [*Megabyte (Mb)*]

Njësi e matjes së informacionit të ruajtur në kompjuter, e barabartë me 1.048.576 byte (zakonisht merret 1 milion byte) ose 1.024 kilobyte.

### **Menaxhim** [*Housekeeping*]

Metodë e organizimit të punës në bibliotekë dhe e mirëmbajtjes sipas rregullave të sistemeve tradicionale dhe të automatizuara. Në sistemet e kompjuterizuara bibliotekare ka të bëjë me programet që kryejnë katalogimin, qarkullimin, porositë, kontrollin i ardhjes së numrave të veçantë të serialeve, identifikimin e numrave që mungojnë etj.

### **Mjete kërkimi** [*Retrieval tools*]

Mekanizma të tillë si skedarë, bibliografi, indekse, motorë kërkimi etj., të krijuar për t'u përdorur në sistemet e kërkimit të informacionit.

### **Model** [*Model*]

Paraqitje tredimensionale, zakonisht në një shkallë të zvogluar, e pamjes fizike të një sendi real të çdo madhësie. Është veçanërisht i dobishëm për paraqitjen e objekteve shumë të mëdha (p.sh. sistemi diellor).

## Modul [Module]

Njësi e një pakete software-i, siç është p.sh. moduli i katalogimit, moduli i pasurimit etj., në një sistem të menaxhimit bibliotekar.

## Monografi [Monograph]

Njësi e plotë bibliografike ose paketë informacioni për një subjekt të vetëm dhe e shkruar zakonisht nga një specialist i fushës. Zakonisht përbëhet nga një pjesë e vetme, por mund të jenë dhe më shumë se një, të botuara në numër të caktuar dhe ndryshe nga serialet, nuk kanë vazhdimësi të pacaktuar.

## Motor kërkimi [Search engine]

Mjet kërkimi në World Wide Web që krahason fjalët kyçe të futura nga përdoruesi që kërkon informacion, me fjalët që gjenden në site-t e Web-it. (P.sh. Yahoo është një motor kërkimi.) Motorët e kërkimit të sofistikuar kanë dhe mundësi të tjera kërkimi përveç kërkimit me fjalë kyçe.

## Ndërtim i numrit (të klasifikimit) [Number building]

Procesi i krijimit të një numri klasifikimi sa më specifik, me anë të shtimit të simboleve të marra nga tabelat ndihmëse të përcaktuesve ose nga pjesë të tjera të tabelës së klasifikimit. Në KDU ose KDD klasifikatori duhet të ndërtojë numrin e klasifikimit edhe kur subjekti nuk përfaqësohet me saktësi nga një numër në skemën kryesore. Ai i shton numrit bazë simbole të gjetura në tabelat ndihmëse (të përcaktuesve) ose një numër tjetër nga skema kryesore, sipas rregullave përkatëse.

## Nëndarje [Subdivision]

Mjet për zgjerimin e një emërtimi lëndor duke treguar një nga aspektet e tij – formën, vendin, periudhën kohore, subjektin. Lidhur me aspektin ato specifikohen në *Nëndarje forme*, *Nëndarje gjeografike*, *Nëndarje kronologjike*, *Nëndarje lëndore*. Nëndarjet i shtohen emërimit kryesor duke u paraprirë me vijë (p.sh. Bibliotekat – Historia).

## Nëndarje lëndore [Topical subdivision]

Nëndarje që tregon aspekt të subjektit kryesor, por jo formë, vend dhe periudhë kohore.

## Nëndarje standarde [Standard subdivision]

Në klasifikimin dhjetor nëndarje që paraqet një

formë fizike që përsëritet vazhdimisht (fjalorë, periodikë etj.) ose mënyrë trajtimi (histori, studim etj.). të zbatueshme në çdo subjekt ose disiplinë.

## Nënfushë [Subfield]

Njësi brenda një fushe të regjistrimit në formatin MARC për të regjistruar si të veçantë çdo element të përshkrimit bibliografik. Çdo nënfushë paraprihet nga Kufizuesi (shenja \$) dhe kodi i nënfushës. Çë zakonisht është shkronjë e vogël e alfabetit latin. P.sh. në fushën e përshkrimit fizik nr. i faqeve paraprihet me \$a, detaje të tjera fizike me \$c dhe dimensionet me \$d.

## Nëndarje lëndore [Subject subdivision]

Terma dhe fjalët që shprehin subjekt dhe pasojë emërtimin lëndor kryesor, për të treguar veçori specifike të një subjekti. (P.sh. *Binëti – Sëmundjet*)

## Nënseri [Subseries]

Seri brenda një serie. P.sh. një seri që gjithmonë shfaqet e lidhur me një seri tjetër dhe formon një seksion të saj. Titulli i nënserisë mund të varet ose jo nga titulli i serisë kryesore.

## Numërtim faqesh [Pagination]

Sistem numrash ose shkronjash që përdoret për treguar vazhdimësinë e faqeve në një dokument të shkruar ose të shtypur. Numri i faqeve përbën një nga elementet e zonës së përshkrimit fizik të njësisë bibliotekare.

## Njësi e shfaqjes pamore (VDU) [Visual Display Unit VDU]

Ekran në të cilin shfaqet informacioni. Njihet edhe si monitor.

## Njësi e sistemit [System unit]

Pjesa kryesore e një sistemi kompiuterik. Ajo përmban njësinë qendrore (CPU), kujtesën, diskun e rëndë, fole disketash dhe vende për lidhje me pajisjet periferike.

## Njësi me shumë pjesë [Multipart item]

Monografi e plotë, e përbërë nga një numër i caktuar pjesësh të veçanta.

## Njësi multimedia [Multimedia item]

Njësi e përbërë nga dy ose më shumë kategori

materialesh ku asnjëra prej tyre nuk identifikohet si predominuese e njësisë. Quhet edhe Kit.

**OCLC (Qendra Bibliotekare Kompiuterike në Rrjet)** [*OCLC (Online Computer Library Center)*] Qendra e shërbimit bibliografik më e madhe dhe më e plotë në botë. Është krijuar në vitin 1971 në SHBA dhe sot ka qelgë në disa vende të botës. Katalogu në rrjet i OCLC ka rreth 50 milion regjistrime. Bibliotekat anëtare shkëmbejnë regjistrime (huazojnë prej tij ose fusin regjistrime të reja), e përdorin katalogun për informacion dhe për huazim ndërbibliotekar si dhe për shërbime të tjera.

**Organizëm i nënrenduar** [*Subordinate body*] Organizëm që është pjesë përbërëse e një organizmi të madh nga i cili varet dhe në raport me të cilin qëndron në renditje hierarkike më të ulët. (P.sh. *Sektori i Bibliografisë* i Bibliotekës Kombëtare).

**Parimet e Parisit** [*Paris Principles*] Emër konvencional për parimet e miratuara në Konferencën Ndërkombëtare të mbajtur në Paris më 9-18 Tetor 1961. e organizuar nga IFLA për standardizimin ndërkombëtar të rregullave të katalogimit.

**Part (Muzikë)** [*Part (Music)*] Muzika e njërit nga zërat ose instrumentat pjesmarrës në një vepër muzikore. Kopje e shkruar me dorë ose e shtypur e një pjesë të tillë për t'u përdorur nga një ckekutues. Specifikohet në zonën e përshkrimit fizik me fjalën *Part*.

**Pasurim** [*Acquisitions*] Procesi i zgjedhjes, porosisë dhe i marrjes së materialeve për bibliotekën nëpërmjet blerjes, shkëmbimit ose dhuratave. Procesi përfshin dhe mbajtjen e buxhetit për pasurimin si dhe komunikimin me botuesit dhe shitësit për të siguruar burime informacioni që plotësojnë nevojat e përdoruesve me sa më pak shpenzime. Zakonisht përbën një nga modulet e një sistemi të integruar bibliotekar. Termi përdoret edhe për atë sektor të bibliotekës që merret me porositjen dhe marrjen e materialeve të reja si dhe me mbajtjen e regjistrimeve për të gjitha veprimet që lidhen me këto procese.

**Periferik** [*Peripheral*] Pajisje që përdoret e lidhur me kompiuterin dhe që nuk është as e pavaruar dhe as e pashkëputur prej tij. Periferikët e mikrokompiuterit përdoren për futjen e të dhënave (tastiera, mausi, skaneri), për marrje informacioni (printerit, monitori), për ruajtje (disketa, CD-ROM), për komunikim (modem).

**Përpunim i gjuhës natyrore** [*Natural language processing (NLP)*]

Analiza kompiuterike e gjuhës së shkruar dhe të folur për të interpretuar kuptimin, me qëllim që kompiuteri ta "kuptojë" dhe të "përgjigjet".

**Përpunim figurash** [*Image processing*] Trajtim i figurave në sistemet kompiuterike. Ky proces kryhet nga shumë sisteme kompiuterizimi bibliotekare.

**Përshkrim me titull** [*Title entry*] Përshkrim në një mjet kërkimi (katalog) ku regjistrimi gjendet me titullin e paketës së informacionit si element hyrës.

**Përshkrim shtesë për autor-titull** [*Name-title added entry*]

Përshkrim shtesë ku një emër autori individual ose kolektiv dhe titulli i njësisë janë vendosur në kryetitull të përshkrimit për të treguar: 1) një vepër që është përfshirë në veprën që katalogohet; 2) një vepër më të madhe, pjesë e së cilës është vepra që katalogohet; 3) një vepër tjetër, e cila ka lidhje me veprën që katalogohet.

**Përshkrim specifik** [*Specific entry*] Përshkrim i një veprë sipas një kryetitulli që shpreh subjekt të veçantë, në dallim nga një përshkrim që ka si kryetitull një subjekt të gjerë dhe që e përfshin subjektin e veçantë si nënçështje të tij.

**Pikë hyrëse parësore** [*Primary access point*] Pikë hyrëse që është zgjedhur si kryesore; zakonisht i referohet përshkrimit bazë.

**Pjesë** [*Part*] Një nga njësitë përbërëse në të cilat është ndarë një vepër nga autori, botuesi ose prodhuesi. Në rastin e monografive të shtypura pjesa është sinonim me

vëllimin. Dallohet nga fashikulli sepse është pjesë përbërëse dhe jo ndarje e përkohshme e një vepre. 2) Në zonën e përshkrimit fizik pjesa tregon njësi bibliografike që lidhet me disa pjesë të tjera të një vëllimi.

## Program [Software]

Seri instruksionesh të hartuara për një kompiuter për ta drejtuar atë në kryerjen e një detyre të caktuar. Të tillë janë përpunues teksti, tabela llogaritjesh, sisteme të menaxhimit të bazave të të dhënave, programe komunikimi dhe sistemet e operimit. Këta janë të përbërë nga grup programesh dhe shpesh quhen paketa software-i.

## Program aplikimi [Applications software]

Program që i lejon përdoruesit të përpunojë të dhëna ose të kryejë llogaritje të nevojshme për të arritur rezultatin e dëshiruar, ndryshe nga programet e operimit, të cilët kontrollojnë kompiuterin dhe drejtojnë punën e programeve të tjera. Programe më të zakonshme aplikimi janë ato për përpunim teksti, llogaritje, e-mail, sisteme të menaxhimit të bazave të të dhënave etj.

## Programi për Katalogimin e Përbashkët [PCC (Program for Cooperative Cataloging)]

Program bashkëpunimi ndërkombëtar më pjesëmarrjen e Bibliotekës së Kongresit dhe të bibliotekave të tjera nga e gjithë bota, që synon realizimin e një katalogimi bazuar në standardet ndërkombëtare që të jetë sa më i përdorshëm, i realizuar në kohë sa më të shpejtë dhe me kosto efektive.

## Protokoll [Protocol]

Bashkësi rregullash standarde që përcaktojnë komunikimin e kompiuterave me njëri-tjetrin përmes rrjeteve. P.sh. HTTP dhe Z39.50 janë protokolle. Transmetimi i të dhënave nëpërmjet Internet-it qeveriset nga protokollit TCP/IP, i cili mundëson komunikimin e përdoruesve të tipeve të ndryshme të kompiuterave. Protokollit përshkruan formatin që duhet të ketë një mesazh dhe mënyrën sipas të cilës kompiuterat duhet të ndryshojnë mesazhin.

## Protokollit Z39.50 [Z39.50 protocol]

Mjet standard aplikimi, që i lejon një kompiuteri të

bëjë kërkesë në një kompiuter tjetër dhe të transferojë rezultatet, pa qenë nevoja që përdoruesi të njohë komandat e kërimit të kompiuterit që gjendet në distancë.

## Qarkullim [Circulation]

Funksion i menaxhimit bibliotekar që ka të bëjë me kontrollin e marrjes dhe të kthimit të materialeve nga përdoruesit e bibliotekës. Zakonisht përbën një nga modulët në sistemet e integruara bibliotekare. Përdoret edhe për numrin e përgjithshëm të njësive të dhëna hua nga biblioteka gjatë një periudhe të caktuar kohore (në një muaj, një vit etj.). Në bibliotekat publike qarkullimi i ulët është tregues i nevojës për spastrimin e koleksioneve.

## Referim autor-titull [Name-title reference]

Referim nga një emër autori individual ose kolektiv dhe titulli i njësisë për një element tjetër kërkimi.

## Referim nga referimi [Refer from reference]

Shënim të termat e përdorur si emërtime të njësuara, që tregojnë se në emërtime të tjera gjenden referime për të termi në fjalë. Të tilla janë e anasjellta e referimit *Shih* që shprehet me simbolin PP (Përdoret për) ose *x* dhe e referimit *Shih edhe* që shprehet me *xx*. Në formatin MARC për termat e njësuar këto shënime ruhen në fushat 4XX dhe 5XX.

## Referim nga subjekt për tek emër [Subject-to-name reference]

Referim nga një emërtim lëndor që shpreh subjekt për të një emër i përveçëm me qëllim që vëmendja e përdoruesit të drejtohet nga një fushë e veçantë tek emra personash ose organizmash që kanë lidhje me këtë fushë. (P.sh. emërtimi *Lumenjtë* mund të ketë si referim emrat e lumenjve të veçantë ose *Autorët* - emrat e autorëve të veçantë.)

## Referim *Shih* [See reference]

Referim në një katalog, indeks ose vepër referuese që e drejton përdoruesin nga një term ose emër i papërdorur si element kërkimi, të termi i përdorur për emra, vende ose subjekte.

## Referim *Shih edhe* [See also reference]

Referim në një katalog, indeks ose vepër referuese që e drejton përdoruesin nga një emërtim të një



emërtim tjetër më i përgjithshëm ose që ka lidhje me të parin.

### Referim shpjegues [*Explanatory reference*]

Referim *Shih* dhe *Shih edhe* që shpjegon rrethanat në të cilat përdoruesi duhet të drejtohet tek emërtime të caktuara.

### Regjistrim i shpejtë [*On-the fly record*]

Regjistrim që krijohet në mënyrë elektronike për përdorim të shpejtë dhe që ka të dhëna të kufizuara. Në katalogët që kanë atë që quhet "ndërfaqe në Web", regjistrimet MARC konvertohen në regjistrime të shpejta të koduara HTML. Kur përdoruesi bën një kërkim, në ekran shfaqet një listë autorësh, titujsh e datash dhe kur ai zgjedh duke klikuar një numër të listës, në ekran shfaqet regjistrimi i plotë MARC nëpërmjet konvertorit HTML që është shkruar për atë katalog.

### Regjistroj [*Check-in*]

Proces i regjistrimit të njësie të huazuara nga përdoruesit nëpërmjet modulit të qarkullimit si dhe i regjistrimit në kartelë të numrave të seriaveve të ardhur në sistemet tradicionale ose me anë të sistemit të kompiuterizuar menaxhimit të seriaveve.

### Rrjet [*Network*]

1) Dy ose më shumë organizma të angazhuar së bashku në shkëmbimin e informacionit nëpërmjet lidhjeve të komunikimit për objektiva të përbashkët. 2) Lidhje midis dy ose më shumë kompiuterve për përdorim të përbashkët të programeve, të të dhënave dhe të periferikëve. Rrjetet mund të kenë lidhje në distanca të vogla dhe formojnë rrjete me shtrirje lokale (LAN) ose mund të kenë lidhje në distanca të largëta që formojnë rrjete me shtrirje në largësi (WAN).

### Rrjet me shtrirje të gjerë (WAN) [*Wide Area Network (WAN)*]

Grup kompiutervash në distancë të largët (në ndërtesa të ndryshme), të lidhur së bashku me anë të linjave të telekomunikimit për të shkëmbyer programe dhe të dhëna.

### Rrjet me shtrirje botërore (WWW) [*World Wide Web -WWW*]

Sistem jolinear, multimedia, fleksibël që ofron

burime informacioni në Internet dhe akses në këto burime. Bazohet në hypertext dhe HTTP.

### Rrjet me shtrirje lokale (LAN) [*Local area Network (LAN)*]

Lidhje së bashku e një grupi kompiutervash që janë në distancë të afërt (p.sh. brenda një godine ose grup godina sh pranë njera tjetrës) për përdorim të përbashkët të programeve, të të dhënave dhe periferikëve. Rrjetet lokale që komunikojnë nëpërmjet Internet-it përdorin fibra optike si mjedis transmetimi.

### Seri [*Series*]

Grup njësisë të veçanta që lidhen mes tyre nga fakti se çdo njësi, përveç titullit të saj, ka dhe një titull kolektiv që i përket të gjithë grupit si një i tërë. Njësitë e veçanta mund të jenë të numëruara ose jo.

### Serial [*Serial*]

Botim që del në pjesë të njëpasnjëshme, të cilat shënohen me simbole numerikë ose kronologjikë (me periodicitet të rregullt ose jo) dhe që do të vazhdojë me afat të papërcaktuar. Përfshihen periodikët, gazetat, vjetarët, revistat dhe scrîtë monografike të numëruara.

### Sinonim [*Synonym*]

Term me kuptim të njëjtë me një term tjetër. Shpesh në fjalorët e termave të kontrolluar (lista të emërtimeve lëndore, tezaurë) përdoren për terma që kanë kuptim të njëjtë dhe për terma që kanë kuptim të përfaqësues.

### Sintezë [*Synthesis*]

Procesi i kompozimit të një numri klasifikimi ose të një emërtimi lëndor me anë të kombinimit të elementëve të ndryshëm, për të shprehur një subjekt të përbërë ose kompleks. (P.sh. sinteza midis nëndarjeve të 591 – Zoologjia e përgjithshme me ato të 592/599 – Zoologjia sistematike. 597-11 Fiziologjia e peshqve, ku 597 – Peshqit dhe 591.1 – Fiziologjia e kafshëve.)

### Sistem shfrytëzimi [*Operating system*]

Software që menaxhon veprimet bazë të kompiuterit dhe shkëmbimin e të dhënave midis njësisë qendrore të përpunimit dhe çdo pajisjeje periferike, pa qenë nevoja të kryhen veprime nga

përdoruesi. Duke qenë i gatshëm sapo kompiuteri hapet, sistemi i shfrytëzimit kontrollon ecurinë e të gjitha programeve të tjera, përfshirë edhe sisteme siguri mi që shmangin përdorime të paautorizuara. Sisteme shfrytëzimi më të zakonshme janë MS-DOS, Windows, Macintosh, UNIX.

## Sistemoj (në raft) [*Shelving*]

Procesi i vendosjes së materialeve ose paketave fizike të informacionit në raftet, duke i renditur sipas numrave të tyre të vendit ose simboleve të tjera që tregojnë pozicionin e tyre.

## Skedar i termave të njësuar për emra [*Name authority file*]

Kolksion i regjistrimeve të termave të njësuar për emra veuakë, emra organizmash dhe emra gjeografikë të përdorur si elemente kërkimi në katalogët e bibliotekës. Mund të citohet edhe burimi i përdorur për formën e vendosur të emrit.

## Skedar i termave të njësuar për subjekte [*Subject authority file*]

Regjistrim i zgjedhjeve të bëra në hartimin e një fjalori të kontrolluar termash që shprehin subjekt. Skedari i termave të njësuar përmban edhe shënime për zgjedhjen e një sinonimi ndaj të tjerëve, referime nga forma që nuk përdoret për tek formë e përdorur, referime për termat më të gjerë, termat më të ngushtë dhe termat që kanë lidhje mes tyre, shënime sqaruese etj.

## Skedar topografik [*Shelflist*]

Listë e materialeve sipas vendosjes në raft. Fillimisht është quajtur kështu lista e materialeve bibliotekare ose paketave fizike të informacionit që gjenden në një bibliotekë, të renditura ashtu siç janë vendosur në raftet e bibliotekës të cilës i përkasin. Me kalimin e kohës kuptimi ka evoluar duke kaluar nga lista, në një skedar ku skedat janë renditur po në atë radhë që janë vendosur dhe librat në raftet. Skedari topografik shërben për verifikimin e fondeve të bibliotekës.

## Soft aplikimi-bazë të dhënash (Klient-server) [*Client-server*]

Arkitekturë e rrjeteve me shtrirje të gjerë (WAN) dhe e atyre lokale (LAN) që i mundëson një kompiuterit klient (zakonisht PC) të marrë dhe të

kopjojë informacion nga baza e të dhënave (serveri) dhe të dy pjesët komunikojnë nëpërmjet rrjetit duke përdorur një protokoll komunikimi. Madhësia dhe shpejtësia e kompiuterit që shërben si server varet nga natyra zbatimeve dhe shkalla e përdorimit.

## Subjekt [*Subject*]

Tema ose lënda e trajtuar nga autori në një vepër, e shprehur ose jo në titullin e saj. Në katalogim për çdo njësi përcaktohen një ose më shumë emërtime lëndore për të shprehur subjektin dhe shërbejnë si pika hyrëse në ndihmë të përdoruesve për të gjetur informacion për subjekte të caktuara.

## Shënim [*Scope note*]

Formulim që përkulizon kuptimin dhe lidhjet e një emërtimi lëndor, të njëjti termi të indeksit ose të një simboli klasifikimi.

## Shënim analitik [*Analytical note*]

Shpjegim në një përshkrim analitik që tregon lidhjen e veprës ose të një pjese të veprës me një vepër më tërësore në të cilën ajo bën pjesë. P.sh. titulli i një antologjie që përmban një tregim, dramë, ese ose poemë.

## Shenjë [*Tracing*]

Emra, tituj, subjekte të përcaktuara si pika hyrëse të vendosura në fund të një përshkrimi dhe që përdoren për të "shënuar" përshkrimet shesë që duhen kopjuar, përveç përshkrimit bazë.

## Shenjë e veprës [*Work mark*]

Shenjë në numrin e vendit të veprës, që i shtohet numrit të autorit dhe zakonisht është shkronja e parë e titullit të veprës, por jo nyje. Përdoret kur janë disa vepra të të njëjtit autor dhe që i përkasin të njëjtës degë të shkencës, me qëllim që ato të renditen alfabetikisht.

## Shërbime teknike [*Technical services*]

Tërësia e veprimtarive në një bibliotekë që përfshin pasurimin, sistemimin, mirëmbajtjen, katalogimin e koleksioneve dhe automatizimin e këtyre proceseve.

## TCP/IP [*TCP/IP*]

Protokolle të përdorur nga kompiuterat në Internet. TCP (Transmission Control Protocol—Protokoll i

kontrollit të transmetimit) kontrollon komunikimin midis proceseve. IP (Internet Protocol) kontrollon komunikimin midis kompiutereve.

**Të dhëna për përgjegjësinë** [*Statement of responsibility*]

Pjesë e përshkrimit bibliografik që ka të bëjë me personat përgjegjës për krijimin e përmbajtjes intelektuale ose artistike të njësisë. p.sh. autori, redaktori ose hartuesi në një vepër të shkruar ose kompozitori i një veprë muzikore. Në shumicën e rasteve gjendet në burimin kryesor të informacionit (fleta e titullit) ose në njësinë në tërësi.

**Të dhëna të lexueshme nga makina** [*Machine-readable data*]

Të dhëna që janë në format që mund të lexohen nga kompiuteri pa pasur nevojë për konvertim. p.sh. regjistrimet bibliografike në formatin MARC. Të dhënat ruhen në skedarë të vendosur në disk ose shirit magnetik.

**TEI (Nismë e kodimit të tekstit)** [*TEI (Text Encoding Initiative)*]

Mënyrë kodimi e krijuar për të kapërcyer vështirësitë e skemave me disa kodime të ndryshme që janë përdorur për kodimin e teksteve të librave të vjetër, letrarë dhe shkollorë. Nëpërmjet TEI dokumentet e koduar më parë mund të shkëmbehen me lehtësi. TEI mundëson përpunimin e tekstit nga programe të ndryshme dhe makina të ndryshme. Teksti mund të paraqitet me saktësi ashtu siç është në formën e tij origjinale të shtypur (në rastin e një teksti të koduar nga libri).

**Term i lidhur (me term tjetër)** [*Related term (RT)*]

Term në të njëjtin nivel specifikimi ose që ka raporte johierarkike me një term tjetër të një liste. në të cilën termat që shprehin subjekt janë konceptuar në marrëdhënie hierarkike. Në listat e emërtimeve lëndore përcaktohet me inicialet LT (Lidhet me termin) ose LS (Lidhet me subjektin).

**Term më i ngushtë** [*Narrower term (NT)*]

Term një nivel më poshtë nga termi i marë në konsideratë në një listë termash lëndore të renditur në marrëdhënie hirarkike. Një emërtim lëndor mund të ketë më shumë se një termë më të ngushtë që

lidhen me të. (p.sh. Biologjia ka disa terma më të ngushtë në një listë emërtimelesh lëndore hierarkike si Biologjia e detit, Biologjia humane, Biomekanika, Gjenetika etj.)

**Terminal** [*Terminal*]

Pajisje që mundëson futjen e informacionit, kërkimin dhe daljen. Vetë terminalet nuk kanë kujtesë ose kapacitet përpunimi. Një kompiuter i vogël mund të shërbejë si terminal për një kompiuter të fuqishëm.

**Thesar** [*Thesaurus*]

Listë termash të kontrolluara, që përfaqësojnë koncepte të veçanta, të shoqëruara me referime, shënime për përdorimin dhe lidhjet midis termave me kuptim më të gjerë dhe më të ngushtë. Përdoret për kërkim më efektiv në një bazë të dhënash.

**Titull** [*Title*]

Fjalë, frazë, karakter, grup karakteresh të vendosur në një njësi dhe që i japin emrin asaj ose vepërës që përmbahet në të.

**Titull alternativ** [*Alternative title*]

Pjesa e dytë e një titulli kryesor të përbërë nga dy pjesë, ku secila prej tyre është një titull më vete. Pjesët lidhen me fjalën *ose* ose me ekuivalentin e saj në gjuhë tjetër. (P.sh. Doktor Fisher i Gjenevës ose Gostia e bombës; Female Quixote, or, the Adventures of Arabella).

**Titull i kreut** [*Caption title*]

Titull i dhënë në fillim të faqes së parë të tekstit të një veprë ose në fillim të kapitujve apo të pjesëve të një libri. Në mungesë të fletës së titullit, ai përdoret si titull për krijimin e përshkrimit bibliografik. Kataloguesi bën shënimin "titulli i kreut" në zonën e shënimeve të përshkrimit bibliografik për të treguar burimin e titullit.

**Titull i saktë** [*Title proper*]

Emri kryesor i një njësie, duke përfshirë çdo titull alternativ dhe duke përjashtuar titujt paralelë dhe informacion plotësues për titullin. Zakonisht gjendet në burimin kryesor të informacionit (fleta e titullit) dhe është clemet i zonës së parë të përshkrimit bibliografik (fusha 200 në UNIMARC).

## Titull paralel [*Parallel title*]

Titulli kryesor në gjuhë ose shkrim tjetër nga origjinali. Element përshkrimi që regjistrohet në zonën e titullit dhe të përgjegjësisë së veprës. i ndarë nga titulli kryesor me hapësirë, shenjën e barazimit, hapsirë (=).

## Transferim skedari [*File transfer*]

Dërgim ose hedhje e skedarëve nga një kompiuter në një tjetër. Protokolli i transferimit të skedarëve (FTP – File Transfer Protocol) përcakton transferimin e skedarëve në Internet.

## Transferim, hedhje në kompiuter [*Download*]

Kopjimi i një ose më shumë skedarëve ose regjistrimeve nga një kompiuter në distancë, nga një server i rrjetit në një kompiuter klient ose nga hard-disku i një kompiuteri në një mjedis tjetër ruajtjeje. Regjistrimet e katalogut të kompiuterizuar shpesh para se të importohen në sistemin bibliotekar, transferohen nga një burim. Hedhja e të dhënave bibliografike në disketë është mundësi me kosto më të ulët se sa printimi i materialit të kërkuar në rrjet.

## UNIMARC (Universal MARC) [*UNIMARC (UNiversal MARC)*]

Version i formatit MARC për katalogimin bibliografik të njësisë. UNIMARC është botuar në vitin 1977 dhe zhvillohet vazhdimisht nga programi UBCIM (Universal Bibliographic Control International MARC) i IFLA-s. Është format i shkëmbimit ndërkombëtar të regjistrimeve bibliografike midis agjencive kombëtare të katalogimit.

## UNIX [*UNIX*]

Sistem shfrytëzimi i kompiuterit i zhvilluar në vitin 1969. UNIX mbështet shumë përdorues dhe shumë detyra. Sistemi është zhvilluar duke kaluar në shumë versione. Punon në platforma të ndryshme hardware-sh.

## USMARC [*USMARC (United States MARC)*]

Sistem i kodimit të të dhënave të regjistrimit bibliografik. USMARC është format MARC që përdoret në SHBA.

## Vendosje relative [*Relative location*]

Sistemim i materialeve bibliotekare në vartësi të raporteve që ata kanë mes tyre. Mënyrë e vendosjes së materialeve në vende të ndryshme kur ato rivendosen në rafta. Ndryshimi i vendit është në vartësi të hyrjeve të reja, të spastrimit, të huazimit dhe kthimit nga përdoruesit. Një vendosje e tillë është ajo sipas klasifikimit. Quhet dhe vendosje sistematike dhe përdoret kryesisht për fondet e hapura.

## Vepër arti e riprodhuar [*Art reproduction*]

Kopje e riprodhuar në mënyrë mekanike e një veprë arti, në përgjithësi si botim tregtar.

## Vepër arti origjinale [*Art original*]

Vepër e krijuar nga një artist, dy ose tredimensionale, që dallon nga riprodhimi i kësaj veprë sepse është origjinale dhe jo e fotografuar ose e shtypur (p.sh. pikturë, vizatim, skulpturë, por jo riprodhim i një pikturë, vizatimi ose skulpturë që mund të riprodhohet në shumë kopje).

## Vijimësi [*Continuation*]

1) Libër ose vepër tjetër e papërfunduar e vazhduar nga një shkrimtar tjetër, zakonisht pas vdekjes së autorit të origjinalit. 2) Vepër e botuar si shtojcë e një botimi të mëparshëm ose pjesë që del në vazhdim të një monografie, të një seriali ose serie.

## Z39 [Z39]

Seksioni i standardeve i ANSI/NISO kushtuar bibliotekave, shkencës së informacionit dhe botimit.

## Z39.50 [Z39.50]

Standard për shkëmbimin e informacionit (si p.sh. regjistrimet bibliografike ose tekst i plotë) midis sistemeve kompiuterike.

## Zonë e përshkrimit fizik [*Physical description area*]

Zonë e përshkrimit bibliografik, në të cilën vendosen të dhënat e përshkrimit fizik të veprës. (P.sh. për librin në këtë zonë jepet sasia e vëllimeve, numri i faqeve, ilustrimet, dimensionet dhe materiale shoqërues.)

**Zonë ndërveprimi [Interface]**

1) a) Pikë në të cilën përfundon një sistem kompiuterik dhe fillon një tjetër. (b) Mjet që lejon shkëmbimin e informacionit midis sistemeve ose ndërmjet pjesëve të të njëjtit sistem. 2) Ndërfaqe.

Pikë ose proces që bashkon dy komponentë të sistemit të përpunimit të të dhënave, p.sh. shfaqja në ekran që shërben si ndërmjetës midis një programi dhe përdoruesit.

(F.XHAJA)

(vijon në numrin e ardhshëm)

# Dictionnaire encyclopédique du Livre

**Nouveau**

Éditions du Cercle de la Librairie

aire  
aire  
aire  
aire  
aire  
aire  
aire  
aire  
aire  
aire

0-Z EN 1-D

A-D







# BIBLIOTHECAE

BIBLIOTEKONOMI PROJEKTE TE REJA DOKUMENTE LEXIME TË REKOMANDUARA HISTORI E LIBRIT DHE E SHYTYPIT